
Zani i Naltë

Themeluar më 1923 - Viti VI (XX) - Nr. 21 (174) ISSN: 2305-655X

SHKËNCË ISLAME | SOCIOLOGJ | PSIKOLOGJ | LETËRSI | HISTORI | MORAL | LITERATURË KOMBËTARE



NUMRI
ISSUE

21

2017

Botues:
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI VI (XX) 2017, NR. 21 (174)

**Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji,
histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare**

www.zaninalte.al

Tiranë, 2017

Zani i Naltë

Revistë shkencore, organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Themeluar në tetor 1923, rifilluar në tetor 2012

VITI VI (XX), tetor, nëntor, dhjetor 2017 nr. 21 (174)

Nën kujdesin e: H. Skender Bruçaj

Drejtor: Dorian Demetja

Bordi editorial: Prof. Dr. Ferdinand Gjana, rektor, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Rahim Ombashi, dekan, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Fahrush Rexhepi, dekan, Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë
Doc. Dr. Fahredin Ebibi, dekan, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Prof. Dr. Ayhan Tekines
Prof. Dr. Hajri Shehu, Tiranë
Prof. Dr. Njazi Kazazi, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër
Prof. Dr. Qazim Qazim, Kosovë
Prof. Dr. Sadije Bushati, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër
Doc. Dr. Naser Ramadani, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Doc. Dr. Ramadan Çipuri, Universiteti i Tiranës
Dr. Agron Tufa, Universiteti Bedër
Dr. Atakan Derelioglu, Universiteti Bedër
Dr. Brikena Smajli, UET
Dr. Erlis Çela, Universiteti Bedër
Dr. Hasan Bello, QSA, Instituti i Historisë
Dr. Matilda Likaj, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
Dr. Xhemal Seferti, Universiteti Bedër
PhD. Cand. Ali Zaimi, drejtor, Medreseja e Tiranës
MS/MA Fatos Koplaku, Washington, DC, SHBA
MA. Ramadan Shkodra - Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë

Kryeredaktor: Dr. Genti Kruja

Redaktor: Andrin Rasha
Haxhi Lika

Në anglisht: Dritan Hoxha

Fushat: Shkencat Islame / Tefsir / Hadith / Fikh / Sociologji / Filozofi /
Gjuhësi / Letërsi / Psikologji / Histori / Kulturë / Art, etj.

Realizimi grafik: Hysen Vogli

Fotoja në kopertinë: Manifestimi i Mevludit, Shkodër, 1937

Adresa: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
Rr. “George W. Bush”, Nr. 50,
Tiranë - Shqipëri

e-mail: info@zaninalte.al
www.zaninalte.al

Përmbajtja

Shkenca Islame

1. Mënyra e drejtë e predikimit të Islamit,
Msc. Veton Tulla & Msc. Hysni Skura, Universiteti Bedër,
Departamenti i Shkencave Islame5
2. Rreth attributeve – “sifateve” të Zotit (xh.sh.),
Azmir Jusufi, Kosovë14

Studime

3. Kontributi i Medresesë “Alauddin” për arsimin fetar dhe kauzën kombëtare gjatë viteve 1985-1995,
Prof. Dr. Qazim Qazimi, Kosovë28
4. Projekti “Depërtoni pra...!”,
Blerim Lazimi, Dibër40

Gjuhë-Letërsi

5. 95-vjetori i Gjymnazit të Shtetit,
Prof. dr. Njazi Kazazi, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”,
Departamenti i Gjuhësisë 51

Histori

6. Një vështrim historik mbi librin “Historia e pashallarëve shqiptarë në Perandorinë Osmane” të Syrja bej Vlorës, II,
Dr. Hasan Bello, Instituti i Historisë, QSA61
7. Xhamia e Et’hem Beut në Tiranë,
Brunilda Basha, Malajzi86
8. Shënimi i ditës së flamurit nga Komuniteti Mysliman në Shqipëri më 1924,
Nuridin Ahmeti99

Shkenca Komunikimi

9. Kontributi i revistës ‘Dituria Islame’ në fushën e predikimit islam – hutbeja si shembull,
Dr. Sedat Islami, Kosovë109

Personalitet

10. Hafiz Sabri Bushati - personalitet i admirueshëm e frymëzues i Shkodrës, nga
Prof. Dr. Sadije Bushati, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”122

Retrospektivë

11. Qytetrimi i vërtetë e Qytetrimi mjeshtëror134
12. Abstracts in English137
13. Rregullat e shkrimit144



Mënyra e drejtë e predikimit të Islamit

Msc. Veton Tulla & Msc. Hysni Skura
Universiteti Bedër
Departamenti i Shkencave Islame

Abstrakt

Islami e konsideron njeriun si krijesën më të nderuar, e cila është e pajisur me ndërgjegje dhe vullnet, dhe e quan lirinë e besimit si një të drejtë të pamobueshme. Feja Islame punon për eliminimin e pengesave që qëndrojnë mes Zotit dhe intelektit njerëzor, ndërgjegjes dhe vullnetit si parime themelore. Dhe kjo sigurisht që arrihet nëpërmjet një edukimi dhe formimi shumëdimensional mbi parimet dhe dispozitat fetare. Është për t'u theksuar fakti se kur Islami kuptohet siç duhet, çdokush mund të ndjekë linjën e quajtur “përfaqësim dhe komunikim”, linjën e praktikimit dhe komunikimit islam në mënyrën më të mirë të mundshme, gjë e cila rrjedhimisht do të çonte drejt një jetese në harmoni dhe paqe me këdo që na rrethon.

Është përgjegjësi profesionale dhe morale për çdo predikues të Islamit (myfti, imam, vaiz, myezhin etj.) që njerëzve, të cilët e rrethojnë, t’jua shpjegojë fenë në mënyrën më të mirë të mundshme, duke mos u shpëputur nga dy burimet kryesore, që janë Kurani dhe Tradita profetike, dhe, sigurisht, duke i ndërthurur këto mësimë me një metodologji të përshtatshme me audiencën e tij.

Feja mund të përkufizohet si tërësia e rregullave dhe parimeve, të cilat janë dërguar nga Zoti, për ta udhëhequr njerëzimin drejt lumturisë, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër. Feja bën të mundur për njerëzit zbatimin e vlerave të larta, të cilat janë fshehur në natyrën e tyre që të përjetojnë, në këtë mënyrë, një ndriçim të veçantë.

Idetë të cilat, në një mënyrë a në një tjetër nuk përputhen me fenë, padyshim që mbeten njëdimensionale dhe zvogëlojnë kapacitetin për të shpjeguar ekzistencën si një e tërë. Nga ana tjetër, një fe, e cila nuk çon në rezultate që e aftësojnë njeriun të bëhet më i zgjuar, çon në humbjen e vlerave të jetës në vend të pikësynimit të dëshiruar, domethënë hapjes dhe kapërcimit të horizonteve të njerëzve.¹

Sipas dijetarit të njohur islam Imam Esh-Shatibij², shtylla bazë e fesë është përfitimi nga kjo jetë dhe nga jeta tjetër. Prandaj ruajtja e besimit, e jetës, e pasurisë, e pasardhësve dhe e mendjes janë objektivat kryesore të fesë.³

Me shfaqjen e mjeteve të komunikimit masiv dhe të transportit, bota është kthyer në një “fshat” të madh. Në një ambient të tillë, është bërë e lehtë të ndikosh

mbi njerëzit, duke u mbështetur te fuqia dhe rëndësia e medias. Duke u nisur nga ky fakt, për fat të keq, në shumë vende të botës, kohët e fundit ka pasur përpjekje për ta portretizuar Islamin si fe e terrorit. Pra duke pasur përballë një situatë të tillë është detyrë për çdo predikues mysliman, që të komunikojë të vërtetën dhe të informojë audiencën (xhematin) e tij rreth të vërtetave të Islamit.

Kuptimi dhe karakteristikat e Islamit

Fjala “Islam” rrjedh nga fjala “silm”, që do të thotë pajtim, paqe, nënshtrim dhe shpëtim. Islami është fe e unitetit. Është për t’u theksuar fakti se Islami është një fe e bazuar në besimin vetëm te Zoti i Plotfuqishëm dhe i Gjithëmëshirshëm. Uniteti, si term i bazuar në vizionin botëror në këndvështrimin e jetës dhe në sistemin shoqëror, presupozon bashkimin e njerëzve vëllezër dhe motra, barazi në të drejtat themelore dhe eliminimin e diskriminimit në bazë të gjuhës, ngjyrës, racës ose familjes dhe farefisit. Islami ka shfuqizuar çdo gjë që i përkiste periudhës së injorancës, të gjitha karakteristikat e saj në periudhat paraislame si p.sh.: egoizmin, brutalitetin, shtypjen dhe padrejtësinë, ai i çrrënjosi në masë të gjerë. Në përputhje me Islamin, parimi “peshku i madh e ha të voglin” u zëvendësua me “duaje fqinjin tënd”; “jeta nuk është një luftë, por

1. Çapan, Ergyn, *Një Vështrim Islam mbi Terrorin dhe Sulmet Vetëvrasëse*, Prizmi, Tiranë, 2006, f. 45.

2. Ndërroi jetë në vitin 790.

3. Çapan, *po aty*, f. 45.

një proces bashkëpunimi”; parimi “të tjerët duhet të punojnë, ndërsa unë të rri” me fjalën “ndihmë”, “shtypja” u zëvendësua me “drejtësinë”, “mungesa e humanizmit” i la vendin “mëshirës”; parimi sipas të cilit njerëzit kanë lindur të lirë dhe të barabartë dhe se njerëzit kanë të drejtë të integrohen në shoqëri u vendos; parimi i padrejtësisë sipas të cilit “e drejta është me të fortin” u çrrënjësos dhe u vendos parimi “fuqia është me të drejtin”, “i drejti është më i fuqishmi” zuri vend dalëngadalë dhe shoqëria besoi tek e vërteta dhe drejtësia që i përkasin Krijuesit dhe jo në ligjet e rastësishme dhe vetjake të një minoriteti fitimtar apo të diktatorëve të përkohshëm.

Islami ka deklaruar gjithmonë se njerëzit gëzojnë respekt pa iu nënshtruar diskriminimit social-politik, materialo-shpirtëror, kulturor-racial e të çfarëdo lloji tjetër dhe i ka nderuar ata me një status të tillë mbi të gjitha krijesat. Kur’ani deklaron: “*Dhe sigurisht ne i kemi nderuar bijtë e Ademit*”.⁴

Prandaj, sipas Islamit, edhe nëse dikush është jobesimtar, pasuritë e tij/saj, jeta dhe nderi nuk mund të cenohen. Shëndeti fizik dhe mendor, si dhe e drejta për të formuar familje janë të drejtat e pamohueshme të çdo individi. Në të njëjtën mënyrë, asnjë e drejtë tjetër nuk mund të shkelet. Edhe në gjendje lufte, gratë, fëmijët dhe të moshuarit, të cilët nuk janë në

gjendje të luftojnë, nuk preken. Në përputhje me Kur’anin e Shenjtë dhe me drejtësinë, që rrjedh nga ai, bëhet e ditur se vrasësi i një njeriu të vetëm është një vrasës i urryer, sikur të jetë vrasësi i gjithë njerëzimit. “*Prandaj Ne i urdhëruam bijtë e Izraelit se kush vret ndokënd, që s’ka vrarë njeri ose që nuk ka bërë çrregullime në Tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit. Dhe, nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve...*”⁵

Në këndvështrimin Islam, të drejtat e njeriut nuk mund të shkelen edhe sikur kjo të jetë në të mirë të komunitetit. Të drejtat e një njeriu janë të shenjta sikurse edhe të drejtat e njerëzve të tjerë.

Përfaqësimi dhe komunikimi islam

Islami e konsideron njeriun si krijesën më të nderuar, e cila është e pajisur me ndërgjegje dhe vullnet, dhe e quan lirinë e besimit si një të drejtë të pamohueshme. Islami punon për eliminimin e pengesave që qëndrojnë mes Zotit dhe intelektit njerëzor, ndërgjegjes dhe vullnetit si parime themelore. Është për t’u theksuar fakti se kur Islami kuptohet siç duhet, çdokush mund të ndjekë linjën e quajtur “përfaqësim dhe komunikim”, linjën e praktikimit dhe komunikimit islam në mënyrën më të mirë të mundshme. Për shembull,

4. Kur’an; Surja Isra’, 17/76.

5. Kur’an; Surja Maide, 5/32.

në shumë ajete kur'anore deklarohet se nuk ka detyrë tjetër përveç asaj që u është ngarkuar profetit islam dhe profetëve të tjerë, që është komunikimi i qartë i fesë.⁶ Për më tepër, Zoti i drejtohet Profetit duke i tërhequr vërejtjen, që të ketë kujdes, duke i kujtuar se ai nuk është dërguar për të bërë presion mbi njerëzit: *“Prandaj këshilloji (njerëzit o Muhamed), se ti je vetëm këshillues; dhe nuk je ngarkuar t'i detyrosh ata me forcë?”*⁷ *“Nuk ka dhunë në fe.”*⁸

Garantimi i lirisë së besimit dhe ndërgjegjes, posedimi i së drejtës për të jetuar në atë mënyrë, që secili dëshiron, dhe institucionalizimi i drejtësisë në një mënyrë të tillë që çdokush të mund të përfitojë, janë norma nga të cilat mund të përfitojnë jo vetëm myslimanët, por gjithashtu edhe jomyslimanët. Si një parim bazë, ekzistenca e më shumë se një besimi dhe të jetuari përcakton kornizën e përgjithshme të pluralizmit. Zoti nuk dëshiron që të gjithë njerëzit të jenë ekzaktësisht njëjloj në aspektin e besimit dhe jetesës, sikur të kishin dalë nga i njëjti kallëp. Ka diferenca mendore mes njerëzve të cilat na lejojnë të dallojmë se cila bashkësi është më e mirë se të tjerat.

6. Kur'an; Surja Nahl 16/35, 82; Surja Ali Imran 3/20; Surja Maide 5/92, 99; Surja Rra'd 13/40; Surja Ibrahim 14/52.

7. Kur'an; Surja Gashije, 88/21-22.

8. Kur'an, Surja Bekare, 2/256.

Objektivat e ligjshëm, metodat e ligjshme dhe fjalët e buta

Islami parashtron nevojën e arritjes së një objektivit të ligjshëm përmes metodave dhe rrugëve të ligjshme. Prandaj ai nuk e pranon në asnjë mënyrë dhunën, torturën, anarkinë, apo terrorin si metoda. Për më tepër, ai bën thirrje, që njerëzit t'u drejtohen me fjalë të buta edhe tiranëve, si faraoni kur bëhet fjalë për komunikimin e fesë. Kur'ani tregon për urdhrin, që i është dhënë Musait dhe Harunit si vijon: *“Shkoni te Faraoni! Ai, me të vërtetë, i ka shkelur të gjithë kufijtë! Flitini atij fjalë të buta, se ndoshta kujtohet a frikësohet!...”*⁹

Në dy nga ajetet, të cilët përcaktojnë se si duhet të jenë marrëdhëniet me të krishterët dhe hebrenjtë, thuhet:

*“Diskutoni me ithtarët e Librit vetëm me mënyrën më të mirë, por jo me keqbërësit e tjerë. Dhe thoni: ‘Ne besojmë në atë që na është zbritur neve dhe në atë që ju është zbritur juve. Zoti ynë dhe Zoti juaj është një - dhe ne Atij i nënshtrohemi si myslimanë’.”*¹⁰

*“Thuaj: ‘O ithtarët e Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: se do të adbuojmë vetëm Allahun, se nuk do t'i shoqërojmë Atij asgjë (në adburim) dhe se nuk do ta mbajmë për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut!...”*¹¹

9. Kur'an; Surja Taha, 43-44.

10. Kur'an; Surja Ankebut, 29:46

11. Kur'an; Surja Al Imran, 3:64

Do të ishte me vend të përmendim një ajet tjetër, i cili përdoret për përcaktimin e mënyrës së komunikimit të fesë ndaj gjithë njerëzve, duke përfshirë edhe pasuesit e Librit (të krishterët dhe hebrenjtë). *“Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë!”*¹²

Një ajet tjetër, i cili flet për sjelljen e butë që Profeti dhe pasuesit e tij duhet të kenë ndaj njerëzve si një “mëshirë nga Zoti” dhe u kujton se duhet të jenë të durueshëm edhe nëse njerëzit e tyre më të afërt i braktisin, thotë:

*“Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largobeshin prej teje.”*¹³

Kuptimet e fjalës “irhab” në Kur’an

Siç dihet nga myslimanët, fjalët lavdëruese në Kur’an zënë një vend të konsiderueshëm. Veçanërisht fjalët, që përdoren vetëm në kontekstin e lavdërimit dhe nderimit kanë një domethënie shumë të veçantë. Fjala irhab është një shembull i fjalëve të tilla. Ajeti në të cilën përdoret kjo fjalë në Kur’an është ai në vijim:

“Përgatisni kundër tyre kuajt dhe forcë për luftë sa të mundni, që të tmerroni armikun e Allahut dhe armikun tuaj, si dhe të tjerë, përveç tyre, të cilët ju nuk i njihni, por

*që Allahu i njeh. Çfarëdo që të shpenzoni në rrugën e Allahut, do t’ju shpërblebet dhe nuk do t’ju bëhet padrejtësi.”*¹⁴

Prandaj ata që besojnë në Kur’an dhe që e kanë atë si pikë orientimi, duhet t’i përmbahen kësaj fjale me respekt dhe me dinjitetin që ajo kërkon. Kuptimi letrar i fjalës irhab i përmendur në ajete është “frikësimi”. Megjithatë kjo është një frikë natyrore, e cila shfaqet ndaj mundësisë së cenimit dhe e cila shkakton një formë frenuese e ajo nuk është cenimi i vetvetes.¹⁵

Komentuesit e Kur’anit e kanë interpretuar fjalën “irhab” të theksuar në ajetin e mësipërm në kuptimin e të qenët të pajisur me armët e nevojshme (si kuajt e luftës) kundër armikut në mënyrë, që të krijojnë një forcë frenuese në përputhje me rrethanat e rastit.¹⁶

Rashid Rida thekson se fjala irhab nuk do të thotë të shpallësh luftë, por përkundrazi, të parandalosh luftën; prandaj ajo nënkupton mbrojtjen e shoqërisë dhe jo shkatërrimin e saj. Ai gjithashtu e interpreton ajetin e lartpërmendur si “përgatitje e armëve të luftës në shkallën më të lartë të mundshme në mënyrë që të parandalohen armiqët (të njohur ose jo) të shpallin luftë ose të sulmojnë”.¹⁷

14. Kur’an; Surja Enfal, 8:60

15. Ibn el Mendhur, Lisan el arab, r-b-b: Ragib, Mufredat, r-b-b: Zabidi, Takh el Arus, r-b-b.

16. Taberi, Xhami el Bejan, 6/42: Razi, Mefatih, 15/192: Alusi. 10/26: Yazir, Hak Dini Kur’an Dili.

17. Rashid Ridha, Tefsir el Mener, 10/66.

12. Kur’an; Surja Nahl, 16:125

13. Kur’an; Surja Al Imran, 3:159

Në hadithe, irhab nënkupton *frenim*¹⁸, përmbajtje dhe në komentimet e haditheve është interpretuar si e tillë¹⁹.

Dijetarët e Legjislacionit Islam gjithashtu e përdorin fjalën irhab në kuptimin e mjetit frenues.²⁰

Si rezultat, kur ne e studiojmë strukturën e fjalës irhab, përdorimin e saj si dhe kuptimin që i është dhënë në librat e hadithit, në komentimet në librat e Legjislacionit Islam dhe në fjalorë të ndryshëm, dalin në dritë faktet e mëposhtme:

1. Fjala irhab e cila përmendet në Kur'an është e lidhur me çështjen e *idad*-it; ajo është një fjalë që ka kuptimin e të qenët gati për të mbrojtur vlerat e shenjta të dikujt. Ajo bazohet në parandalimin e shkeljeve, në përballimin e tiranisë dhe në tërheqjen e vërejtjes atyre të cilët kanë prirje kriminale. Kjo çështje është njohur dhe pranuar nga shoqëritë dhe nuk bie në kundërshtim me vlerat njerëzore.

2. Dijetarët myslimanë përdorin fjalën irhab në veprat e tyre me kuptimin e “dekurajimit të armikut përpara ose gjatë luftës”, për t'i demoralizuar ata shpirtërisht dhe psikologjikisht.

18. Bazzar, *Mesned*, 6/30; Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 3/493.

19. Azim Abadi, *Aun el Me'bud*, 8/159.

20. Sarahsi, *mabsut*, 10/42; Ibn el Kudama, el Kafi; Bahuti, *Kesh'shaf el Gina*, 3/65; Ebu Is'hak, esh Shirazi, *Mubedh-dheb*, 2/231; Ibn el Abidin, 6/305.

Përveç këtyre dy formave të cituara në Kur'an, nuk ekziston asnjë kuptim tjetër i fjalës *irhab* si në Kur'an ashtu edhe në Sunet, si dhe nuk mund të gjendet asnjë i tillë në vepra të tjera të shkruara, të cilat burojnë nga Kur'ani dhe Suneti. Prandaj nuk do të ishte korrekte që fjala *irhab* e përmendur në Kur'an, të interpretohet si vrasje e njerëzve të pafajshëm në vende publike, në vendosje bombash në trup, me gjakderdhje, me zjarrvënie, duke shkaktuar dëme në banesa apo prona, në përhapje frike me qëllim vendosjen e kaosit në një shoqëri të caktuar. Nuk do të ishte korrekte, gjithashtu, që të përdorej Kur'ani si argument për mbështetjen e këtyre akteve.

Duke shtuar këtu edhe një fakt domethënës, i cili duhet të merret në konsideratë: Të gjithë fjalorët klasikë arabë përmbajnë vetëm fjalën *ihafa* (frikësim) si përkufizim i fjalës *irhab*. Megjithatë është vërejtur se në disa fjalorë të përpiluar në gjysmën e dytë të shek. XX, përkufizimi i fjalës *irhab* është ndryshuar dhe modifikuar. Me qëllim ose jo, veçanërisht në fjalorët e përgatitur nga jomyslimanet, fjala irhab është përkufizuar si “terrorizëm”²¹.

21. Oxford Wordpower, New York: Oxford University Press, 1999; Hans Wehr, A Dictionary of Modern Written Arabic, Beirut, 1960; English Arabic Glossary, Encyclopedia Britannica, 11/650-651.

Çështja e ekstremizmit dhe radikalizmit është më aktuale se kurrë. Tabloja e botës sot na dikton qartë nevojën që këtë temë ta trajtojmë në këndvështrime të ndryshme dhe me të gjitha dimensionet e saj, duke propozuar zgjidhje praktike, të cilat ruajnë përputhshmërinë me realitetin.

Një rol të rëndësishëm në parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizmit luajnë liderët fetarë me predikimet e tyre në faltore dhe aktivitetet e shumëllojshme të thurura rreth mesazheve, që transmetohen në mësimet e ndryshme fetare.

Institucionet përkatëse kanë luajtur një rol të rëndësishëm në krijimin e një atmosfere të tillë mes anëtarëve të ndryshëm të shoqërisë. Por, siç na dikton edhe aktiviteti i Profetit Muhamed (paqja e bekimet e Zotit qofshin mbi të), zgjidhja ideale arrihet në momentin kur, çdo anëtar i komuniteteve të ndryshme, e ka fort të qartë qëndrimin karshi fenomeneve shoqërore që e detyrojnë atë të reagojë.

Në bashkësinë islame, pikërisht këtu imami dhe xhamia luajnë një rol kyç, sepse nëpërmjet tyre besimtarët ushqehen me informacione të ndryshme fetare e shoqërore.

Kështu është e nevojshme që, hytbeja e ditës së xhuma, vazi (ligjërimi) përpara saj po ditën e xhuma, apo mësimet e tjera feje gjatë javës, të jenë ndër aktivitetet e çdo xhamie. Kjo, pasi xhamia nuk është vetëm vend adhurimi dhe faljeje, por edhe vend edukimi e socializimi. Ndër pikat që duhen pasur parasysh gjatë predikimeve veçojmë²²:

22.<http://www.dritaislame.al/natyra-e->

1 – Ligjërimi është art më vete dhe, për të arritur rezultat, kërkohet që ligjëruesi të jetë i qartë në disa pika. Është e nevojshme që predikuesi të jetë i vëmendshëm dhe i qartë, sepse nëse nuk ka një mesazh ushqyes, atëherë audienca e tij nuk arrin të marrë një formim të shëndoshë.

2 – Një pikë tjetër që audiencës i tërheq vëmendjen dhe shpeshherë i bën të ndihen krenarë për persona apo fraksione të caktuara, është ligjërimi që ka kritikën si qëllim në vetvete. Ndryshe nga sa mund të mendohet, gjuha kritike nuk është tipar primar në predikimet fetare, sepse lë gjithmonë vend për keqkuptim, sidomos nëse kjo është e vazhdueshme. Edhe sipas doktrinës fetare, kritika e vazhdueshme është pozitive, por vetëm nëse ia drejtojmë vetes sonë.

3 – Bashkëngjitur me këtë pikë mund të sjellim në vëmendje edhe shmangien e çështjeve, që hapin diskutime të panevojshme, ose edhe më keq, trajtimin e çështjeve politike. Xhamitë në ditët e sotme janë objekte multifunksionale, të cilat krahas funksionit të vendfaljes, shërbejnë edhe si vatra të përfitimit të edukatës morale dhe fetare. Ky është edhe qëllimi për të cilën të gjithë ne si besimtarë grumbullohemi në to. Përfshirja e ambienteve të xhamive në aktivitete apo debate jashtë tipareve të tyre aktuale, nuk do të bëheshin shkak vetëm se për përçarje.

predikimit-dhe-aktivitetet-ne-xhami-si-faktore-parandalues-te-ekstremizmit/, 23.11.2017

4 – Ligjëratat duhet të jenë të natyrës përgëzuese dhe inkurajuese. Imami duhet të përcjellë te audienca e tij qasje pozitive për të gjithë ata që kanë mendim të ndryshëm nga ai i yni. Këtë e mbështesim me hadithin e profetit të Zotit, ku porositi: “*Lehtësoni dhe mos vështirësoni, përgëzoni dhe mos largoni/mos qortoni.*”²³

5 – Ligjëruesi duhet të njohë shumë mirë burimet e fesë islame. Literatura klasike, që përbën kulturën e dijes së qytetërimit islam, duhet patjetër të njihet mirë. Por, nga ana tjetër, nëse do të përjashtonim besimin dhe adhurimet, çështjet e marrëdhënieve civile kanë gjithnjë nevojë për një interpretim të drejtë e bashkëkohor. Në këtë këndvështrim, Islami nuk është statik dhe veçanërisht shkenca e jurisprudencës islame, si natyrë, është shumë dinamike. Ajo mbetet statike në momentin që nuk trajtohet në përputhje me rrethanat dhe kohën. Raste klasike përbëjnë fetvatë e dhëna nga dijetarë të mëdhenj, por që janë në rrethana krejtësisht të ndryshme dhe jashtë realitetit të vendit ku ne predikojmë. Ndonjëherë, ato, në vend të zgjidhjes, hapin më tepër probleme. Prandaj, kumtuesit e fesë, në këtë rast imamët e xhamive, kanë mbi supë një barrë shumë të rëndë, që kërkon një përgjegjshmëri dhe seriozitet maksimal. Krahas ruajtjes së kritereve të përcaktuara nga institucioni më i lartë i fesë, nëse është e nevojshme, ligjëruesi duhet të konsultohet me persona më të informuar për të kryer në formën e duhur detyrën e lartë të transmetimit të fesë.

6 – Krahas këtyre, imami i xhamisë ka për detyrë të ketë nën kontroll gjendjen e xhematit të xhamisë ku ushtron detyrën, në mënyrë që t’i paraprijë konflikteve të mundshme. Ai duhet ta edukojë xhematin e tij me një shpirt dhe botëkuptim të tillë që ata të jenë të gatshëm të pranojnë mendimin ndryshe dhe të respektojnë të tjerët, duke forcuar kështu frymën e bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit.

7 – Xhamia është më efektive në kryerjen e misionit të saj në momentin që organizon edhe aktivitete të ndryshme sociale. Përfshirja aktive e pjesëtarëve të xhematit të xhamisë, bën që gjithsecili të ndiejë që po jep kontributin e tij dhe kjo shton ndjenjat pozitive karshi të tjerëve, duke sjellë stabilitet e harmoni.

Si përfundim, mund të thuhet se çdokush është i rrezikuar nga ekstremizmi dhe radikalizmi. Prandaj kjo çështje nuk duhet nënvlerësuar asnjëherë. Shkaqet që çojnë në të janë:

- Mosnjohja e drejtë e çështjeve të fesë.
- Sipërfaqësia në të kuptuarit e teksteve pa u thelluar në njohjen e qëllimeve, shkaqeve dhe urtësive që fshihen pas tyre.
- Preokupimi me çështje sekondare dhe anashkalimi i çështje primare dhe madhore.
- Pasimi i teksteve të paqarta dhe anashkalimi i teksteve të qarta.
- Mungesa e një edukimi dhe arsimimi pranë predikuesve, imamëve të kualifikuar dhe të miratuar nga institucioni më i lartë i fesë.

23. Buhariu, 3:72.

Përfundim

Si përfundim themi se Islami e konsideron njeriun si krijesën më të nderuar, e cila është e pajisur me ndërgjegje dhe vullnet, dhe e quan lirinë e besimit si një të drejtë të pamohueshme. Feja Islame punon për eliminimin e pengesave që qëndrojnë mes Zotit dhe intelektit njerëzor, ndërgjegjes dhe vullnetit si parime themelore. Dhe kjo sigurisht që arrihet nëpërmjet një edukimi dhe formimi shumëdimensional mbi parimet dhe dispozitat fetare. Është për t'u theksuar fakti se kur Islami kuptohet siç duhet, çdokush mund të ndjekë linjën e quajtur "përfaqësim dhe komunikim", linjën e praktikimit dhe komunikimit islam në mënyrën më të mirë të mundshme, gjë e cila rrjedhimisht do të çonte drejt një jetese në harmoni dhe paqe me këdo që na rrethon.

Është përgjegjësi profesionale dhe morale për çdo predikues të Islamit (myfti, imam, vaiz, myezin etj.) që njerëzve, të cilët e rrethojnë, t'jua shpjegojë fenë në mënyrën më të mirë të mundshme, duke mos u shkëputur nga dy burimet kryesore, që janë Kurani dhe Tradita profetike, dhe, sigurisht, duke i ndërthurur këto mësimë me një metodologji të përshtatshme me audiencën e tij.

Referencat:

Çapan, Ergyn, *Një Vësbtrim Islam mbi Terrorin dhe Sulmet Vetëvrasëse*, Prizmi, Tiranë, 2006.

Kur'an, përk. i Hasan Nahit, botimet AIITC, Tiranë, 2011.

Ibn el Mendhur, *Lisan el arab*, *r-h-b*: Ragib, Mufredat, *r-h-b*: Zabidi, *Taxh el Arus*, *r-h-b*.

Taberi, Xhami el Bejan, 6/42: Razi, *Mefatih*, 15/192: Alusi. 10/26: Yazir, *Hak Dini Kur'an Dili*.

Rashid Ridha, *Tefsir el Mener*, 10/66.

Bazzar, *Mesned*, 6/30; Ahmed bin Hanbel, *Musned*, 3/493.

Azim Abadi, *Aun el Me'bud*, 8/159.

Sarahsi, *mehsut*, 10/42: Ibn el Kudama, el Kafi; Bahuti, *Kesh'bf el Gina*, 3/65; Ebu Is'hak, esh Shirazi, *Mubedh-dheb*, 2/231; Ibn el Abidin, 6/305.

Oxford Wordpower, New York: Oxford University Press, 1999; Hans Wehr, *A Dictionary of Modern Written Arabic*, Beirut, 1960; *English Arabic Glossary*, *Encyclopedia Britanica*, 11/650-651.

Buhari, 3:72.

<http://www.dritaislame.al/natyra-e-predikimit-dhe-aktivitetet-ne-xhami-si-faktore-parandalues-te-ekstremizmit/>, 23.11.2017

Rreth attributeve “Sifateve” të Zotit xh. sh.

(صفات الله)

Azmir Jusufi (PHDc), Prizren - Kosovë

Abstrakt

Është e njohur se, dhe është shumë larg asaj, Zoti ka trup, se ka zënë vend në hapësirë, se është i lëvizshëm ose jo, se është i karakterizuar me ndjenjat e jashtme dhe të brendshme sikurse njeriu. Atij nuk i përngjan asgjë. Megjithatë, në mënyrë për të përmbushur vullnetin e njeriut, dhe për t'i ndihmuar njeriut, Zoti i Madhërisëm, në shpalljen e fundit, në Kur'an, ka përmendur atributet që i përkasin Atij të Plotfuqishmit, (por) në mënyrë që Zoti të mbetet i pakrahasueshmi, siç edhe është në fakt.

Po qe se njerëzit - filozofët - do të ishin ndalur në atë që vetë logjika mundëson rreth njohjes së fuqisë mbinatyrore (Zotit), do të ishte e mjaftueshme. Megjithatë, ajo që shkaktoi dialogun i mërziati ata dhe i lodhi pa nevojë, është fakti se ata i hynë hulumtimit dhe studimit në lidhje me diçka që nuk ishte nevojë urgjente.

Hyrje

Gjeneratat e para (*selefus-salihin*) konsideruan se duhet t'i përmbahemi tekstit të shpallur, por nuk i lejuan vetes shpjegimin e teksteve kur'anore që flasin për atributet e Zotit xh.sh. Ata nuk u treguan të lirë në kuptimin

e tyre e as mohuan gjë nga ajo se si është njohja e cilësive të Zotit dhe Qenies së Tij përtej aftësive e të kuptuarit të mendjes së njeriut. Ata preferuan që të mos i interpretonin ato në mënyrë që t'u shmangen gabimeve. Mirëpo, siç do të shohim në vazhdim të tekstit, gjeneratat

e mëvonshme nuk hezituan që të shpreheshin në komentimin e ajeteve që flasin rreth attributeve të Zotit Fuqiptotë.

Në tekstin vijues do të bëhet fjalë rreth mësimit të hershëm të attributeve të Zotit, më pas do të shohim se prej nga rrjedh mësimi rreth attributeve të Zotit, a është mësimi i pasuar nga feja islame apo gjë e huazuar nga doktrinat e tjera apo gjuhë të tjera.

Në vazhdim të tekstit do të përmenden disa mendime të apologjetëve islamë të hershëm dhe të mëvonshëm rreth attributeve të Zotit xh.sh.; më pas, do të bëhet fjalë rreth attributeve të Zotit xh.sh. në përkthimet dhe komentimet e Kur'anit, dhe, në përfundim, do të sillen shembuj nga përkthimi dhe komentimi i Kur'anit nga H. Sherif Ahmeti dhe mënyrën e përkthimit të ajeteve që flasin rreth attributeve të Zotit xh.sh.

“Philosophia theologicae” dhe mësimi i hershëm rreth attributeve të Zotit

Në shekullin e dytë, përkatësisht në shekullin e tretë të erës sonë, për historinë njerëzore ndodhi kontakti vendimtar mes Athinës dhe Jerusalemit. Duke dashur që botës greko-romake t'i tregohej se krishterimi nuk është ekskluzivisht religion irracional, siç theksohej sidomos në polemikën me Origen

Kelsos, autorët e hershëm të krishterë duhet të hynin në polemikë, përkatësisht dialog produktiv, me filozofinë greke duke shfrytëzuar argumentet logjike dhe metafizike. Ky takim frytdhënës i Athinës me Jerusalemin ndodhi në Aleksandri, në atë kohë njëra prej qendrave më të mëdha të mësimit dhe urtësisë helenike.¹

Si përkrahës besnik i monoteizmit të Dhjatës së Vjetër dhe kreacionizmit nga njëra anë, dhe si intelektual i Aleksandrisë nga ana tjetër, Filoni (Philon)² nuk kishte mundur që ta pranojë se marrëdhënia në mes të Zotit dhe botës së krijuar të shprehet në kategoritë e antropomorfizmit dhe natyralizmit primitiv. Zoti, sipas Filonit, është absolutisht transcendent.³

1. Prof. dr. Adnan Silajdžić, *Rane škole kelama (Uvod u islamsko klasično mišljenje)*, FIN, Sarajevë, f. 171.

2. **Filoni i Aleksandrisë** (Filoni Hebre, latinisht *Philo Iudaeus* ose *Philo Alexandrinus*; Aleksandri, rreth v. 25 para Krishtit. – rreth v. 40.), filozofi helenik hebre. Është lindur në Aleksandri në familje hebreje të pasur dhe me ndikim. Duke kërkuar një kompromis në mes fesë hebreje dhe të kuptuarit helenistik të jetës dhe filozofisë, e sidomos me doktrinën e tij rreth Logosit, e përgatiti terrenin për afrimin ndërmjet teologjisë së krishterë dhe filozofisë greke. Shih: M. Poljak, “Filon Aleksandrijski kao spona 658 između antike i srednjeg vijeka”, **Filozofska istraživanja**, Viti 29, vëll. 4, 2009, f. 657.

3. Prof. dr. Adnan Silajdžić, *Rane škole kelama (Uvod u islamsko klasično mišljenje)*, vep. cit., f. 172.

Pas Filonit, idenë e Zotit të panjohur (pamundësisë për ta njohur Zotin), në mendimet e veta, do ta fusin Albini dhe Plotini, e nëpërmjet tyre, do ta merrte patriarkana lindore e krishterë dhe teologjia e hershme myslimane në mësimet e veta të drejtimit mu'tezilit.⁴

Origjina e mësimet të hershëm mysliman rreth attributeve të Zotit

Si përgjigje në pyetjen e relacionit ontologjik të Zotit dhe botës si shpikje e Tij, në historinë e hershme myslimane shfaqen tri mendime relevante, të cilat për mendimin filozofiko-teologjik dhe teozofiko-mistik mysliman do të jenë të pakalueshme. Ato janë:

- Shkolla filozofiko-teologjike mu'tezilite, e cila e afirmon esencën e Zotit dhe që njëkohësisht refuzon që të pranojë se Zoti ka attribute, të cilat janë të ndara nga Ai (esenca e Tij). Kjo tendencë e Kelamit të hershëm mysliman determinon mendimin fundamental religjioz në Islam, i cili mund të karakterizohet si ndonjë mënyrë abstrakte e monoteizmit, e që flet për ndikimin e Aristotelit, përkatësisht, të mësuarit e tij rreth Qenies.

Ndryshe nga kjo shkollë, e cila e afirmon transcendencën e Zotit dhe që refuzon realitetin e attributeve hyjnore, *xbehmitët* dhe *karamitët*, nga

4. Ibid., f. 172.

ana tjetër, i japin theks të veçantë imanencës së Zotit me të gjitha devijimet, të cilat dalin nga një mësim i tillë. Koncepti i tyre është fundamental antropomorfik.

- Shkollat teologjiko-filozofike *Esb'arite* dhe *Maturidite*, të cilat, pa marrë parasysh dallimet e tyre doktrinare, kanë marrë pozitën e mesme - pajtuese, që njëkohësisht e afirmojnë esencën e Zotit dhe Attributeve të Tij, të cilat vërtet ko-ekzistojnë me të.⁵

Në pjesën e parë të shekullin 8, mu'tezilitët kanë qenë të parët, të cilët, në mënyrë sistematike dhe argumentuese, refuzonin atributet e Zotit. Argumentimi i tyre kundër ekzistimit të attributeve të përhershme dhe ekzistuese të Zotit, përbëhej nga dy pjesë: E para, pretenduan se gjithçka që është e përhershme sipas logjikës së gjërave duhet të jetë Zot; e dyta, se Njëshmëria e Zotit ndalon çfarëdo pluraliteti në Zotin, edhe atëherë kur pjesët e tij janë të pandara nga Qenia e Tij, e gjithë kjo, sipas mendimit dhe pretendimit të Uasil b. 'Ataut, themeluesit të shkollës filozofiko-teologjike mu'tezilite.

Si argumentimi i parë edhe ai i dytë, sfondin e ka në filozofinë religjioze të Filon Aleksandrit, me të cilin myslimanët u njohën përmes teologëve të krishterë. Mbështetjen e argumentimit të tyre të parë e gjejmë në tezën e Filonit se *Zoti është i përhershëm*, me fjalë të tjera, gjithçka që përshkruhet si e përhershme

5. Ibid., f. 177-178.

duhet të jetë patjetër Zot. Pjesën e dytë të argumentimit të tyre, mu'tezilitët gjithashtu e mbështesin në pretendimin e Filonit se Njeshmëria e Zotit është njëshmëria absolute, e cila nuk pranon çfarëdo bashkimi apo pjesë lidhjeje.⁶

Mu'tezilitët ishin të mendimit se në qoftë se Zotit i veshim attribute, kalojmë në teorinë e teologjisë së krishtere të doktrinës së të besuarit në: *Atin, birin dhe Shpirtin e Shenjtë*.

El-Esh'ariu, si pajtues i dy shikimeve ekstreme (hanbelite dhe mu'tezilite), në qendër të mësimin të tij filozofiko-teologjik vendos problematikën e attributeve hyjnore. Vëmendjen e tij ai e drejton në dy format e të folurit kuranor rreth Zotit. Krahas attributeve *substanciale* El-Esh'ariu beson edhe në ekzistimin e attributeve antropomorfe siç janë: Fytyra e Zotit, dora, sytë, etj. Bëhet fjalë për të ashtuquajtura *attribute të shpallura*, të cilat, në literaturën teologjike, karakterizohen si *sifat el-habarije*, përkatësisht *sifat es-semi'je*.

Duke shikuar në këto dy format e të folurit kuranor rreth Zotit, në shek. IX dhe X, do të paraqiten dy drejtime të ndryshme radikale, të cilat do të ndajnë mendimin e hapur të Irakut. Nga njëra anë, në emër të transcendencës absolute hyjnore, mu'tezilët do të refuzojnë ekzistencën e attributeve substantive dhe antropomorfe. Me dëshirën për të ruajtur misterin absolut

transcendent hyjnor, ata shpikën *teologjinë apofaktike*. Në kundërshtim me mësimet mu'tezilite, dijetarët hanbelij të hadithit dhe fikhut, do të mësojnë ekzistimin e attributeve antropomorfe dhe substantive, në atë formë për të cilën flet rreth tyre Kur'ani.⁷

El-Esh'ariu, nga njëra anë, nën ndikimin e mësuesit të tij el-Xhubai', parasheh nevojën e artikulimit racional të attributeve të Zotit, kurse nga ana tjetër, nën presion të madh nga dijetarët hanbelij, ai në raport me mu'tezilët mban qëndrim krejtësisht të kundërt.⁸ Deri në moshën e tij 40 vjeçare, El-Esh'ariu ishte mu'tezil i bindur, kurse në vitet e mëvonshme të jetës së tij ai na paraqitet si përkrahës i anti-mu'tezilëve, para së gjithash, si përkrahës i hanbelive, e që e gjithë kjo do të reflektohet në mësimin e tij rreth attributeve të Zotit, por jo edhe si përkrahës i denjë i mësimin të tyre, si ilustrim do të përmendim problematikën e "*istinias*" (qëndrimin të Zotin mbi Arsh). El-Esh'ariu, për shembull, kur flet për *atributet e shpallura* dhe ato *antropomorfe*, e refuzon mësimin e hanbelive se qëndrimi i Zotit mbi *Arsh – Fron (istina)* është atribut i Zotit, sepse, sipas tij, *istina* është akt, dhe si i tillë ai nuk është *atribut substantiv* e as që është *fjalë*, gjegjësisht *i foluri*, e që *sife (atributi)* është pra ose njëra ose gjëja tjetër.⁹

7. Ibid., f. 209-210.

8. Ibid., f. 210.

9. Për më shumë rreth kësaj problematike

6. Ibid., f. 178-179.

Sa i përket *atributeve antropomorfe* të Zotit, El-Esh'ariu në *Risalen* ose *Ibanen* e tij pretendon se: *dora e Zotit* nuk e karakterizon *bamirësinë e Zotit*, e as *sytë e Zotit* karakterizojnë *dijen e Zotit*, por, duhet ta kemi të qartë se ato nuk janë gjymtyrë të ngjashme me gjymtyrë të njeriut (*xbeuarib*),¹⁰ por thjesht janë *atributet dhe kualitetet hyjnore*.¹¹

Sa i përket El-Maturidiut, ai gjithmonë u përpoq që të trasojë drejtimin e mesëm, në mes të racionalistëve ekstrem (mu'tezilëve) dhe tradicionalistëve (hanbelive). Ai do t'i përkrahë të parët në disa pika të caktuara, por, asnjëherë nuk do ta pranojë filozofinë e Aristotelit si bazë e doktrinës religjioze. Në mënyrë të ngjashme ai pajtohet me tradicionalistët në çështje të rëndësishme, por, gjithmonë nuk është i gatshëm ta marrë Kur'anin dhe Hadithin në kuptimin e tyre të

fjalëpërfjalshëm, dhe kështu të bjerë në antropomorfizëm të tejkaluar. Si shembull, ai pajtohet me mu'tezilët se Zoti i dhuroi njeriut racion në mënyrë që përmes saj të njohë ekzistencën e Zotit, por thotë që racio (mendjalogjika) nuk mund të jetë autoriteti përfundimtar për detyrën njerëzore dhe ligjin e religjionit, sepse, sipas tij, baza e detyrimeve religjioze është shpallja, e jo racio-mendja.¹²

El-Maturidiu e kishte formuar sistemin e vet të të mësuarit, kryesisht në dy principe: *liria nga ngjashmëritë (tenzih)* dhe *urtësia Hyjnore (hikme)*. Sa i përket principit të parë, e cila është problematika jonë këtu, *principi i lirisë nga ngjashmëritë (tenzih)*, kundërshton *ngjashmërinë (teshbih)* dhe *antropomorfizmin (texhsim)* në të gjitha format e tyre, pa mohuar të attributeve të Zotit. Shprehjet antropomorfike të përdorura në Kur'an si: *duart, fytyra, sytë e Zotit dhe qëndrimi i Tij mbi fron*, nuk duhen marrë në kuptimin e tyre faktik-të përcjellë, për arsye se interpretimi i fjalëpërfjalshëm i këtyre shprehjeve është në kundërshtim me ajetet eksplicite të Kur'anit. Këto pjesë, për këtë arsye, duhen interpretuar në faqet e qarta të *tenzihit*, në përputhje me doktrinën e *teuhidit* dhe në atë mënyrë që interpretimi të mos bjerë në kundërshtim me atë që kërkon përdorimi dhe idiomatika e gjuhës arabe, ose, kuptimi i tyre i vërtetë duhet t'i lihet njohjes së Zotit.¹³ Pra me fjalë

shih: Prof. dr. Adnan Silajdžić, *Rane škole kelama (Uvod u islamsko klasično mišljenje)*, vep. cit., f. 172.

10. Në lidhje me këtë të bëjmë një krahasim: p.sh., për shprehjen kuranore "jedull-llah - dora e Zotit" - mu'tezilët e komentojnë si "bamirësi e Zotit", kurse hanbelitë e komentojnë në kuptimin përcjellës, pra, se Zoti ka duar. Mirëpo, El-Esh'ariu këtë e komenton si "dora e Zotit", por jo e ngjashme me dorën e njeriut (si krijesë e Zotit), sipas mësimave kuranore, Zotit nuk i përngjan asgjë.

11. Shih: Prof. dr. Adnan Silajdžić, *Rane škole kelama (Uvod u islamsko klasično mišljenje)*, vep. cit. f. 229-230. Po ashtu: Adnan Silajdžić, *Filozofijska teologjia Abu al-Hasana al-Aš'arija*, Sarajevë, 1999, f. 152.

12. Ibid., f. 265.

13. Ibid., f. 266-267.

tjera, ai në *Traktatin e tij rreth besimit islam*, thotë: “...Shprehjet *Dora, Fytyra dhe Këmba* nënkuptojnë *mbisundimin*”, duke dëshiruar me një komentim të këtillë që ta ruajë transcendencën e Qenies së Zotit.¹⁴ El-Maturidiu thotë se të gjitha atributet e Zotit janë të përthershme¹⁵, qofshin ato të esencës apo aksionit.

Ebu Hanife në librin e tij *Fikhu-l-ekber*, thotë se: “*Zoti ka duar dhe fytyrë. Ka Qenien e Tij, siç ka përmendur i Lartësuar në Kur’an si fytyrë, duar, dhe Qenia e Tij janë atributet e Tij, edhe pse ne nuk e njohim çfarësinë e tyre. Nuk themi se dora e Tij do të thotë mirësi-begati, sepse nga kjo do të kuptohej refuzimi (ibtal) i një atributi të Tij,*¹⁶ *siç thonë kaderitë dhe mu’tezilët...*”¹⁷

14. El-Maturidi, “Traktat o islamskom vjerovanju”, f. 21. Po ashtu: Rifet Šahinović, “Božiji atributi”, *Glasnik*, nr. 11-12, 2010, f. 1067.

15. Ngjashëm në mendim sikurse edhe Ebu Hanife. Shih: Ebu Hanife, *Fikhu-l-ekber*, f. 6.

16. Ky tekst, me të cilin Ebu Hanife e përshkroi medhhebin e tij rreth pyetjes së attributeve të Zotit është tejet i qartë dhe bazohet si vijon: 1. *Gjithçka që erdhi në Kuran dhe synet nga emrat dhe atributet e Allahut, është obligim që të besohet, pa ndonjë ngjashmëri të këtyre attributeve me attribute të krijesave (tesbih) dhe pa refuzim të kuptimit të tyre të vërtetë, 2. Nuk është i lejuar komentimi i ndonjë atributi të Allahut në kuptimin e përcjellë –faktik (në mënyrë metaforike, (te’uil) me ndonjë atribut tjetër, 3. Kush bën komentimin e ndonjë atributi në kuptimin e përcjellë (te’uil), ai e bëri devijimin e tij (tabrij) dhe bëri negacionin faktik të atij atributi (ta’uil). Shih: Ebu Hanife, *Fikhu-l-ekber*, f. 6, (komenti rreth sifateve-atributeve të Allahut).*

17. Ibid., f. 8.

Imam Tahaviu, sikurse edhe Maturidiu, ishte përkrahës i Ebu Hanifes në jurisprudencë dhe teologji. Dallimi mes tij dhe el-Maturidiut është tejet i qartë; el-Maturidiu ishte dialektiku i qartë dhe qëllimi i tij ishte i drejtuar në atë që të nxjerrë bazën filozofike duke e argumentuar me konkludime skolastike dhe duke e afruar me mendimet racionaliste. Et-Tahaviu, si tradicionalist i vërtetë, nuk i jepte përparësi çfarëdo diskutimi racionalist ose mendimi spekulativ rreth çështjeve të besimit, por preferonte që të besojë në to duke i pranuar pa pyetje. Kështu që sistemi i Tahaviut mund të karakterizohet si dogmatik, kurse ai i Maturidiut kritik.¹⁸

Rreth attributeve të Zotit në përkthimet dhe komentimet e Kur’anit

Gjenerata e parë në islam (*selef*) konsideronte se duhet të përmbahemi në tekstin e shpallur, por nuk i lejonin vetes shpjegimin e teksteve kuranore që flasin për atributet e Zotit xh.sh. Ata nuk u treguan të lirë (liberal) në kuptimin e tyre e as që mohuan gjë nga ajo se si është njohja e cilësive të Zotit dhe Qenies së Tij përtej aftësive e të kuptuarit të mendjes së njeriut. Ata

18. Prof. dr. Adnan Silajdzic, *Rane škole kelama (Uvod u islamsko klasično mišljenje)*, vep. cit. f. 281.

preferonin që të mos i interpretojnë në mënyrë që t'i shmangen gabimeve.¹⁹

Ebu Hanife, në lidhje me dialogimin dhe shpjegimin rreth attributeve të Zotit, i kishte këshilluar nxënësit e tij që të mos hyjnë në diskutime rreth kësaj çështjeje, por të kënaqen me përshkrimin e Zotit me ato kualitete me të cilat Ai e përshkroi veten e Tij. Për t'iu larguar vështirësive të përmbajtura në atributet e konfirmuara, ai, thjesht, kishte thënë se atributet “as që janë Ai, e as që janë diçka tjetër Tij” (*la huc ue gajrubu*).²⁰

Sa i përket dijetarëve myslimanë të periudhave të mëvonshme (*halef*), ata i dhanë përparësi arsyes në të kuptuarit e teksteve në këtë fushë. Sipas tyre, kuptimi i këtyre ajeteve nuk është ashtu siç është dhënë në formën e jashtme.²¹

Këtu është e rëndësishme që të theksohen dy terma që kanë të bëjnë me problematikën për të cilën bëhet fjalë, e ato janë *tenzib* dhe *tesbbih*. *Tenzib* do të thotë: “Të konsideruarit e Qenies së Zotit larg të gjitha jo përsosmërive.” Cilido atribuim i ngjashëm me kualitetet e njeriut, kurrsesi nuk duhet t'i atribuohet

Zotit. Në krahasim me *tenzib*-un, *tesbbih* do të thotë përshkrim apo atribuim i Zotit me attribute të ngjashme si të njeriut, si p.sh. dëgjimi, shikimi, etj.²²

Problemi në përkthimin e Kur'anit, e që parashtrohet më seriozisht, janë *deklaratat gjerësisht të stilizuara rreth Qenies së Zotit*. Përkthyesit tanë, thotë prof. dr. Enes Karić, ishin të ndarë në lidhje me këtë çështje dhe ofruan dy mundësi:

- deklarata të tilla në gjuhën boshnjake, serbe dhe kroate (dhe në gjuhë të tjera, A. J.) duhet të përkthehen fjalë për fjalë, (sipas parimit كيف بلا - A. J.);

- këto janë deklarata *metaforike* dhe *alegorike*, dhe duhet të përkthehen në një *kuptim të dytë – kuptim të përcjellë*.²³

Ignaz Goldziher, në lidhje me këtë problematikë, përmend tre terma të rëndësishme hermeneutike nga komentimi i Kur'anit nga Zamahsheriu, dhe ato janë:

- shprehje imagjinare ose imazhe poetike, arabisht: *tahjil* (تحويل),

- *temthil*-تمثيل ose komunikimi i mesazhit të Kur'anit nëpërmjet citimit të shembujve, dhe

- *tasuair*-تصوير ose paraqitje e shembujve të pazakontë, paraqitje imagjinare.

19. Rifet Šahinović, “Božiji atributi”, *Glasnik*, nr. 11-12., Rijaseti i Bashkësisë Islame në BeH, Sarajevë, 2010, f. 1065.

20. Prof. dr. Adnan Silajdžić, *Rane škole kelama (Uvod u islamsko klasično mišljenje)*, vep. cit. f. 285.

21. Rifet Šahinović, Božiji atributi“, vep. cit., f. 1065.

22. Më shumë rreth këtyre dy termave, shih në: Enes Karić, *Kur'an u savremenom dobu I*, El-Kalem, Sarajevë, 1997, f. 174-178.

23. Enes Karić, *Kako tumačiti Kur'an*, Tugra, Sarajevë, 2005, f. 148.

Sipas *Goldziberit*, Zamahsheri u i vuri këto tri terma (tahjil, temthil, tasuir) në hermeneutikën e tij të Kur'anit. Ortodoksia, kundër së cilës Zamahsheri luftoi, konsideroi, për shembull, se deklarata Kuranore (“e Djathta e Zotit”): është e palejueshme për të kuptuar përtej domethënies themelore të fjalëve që janë përbrenda.

Miço Ljubibratić, përkthyesi i parë i Kur'anit në gjuhën serbo-kroate, ajetin 67 të sures Ez-Zumer²⁴, e përktheu si vijon: “... e tërë toka do të jetë vetëm një grusht pluhuri në duart e Tij, dhe qiejt do të jenë të mbështjella si një fashë në të djathtën e Tij...”²⁵ (Ez-Zumer, 67).

Ndërsa Besim Korkuti, përkthyesi i Kur'anit në gjuhën boshnjake, këtë ajet e përkthen si vijon: “... e gjithë Toka në Ditën e Gjykimit do të jetë në sundimin e Tij, e qiejt në fuqinë e Tij të mbështjellë do të mbesin...”²⁶ (Ez-Zumer, 67).

Sipas Zamahsherit, nëse shprehjet “dora e Zotit” (يد الله), “syri i Zotit” (عين الله), “afërsia e Zotit” (قرب الله), etj., përkthehen dhe interpretohen fjalë për fjalë, atëherë, siç thotë ai, nga konceptimi transcendental i Allahut nuk mbetet pothuajse asgjë.²⁷

24. Ajeti: “وما قدروا الله حق قدره والأرض جميعا قبضته يوم”
”القيامة والسموات مطويات بيمينه سبحانه وتعالى عما يشركون”.

25. *Koran*, Miço Ljubibratić (Hercegovac), Sarajevë, 1990, f. 341.

26. *Kur'an s prevodom*, përktheu: Besim Korkuti, Medinetu el-Munevereh, Arabia Saudite, 1990, f. 465.

27. Enes Karić, *Kako tumačiti Kur'an*, vep. cit.,

Në gjuhën arabe fjalët nga këto sintagma kanë një kuptim të gjerë. Sipas fjalorit të Ibn Mendhurit, fjala *jed*²⁸ (me kuptim themelor të *dorës*) do të thotë: dinjitet, nder, reputacion, autoritet, fuqi, pushtet, mbrojtje, etj. Zamahsheri, duke e ditur për kuptime të tilla të fjalës, në interpretimin e tij kishte shmangur imazhin antropomorf të Zotit. Në këtë, siç thotë Prof. dr. Enes Karić, nga të gjithë përkthyesit tanë të Kur'anit më besnikë i qëndroi Korkuti, duke i përkthyer zakonisht këto fraza *metaforikisht* e jo *tekstualisht* (fjalë për fjalë).²⁹

Prof. dr. Enes Karić, thotë se përkthyesit tanë (përkthyesit e Kur'anit në gjuhën boshnjake, A.J.) shpesh u lëkundën se kë të kënaqin (përkrahin) dhe si t'i përkthejnë ajetet e paqarta “muteshabih” të

f. 150.

28. **Ibn Mendhuri** pretendon se fjala *jed* do të thotë *pëllëmbë*, pastaj e përmend filologun e njohur Ibn Is'hakun, i cili specifikon se në gjuhën arabe fjala *jed* (dora) paraqet një pjesë e trupit nga majat e gishtave deri te pëllëmba: اليد الكف وقال أبو إسحق اليد من أطراف الأصابع إلى الكف. Megjithatë, shumë shpejt kalon në kuptimin metaforik të fjalës *jed* në arabisht. Ai, për shembull, argumenton se fjala do të thotë “bekim” dhe “bamirësi”. Dhe përmend mendimin se fjala *jed* do të thotë “pushtet” dhe “fuqi”: واليد - والإحسان - والقوة وأيد الله أي قواه وما لي بفلان يدان أي طاقة وفي التنزيل العزيز والسماء يتيناها بأيدي. Shih: Ibn Mandhur, *Lisanul arab*, vëll. 15, Dar es-Sadiri, Beirut, pa vit botimi, f. 419. Gjithashtu: Enes Karić, *Kako tumačiti Kur'an*, vep. cit., f. 150. (shënimi 34).

29. *Ibid.*, f. 151.

Kur'anit.³⁰ Ai thotë gjithashtu se nga origjinali më së shumti u “largua” Korkuti, ndërsa M. Ljubibratić dhe Dž. Čaušević shpesh ishin “literal” (të fjalëpërfjalshëm). Arsyeja për këtë është në pikëpamjet divergjente në lidhje me konceptin islam të Zotit. “Zoti transcendental” nga përkthimi i Korkutit ndryshon nga “koncepti ortodoks i Zotit” nga përkthimi i Dž. Čaušević dhe M. Ljubibratić.³¹

Atributet e Zotit në përkthimin dhe komentimin e Kur'anit nga H. Sherif Ahmeti

Është e njohur se, dhe është shumë larg asaj, - thotë Sherif Ahmeti, - Zoti ka trup, se ka zënë vend në hapësirë, se është i lëvizshëm ose jo, se është i karakterizuar me ndjenjat e jashtme dhe të brendshme sikurse njeriu. Atij nuk i përngjan asgjë. Megjithatë, në mënyrë për të përmbushur vullnetin e njeriut, dhe për t'i ndihmuar njeriut, Zoti i Madhërishëm, në shpalljen e fundit, në Kur'an ka përmendur atributet që i përkasin Atij të Plotfuqishmit, (por) në mënyrë që Zoti të mbetet i pakrahasueshmi, siç edhe është në fakt.³²

30. Ibid., f. 153.

31. Ibid., f. 154.

32. Sherif Ahmeti, *Komente dhe mendime islame*, Lidhja, Prishtinë, 1995, f. 52. Po ashtu: Sherif Ahmeti, “Allahu është më i madhi”, *Edukata Islame*, nr. 11-12, 1974, f. 37-41.

Sherif Ahmeti po ashtu thotë se, Zoti me qëllim që të ndihmojë edhe më tepër ndjenjat e njeriut që edhe më tepër të kuptojnë lidhjen, Ai qenien e vet e afroi krejt afër kuptimit të njeriut. Në shumë vende në Kur'an qenies së vet i dha forma, pozita, të cilat duken se janë të ngjashme me të njeriut, edhe pse Ai nuk është i ngjashëm me asgjë, por vetëm për t'i plotësuar dëshirën dhe për t'ia ruajtur ndjenjat.³³

Në vazhdim do të shohim se si Sherif Ahmeti i përkthen ajetet e caktuara të cilat flasin për atributet e Zotit:

- Në faqen 34 të përkthimit dhe komentimit të Kur'anit, Sherif Ahmeti ajetin 29 të sures el-Bekare e përktheu si vijon: **“Ai (Allahu) është që për juve krijoi gjithçka ka në tokë, pastaj vullnetin e vet ia drejtoi qiellit...”** (El-Bekare, 29);

- Në faqen 52 të përkthimit dhe komentimit të Kur'anit, Sherif Ahmeti ajetin 115 të sures el-Bekare³⁴ e përktheu si vijon: **“... dhe kahdo që të ktheheni, aty është ana e Allahut...”**³⁵ (El-Bekare, 115);

- Në faqen 69 të përkthimit dhe komentimit të Kur'anit, Sherif Ahmeti ajetin 210 të sures el-Bekare³⁶

33. Ibid., f. 52.

34. Ajeti është: “ولله المشرق والمغرب فأينما تولوا فثم وجهه” “الله إن الله واسع عليم”.

35. *Kur'an-i, përkthim me komentim*, përktheu dhe komentoi: H. Sherif Ahmeti, *vep. cit.*, f. 52.

36. Ajeti është: “هل ينظرون إلا أن يأتيهم الله في ظلل من الغمام والملائكة وقضي الأمر وإلى الله ترجع الأمور”

e përktheu si vijon: **“Ata nuk janë duke pritur tjetër, por vetëm t’u vijë Allahu (urdhëri i Allahut në ditën e gjykimit)...»**³⁷ (El-Bekare, 210).

Sherif Ahmeti, duke komentuar këtë ajet, në faqen 72, thotë: “Ardhja e Zotit dhe engjëjve nëpërmjet reve, ka të bëjë me ditën e gjykimit dhe paraqet madhërinë e një tmerri të madh ku i tërë sundimi atë ditë i takon vetëm Allahut, e Ai shpërblen të mirët dhe i ndëshkon të këqijtë.”³⁸;

- Në faqen 172 të përkthimit dhe komentimit të Kur’anit, Sherif Ahmeti ajetin 64 të sures El-Maide³⁹ e përktheu si vijon: “Jehuditë thanë: **“Dora e Allahut është e shtrënguar!”**⁴⁰ (El-Maide, 64);

- Në faqen 200 të përkthimit të Kur’anit, Sherif Ahmeti ajetin 103 të sures el-En’am⁴¹ e përktheu si vijon: **“Të parët (e njerëzve) nuk mund ta përfshijnë Atë, e Ai i përfshin të parët...”**⁴² (El-En’am, 103).

Në komentimin e këtij ajeti, në të njëjtën faqe, thotë: “Në domethënien e ajetit dijetarët islamë janë të ndarë në mendime. Çka është më e sigurt: Zotin do ta shohim në botën tjetër.”

- Në faqen 221 të përkthimit

37. Ibid., f. 69.

38. Ibid. f. 72.

39. Ajeti është: “وقالت اليهود يد الله مغلولة غلت أيديهم...”
 “ولعنوا بما قالوا بل يدها مبسوطتان ينفق كيف يشاء”.

40. Ibid., f. 172.

41. Ajeti është: “لا تدركه الأبصار وهو يدرك الأبصار وهو اللطيف الخبير”.

42. Ibid., f. 200.

dhe komentimit të Kur’anit, Sherif Ahmeti ajetin 54 të sures el- A’raf⁴³ e përktheu si vijon: **“Vërtet, Zoti juaj, Allahu është ai që krijoi qiejt e tokën brenda gjashtë ditësh, pastaj qëndroi mbi Arshin...”**⁴⁴ (El-A’raf , 54).

Në komentimin e këtij ajeti, në faqen 222 të përkthimit dhe komentimit të Kur’anit, Sherif Ahmeti thotë si vijon: “... Qëndrimi i Zotit mbi Arshin duhet besuar bindshëm e pa kurrfarë komentimi...”⁴⁵.

Në kontekstin për *Fronin e Zotit* (‘Arshin), siç është përmendur në Kur’an, Ebu Hanife mendon se shprehja duhet të merret në kuptimin fjalë për fjalë të vendeve të ndryshme. Duke pasur parasysh se Zoti është Krijues i vendit, nuk mund të thuhet se Ai është i kufizuar në hapësirë. Ai është aty ku ishte edhe para krijimit të hapësirës. Duke e kundërshtuar mendimin e antropomorfistëve se Zoti është në vendin e caktuar, ai thotë: “Në mësojmë se Allahu u ul në Fronin e Tij, por këtë nuk e kishte si të patjetërsueshme”. Tahaviu e përkrahu mendimin e Ebu Hanifes pa hyrë në shpjegime të mëtejshme, kurse Maturidiu shkoj një hap përpara duke i komentuar këto

43. Ajeti është: “إن ربكم الله الذي خلق السماوات... والأرض في ستة أيام ثم استوى على العرش”.

44. *Kur’an-i, përkthim me komentim*, përktheu dhe komentoi: H. Sherif Ahmeti, *vep. cit.*, f. 221.

45. Ibid., f. 222.

ajete në mënyrë racionale, kështu që ai e refuzon mendimin e atyre që thonë se *Froni* (*Arshi*) është vendi i posaçëm mbi të cilin është Zoti, por është edhe kundër atyre që thonë se Zoti është në çdo vend.⁴⁶

- Në faqen 298 të përkthimit dhe komentimit të Kur'anit, Sherif Ahmeti ajetin e 7 të sures Hud⁴⁷ e përktheu si vijon: “**Ai është i cili krijoi qiejt e tokën brenda gjashtë ditëve (fazave), e Arshi (Froni) i Tij kishte qenë (më parë) mbi ujë...**”⁴⁸ (Hud, 7);

- Në faqen 334 të përkthimit dhe komentimit të Kur'anit, Sherif Ahmeti ajetin e 2 të sures er-Ra'd⁴⁹ e përktheu si vijon: “**... Ai mbizotëroi Arshin...**”⁵⁰ (Er-Ra'd, 2);

- Në faqen 429 të përkthimit dhe komentimit të Kur'anit, Sherif Ahmeti ajetin e 5 të sures Ta-Ha⁵¹ e përktheu si vijon: “**... (E Ai është) Mëshiruesi që krijoi tokën dhe qiejt e lartë.**”⁵² (Ta-Ha, 5);

- Në faqen 501 të përkthimit dhe komentimit të Kur'anit, Sherif Ahmeti ajetin e 59 të sures el-

Furkan⁵³ e përktheu si vijon: “**... e pastaj mbizotëroi Arshin...**”⁵⁴ (El-Furkan, 59);

- Në faqen 543 të përkthimit dhe komentimit të Kur'anit, Sherif Ahmeti ajetin e 88 të sures el-Kasas *كل شيء هالك إلا وجهه* nuk e përkthen fare, ndërsa në botimin e përkthimit të tij të Kur'anit në vitin 1993 në Medine, në këtë ajet është bërë intervenimi, dhe ky ajet është përkthyer kështu: “**...Veç Allahut mos adhuro ndonjë zot tjetër, s'ka të adhuruar tjetër veç Tij. Çdo send zhduket e Ai jo. Vetëm Atij i takon gjykimi dhe tek Ai do të ktheheni!**”⁵⁵ (El-Kasas, 88).

Në komentin e këtij ajeti në faqen 544, Sherif Ahmeti thotë si vijon: “... madhëria i takon vetëm Allahut që çdo send zhduket e Ai jo...”⁵⁶;

- Në faqe 571 të përkthimit dhe komentimit të Kur'anit, Sherif Ahmeti ajetin e 4 të sures es-Sexhde⁵⁷ e përkthen si vijon: “**... pastaj mbizotëroi Arshin...**”⁵⁸ (Es-Sexhde, 4).

53. Ajete është: “الذي خلق السماوات والأرض وما بينهما”
”في ستة أيام ثم استوى على العرش”.

54. Ibid., f. 501.

55. *Kur'an-i përkthim me komentim në gjuhën shqipe*, përktheu dhe komento: H. Sherif Ahmeti, Arabia Saudite, 1413 h., 1993, f. 452.

56. *Kur'an-i, përkthim me komentim*, përktheu dhe komento: H. Sherif Ahmeti, *vep. cit.*, f. 544.

57. Ajete është: “الذي خلق السماوات والأرض وما”
”بينهما في ستة أيام ثم استوى على العرش”.

58. Ibid., f. 571.

46. Për më shumë shih: Prof. dr. Adnan Silajdžić, *Rane škole kelama (Uvod i islamsko klasično mišljenje)*, *vep. cit.*, f. 287.

47. Ajete është: “وهو الذي خلق السماوات والأرض في ستة”
”أيام وكان عرشه على الماء”.

48. Ibid., f. 278.

49. Ajete është: “الله الذي رفع السماوات بغير عمد ترونها”
”ثم استوى على العرش”.

50. Ibid., f. 334.

51. Ajete është: “الرحمن على العرش استوى”.

52. Ibid., f. 429.

Në komentimin e këtij ajeti, në faqen 572, thotë: **“Kur’ani është shpallje prej atij Zoti që krijoi qiejt e tokën dhe gjithçka tjetër brenda gjashtë dite, që mbizotëroi gjithësinë dhe që udhëheq me të gjitha çështjet”**⁵⁹;

- Në faqen 742 të përkthimit dhe komentimit të Kur’anit, Sherif Ahmeti ajetin 27 të sures Rrahman⁶⁰ e përktheu si vijon: **“E do të mbetet vetëm Zotin yt ...”**⁶¹ (Err-Rrahman, 27), e nuk e përktheu siç është në origjinalin Kuranor: **“E do të mbetet vetëm Fytyra e Zotit...”**;

- Në faqen 797 të përkthimit dhe komentimit të Kur’anit, Sherif Ahmeti ajetin 42, të sures Kalem⁶² e përktheu si vijon: **“(Përkujto) Ditën kur ashpërsohet çështja deri në kulm (në kijamet)...”**⁶³

Besim Korkuti në gjuhën boshnjake këtë pjesë të ajetit e përktheu si vijon: “Në Ditën kur të bëhet e padurueshme...”, dhe në këtë mënyrë, edhe këtu bën përjashtim nga përkthimi tekstual dhe e ndjek Zamahsheriun, i cili fjalët e Allahut: *“Në Ditën kur të zbulohet këmba ...”* e merr në kuptimin: *“Në ditën kur të bëhet e padurueshme...”*. Zamahsheriun *sakun* (këmba) e përkthen me fjalën *shiddetun* (e padurueshme, vështirësi). Këtu, sipas Zamahsheriut, nuk ka

këmbë, dhe as që ka ndonjë zbulim (*La keshfe ve la saka*).⁶⁴ Prof. dr. Enes Karić⁶⁵ dhe Mićo Ljubibratić⁶⁶ në ajetin e lartpërmendur, fjalën *sak* e përkthejnë tekstualisht si “këmba”. Dhe është tejet interesant përkthimi i Muhammed Asadit: *“Në Ditën kur vetëm qenia njerëzore të jetë e zhveshur deri në kockë ...”*⁶⁷

Sherif Ahmeti përmend mendimin e Sharaviut për çështjen e *dialogut rreth Zotit*, dhe thotë: “Po që se njerëzit - filozofët të jenë ndalur në atë që vetë logjika mundëson rreth njohjes së fuqisë mbinatyrore (Zotit, A. J.), do të ishte e mjaftueshme. Megjithatë, ajo që shkaktoi dialogun i mërzi ata dhe i lodhi pa nevojë, fakti është se ata kanë hyrë në hulumtim dhe studim në lidhje me diçka që nuk ishte në vend (nuk ishte nevojë urgjente, A.J.)”.

Sherif Ahmeti, në përgjithësi rreth shpjegimit të cilësive të Zotit, thotë: “Shpjegimet që iu dhanë këtyre teksteve të Kur’anit janë të fjalë për fjalë me aq sa mundet të kuptohet nga thesari i gjuhës arabe, megjithëse kuptimi i tyre është shumë më i gjerë dhe qëllimin final të këtyre thënieve e di vetëm Zoti xh.sh.”⁶⁸

64. Dr. Jusuf Ramić, *Tefsir – historija i metodologjia*, vep. cit., f. 291.

65. *Prijevod Kur’ana*, preveo Enes Karić, vep. cit., str. 565.

66. *Koran*, Mićo Ljubibratić (Hercegovac), vep. cit., str. 429.

67. Shih: *Poruka Kur’ana, prijevod i komentar: Muhammed Asad*, nga anglishtja përktheu: Hilmo Čerimović, vep. cit.,

68. Sherif Ahmeti, *Komente dhe mendime*

59. Ibid., f. 572.

60. Ajeti: “ويبقى وجه ربك ذو الجلال والإكرام”.

61. Ibid., f. 742.

62. Ajeti: “يوم يكشف عن ساق ويدعون إلى السجود فلا يستطيعون”.

63. Ibid., f. 797.

Përfundim:

Gjeneratat e para (*selef*) konsideronin se duhet t'i përmbahemi tekstit të shpallur, por nuk i lejonin vetes shpjegimin e teksteve Kuranore që flasin për atributet e Zotit xh.sh. Ata nuk u treguan të lirë/liberalë në kuptimin e tyre e as që mohuan gjë nga ajo se si është njohja e cilësive të Zotit dhe Qenies së Tij përtej aftësive e të kuptuarit të mendjes së njeriut. Mirëpo, gjeneratat e mëvonshme (*balef*) u treguan të lirë në komentimin e kuptimeve të tyre.

Mësimi rreth attributeve të Zotit është diçka e huazuar nga doktrinat e feve të tjera, kryesisht nga krishterimi. Fillimisht, me këtë problematikë filloi të merret Filoni, e pas tij, idenë e Zotit të panjohur (pamundësisë për ta njohur Zotin), në mendimet e veta, do ta fusin Albini dhe Plotini, e nëpërmjet tyre, do ta merrte patriarkana lindore e krishterë dhe teologjia e hershme myslimane në mësimet e veta të drejtimit mu'tezilitë.

islame, vep. cit., f. 53.

H. Sherif Ahmeti, siç kuptuam edhe nga teksti i mësipërm, ajetet që flasin për atributet e Zotit do të duhej të përkthehen fjalë për fjalë, pra, tekstualisht, megjithatë, nga përkthimet e ajeteve të përmendura më lart nga H. Sherif Ahmeti, shohim se ai nuk e përfilli në praktikën e përkthimit këtë rregull në përpikëri, kështu që është lëkundur gjatë përkthimit, nganjëherë këto ajete i përktheu fjalë për fjalë, gjë që ishte një rast shumë i rrallë, ndonjëherë i përktheu fjalë për fjalë (si në origjinal), por në kllapa jepte komente e që, në shumicën e rasteve, sikurse pamë nga shembujt e përkthimit të tij, mendoj se kishte ndjekur Besim Korkutin në përkthimin e tij, ndërsa në komentim - mendimet dhe komentet e Zamahsheriut dhe tefsirin e tij *Keshaf*.

Në fund të kësaj problematike, mendoj se nuk do të ishte e tepërt nëse e përmendim J. J. G. Jansenin, i cili me të drejtë pohon “se *komentimi i Kur'anit nga Zamahsheriun duhet studiuar kryesisht si një vepër filologjike, e jo si vepër dogmatike (teologjike)*.”⁶⁹

69. *Koran*, përktheu: Mico Ljubibratic (Hercegovac), *vep. cit.*, f. 16.

Literatura:

1. Ahmeti, Sherif (1974), “Allahu është më i madhi”, **Edukata Islame**, nr. 11-12, Prishtinë.
2. Ahmeti, Sherif (1995), *Komente dhe mendime islame*, Lidhja, Prishtinë.
3. Asad, Muhammed (2004), *Poruka Kur’ana*, nga anglishtja përktheu: Hilmo Ćerimović, El-Kalem, Sarajevë.
4. Ebu Hanife, *Fikhu-l-ekber*.
5. El-Maturidi, “Traktat o islamskom vjerovanju”.
6. Ibn Mandhur, *Lisanul arab*, vëll. 15, Dar es-Sadiri, Bejrut, pa vit botimi.
7. Karić, Enes (1997), *Kur’an u savremenom dobu I*, El-Kalem, Sarajevë.
8. Karić, Enes (2005), *Kako tumačiti Kur’an*, Tugra, Sarajevë.
9. Korkut, Besim (1990), *Kur’an s prevodom*, përktheu: Medinetu el-Munevvereh, Arabia Saudite.
10. *Kur’an-i përkthim me komentim në gjuhën shqipe*, përktheu dhe komentoi: H. Sherif Ahmeti, Arabia Saudite, 1413 h., 1993.
11. Ljubibratić (Hercegovac), Mićo (1990), *Koran*, Sarajevë.
12. Poljak, M. (2009), “Filon Aleksandrijski kao spona 658 između antike i srednjeg vijeka”, **Filozofska istraživanja**, Viti 29, vëll. 4, Zagreb.
13. Ramić, Jusuf (2001), *Tefsir – historija i metodologija*, FIN, Sarajevë.
14. Šahinović, Rifet (2010), “Božiji atributi”, **Glasnik**, nr. 11-12., Rijaseti i Bashkësisë Islame në BeH, Sarajevë.
15. Šahinović, Rifet (2010), „Božiji atributi“, **Glasnik**, nr. 11-12, Sarajevë.
16. Silajdžić, Adnan (1999), *Filozofijska teologija Abu al-Hasana al-Aš’arija*, BKC, Sarajevë.
17. Silajdžić, Adnan (2004), *Rane škole kelama (Uvod u islamsko klasično mišljenje)*, FIN, Sarajevë.

Kontributi i medresesë “Alauddin” për arsimin fetar dhe kauzën kombëtare gjate viteve 1985-1995

Prof. Dr. Qazim Qazimi, Kosovë

Abstrakt

Medreseja “Alauddin” me veprimtarinë e saj arsimore fetare shumë të suksesshme, sikundër edhe me aktivitetet e saj të gjithmbarshme, në të gjitha format e mundshme, dha kontribut të pazëvendësueshëm dhe të pakërbasueshëm konform zhvillimit të gjithanshëm të arsimit shqip në Kosovë.

Kjo medrese, që nga themelimi e në vazhdimësi, i ka kontribuar arsimit fetar për të përgatitur kuadro për të gjitha trojet shqiptare, por edhe jashtë saj. Ajo me veprimtarinë arsimore-edukative, sikundër edhe me aktivitetet e saj të gjithanshme, dha kontribut të pakontestueshëm edhe për kauzën kombëtare.

Duhet pranuar se fati i Medresesë “Alauddin” ishte dhe vazhdon të jetë i lidhur ngushtë me fatin e popullit shqiptar në përgjithësi e atë të Kosovës në veçanti.

Medreseja “Alauddin” e Prishtinës është institucion i ciklit të mesëm shkollor që merret me arsimimin dhe edukimin e të rinjve myslimanë në shkencat islame dhe fusha të tjera të dijes. Medreseja filloi punë në vitin shkollor 1951-

52¹, saktësisht me datë 01/11/1951, në lokalet e një mejtepi, që gjendej në oborrin e xhamisë “Alauddin” në lagjen Vellusha e Epërme në Prishtinë, në fillim si shkollë e ciklit të ulët, për t’u avancuar më vonë,

1. Shih: I. Lanza, “Pasqyrë e shkurtër e veprimtarisë së Medreses në Prishtinë”, Edukata Islame, nr. 15-16, Prishtinë, 1976.


pas 11 vitesh, në shkollë të mesme. Medreseja e Mesme në Prishtinë nisi punën në shtator të vitit shkollor 1962-63.²

Duhet theksuar se prej themelimit të Medresesë, kolektivi punues i saj është ballafaquar me vështirësi të konsiderueshme, për arsye se veprimtarinë e vet arsimore-edukative, që e zhvillonte në kushte dhe rrethana tejet të vështira, qoftë për shkak të infrastrukturës së dobët, problemeve financiare, por edhe mungesës së teksteve për lëndët profesionale. Mirëpo, pas një angazhimi intensiv gjashtëvjeçar të Bashkësisë Islame të Kosovës dhe këmbënguljes së kolektivit punues të saj për punë sa më të suksesshme në mësimdhënie dhe aktivitete të tjera, u ndërtua objekti i ri i Medresesë, përfundimi i të cilit u bë më 14/ 09/ 1985.³

Medreseja që nga 1985 do të kishte një objekt modern. Në ambientet e saj tani gjendet edhe konvikti i përbërë nga 72 dhoma gjumi, i pajisur me të gjitha mjediset e nevojshme për zhvillimin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies në nivel bashkëkohor. Në ambientet e Medresesë, përveç tjerash ka: xhami, salla leximi, bibliotekë, kuzhinë, sallë ngrënie, apo edhe palestër sportive etj.⁴

Puna më specifike në Medrese dhe aktivitetet e njëpasnjëshme do të ndodhin pikërisht pas kalimit në objektin e ri të Medresesë.

Nisur nga këto favore, që në vitet '90, Medreseja "Alauddin" do të organizonte Programin për Festën e Kurban Bajramit, që do të transmetohej për herë të parë përmes RTP-ës për Rrjetin televiziv Jugosllav, nga Xhamia e Madhe në Prishtinë, më 03. 07. 1990, që nga ora pesë e mëngjesit.



Dokumenti: Skenari i hartuar në 14 faqe për festën e Kurban Bajramit në qershor të vitit 1990.

2. Po aty.

3. <http://medreseja.com/Kategoria/prezantim-i-shkolles/historiku-i-shkolles/>

4. Shih, <https://sq.wikipedia.org/>

[wiki/Medreseja_Alauddin#Fillet_e_medreseve_n.C3.AB_trevat_shqiptare](https://www.wikidata.org/wiki/Medreseja_Alauddin#Fillet_e_medreseve_n.C3.AB_trevat_shqiptare)



Në fotografi: Kori i nxënësve të Medresesë gjatë shfaqjes së programit në ambientet e Xhamisë së Madhe (Sulltan Fatih). Prishtinë, më 03. 07. 1990.

Duhet potencuar se pas marrjes së autonomisë së Kosovës nga qeveria serbe në vitin 1989, hapi i parë që ndërmoi Serbia, ishte ndalimi i punës së institucioneve arsimore në gjuhën shqipe. Dhe kjo do të ndodhë pas refuzimit të plotë të planprogrameve serbe nga autoritetet e Prishtinës. Si hakmarrje ndaj refuzimit dhe për qëllime politike, Serbia përjashtoi nga puna rreth 23.000 mësimdhënës shqiptarë dhe largoi nga objektet shkollore dhe universitare rreth 500.000 nxënës dhe studentë. Ky akt barbar shkaktoi pasoja të mëdha

në zhvillimin normal të sistemit të arsimit dhe i imponoi zhvillimin e sistemit arsimor për kushtet lufte.

Dëbimi i nxënësve dhe i studentëve shqiptarë nga ambientet shkollore e hapësirat universitare dhe ndërprerja e të gjitha aktiviteteve mësimore dhe studimore nga shtatori i vitit 1991 deri në janar 1992, bëri që Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë “Naim Frashëri” LASH-i⁵ në bashkëpunim me subjekte të tjera arsimore dhe politike të merrte vendimin për organizimin e procesit mësimor në shtëpi private që më vonë u quajtën “Shtëpi-shkolla”.

5. Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë “Naim Frashëri” e themeluar më 12.12.1990. LASH-i përcaktoi frymën e një rezistence masive kundër planeve diskriminuese serbe ndaj arsimit shqiptar në Kosovë.

SHËNUAR NË MEDRESENË «ALAUDIN» NË PRISHTINË

SHKOLLA FETARE EDHE NË FUNKSION TË ÇËSHTJES KOMBËTARE

Medresea funksionon që nga viti 1952 si shkollë fillore, kurse nga viti 1962 shkollë e mesme. — Gjatë kësaj periudhe nëpër këtë vatër edukativo—arsimore kaluan mbi 1.500 nxënës, kurse e kryen rreth një mijë sish. — Nga ky vit shkollor Medresea është në kuadër të shkollave shtetërore të Republikës së Kosovës

Tash e 42 vjet në Prishtinë funksionon medresea «Alaudin», nëpër të cilën ka kaluar një numër i madh nxënësish. Mirëpo, nga ky vit shkollor kjo vatër edukativo—arsimore është në kuadër të shkollave shtetërore të Republikës së Kosovës dhe në të shkollohen nxënës nga tërë Kosova dhe më gjërë.

Sic u informuam nga Qazim Qazimi, drejtor, Medresea funksionon që nga viti 1952. Atë botë ishte e rangut të shkollës fillore, përkatësisht medrese e ulët, kurse nga viti 1962 është shkollë e mesme. Një kohë ishte pesëvjeçare, kurse nga viti 1989 është shkollë e mesme katërveçare. Nëpër Medresea deri më tash kanë kaluar rreth 1.500 nxënës, kurse e kanë kryer afro një mijë sish. Nxënësit tanë pas kryerjes së Medresës kanë studiuar dhe studiojnë nëpër 22 universitete të katër kontinenteve të botës dhe kudo që gjenden ata dallohen për nga njohuritë dhe kultura që posedojnë. Për këtë edhe jemi krenarë.

Medresea «Alaudin» në Prishtinë ka edhe paralelet e veta të ndara, si në Prizren, që u hapën për herë të parë në këtë vit shkollor dhe në Novi-Pazar, ku mësimi zhvillohet në gjuhën boshnjake e



Medresea «Alaudin» në Prishtinë — shkollë e mesme shtetërore: Çast nga procesi edukativo—arsimor në këtë vatër të diturisë

I-IV. Kuadrot e kësaj vatre edukativo—arsimore janë plotësisht të kualifikuara. Këtu mësohen 25 lëndë mësimore. Përveç lëndëve profesionale të mësimin fetar, mësohen edhe lëndët e saktë dhe ato shoqërore, si histori—kombëtare dhe gjeografia e viseve etnike shqiptare, pastaj mësohen katër gjuhë, si gjuha shqipe (tri orë në javë), gjuha arabe (pesë), osmano—turke (dy) dhe gjuha angleze (dy orë në javë). Gjatë këtij vit shkollor

ushqehen tri herë në ditë, kurse nëpër dhoma të fjetjes janë të vendosur nga 2–4 veta. Për këto kushte pagesa është mjaft simbolike, përkatësisht ata paguajnë vetëm 15 DEM në muaj.

Do përmëndur se mësimi në Medresea zhvillohet në kushte okupimi. Edhe këta shkollorë e ndajnë fatin e moshatarëve të tyre që i vijnë mësimet në shkollat e tjera të mesme të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare jashtë shtetit shqiptar. As kjo vatër edukativo—arsimore nuk është kursyer nga okupatori serb. Shumë herë në të ka hyrë policia serbe, të cilët në mënyrë me brutale kanë shkatërruar mobiliet dhe orenditë shkollore dhe ato të jetesës. Ndërhyrje pollore ka pasur edhe në kohën e Ramazanit të sivjetshëm. Megjithatë, pra pavarësisht nga torturat që mund t'u bëjnë policia serbe nxënësve dhe arsimtarëve të kësaj vatre edukativo—arsimore, medresea «Alaudin» në Prishtinë në radhë të parë është vënë në funksion të çështjes fetare, por dhe të çështjes kombëtare shqiptare. Për interesat kombëtare Medresea përherë i ka dyert e hapura, tha në fund të bisedës Qazim Qazimi, drejtor i kësaj shkolle të mesme në Prishtinë.


Në ato kohë të vështira edhe në Medresea ndodhin ndryshime. Kështu që nga viti 1991, për herë të parë do të kemi zgjedhje në Medresea. Administrata e re e Medresesë në krye me drejtorin porsazgjedhur Prof. Qazim Qazimin, vazhdon me aktivitetet e filluara më herët dhe duke intensifikuar edhe më shumë kontributin e Medresesë për arsimin fetar dhe kauzën kombëtare.⁶

Në këto kohë të vështira, Medresenë do ta vizitojë edhe

Atëherë kur u dëbuan me dhunë nxënësit dhe studentët shqiptarë nga ambientet shkollore dhe hapësirat universitare, kur u ndërprejnë të gjitha aktivitetet mësimore dhe studimore, kur u mbyllën të gjitha shkollat fillore dhe të mesme, kur nisi të aplikohet procesi mësimor në shtëpi private, këshilli mësimor-edukativ i Medresesë, me në krye drejtorin e atëhershëm, Prof. Resul Rexhepin, dhe me bekimin e Meshihatit, mori vendimin për strehimin e studentëve në ambientet e Medresesë - konviktin e saj dhe hapjen e sallave të mësimdhënies për ligjëruesit e Universitetit të Prishtinës.

6. Shih: Gazetën «Bujku», e premte, 20 maj, 1994, fq. 6, shënuar në Medresea, me titull, «Shkolla fetare edhe në funksion të çështjes kombëtare». Gazetar F. Kristaj.

nënkryetari i LDK-ës, Prof. Dr. Fehmi Agani, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit koordinues për çështjen e zhvillimit të mësimi në gjuhën shqipe në Republikën e Kosovës. Ai deklaroi se përkundër të gjitha vështirësive mësimi në Medrese duhet të vazhdojë.⁷



Duhet pranuar se fati i Medresës “Alauddin” ishte dhe vazhdon të jetë i lidhur ngushtë me fatin e popullit shqiptar (në përgjithësi) e atë të Kosovës në veçanti.

Në ambientet e Medresës janë zhvilluar edhe shumë aktivitete tjera jashtë procesit mësimor dhe atij profesional. Aty është organizuar edhe Akademia solemne e Universitetit të Prishtinës kushtuar 11-vjetorit të Lëvizjes Studentore të Kosovës.⁸

08.10.1993 Shih, Gazeta “Bujku”, e martë, 8. Shih: Gazetën “Bujku”, e enjte, 12, mars,

Medreseja me veprimtarinë e saj arsimore fetare shumë të suksesshme, sikundër edhe me aktivitetet e saj të gjithmbarshme, në të gjitha format e mundshme, dhe kontribut të pazëvendësueshëm dhe të pakrahasueshëm konform zhvillimit të gjithanshëm të arsimit shqip në atë periudhë në Kosovë.

Medreseja “Alauddin”, që nga themelimi e në vazhdimësi, i ka kontribuar arsimit fetar për të përgatitur kadro për të gjitha trojet shqiptare, por edhe jashtë saj. Ajo me veprimtarinë arsimore-edukative, sikundër edhe me aktivitetet e saj të gjithanshme, dhe kontribut të pakontestueshëm edhe për kauzën kombëtare.⁹



1992, f. 1 dhe 3. Me titull: “Kthesë Historike e Rezistencës Gjithëkombëtare”.

9. Shih edhe Gazetën “Bujku”, e martë, 14, Dhjetor, 1993, f. 4. me titull, “Medreseja “Alauddin” e Prishtinës, Vatër arsimore-fetare me rëndësi kombëtare”.

Medreseja në intervalin kohor 1985-1995 u bë vatër arsimore-fetare me rëndësi kombëtare dhe simbol i rezistencës shqiptare kundër okupatorit shekullor sllav dhe u bë fortifikatë për ruajtjen vlerave dhe të identitetit fetar e kombëtar në trojet shqiptare të okupuara nga ish Jugosllavia.¹⁰

Nga Universiteti i Prishtinës në ambientet e Medresesë “Alauddin”, në ato kohë dramatike për arsimin shqip, medreseja hapi dyert e veta për të gjithë dhe duke u organizuar ligjërata që mbaheshin nga profesorët e shumë fakulteteve të Universitetit të Prishtinës, si ata të Fakultetit të Filologjisë, Ekonomikut, Drejtësisë etj. Në ambientet e Medresesë ligjëruan shumë profesorë të fushave të ndryshme, por aty edhe u diplomuan shumë studentë, magjistruan, por u mbrojtën edhe doktoratura.¹¹



Në lokalet e saj janë organizuar edhe konferenca e seminare të ndryshme, madje edhe të niveleve ndërkombëtare, siç ishte: “*Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët*”, në tetor të viti 1992.¹² Janë mbajtur edhe shumë tribuna fetare e shkencore, kuice (pyetësorë) e gara diturie, sportive, tubime e manifestime të ndryshme. Në ambientet e Medresesë ka vepruar edhe “Lidhja e arsimtarëve shqiptarë - LASH-i”, ku një nënkryetar dhe një anëtar i Kryesisë së saj ishin Drejtori i atëhershëm dhe një profesor i Medresesë. Në ambientet e Medresesë ka funksionuar edhe “Shoqata Bamirëse Islame (SHBI)”, “Sami Frashëri”¹³, e themeluar në vitin 1990. Ajo ka ndihmuar arsimtarët shqiptarë, spitalet, policinë e Kosovës dhe mbarë popullatën aty ku e kërkonte nevoja.


12. “*Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët*”: simpozium ndërkombëtar i mbajtur në Prishtinë më 15-17 Tetor 1992. Organizuar nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës.

13. Shih gazetën “Shkëndija”, dhjetor, 1991, f. 12, me titull “*Shoqata Bamirëse Islame Sami Frashëri Ndihmon Arsimtarët Shqiptarë*”.

Shih edhe Gazetën “Bujku”, 28 tetor 1991, f. 2 me nëntitull “*Veprimtaria SHBH “Sami Frashëri”*”

10. Shih Gazetën “Bota e Re”, korrik, 1994, f. 4, me titull “*Dyertë e Hapura për të gjithë*”.

11. Janë mbrojtur dy magjistratura dhe dy doktoratura në kuadër të UP-së.



Në Medrese u themelua edhe “Shoqata e përbashkët Kosovaro-Sanxhakiane” 1992. Dje në Medresenë Mesme “Alauddin” të Prishtinës u mbajt Kuvendi Themelues i Shoqatës së përbashkët Kosovare-Sanxhakiane, lajmëronte Gazeta “Shkëndija” më 20.04.1992.¹⁴



Edhe “Shoqata e Intelektualëve Shqiptarë” 1992 u themelua në Medrese. Tubime të nivelit shtetëror ka mbajtur edhe “Sindikatat e


14. Shih gazetën “Shkëndija”, 20.04.1992, f. 12, me titull “U themelua Shoqata e përbashkët Kosovare Sanxhakiane”.

Pavarura të Kosovës”. Por edhe disa nga partitë politike shqiptare aty janë themeluar dhe kanë mbajtur tubimet konstituive, kuvendet dhe kongreset e tyre.

Është për tu mbajtur mend se me 23 qershor të viti 1992, ishte planifikuar të mbahej Kuvendi i Republikës së Kosovës në ambientet e Medresesë dhe me këtë rast një komision që ishte i caktuar për organizimin dhe përgatitjen e Kuvendit të Republikës së Kosovës ushtroi kërkesën për lejimin e objektit të Medresesë për këtë qëllim:


Në vazhdim po japim tri dokumente origjinale të kohës:

1. *Kërkesa e komisionit për përgatitjen e Kuvendit drejtuar Drejtorisë së Medresesë “Alauddin” Prishtinë : për lejimin e lokalit për mbledhjen e Kuvendit më 23 qershor 1992, e ushtruar në Prishtinë më 18.VI.1992, prej gjashtë anëtarëve të komisionit, emrat e të cilëve figurojnë në kërkesë dhe e firmosur nga katër anëtarë të atij komisioni të cilët kanë qitën nënshkrimin e tyre në kërkesë.*




2. Kontrata e lidhur për dhënien e objektit të Medresesë me qira për mbajtjen e Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 23 qershor 1992, në ambientet e Medresesë e nënshkruar nga zyrtarët e institucioneve:

Dr. Rexhep Gjergji dhe Qazim Qazimi - drejtor i Medresesë.



3. Ftesa e Kryetarit të Kuvendit të Ilaz Ramajlit, d.v. për drejtorin e Medresesë për pjesëmarrje si mysafir në mbledhjen konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës.



Por, për të keqen e të gjithëve, në të gdhirën e mëngjesit të 23 qershorit të vitit 1992, ndërhyri policia e Serbisë dhe brutalisht e pengoi mbajtjen e Mbledhjes themeluese të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe okupoi Medresenë për tri ditë rresht.¹⁵



Me këtë rast regjimi serb-policia keqtrajtoi, burgosi, trupin menaxhues dhe punëtorët teknik që ndodheshin në objektin e Medresesë dhe okupoi në mënyrë klasike Medresenë. Duhet theksuar se Medreseja mbeti e okupuar tri ditë rresht dhe ajo nga policia serbe u shndërrua në fortesë për vendosjen e tyre dhe si një lloj hoteli për akomodimin e tyre, duke shfrytëzuar të gjitha të mirat që ishin bërë gati për kuvendarët.¹⁶

15. Shih edhe gazetën “Bujku”, e mërkurë, 24 qershor, 1992, f. 1, 2 dhe 3, dje në Prishtinë “Mbjajtjen e Mbledhjes Themeluese të Kuvendit të Republikës së Kosovës e Pengoi Policia Serbe”.

16. Shih gazetën “Bujku”, e enjte, 25 qershor, 1992, f. 4, edhe dje Medreseja “Alaudin” në Prishtinë u mbajt e okupuar “Medreseja - Fortesë e policëve serbë”.



Në Medrese policia e Serbisë theu dhe shkatërroi shumëçka nga inventari i Medresesë dhe për këtë administrata mbajti një konferencë për shtyp ku u dënua okupimi i Medresesë dhe pos tjerash u tha se “U dëmtua rëndë inventari i Medresesë”, dhe u bënë vepra vandale.¹⁷

Për këtë rast kanë shkruar edhe mediat e kohës në Kosovë, ish Jugosllavi, por edhe “*Human Rights Watch*”.

Arrests in June 1992

On May 24, 1992, ethnic Albanians held elections in which they voted for representatives to the clandestine Albanian parliament and government. The Serbian authorities declared the voting to be illegal. On June 23, 1992, the opening session of the newly-elected Kosovo legislature was to have taken place in an Islamic religious school. The police prevented the meeting from being held and several persons were arrested. According to information received by Helsinki Watch from the Committee for the Defense of Human Rights and Freedoms in Kosovo, the June 23 meeting was to have been held at the “Alaudin”



17. Shih gazetën “*Bujku*”, e mërkurë, 24 qershor, 1992, f. 2, me titull “U dëmtua rëndë inventari i Medresesë”.

Duhet theksuar se Medreseja Alauddin e Prishtinës hapi paralelen e ndarë fizike në Jeni Pazar (Novi Pazar) dhe kjo paralele nisi punën më 17 shtator të vitit 1990 në ambientet e Këshillit të Bashkësisë Islame të Novi-Pazarit. Medreseja Alauddin e Prishtinës më 03.09.1993 ka hapur paralelen e ndarë të saj në Prizren dhe një vit më vonë, më 24 tetor, 1994, në lokalet e Këshillit të Bashkësisë Islame në Gjilan ka filluar punën edhe paralelja e ndarë fizike e kësaj Medreseje në Gjilan.²¹

Kështu që gjatë vitit shkollor 1995/96 Medreseja “Alauddin” numëronte 288 nxënës në Prishtinë, në Prizren 132, (në tri vite) dhe në Gjilan 80 nxënës në dy vite.²²

Medreseja “Alauddin” është pranuar në rangun e shkollave të mesme të Kosovës duke u zyrtarizuar në “Kumtari i Arsimit” i Shkollave të Mesme të Kosovës, (neni 39 dhe 42)²³.

Për këtë lajm të shumëpritur informonin edhe gazetat e kohës në gjuhën shqipe e ndër to edhe gazeta “Bujku”, e 24, dhjetorit, 1993, f. 3. me nëntitull, “Medreseja në kuadër të shkollave të mesme”.²⁴

21. Shih gazetën “Bujku”, 24 tetor, 1994, me titull, në Gjilan”. Filloi punën Paralelja e medresesë së Mesme”.

22. <http://medreseja.com/Kategoria/prezantim-i-shkolles/historiku-i-shkolles/>

23. Shih “Kumtari i Arsimit” i Shkollave të Mesme të Kosovës më 1994 (neni 39 dhe 42).

24. Shih edhe gazetën “Bujku”, e premte, 24, dhjetor, 1993, f. 3. me nëntitull, “Medreseja në

Medreseja në kuadër të shkollave të mesme

Pasi Zjedin Gashi komunikoi se tash e tutje edhe Medreseja «Alauddin» është në kuadër të shkollave të mesme të Kosovës, fjalën e mori Qazim Qazimi, drejtor i Medresesë. Ai, ndër të tjera, tha se në këtë shkollë të mesme mësimet i vijojnë 427 nxënës (këtu janë të llogaritur edhe nxënësit e paraleleve të ndara në Novi – Pazar dhe në Prizren). Mësimet e gjysmëvjetorit të parë kanë filluar më 1 shtator, por për shkak të specifikave që ka kjo shkollë, pushimet e gjysmëvjetorit të parë fillojnë më 4 shkurt, kur filion muaji i ramazanit, e përfundojnë më 15 mars të vitit të ardhshëm.

Duhet theksuar se në këtë interval kohor 1985-1995, një rëndësi e veçantë i është kushtuar përgatitjes dhe botimit të teksteve për nxënësit e Medresesë. Në vitin shkollor 1991/1992 u dizajnuar dhe u zyrtarizua “Emblema simbolike e Medresesë”²⁵



kuadër të shkollave të mesme”.

25. Shih emblemën e dizajnuar nga Prof. Nusret Simnica, bashkëpunëtor i jashtëm, i angazhuar me honorar.

Po për herë të parë dhe u shtyp (botua) “Plani dhe programet mësimore”.²⁶ Meqë nga e kaluara prej teksteve ishin trashëguar vetëm një libër-tekst (Historia e Pejgamberëve) dhe disa dispensa, gjatë viteve 1985-1995 janë botuar tetë tituj-tekste për nxënësit e Medresesë.

1-“*Historia Islame-II*”, Bajrush Ahmeti,1992.

2-“*Historia Islame-III*”, Bajrush Ahmeti, 1992.

3-“*Hyrje në shkencat kur’anore*”, Qazim Qazimi, 1993.

4-“*Shkencat e Hadithit*”, Qazim Qazimi, 1993.

5-“*Morali Islam- Ahlaku-1*”, Naim Tërnavë, 1993.

6-“*Bazat e Besimit-Akaidi-I*”, Naim Tërnavë, 1994.


7-“*Njëqind e një Hadithe*”, Bajrush Ahmeti, 1995.

8-“*Pasqyrë e Filozofisë Islame*”, Naim Tërnavë 1995.²⁷

Tekstet e botuara në Medresenë e Prishtinës janë përdorur edhe në medrese të tjera jashtë Kosovës. Madje, disa prej tyre janë ribotuar dhe aplikuar për mësimdhënie në medresetë respektive në gjuhën shqipe, por edhe në atë boshnjake.

Të themi edhe këtë (Duhet përmendur) se dhjetëvjeçari (1985-1995), ishte një periudhë kohore e

thyerjeve dhe kthesave të mëdha, ku Medreseja “Alauddin” e Prishtinës dha kontributin maksimal për arsimin fetar islam dhe kauzën kombëtare shqiptare, duke ndarë fatin dhe fatalitetin me popullin që e mbajti gjallë.²⁸



Këtë punim po e përmbyll me një shkresë të përcjellur përmes e-mailit me ish Presidentin e Kosovës, Prof. Dr. Fatmir Sejdiun, i cili për Medresenë shprehet:

I nderuari Prof. Qazim,

Ju faleminderit për e-mailin e dërguar. Kjo është një dëshmi e fuqishme për angazhimin Tuaj dhe gjithë kolektivit të Medresesë në proceset e mëdha për liri dhe pavarësi të Kosovës.

Me respekt,
Fatmir Sejdiu

26. Shih “Plani dhe programet (globale) mësimore të Medresesë së Mesme Alauddin”, Prishtinë, 1991.

27. Shih botimet e Medresesë në vitet 1991-1995.

28. Shih gazetën “Shkëndija”, 15, 04, 1992, f. 12, me titull “Medreseja Alauddin e Prishtinës në shërbime vitale të popullit”.

Projekti “Depërtoni pra...!”

Blerim Lazimi, Dibër

Abstrakt

*Fluturimet e para, lëshimi i satelitëve, shkelja e njeriut në Hënë, studimi i drejtpërdrejtë i Marsit, studimi i sistemit tonë diellor e më gjerë, janë prova se njerëzimi, dashur pa dashur, ka ecur në rrugën e planifikuar, ashtu si edhe Gjithësia. Kjo tregon saktësinë e Kur’anit, **çdo** fjali e të cilit është një argument më vete. S’ka dyshim se Kur’ani është fjala e Zotit. E si mund të jenë produkte të mendjes njerëzore të shekullit VII (e.s.) projekte kaq të qarta të zhvillimit të shkencës, metoda aplikimi kaq progresive, parashikime kaq precize për të ardhmen e njerëzimit?! Si mundet të konsiderohet Kur’ani fjalë e njeriut, kur ai në **çdo** këndvështrim është larg legjendave që mbizotëronin kohën?! Pa dyshim, projektin e publikoi vetëm Ai që e projektoi Gjithësinë, krijoi njeriun dhe gjithëka ka në qiej e tokë, Ai që është Zotërues i Dijes. Vetëm nën frymëzimin e Tij gjen zbatim praktikë që **çon** në zbulimin e së Vërtetës. Allahu e di të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e kozmosit dhe të njeriut.*

Anuk ua bëmë Ne Tokën si djep?¹ Pas afro 1400 vjetësh, njëri prej pionierëve pararendës të fluturimeve ndërplanetare, Kostandin Ciollovski, shprehet: “*Toka është djepi i njerëzimit. Por, ashtu si fëmija, ai nuk mund të qëndrojë përjetësisht në djep.*”² Çfarë ngjashmërie! Ngjashmëri apo

huazim? E megjithatë, a nuk i ka bërë ai, “pa dashur”, një koment (tefsir) interesant ajetit Kur’anor! Njeriu do t’i kalojë kufijtë e Tokës-djep.

Ndër legjendat e antikitetit grek, që kanë arritur deri në kohën tonë, është edhe legjenda e Ikarit: “Babai i tij, si mjeshtër që ishte, ndërtoi krahë me pendë shqiponje. At e bir, së bashku, fluturuan lart, mbi retë. Ikar i nuk ngopej nga kënaqësia dhe kureshtja. Me dëshirën për të

1. Kur’ani, En-Nebe’ 78:6.

2. Revista “Shkenca dhe Jeta”, artikulli “Njeriu në Mars”, Skënder Shkupi.

fluturuar sa më lart, ai u shkëput nga i ati, që e kishte këshilluar të ishte i kujdesshëm e të mos largohej shumë. Por Ikari ëndërronte të shkëputej nga Toka dhe të fluturonte drejt Diellit. Kur po i afrohej Diellit, dylli, me të cilin ishin ngjitur pendët, u shkri dhe kështu ai ra i vdekur në Tokë, pa mundur të realizojë ëndrrën e tij”. Është një legjendë që shpreh dëshirën e zjarrtë të njeriut për të prekur realitetin tejtokësor, por, që fatkeqësisht, ka një përfundim fatal. Sipas saj, njeriu e ka të pamundur t’i afrohet “qiellit” që shikon çdo natë. Ky fatalizëm e shoqëroi gjatë njerëzimin. Madje, mbrojtësit fanatikë të fatalizmit nxinë më shumë errësirën mesjetare, duke shuar pishtarët e dijes, që kërkonin të njihnin botën që i rrethonte.

Ëndrra mbijetoi, sepse jetoi shpresa. Qytetërimi grek kishte perënduar me kohë. Perandoritë romake e perse ishin në prag të rënies. Në Mekë të Arabisë Saudite, në vitet 632-610 (E.S.), zë fill, përmes vështirësive, të plotësohet feja që iu shpall Ademit, Nuhut, Ibrahimit, Musait e Isait, feja Islame. Pejgamberi Muhamed i ftoi njerëzit në besimin në një Zot të Vetëm dhe Krijues të Gjithësisë. Ai edukoi, jo vetëm te bashkëkohësit e tij, por edhe në brezat e mëvonshëm e në mbarë njerëzimin, ndjenjën e meditimit për harmoninë në qiej e tokë, pasionin për të kërkuar diturinë kudo që të ishte. Kur’ani, libri që iu revelua nga Zoti pjesë-pjesë

gjatë 23 viteve, fillon me urdhrin **“Lexo me emrin e Zotit tënd, që krijoi (çdo gjë)”**³ Në një kohë që Evropa po hynte në epokën e errët të Mesjetës, në Kur’an publikohet projekt-ideja e shpresës për ta kthyer në realitet ëndrrën e fluturimit përtej Tokëdjepit. Në kapitullin **“Er-Rahman - I Gjithëmëshirshmi”**, Zoti iu drejton këtë thirrje krijesave inteligjente: **“O grupimi i xhinëve dhe i njerëzve! Nëse keni mundësi të dilni përtej kufijve të qiejve e të tokës, depërtoni pra! Por ju nuk do të mundeni, përveç me fuqi (njohuri të thella dijesh dhe fuqi ekonomike e administrative).”**⁴ Ky ajet, si dhe shumë të tjerë, frymëzuan dhe bënë që “njeriu i shkretëtirës” ta përfytyronte si një prej kënaqësive të botës së mrekullueshme të “njëmijë e një netëve” udhëtimin me qilim fluturues.

Pak histori për përpjekjet e njeriut për të fluturuar...

I pari që bëri përpjekje konkrete për sendërtimin e ëndrrës ishte, jo rastësisht, Abbas bin Firnas (810-887 e.s.). Në vitet 852-875, Abas bin Firnas bëri përpjekjet e para në historinë e njerëzimit për të fluturuar. Ftuesi i mirënjohur në fenë Islame Amr Khalid shprehet në predikimin

3. Kur’ani, El-‘Alek 96:1 (përkthimi në shqip nga Sh. Ahmeti, 1992).

4. Kur’ani, Err-Rahman 55:33 (përkthimi në shqip nga Sh. Ahmeti; dhe përkthimi nga një grup pranë Darus- Selam, Riad, Arabia Saudite, botim II, viti 2000).

e tij “Ndërtuesit e jetës” (pjesa e dytë) se “... *Ai* (Abbas bin Firnas) *ishte i motivuar nga ajeti* “**O grupimi i xhinëve dhe i njerëzve! Nëse keni mundësi të dilni përtej kufijve të qiejve e të tokës, depërtoni pra! Por ju nuk do të mundeni, përveç me fuqi.**” *Ai zbatoi këtë ajet. Ai mblodhi njerëzit e Kordobës për të dëshmuar tentimin e tij. Të gjithë njerëzit mendojnë se ai ka dështuar, por ai pati sukses edhe pse theu këmbët gjatë uljes në tokë...*”

Abbas bin Firnas rrjedh nga një familje myslimane berbere. Ai ka lindur në Tokoronna të Andaluzisë (sot Ronda, Spanjë) që në atë kohë sundohej nga Umejadët. Biografët e përshkruajnë atë si një filozof të shkëlqyer, studiues të shkencave të kimisë, fizikës dhe astronomisë, shpikës, inxhinier, mjek, poet në gjuhën arabe dhe muzikant andaluzian. Ai ka shpikur orët me ujë. Në shtëpinë e tij modeloi me qelq sferën qiellore, me yjet, retë, vetëtimat etj., ku vizitorët e ndryshëm e shikonin plotë kureshtje. Në kumtesën me titull “Kontributi i arabëve myslimanë në shkencat praktike dhe matematikë” të mbajtur në simpoziumin “Roli i civilizimit arabo-islam në renesancën evropiane” (Damask, 24 maj 1995), dr. Sheuki Ebu Halil pohon që Abbas bin Firnas është edhe zbuluesi i teleskopit,⁵ afro 700 vjet para Galileit (Kujtojmë që kjo shpikje i njihet Galileit. Dhe për

këtë fakt, viti 2009 është quajtur si viti i Galileit, me rastin e 400 vjetorit të teleskopit të parë).

Në vitin 852, Ibn Firnas vendos të fluturojë duke nisur nga një kullë në Kordobë, duke u mbështetur në modelin fluturues të zogjve. Në vitin 875, në moshën 65 vjeçare, mundi të fluturonte në ajër për rreth 10 minuta. Në shenjë mirënjohjeje dhe nderi ndaj kontributit që ai dha, libianët kanë prodhuar një pullë me portretin e tij; në Irak një aeroport (në veri të Bagdadit) mban emrin e tij, ndërsa në rrugën që të çon në Aeroportin Ndërkombëtar të Bagdadit është ndërtuar statuja e tij; modelin e avionit të lehtë me helikë, algjerianët e kanë quajtur Firnas; një krater në Hënë mban emrin Abbas bin Firnas.

U zgjata pak në disa detaje të jetës së Abbas bin Firnas, jo vetëm për faktin që figura e tij nuk është shumë e njohur, por edhe për të theksuar dhe nxjerrë konkluzionin se ne, myslimanët e sotëm, duhet të studiojmë dhe punojmë në frymën e Kur’anit, për të ndërtuar të tashmen në dimensionet e traditës sonë të shkëlqyer islame. Prof. dr. Mehdi Golshani shkruan: “...Në të vërtetë, që në sajë të nxitjes së Kur’anit për të studiuar dukuritë e natyrës, që shkencëtarët myslimanë u përfshinë më thellë në këtë fushë. Zhvillimi i qytetërimit islam, gjithashtu, iu detyrua në një shkallë më të madhe botëkuptimit Kur’anor... Fatkeqësisht, ky lloj botëkuptimi ndaj shkencave të natyrës u flak ca nga

5. Shih “Roli i civilizimit arabo-islam në renesancën evropiane”, f. 69, “Furkan ISM”, Shkup 1999.

ca në botën islame dhe myslimanët i shpërfillën këshillat e Kur'anit të Shenjtë për ta studiuar natyrën dhe për të shfrytëzuar mundësitë që Zoti ka dhënë për njeriun...⁶ Këtë rrezik historik për myslimanët thekson edhe F. Gylen “Ata që i pengojnë myslimanët për ta kuptuar Kur'anin e për t'u thelluar në të, i largojnë ata, për rrjedhojë, nga fryma e fesë së tyre dhe thelbi i Islamit.”⁷ Më tej, prof. dr. Mehdi Golshani vazhdon duke treguar edhe pasoja të tjera të humbjes së lidhjes me Kur'anin “... dhe kur myslimanët e shpërfillin këtë detyrë të domosdoshme, sot, ne shohim që myslimanët janë të paafte të përdorin burimet e tyre dhe ua lënë të tjerëve t'i shfrytëzojnë ato, siç thotë poeti i njohur pakistanez Ikbāl:

Myslmani i së djeshmes ishte krenar dhe i nderuar për dijen e tij,

(kurse) sot shpina e myslimanëve përkulet (përpara të tjerëve)...⁸

Më pas, ishte Leonardo da Vinçi (1452-1519) që, duke u mbështetur në modelin e zogjve, bëri përpjekje serioze për të mundësuar fluturimin. Por puna prej rreth 25 vjetësh e tij nuk dha rezultate.

E megjithatë, këto ishin shenja që projekti i shpallur në Kur'an po niste të zbatohet...

4 tetori 1957 ishte dita kur nga Toka u lëshua sateliti i parë artificial. Lëshimi i tij shënoi një nga momentet më të shquara në historinë e shkencës, sepse me të u hap një horizont i ri i pafundmë studimi, filloi era e fluturimeve kozmike. Njerëzimi pa me admirim se kishte ardhur koha që edhe vetë ai do të çante rrugën për në kozmos, duke dalë jashtë kufijve të Tokës, ku ndjehej si i gozhduar në të. Rreth tre vjet e gjysmë më vonë (12 prill 1961), fluturimi i Juri Gagarin-it tregoi se ëndrra e njeriut për të fluturuar drejt qiellit po fillonte të bëhej realitet. Ndërsa, në 20 korrik të vitit 1969, njeriu mundi të ecë mbi sipërfaqen e Hënës. Në këto 40-50 vjet janë bërë përparime të shpejta e të mëdha në të gjithë elementët përbërës të një fluturimi kozmik.

Realizimi i fluturimeve kozmike përbën një sukses të shkëlqyer, që qëndron përkrah me zbulimet më të rëndësishme në historinë e njerëzimit. Sigurisht, që kjo punë madhështore ka pasur vështirësi të shumta. Një mori problemesh teorike e praktike kërkonin zgjidhje nga shkencëtarë të të gjitha fushave të dijes, si: njohja e ligjeve në kozmos, probleme të konstruksionit dhe teknikës në ndërtimin e anijeve kozmike, masat që duhen marrë për sigurimin e shëndetit dhe aftësive mendore e fizike të kozmonautit në kushtet e udhëtimit, probleme të komunikimit, sigurimit të energjisë, etj. Të shohim shkurtimisht vështirësitë që kanë kapërcyer shkencëtarët.

6. “Kurani i Shenjtë dhe shkencat e natyrës”, prof. dr. Mehdi Golshani, f. 57-60, Tiranë 2007.

7. “Kriteret”, F. Gylen, f. 39, Prizmi, Tiranë 2003.

8. “Kurani i Shenjtë dhe shkencat e natyrës”, prof. dr. Mehdi Golshani, f. 62, Tiranë 2007.

1. Njohja e ligjeve në gjithësi

Çdo dy trupa në Gjithësi bashkëveprojnë, duke tërhequr njëri-tjetrin. Ligjin e një tërheqjeje të tillë universale e zbuloi Isak Njutoni (vitet 1600, afro 1000 vite pas Kur'anit). Duke marrë parasysh se masa e Tokës është shumë e madhe në krahasim me masat e trupave që ndodhen mbi të, çdo objekt i lëshuar përmbi sipërfaqen e Tokës, fillon të lëvizë drejt saj, për shkak të tërheqjes gravitacionale. Sa më e madhe të jetë masa e objektit, aq më e madhe do të jetë edhe forca tërheqëse. Nga përllogaritjet është arritur se që një trup i hedhur të mos bjerë në Tokë, pra “të mposhtë” tërheqjen e Tokës, duhet t'i jepet atij minimumi një shpejtësi prej 7900 m/s (që quhet “shpejtësi e parë kozmike”). Me këtë shpejtësi, trupi mund të kthehet në satelit artificial të Tokës. Në qoftë se trupit i jepet një shpejtësi më e madhe se 17000 m/s, ai shkëputet nga sistemi ynë diellor dhe, sipas kushteve, ai mund të bjerë në ndonjë yll, apo të kthehet në planet të ndonjë ylli tjetër.⁹ Realizimi i shpejtësive të tilla (mbi 7.9 km/s) ka qenë një nga problemet e para të vështira për t'u zgjidhur, aq më shumë kur kësaj i shtohet edhe masa e madhe e anijes kozmike (prej disa tonelatash). Kjo kërkon harxhimin e një sasive kolosale energjie, pra edhe gjetjen e burimeve të saj.

9. “Fluturimet kozmike”, Sotir Kuneshka, Tiranë, 1981.

2. Ligje të tjera të lëvizjes

Atmosfera tokësore, kaq e vlefshme për zhvillimin e jetës në Tokë, përbën një pengesë të konsiderueshme për nisjen e raketave kozmike nga Toka. Dihet se kur një trup lëviz në ajër, ai has në një farë pengese që quhet rezistencë e ajrit. Raketa kozmike, e lëshuar nga Toka në hapësirë, duhet të përshkojë me doemos atmosferën. Sa më e madhe të jetë shpejtësia, aq më e madhe është rezistenca. Prandaj, përveç energjisë së domosdoshme për të arritur shpejtësinë e nevojshme, duhet shpenzuar energji edhe për të mposhtur rezistencën e ajrit. Por llogaritjet nuk mbarojnë me kaq. Dihet, gjithashtu, se rezistenca e ajrit, që vjen nga fërkimi i tij me trupin, shoqërohet me nxehjen e trupit. Është llogaritur se në qoftë se raketa përshkon shtresën e dendur të atmosferës me shpejtësi rreth 11000 m/s, fërkimi është kaq i madh, saqë temperatura mund të arrijë deri në 5000 °C. Një temperaturë e tillë shkrin dhe djeg çdo objekt. Për të kaluar këtë pengesë, shkencëtarët dhe inxhinierët menduan dhe projektuan ndërtimin e raketave kozmike shumëfazëshe. Raketa të tilla përbëhen nga disa pjesë. Vetëm njëra prej tyre përbën anijen kozmike. Pjesët e tjera përdoren për rritjen graduale të shpejtësisë së saj deri në vlerën e duhur. Gjatë udhëtimit anija kozmike i lëshon automatikisht pjesët që kanë mbaruar funksionin e

tyre. Kjo bëhet për të kaluar pjesën më të dendur të atmosferës me një shpejtësi që nuk përbën rrezik për djegien e raketës. Gjithashtu, rritja graduale e shpejtësisë është një çështje jetike për kozmonautin. Energjia e harxhuar që nga çasti i nisjes nga Toka është shumë e madhe. Fuqia e zhvilluar nga motorët reaktivë gjatë fluturimit matet me miliona kilovat. Për të arritur fuqi të tilla, shkencëtarëve u është dashur të studiojnë dhe të gjejnë lëndët djegëse më të përshtatshme: ato duhet të kenë aftësi kalorifike shumë të lartë dhe masë specifike sa më të vogël.¹⁰

Një problem tjetër teorik, i vështirë dhe delikat, është edhe ai i llogaritjes së trajektorës së raketës kozmike. Cila do të jetë trajektorja që duhet të përshkojë ajo, në mënyrë që të përmbushë misionin për të cilin është lëshuar? Mbi objektin e lëshuar, përveç Tokës, ushtrojnë forcë tërheqëse edhe trupat qiellorë (sipas ligjit të tërheqjes së gjithësisë). Gjithashtu trupat qiellorë janë vazhdimisht në lëvizje, si rreth vetes ashtu edhe sipas orbitave. Se sa delikate dhe të përpikta duhet të jenë llogaritjet, mjafton të përmendim një shembull nga dërgimi i raketave kozmike në Hënë. Në qoftë se nisja e raketës bëhet 10 s para apo 10 s më vonë nga çasti i caktuar, ajo do të binte afro 200 km më larg nga vendi i caktuar në Hënë. Një gabim prej 1m/s në shpejtësinë fillestare (kjo vlerë është 1/10000 e shpejtësisë së

raketës) do të shkaktonte një largim nga pika e rënies prej 250 km. Për një gabim prej 1' (minute) harku në drejtimin fillestar të hedhjes, raketa do të spostohej në pikën e rënies me 200 km. Po të mos llogaritet influenca gravitacionale e Diellit, raketa do të binte 100-150 km më larg vendit të parashikuar. Sikur të bëheshin 2-3 gabime të tilla, siç i përmendëm më lart, raketa do t'i kalonte anash Hënës, madje mund t'i largohej asaj përgjithmonë.¹¹ Kuptohet se ç'rëndësi paraqet njohja e përpiktë e këtyre elementëve të lëvizjes në çdo çast për dhënien e komandave. Akoma më tej, një volum i tillë llogaritjesh teorike është i mundshëm në sajë të një investimi të madh mendor e intelektual.

3. Probleme me kozmonautin

Një varg tjetër problemesh ka qenë në lidhje me jetën e kozmonautit, me funksionimin e rregullt të organizmit të tij. Lëvizja e raketës është lëvizje me nxitim (e përshpejtuar gjatë nisjes). Kjo krijon për kozmonautin gjendjen e mbipeshës (P.sh. kur nxitimi është 66.7 m/s^2 , kozmonauti me masë 70 kg do të rëndonte mbi dyshe me forcën e 537 kg. Pra, është njëllor sikur njeriu të mbajë mbi shpinë një ngarkesë prej 467 kg!). Kuptohet lehtë se ç'efekte negative ka një mbingarkesë e tillë mbi organizmin e njeriut kur ajo vepron qoftë edhe për

10. Po aty.

11. Po aty.

një minutë. Mundësitë e organizmit të njeriut për të duruar ngarkesa të zgjatura në kohë, janë të kufizuara. Prandaj, një nga kushtet e fluturimit të njeriut në kozmos është krijimi i një regjimi të tillë të nisjes, për të cilin as vetë mbingarkesa, as veprimi i zgjatur i saj, të mos kalojnë kufijtë e lejuar. Gjithashtu, merret parasysh edhe drejtimi i veprimit të mbingarkesës. Eksperimentet tregojnë se njeriu i duron më lehtë ngarkesat që veprojnë në drejtimin shpinë-kraharor ose anasjelltas. Në qoftë se forcat që prodhojnë mbingarkesën drejtohen pothuaj pingul me enët kryesore të gjakut, atëherë ato zvogëlojnë në minimum mundësinë e arritjes së gjakut në kokë dhe në këmbë. Në qoftë se mbingarkesa (gjatë ngjitjes) ushtrohet sipas boshtit të trupit, atëherë gjaku do të grumbullohet në këmbët, ndërsa në kokë do të ketë më pak gjak dhe kjo gjë shkakton dëme serioze në organizëm. Shkencëtarët, nëpërmjet eksperimenteve të shumta, kanë mundur të gjejnë pozicionet më të përshtatshme për kozmonautët gjatë udhëtimit, kanë përcaktuar vlerat kufitare të nxitimit, pra edhe të mbingarkesës së përballueshme.¹² Për një përshtatje sa më të mirë të kozmonautëve me kushtet e fluturimit, organizohen stërvitje speciale, rigorozisht të studiuara. A nuk kërkon edhe kjo një investim jashtëzakonisht të madh intelektual, fizik dhe ekonomik?!

12. Po aty.

Kozmonautit nuk i duhet të mësohet vetëm me mbipeshën, por edhe me gjendjen e mungesës së peshës. Në lidhje me mungesën e peshës dalin një varg çështjesh, që kanë të bëjnë me jetën dhe aktivitetin e njeriut në kozmos. Në gjendjen e mungesës së peshës njeriu humb nocionin e orientimit. Për të nuk kanë kuptim fjalët “poshtë” dhe “sipër”. Një send i lëshuar në ajër, përbrenda kabinës, qëndron pezull. Kozmonauti nuk mund të derdhë pijen nga një shishe në gotë. Në qoftë se një sasi lëngu nxirret nga ena, ai do të marrë formën e sferës dhe do të qëndrojë pezull në ajër, ose do të sillet në ajrin e kabinës. Ushqimet përgatiten në trajtë xhelatine dhe, njeriu, për t’i marrë ato, duhet t’i thithë nga gryka e enës.¹³

Anija kozmike duhet të jetë e mbyllur hermetikisht, për të mos pasur as daljen më të vogël të ajrit. Është projektuar dhe ndërtuar një sistem ventilacioni dhe aspiracioni për të siguruar oksigjenin e nevojshëm (i cili vazhdimisht konsumohet nga kozmonautët), për të mbajtur lagështinë dhe përbërjen e ajrit në parametra normale. Një pajisje e posaçme mban temperaturën e mjedisit brenda kufijve të përshtatshëm 15-20 °C.¹⁴

Kozmonauti ka veshjen e tij të posaçme, sidomos skafandrën të ndërtuar prej lënde refraktare, e cila i siguron atij një frymëmarrje e temperaturë normale dhe e mbron nga rrezatimet e ndryshme kozmike, etj.

13. Po aty.

14. Po aty.

4. Probleme të tjera me anijes kozmike

Faqet e anijes kozmike duhet të jenë të trasha, të forta dhe prej lënde refraktare. Kjo bëhet për të evituar shpimin e anijes nga goditja e mundshme me ndonjë meteor të vogël; për të mbajtur brenda një temperaturë normale, sido që të jetë temperatura jashtë saj; për t'u rezistuar temperaturave të larta, duke e përçuar sa më pak nxehtësinë në faqet e brendshme dhe anasjelltas; për ta mbrojtur kozmonautin nga rrezatimet kozmike, etj.¹⁵

5. Komunikimi

Një rol të rëndësishëm në fluturimet kozmike ka ndërlidhja dhe komunikimi i anijes kozmike me qendrën e komandimit në Tokë. Me anë të ndërlidhjes mund të komandohen nga Toka pajisje të ndryshme të anijes edhe pa praninë e njeriut.¹⁶ Mjafton të kujtojmë informacionet mjaft të vlefshme që dha anija-sondë që u dërgua në planetin Mars (edhe pse në të nuk kishte njerëz).

Përgatitjet dhe realizimi i fluturimeve kozmike u paraqit në mënyrë shumë skematike e të thjeshtuar. Mund të kuptohet lehtë se sa vështirësi kanë hasur shkencëtarët dhe konstruktorët për zgjidhjen e plotë të problemeve. Sa llogaritje dhe sa prova janë bërë deri në zgjidhjen përfundimtare!

15. Po aty.

16. Po aty.

Pas gjithë kësaj pune për sendërtimin e ëndrrës për të kaluar kufijtë e Tokës, arsyetimi i shëndoshë e korrekt na shtyn të pohojmë:

Së pari, kjo ndërmarrje e guximshme ka kërkuar një kapacitet voluminoz njohurish teorike nga shkencat fizike, matematike, biokimike, inxhinierike, mjekësore, sociologjike e psikologjike. Akoma më shumë, në këtë volum njohurish përfshihen dituritë e grumbulluara e të sistemuara të paktën gjatë këtyre 400 viteve të fundit (në të gjitha fushat e shkencës). Pra, duhet një fuqi intelektuale e mendore e jashtëzakonshme, e paimagjinueshme (e pavlerësueshme financiarisht) për t'u zotëruar nga një njeri i vetëm, apo grup i vogël njerëzish.

Së dyti, realizimi i fluturimeve kozmike është bërë i mundur falë punës këmbëngulëse dhe diturisë së brezave të tërë të dijetarëve, të të gjitha degëve të shkencës. A mund të vlerësohet sa kohë i kanë kushtuar aplikimit të diturive të tyre? A mund të vlerësohet mundi dhe djersa e tyre në kërkim të realizimit të ëndrrës? Pa dyshim që vetëm me fjalë mund të vlerësojmë se: “koha, mundi dhe djersa janë kolosale” (ekonomikisht vlerësimet janë marramendëse).

Së treti, në këndvështrimin ekonomik, çdo fluturim kozmik ka koston e tij: projekti, infrastruktura, lëndët e para, ndërtimi i anijes,

burimet njerëzore, etj., etj... Pra, edhe ekonomikisht kërkohet një investim shumë i madh. Mjaft vende të pasura evropiane bashkëpunojnë për të realizuar financiarisht projekte të tilla.

Përfundimisht, që të bëhej i mundur depërtimi i njeriut përtej kufijve të Tokës, drejt qiellit, duhej:

➤ një kohë e nevojshme për të grumbulluar dituritë e domosdoshme;

➤ fuqia njerëzore: intelektuale, zbatuese, financiare, administrative, etj.

* * *

Tashmë e kemi të lehtë të kuptojmë ajetin Kur'anor në kapitullin **“I Gjithëmëshirshmi”**. Ajo çfarë shohim sot na bën të pohojmë se para afro 1400 vjetësh, në mënyrë shumë precize dhe të përmbledhur, është parashtruar çdo të ndodhte më pas, në kohën tonë, apo edhe më vonë. **“Betohem për qiellin (që e kam ndërtuar) plot rrugë!”**¹⁷ - betohet Zoti në Kur'an. E më tej: **“O grupimi i xhinëve dhe i njerëzve! Nëse keni mundësi të dilni përtej kufijve të qiejve e të tokës, depërtoni pra!...”**¹⁸

Kjo pjesë e ajetit e fton njeriun të studiojë, të njohë, të gjejë mundësitë për të dalë përtej tokës, të gjejë rrugët me të cilat Zoti e pajisi qiellin, për të vizituar e shijuar panairin

17. Kur'ani, Edh-Dharijat 51:7 (përkthimi në shqip nga Sh. Ahmeti, 1992).

18. Kur'ani, Err-Rrahman 55:33 (përkthimi në shqip nga Sh. Ahmeti; dhe përkthimi nga një grup pranë Darus-Selam, Riad, Arabia Saudite, botim II, viti 2000).

madhështor të gjithësisë. Mundësinë dhe aftësinë për ta dëgjuar këtë thirrje 14 shekullore e kanë vetëm të zotët e mendjes. Një nga këto mundësi është dituria, që e kanë kërkuar përmes sakrificash dhe një vullneti të hekurt. Ndërsa I Gjithëdituri ua mësonte atë që nuk e dinin (pa bërë asnjë dallim fetar, racor apo klasor mes njerëzve). E kështu, kohë pas kohe, brez pas brezi, njohuritë mbi botën dhe ligjet e funksionimit të saj shtoheshin, për t'ua lënë trashëgim pasardhësve. **“... Por ju nuk do të mundeni, përveç me fuqi (nga Allahu).”**¹⁹ Shihni pra, në “projektin” e publikuar në Kur'an vihet si kusht për t'u zbatuar “zotërimi i fuqisë”. Sot e kemi të lehtë të kuptojmë se me “fuqi” nënkuptohet dituria e gjithanshme, aftësitë mendore, intelektuale e fizike të qenies njerëzore, burimet e energjisë dhe fuqia ekonomike. “Çdo gjë është krijuar për t'i shërbyer njeriut, ndërsa njeriu për t'i shërbyer Zotit.” (Alija Izetbegović) Falënderimet i qofshin Zotit që i dhuroi njeriut një fuqi të tillë.

Era e fluturimeve kozmike sapo ka filluar... Në një kohë kur grekët e lashtë kishin thurur legjenda për dëshirën e njeriut për të fluturuar drejt qiejve, në një kohë kur bota (Evropa) po fillonte përjetimin e një periudhe të errët, në shkretëtirat e Mekës i shpallet Muhamedit projekti i zhvillimit të shkencës, si dhe rrugët e

19. Kur'ani, Err-Rrahman 55:33 (përkthimi në shqip nga Sh. Ahmeti; dhe përkthimi nga një grup pranë Darus-Selam, Riad, Arabia Saudite, botim II, viti 2000).

aplikimit të saj. Rezultati i projektit do të ishte njohja dhe ekspansioni drejt qiellit. Një tjetër ajet (argument), mjaft interesant, që mbështet këtë rezultat gjendet në kapitullin **“Lukman”**. Lukmani, një plak i urtë dhe i mençur, e këshillon të birin **“O djali im! S’ka dyshim, se edhe nëse ajo (vepra) peshon sa kokrra e lirit, e të jetë fshehur në rrasë guri, ose në qiej apo në tokë, Allahu do ta sjellë atë, se Allahu është i butë dhe hollësisht i informuar.”**²⁰ Pra, vini re, në ajet bëhet fjalë edhe për veprën, punën (e njeriut) “të fshehur” në qiej..., ç’ka nënkupton parashikimin Kur’anor që njeriu do të mund të kalojë kufijtë e Tokës dhe puna e tij do të regjistrohet edhe përtej saj.

Sigurisht që nuk mund të lihet pa përmendur njohuria (marifet-i) e profetit Ibrahim mbi qiejt e tokën. **“Edhe kështu Ibrahimit ia mundësuam t’i shohë madhësitë e qiejve e të tokës, për t’u bërë edhe më i bindur.”**²¹ Por prekja e këtyre dimensioneve, përkthimi konkret i madhësive të qiejve e tokës, është pa dyshim **“Mîraxhi”** i peygamberit Muhamed, i cili përbën udhëtimin e parë të njeriut në hapësirat qiellore. Ashtu si në çdo këndvështrim, social, kulturor e shpirtëror, material e shkencor, peygamberi Muhamed përbën një horizont për t’u arritur, edhe ky udhëtim-mrekulli deri në kufijtë e universit përbën një kulm

drite, që e fton njeriun për t’iu afruar. Është interesante të theksohet se e tërë historia e progresit të shkencës dhe teknologjisë është zhvilluar dhe po zhvillohet në gjurmët e linjës profetike nga Ibrahim deri te Muhamedi. Fillon metodikisht me vrojtimin, hulumtimin dhe arsyetimin ibrahimian dhe, me profetët e dërguar kohë pas kohe, përvijohen një e nga një horizontet e arritjeve njerëzore në fusha të ndryshme të shkencës dhe teknologjisë. Aureola e këtyre horizonteve është profeti Muhamed me Kur’anin e Nderuar.

Dijetari islam AbdulMexhid ez-Zindani polemizon me dyshuesit, të cilët, të entuziazmuar nga arritjet shkencore në fushën fluturimeve kozmike, pohojnë se kjo është goditje ndaj besimit në Zot. Nisur nga ajeti 33 i kapitullit **“I Gjithëmëshirshmi”**, ai thekson se pikërisht në këto arritje dhe të tjera gjendet mrekullia e të Dërguarit Muhamed, si dhe vërtetimi i shpalljes në Librin e të Gjithëditurit. **“...Prandaj, hapësira për pushtimin e gjithësisë nga njeriu është e hapur dhe atij i mbetet që të lëshohet në Hënë, Mars e planetë të tjerë... Kur’ani është i pari që lajmëron mbi mundësinë për pushtimin e gjithësisë, në kohën kur ka qenë e pamundur të flitet për pushtimin. Kjo është dëshmi e qartë se Kur’ani është nga Ai, i Cili di fshehtësitë e qiejve dhe të tokës.”**²²

Fluturimet e para, lëshimi i satelitëve, shkelja e njeriut në Hënë,

20. Kur’ani, Lukman 31:16 (përkthimi në shqip nga Sh. Ahmeti, 1992).

21. Kur’ani, El-En’am 6:75 (përkthimi në shqip nga Sh. Ahmeti, 1992).

22. “Njëshmëria e Krijuesit” Abdul Mexhid ez-Zindani, Prishtinë, 1998, f. 454.

studimi i drejtpërdrejtë i Marsit, studimi i sistemit tonë diellor e më gjerë, janë prova se njerëzimi, dashur pa dashur, ka ecur në rrugën e planifikuar, ashtu si edhe Gjithësia. Kjo tregon saktësinë e Kur'anit, çdo fjali e të cilit është një argument më vete. S'ka dyshim se Kur'ani është fjala e Zotit. E si mund të jenë produkte të mendjes njerëzore të shekullit VII (e.s.) projekte kaq të qarta të zhvillimit të shkencës, metoda aplikimi kaq progresive, parashikime kaq precize për të ardhmen e njerëzimit?! Si mundet të konsiderohet Kur'ani fjalë e njeriut, kur ai në çdo këndvështrim është larg legjendave që mbizotëronin kohën?! Pa dyshim, projektin e publikoi vetëm Ai që e projektoi Gjithësinë, krijoi njeriun dhe gjithçka

ka në qiej e tokë, Ai që është Zotërues i Dijes. Vetëm nën frymëzimin e Tij gjen zbatim praktika që çon në zbulimin e së Vërtetës. Allahu e di të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e kozmosit dhe të njeriut. E, për ta orientuar drejt njeriun, i dha Librin e Qartë-Kur'anin. **“Ai është plot argumente të qarta në zemrat e atyre që u është dhënë dituria. E, argumentet Tona nuk i mohon kush, përveç të shfrenuarve.”**²³

“Ti je pa të meta. Ne nuk kemi dije tjetër përveç atë që na e mësove Ti. Vërtetë, Ti je i Gjithëdijshmi, i Urti.”²⁴

23. Kur'ani, 29/49 (përkthimi në shqip nga Sh. Ahmeti, 1992).

24. Kur'ani, El-Bekare 2:32.

95-vjetori i Gjimnazit të Shtetit

Prof. dr. Njazi Kazazi
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Departamenti i Gjuhësisë

Abstrakt

Nga propaganda zyrtare “Shkolla e vjetër feudo-borgjeze e paraçlirimit u godit rëndë si në përmbajtje, ashtu edhe në metodë”, mbasi Partia e udhëhequr nga Enver Hoxha, përcaktimin e rrugës së zhvillimit revolucionar të arsimit në Shqipëri e realizoi “...në luftën që i bëhej shkollës së vjetër”. Në kushtet e një totalitarizmi të tillë dhe të një politizimi të tejskajshëm “...autorit i lejohet liria e mendimit në trajtimin e historisë, por brenda cageve ku ajo nuk binte në kundërshtim me disa postulate të ngurtësuara marksiste-leniniste.”

Studiuues - titullarë të këtyre fushave kanë theksuar se këto shkolla kishin “frymë fetare e klerikale, reaksionare dhe antikombëtare, në shërbim të padronëve të huaj...” dhe se ajo ishte “...shkollë me karakter antidemokratik e mbi të gjitha me një frymë të tërbuar agresive antikomuniste” dhe më poshtë si për merak rithekson “një kështjellë e vërtetë e reaksionit kulturor dhe ideologjik në shërbim të të huajve.... me frymë jo vetëm antipopullore, por, siç thamë edhe antikombëtare.”

1. Hyrje

Monografia “Zhvillimi i arsimit të mesëm në Shkodër (Nga fillimet deri në vitet ‘20 të shekullit XX)”, shtëpia botuese “Rozafa”, Shkodër, 2014, që po paraqesim, synon të ndriçojë sadopak historinë e traditën e arsimit të mesëm në

trëvën e Shkodrës e kësisoj të japë një ndihmesë modeste në punën e këtyre shkollave, për rëndësinë e tyre në arsimin e kulturimin e masave të popullit, për përgatitjen e intelektualëve që punuan dhe kontribuan në fushat e ndryshme të jetës, që nga drejtimi i shtetit e deri si mësues në shkolla të ndryshme të vendit.

Gjatë këtyre 20 viteve janë botuar shumë vepra madhore dhe monografi, të cilat, në mënyrë të përmbledhur, do t'i përfshijmë në këtë botim, si:

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë (më pas ASHSH): Fjalori Enciklopedik Shqiptar (më pas FESH). Botim i ri. Grup autorësh. Vëll. 1-2. Tiranë, 2008. Vëll. 3. Tiranë, 2009.

- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës (më pas MASH), Instituti i Studimeve Pedagogjike (më pas ISP): "Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar". Grup autorësh. Tiranë, 2003.

- Shefik Osmani: "Reflekse etnopedagogjike". Vëllimi 1. Tiranë, 1998.

- Shefik Osmani: "Shpalime etnopedagogjike - Panoramë retrospektive e mendimit pedagogjik shqiptar". Vëllimi 2. Tiranë, 2008.

- Shefik Osmani - Njazi Kazazi: "Abetaret Shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike". Botim i MASH dhe i Shtëpisë botuese "Idromeno", Tiranë, 2000.

- Tomor Osmani: "Komisia Letrare Shqipe në Shkodër (1916-1918)". Shtëpia botuese "Camaj-Pipa". Shkodër, 2004 (Rib. 2009, 2012).

- Tomor Osmani: "Udha e shkronjave shqipe-Histori e alfabetit". Botim i ASHSH. "Ilar", Tiranë, 2008.

- Vehbi Hoti: "Luigj Gurakuqi, për shkollën shqipe dhe arsimin kombëtar". Monografi. "Camaj-Pipa", Shkodër, 2002.

- Vehbi Hoti: "Ethem Osmani Mësues i Popullit" (Monografi), "Camaj-Pipa", Shkodër, 2012.

- Mentor Quku: "Historia 100-vjeçare e shkollës së Barbullushit (1901-2001)", Shtëpia botuese "Lilo", Shkodër, 2001.

- Iljaz Gogaj: "Shkolla teknike dhe Harry Trevlye Fultz". (Botim i rivështruar). Tiranë, 2010.

- Ilir Kanini: "Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës së Parë Botërore". (Zona e pushtimit Austro-hungarez, 1916-1918). Tiranë, 2001.

- Ludovik Shllaku: "Shkollat klerikale". (Vështrim historik nga fillimet deri në vitin 1924). Monografi. "Camaj-Pipa". Shkodër, 2002.

- Pipa, Fehime: "Një shekull shkollë shqipe", (1861-1961). "Shëjzat", Romë, 1961, nr. 7-8; 1962, nr. 1-2; 1962, nr. 3-4; 1962, nr. 5-6; 1962, nr. 7-8; 1962, nr. 9-10; 1962, nr. 11-12; 1963, nr. 3-4.

- Smajl Bala: "Historiku i shkollave dhe mësuesit e Shkodrës (1662-1945)" në dy vëllime: Vëll. I, Vëll. II. Shkodër, 2011

- Fiqiret Hoxha "Fletët e Jetës, Histori pedagogjike ndër vite", (Historiku i shkollave Ruse, sot "Skënderbeg"), Botimet "Camaj-Pipa", Shkodër, 2010.

- Abdullah Poti "Shkollat e mësuesit në Anën e Malit", Shtëpia botuese "Camaj-Pipa", Shkodër, 2010.

- Kujtim Shimaj "Historiku i arsimit në Zonën e Bushatit", Shtëpia botuese "Pakti", 2011.

Ajo që na shtyu për t'i hyrë kësaj pune ka qenë qëndrimi zyrtar i partisë-shtet gjatë 47 viteve të regjimit komunist. Ky qëndrim është paraqitur zakonisht: në lënien në heshtje të këtyre shkollave, në denigrimin e tyre, pa parë asgjë pozitive tek ato.

Nga propaganda zyrtare “*Shkolla e vjetër feudo-borgjeze e paraqirimit u godit rëndë si në përmbajtje, ashtu edhe në metodë*”, mbasi Partia e udhëhequr nga Enver Hoxha, përcaktimin e rrugës së zhvillimit revolucionar të arsimit në Shqipëri e realizoi “...në luftën që i bëhej shkollës së vjetër”. Në kushtet e një totalitarizmi të tillë dhe të një politizimi të tejskajshëm “... autorit i lejohet liria e mendimit në trajtimin e historisë, por brenda cageve ku ajo nuk binte në kundërshtim me disa postulate të ngurtësuar marksiste-leniniste.”¹

Studues - titullarë të këtyre fushave kanë theksuar se këto shkolla kishin “*frymë fetare e klerikale, reaksionare dhe antikombëtare, në shërbim të padronëve të huaj...*” dhe se ajo ishte “...shkollë me karakter antidemokratik e mbi të gjitha me një frymë të tërbuar agresive antikomuniste” dhe më poshtë si për merak rithekson “*një këshjtjellë (Kolegja Saverjane dhe Gjimnazi “Illyricum” - shënimi im - Nj. K.) e vërtetë e reaksionit kulturor dhe ideologjik në shërbim të të huajve... me frymë jo vetëm antipopullore, por, siç thamë edhe antikombëtare.*”

Pikërisht për të ndriçuar sadopak punën e mësuesve dhe të nxënësve të këtyre shkollave, ndihmesën që kanë dhënë ato në çështjen kombëtare dhe në edukimin e breznive të reja, ndërmorëm këtë studim me pretendimin për të vënë në vend atë që është mohuar për gjysmë shekulli, për të zënë edhe ato vendin që u takon në historinë e arsimit shqiptar, këtë të drejtë të ligjshme që ua japin ditët e bardha të demokracisë që erdhën te ne. Por, ashtu si për një poet tonin të njohur, edhe për mua “...demokracia nuk është një makinë elektronike llogaritëse për të gërmuar në koleksionet e gazetave dhe të revistave gjysmëshekullore dhe për të numëruar fjalitë dhe frazat e botuara nga njëri apo tjetri dhe për t'i përdorur si argumente akuzimi.”²

Natyrisht kemi synuar t'i bëjmë të njohur studuesve të arsimit, shkollës dhe të mendimit pedagogjik shqiptar, si dhe opinionit tonë në përgjithësi, disa probleme që lidhen me:

- Hapjen e këtyre shkollave (kuadri i të cilave plotësohet në fillimin e viteve '20 të shekullit XX.);
- Programet e tekstet me të cilat kanë punuar;
- Punën e mësuesve dhe nxënësve që dolën nga këto shkolla;
- Vendin që zinin lëndë të ndryshme dhe formimi teoriko-praktik që jepnin ato;
- Rregullsinë e punës në dokumentacionin shkollor;

1. S. Pollo, Skematizmi-dhunë në historinë e popullit, “Drita” 12.5.1991, f. 5.

2. Dritëro Agolli, O tempora, O mores!, “Drita”, 13.01.1991.

- Lidhja e shkollës me prindërit dhe njohja e opinionit me rezultatet e shkollave në fjalë;

- Punën edukative dhe kulturore të shkollës;

- Botimet për shkollën dhe kualifikimin e mësuesve;

- Bazën materiale dhe bibliotekat shkollore.

Në fund të punimit kemi bërë një paraqitje të shkurtër për disa portrete mësuesish të shkollave të mesme me veprimtari të shquar arsimore e pedagogjike në fusha të ndryshme, të cilat ishin lënë në heshtje ose denigruar nga pushteti komunist për “faje të ndryshme”, ndonëse qenë mësues në kuptimin e plotë të fjalës, atdhetarë dhe punëtorë të palodhur, njerëz të ndershëm dhe të devotshëm, qytetarë dhe intelektualë që janë për t’u pasur zili. Në mes të tyre mund të përmendim: Mirash Ivanaj, Gjergj Fishta, Daut Boriçi, Mati Logoreci, Ethem Osmani, Isuf Tabaku, Gasper Beltoja, Rexhep Kruja, Kol Kamsi, Gasper Jakova, Haxhi Sheh Shamia, At Donat Kurti, Konsilja Muzhani, Simon Rrota, Ndue Paluca, Zef Mark Harapi, Engjëll Ndocaj, Haxhi Hafiz Abaz Golemi, Musa Tabaku, Jusuf Kraja, etj., etj.

2. Gjumnazi i Shtetit-1922

Për gjumnazin e shtetit në Shkodër, hapur më 1922, është folur dhe shkruar shumë. Janë botuar shumë artikuj nga autorë dhe

studiuës të ndryshëm, si dhe një libër (i cituar) nga Xh. Repishti e F. Luli (me rastin e 50- vjetorit të krijimit të tij). Në historinë e Arsimit Shqiptar i kushtohen disa faqe kësaj shkolle.

Hapja e gjumnazit të shtetit në këtë qytet me tradita të lashta në të gjitha fushat, por edhe me kontribut në fushën e arsimit kombëtar, ishte një ngjarje me rëndësi në historinë e tij, por “*ishte edhe nevojë e kohës*”.³

Është i njohur fakti që Ministria e Arsimit nën presionin e opinionit publik të qytetit, që përfaqësohej nga një peticion prej 56 nënshkrimesh, i cili përmbliidhte “*shtresa të ndryshme të popullsisë e nga shumica e lagjeve të qytetit*”⁴, u detyrua të hapte këtë shkollë shtetërore laike.

Në botimet e sipërpërmendura tregohet me hollësi edhe lufta, përpjekjet, por edhe kundërshtimet për hapjen e kësaj shkolle.

Synimi ynë është që t’u japim diçka për planin mësimor të shkollës, programet me të cilat mësonte, nivelin e nxënësve, me aq sa kemi mundur të gjejmë të dhëna, për bazën materiale të shkollës, për personelin mësimor etj., duke menduar se kësajsoj plotësojmë në njëfarë mënyre mangësitë e botimeve të mëparshme për këto çështje.

Në informacionin e parë që kemi gjetur për hapjen e shkollës, dërguar Ministrisë së Arsimit më 13.10.1922, njoftohet se “...më

3. Xhevat Repishti, Faik Luli: “Gjumnazi i shtetit”, Shkodër, 1972, f. 24-25.

4. MASH, ISP: “Historia e arsimit...”, Grup autorësh, Tiranë, 2003, f. 401 e 403.

5.10.1922, *Gjimnazin e hapme*” dhe vazhdon “*deri sot janë shkruar 29 vetë, 26 në klasën e parë dhe 3 në klasën e dytë, të ardhur prej shkollave qytetse, tre prej Gjimnazit Françes-kanë, 4 prej shkollës tregtare të jezuitëve.*” Në një informacion shtesë tregohet se janë regjistruar 38 nxënës, prej të cilëve 35 në klasën e parë.⁵

Lëndët e mësimi u ndanë: Kol Kamsi - gjuhë shqipe, Kol Margjini - histori edhe shkronjë, Ruhi Zeka - matematikë, Kol Kraja - frëngjisht, Simon Rrota - vizatim, Luigj Shala - shkenca natyrore. Letërdërguesi, Luigj Shala, bënte punën e drejtuesit të shkollës në rangun e nëndrejtorit.

Janë njohur gjithashtu edhe diskutimet e bëra lidhur me gjuhën që do të hapej gjimnazi dhe përpjekjet për të sjellë nga jashtë një drejtor me autoritet shkencor, dihet edhe propozimi që iu bë albanologut të njohur Maksimilian Lambertz.

5. AQSH, F. 6, D. 21, Fl. 4, V.1922.

Informacioni shtron kërkesën për futjen në planin mësimor të lëndës “gjuhë latine” se “*një gjimnaz pa gjuhën latine nuk mund të hapet tuj genë se kjo asht landa ma e parë e gjith kësaj kategorije shkollash. Për mësues nuk kemi. Ju lutëm mësuesve françeskanë, por ata janë shumë të zënë me punë të veta dhe s’mund ta përballojnë.*”⁶

Nga informacioni marrim vesh për gjendjen shumë të keqe të bazës materiale, orenditë e vjetra, mjetet mësimore shumë të pakta, për të cilat në një informacion tjetër do të kërkohej me hollësi nevoja e tyre, duke i bërë lutje Ministrisë që të jepte një fond për sigurimin e tyre.

Mendojmë se është me interes të sjellim një paraqitje të planit mësimor të plotë me të cilin punoi gjimnazi në dy vitet e para të jetës së tij. Plani mësimor në fjalë miratuar nga Ministria e Arsimit i përcillet drejtorisë së shkollës nga inspektori i atëhershëm i arsimit Ismail Anamali.

6. AQSH, F. 699, D. 2; V. 1922, Fl. 2.

PROGRAMA E GJIMNAZIT SHQIP CIKLI I PARË KL. I

E ndamja A	Gj. Klasik	E ndamja B	Gj. Qytetuer
Shqip e latinisht	10 orë	Shqip	6 orë
Gjuhët e gjalla	5 orë	Gjuhët e gjalla	5 orë
Histori e gjeografi	3 orë	Histori e gjeografi	3 orë
Njehsim	2 orë	Njehsim	2 orë
Shkenca natyrore	1 orë	Shkenca natyrore	1 orë
Vizatim	2 orë	Vizatim	2 orë
Shuma	23 orë	Shuma	19 orë

Kl. II

E ndamja A	Gj. Klasik	E ndamja B	Gj. Qytetuer
Shqip e latinisht	10 orë	Shqip	6 orë
Gjuhët e gjalla	5 orë	Gjuhët e gjalla	3 orë
Histori e gjeografi	3 orë	Histori e gjeografi	3 orë
Njehsim	2 orë	Mat. e viz. Gjeomet.	2 orë
Shkenca natyrore	1 orë	Shkenca natyrore	1 orë
Vizatim	2 orë	Vizatim	1 orë
Shuma	23 orë	Shuma	16 orë

Për të krijuar një ide se ç'kishte plani mësimor po e ilustruam me ato që shkruheshin për lëndën e gjuhës shqipe: - Në gramatikë në klasën e parë fillohej me studimin e sintaksës (këtë mënyrë të fillimit të mësimin të gjuhës me sintaksën e kemi gjetur edhe te tekstet e tjera, madje që në klasat fillore; për këtë analizë që i kemi bërë tekstit të gjuhës nga G. Mikeli, e gjejmë edhe sot të zbatuar në librat e rinj të gjuhës shqipe, klasa e dytë dhe e tretë që zbatohet për herë të parë këto dy vitet e fundit në shkollat tona). Qëllimi ishte që të ushtroheshin nxënësit në gjuhën e folur dhe në ortografi. Programi parashikonte dhe njohuri për dialektet. Në klasën e dytë vazhdohej studimi dhe thellimi i përvetësimit të sintaksës, vazhdohej me stërvitje të folurit dhe ortografi, por në këtë klasë fillohej edhe puna për realizimin e hartimeve të thjeshta. Nga programi dukej qartë se i jepej rëndësi anës praktike të përdorimit të gjuhës në të folur dhe në të shkruar dhe pas tyre *“do të mësohen rregullat”*.⁷

7. AQSH, F. 669, V. 1922, D. 3, Fl. 4-9.

Në lëndën e letërsisë i jepej vend i gjerë këndimit, shpjegimit dhe mësimin përmendësh të autorëve tanë, por edhe nga prozatorë dhe poetë të kohës së mesme të përkthyer në shqip. Nga autorët shqiptarë do të zhvilloheshin: Budi, Kristoforidhi, Sami e Naim Frashëri. Se si u zhvilluan mësimet dhe në ç'nivel që puna e mësuesve gjatë vitit të parë na tregon një informacion i dërguar nga drejtori i shkollës për këtë.

Natyrisht që po japim në mënyrë të përmbledhur disa nga problemet kryesore të punës mësimore edukative gjatë vitit të parë të punës së gjimnazit. Informacioni në fjalë është prej 6 faqesh të daktilografuara, punuar me shumë rregull e qartësi, me të mirat e të metat dhe paraqiste gjendjen faktike pa zbulime. Këtë praktikë e kemi gjetur edhe në vite të tjera nga drejtorët pasardhës të kësaj shkolle, por edhe të shkollave simotra të kësaj kohe. Informacioni mban datën 3.2.1923, ndonëse firma nuk është e lexueshme plotësisht. Nga burime të tjera e dimë se drejtor në këtë vit ishte Xhevat Korça.

Nga ky informacion mësojmë se:

- Gjimnazi deri në atë kohë mund të quhej real kurse nga janari e këndeje ishin plotësuar mësimet në të dy degët (real dhe klasik).

- Kishte shumë mangësi dhe vështirësi në plotësimin e mjeteve mësimore gjë që “*kanë shkatëruar një fryt jo krejt të kënaqshëm*”.⁸

- Trupi mësimor, ka punuar mjaft mirë, por bëhen edhe diferencime në punën e tyre.

- Drejtoria kishte bërë kontrollë në punën e mësuesve dhe në nivelin e përvetësimit të njohurive nga nxënësit sipas saj mjaft nxënës paraqisnin dobësi prandaj me ta duhej bërë punë e diferencuar për të arritur shokët, “*ndryshe nuk mund të vazhdojmë me të*”, theksohet aty.

I rekomandon Ministrisë së Arsimit që në gjuhët e gjalla është më e dobishme që në vend të frëngjishtes të vihej gjermanishtja ose italishtja, meqë nxënësit do të vazhdonin më tepër mësimet në Itali e Gjermani dhe më pak në Francë.

- Vlerësonte në mënyrë të veçantë lëndën e muzikës, e cila “*asht mjeti më efektiv për dëfrimin dhe naltësimin e shpirtit të nxënësve*”,⁹ dhe kërkon nga Ministria një fond për të blerë instrumente muzikore, të cilat sipas mendimit të tij, do të jepnin frytet e duhura.

Siç kuptohet nga informacioni, gjendja dhe pajisja e nxënësve me libra ishte shumë e vështirë, prandaj i kërkohej asaj Ministrie që, veç të tjerave, t’u jepte edhe një shaptilograf për të kopjuar disa nga tekstet që u mungonin.

8. AQSH, F. 669, D. 8, V. 1923, Fl. 2.

9. AQSH, F. 669, D. 8, V. 1923, Fl. 2.

I sollëm këto mendime që studiuesit të krijojnë një ide sa më të qartë për interesat, metodën e punës, problemet, shkallën e formimit, kulturën, marrëdhëniet me dikasterin, sa korrektë dhe kërkues ishin në punë, marrëdhëniet ndërmjet drejtorisë dhe mësuesve.

Nga viti në vit shkolla erdhi duke u plotësuar me klasë. Deri në vitin 1924-25 kishte klasën e katërt dhe në vitin 1925-26 kishte edhe klasën e pestë. Drejtori i atëhershëm në pasqyrën e regjistrimit të fillimit të këtij viti shkruan: *Nxënës gjithsej janë nënshkrue 89 të ndarë sipas klasave në këtë mënyrë:*

Gjithsej sipas viteve

Klasa e parë	32	32
Klasa e dytë -R-	14	
-K-	4	18
Klasa e tretë -R-	16	16
Klasa e katërt -R-	13	
-K-	5	18
Klasa e pestë -K-	5	5
		89

Siç e kemi përmendur edhe në fillimet e arsimit të mesëm, në vitin shkollor 1925-26 hapet pranë gjimnazit edhe dega normale. Në një lajm të drejtorisë së shkollës, me firmë të dr. Mirash Ivanajt, theksohet se Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit me tel. nr. 1860, dt. 26.10.1925, lajmëron se pëlqen propozimin e kësaj drejtorie për çeljen e degës normale në të cilën vetëm për këtë vit do të pranoheshin nxënës të klasës së katërt. Mësimet fillojnë më 2.11.1925.¹⁰

10. AQSH, F. 669, D. 47, V. 1925, Fl. 29.

Duke krahasuar planin mësimor të vitit të parë me këtë të viteve 1924, 1925 dhe 1926 shohim disa ndryshime që më tepër synonin në forcimin e shkollës, gjë që pasqyrohet në plan dhe në shtimin e lëndëve të reja, kështu sasia e orëve javore shkon nga 25-23 në 26-27. Për të ilustruar këtë mendim po sjellim dy pasqyrat që vijojnë:

Për të dhënë një mendim të plotë dhe të saktë për përparimin e nxënësve dhe nivelin e tyre në gjimnazin e shtetit e kemi të vështirë në mungesë të materialeve për këtë problem, megjithatë po përpiqemi të sqarojmë diçka nëpërmjet statistikave dhe ndonjë burimi tjetër.

Rezultatet e vitit të parë të shkollës ishin këto:

Pasqyrë nr. 1
viti 1924-25

Nxënës gjithsej	Kalojnë	Riprovim	Mbeten
37	21	13	3

Rendi	Dega	Lëndët									Orë							
		Shq	L	Fr	Mat	Gjr	His	Shk	Viz	Muz	Kal	Moral	Gjer	Javore				
I	Klas	5	5	4	3	2	2	2	1	1	1	1	1	1	1	1	1	26
	Real	5	-	5	5	2	2	2	2	2	1	-	-	-	-	-	-	26
II III	Real	5	-	5	5	2	2	2	2	2	2	-	-	-	-	-	-	25
	Klas	5	5	3	3	2	2	2	2	2	2	-	-	-	-	-	-	26
IV	Real	5	-	4	7	2	2	2	2	2	2	-	-	4	-	-	-	26
	Klas	4	6	3	3	2	2	2	2	2	2	-	1	-	-	-	-	27*

Rendi	Dega	Lëndët										Orë						
		Shq	Fr	Gjer	Lat	Mat	Gjgr	Hist	Shk	Fi	Viz	Kal	V.gj	M	Fiz	Javore		
I	Klas Real	4	4	-	-	3	2	2	2	2	-	-	2	2	2	2	2	25
	Real Klas	4	4	-	3	4	2	2	2	2	-	-	2	2	2	2	2	29
II III	Real Klas	4	4	-	-	4	2	2	2	2	-	-	2	2	2	2	2	26
	Klas	3	3	4	-	4	2	2	1	2	-	-	2	1	2	-	-	26
IV V		3	3	-	4	3	2	3	1	2	-	-	2	1	2	-	-	26
		3	4	3	-	4	2	3	1	2	-	-	2	1	2	-	-	26
		2	3	-	4	4	2	3	-	3	1	-	2	-	2	-	-	26**

*. ASH, F. 669, D. 47, Fl. 4-5, V. 1925.

** ASH, F. 669, D. 47, V.1925, Fl. 11.

Riprovimet do të bëheshin në lëndët: gjuhë shqipe - 5 nxënës, frëngjisht - 11, histori - 5, gjeografi - 3, matematikë - 1, histori natyre - 5.¹¹

Siç duket Ministria e Arsimit dhe inspektorati nuk kërkonte përqindje të plotë kalimi dhe notë mesatare të lartë, parametra të cilat nuk i kemi parë absolutisht në asnjë statistikë të shkollave të paraçlirimit, por i kemi ndeshur çdo herë dhe kanë qenë shifra referimi për të treguar sukseset e arsimit në të gjithë shkollën shqiptare pas vitit 1944.).

Për të gjykuar sadopak për nivelin e përvetësimit të njohurive shkencore dhe përgatitjen e nxënësve na jep dorë një gjykim i Ministrisë të Arsimit të atëhershëm, Rexhep Mitrovica, i cili, në një letër të hapur dërguar arsimtarëve (letra e dytë e tij), duke trajtuar probleme të të mësuarit në shkollë, thekson se “mësuesi duhet të zhvillojë sidomos energjitë natyrore të fëmijës, t’i zgjojë t’i vejë në lëvizje t’i ngacmojë. Rëndësia nuk asht me derdhë njoftime të cilat i merr pozitivisht përkundrazi me e sjellun fëmijën të vërejë, të kujdeset, të mendojë, të gjejë.”¹² Për ilustrim po sjellim një shembull nga Gjimnazi i Shkodrës: “merrni nxënës të këtij gjimnazi dhe bëni një pyetje mbi historinë. Do të shihni se përgjigja e tij nuk do të përmbledhet në të thurur përmendsh të ngjarjes, por ka për t’analizue faktorët e kësaj, u bën kritikën, ua gjen gabimet dhe jep një gjykim mbi përfundimin mbas kapacitetit t’arsyetuemit të tij.”¹³

Në kuadrin e Gjimnazit ka pasur gjithmonë mësues të nderuar. Natyrisht për të bërë një listë të tillë është tepër e vështirë, mbasi aty renditen me qindra. Por emrat e Dr. Mirash Ivanajt, Ndue Palucës, Loro Rashës, Anton Dedës, Kolë Krajës, D. Mozalit, Januz Boliqit, L. Prelës që punuan në vitet e para të jetës së këtij gjimnazi do të mbeten në kujtesën e brezave të nxënësve që mësuan në këtë Gjimnaz e në Historinë e arsimit të rrethit të Shkodrës.

Pas provimeve të maturantëve të parë në degën klasike e reale, që u bë në qershor të vitit 1929, që ishte një ngjarje e rëndësishme në historinë e qytetit, për të cilën, në librin e procesverbalit të provimeve, është shkruar “Për herë të parë bahet në Shqipëri në gjuhën shqipe e në gjimnaze shtetërore provimi i maturës i gjimnazit të lartë”¹⁴, kanë dalë dhjetëra breza maturantë që kanë kontribuar në fusha të ndryshme të jetës dhe kanë ngritur lart lavdinë e këtij Gjimnazi.

Në jetën time të gjatë në arsim kam pasur rastin të njihem më shumë personalitete të arsimit që kanë punuar në këtë shkollë dhe do flas vetëm për dy miq të mi, (njëri prej të cilëve ka kaluar në botën tjetër dhe i dyti vazhdon punën edhe sot):

Ndër personalitetet e shquara të arsimit, të shkencës dhe kulturës shqiptare zë vend të nderuar edhe

11. AQSH, F. 669, D. 8, V. 1922, Fl. 9.

12. Po aty, f. 31.

13. Rev. Pedagogjike, f. 29, nr. i posaçëm.

14. Xh. Repishti, F Luli, libri i cit., f. 11.

Prof. dr. Jup Kastrati- “Mësues i Popullit” (me rastin e 100-vjetorit të Mësonjëtores shqipe të Korçës-1987) dhe “Mjeshtër i Madh i Punës” (dekorohet nga Presidenti i Republikës në vitin 1999) dhe në vitin 2002, Këshilli bashkiak i Shkodrës i dha titullin “Qytetar nderi”.

Përveç teksteve mësimore universitare dy kanë qenë “fushat e zemrës” të Prof. Kastratit: fusha e albanologjisë, gramatologjisë dhe fusha e studimeve deradiane.

Kështu që, studiuesit seriozë kanë theksuar se, gjatë viteve 1956-2003, nga veprimtaria shkencore botuese e studiuesit të afirmuar të gjuhës amtare, Prof. Jup Kastrati, ne trashëguam: **rreth 900 studime** dhe artikuj të përfshira në **14.000 faqe shtypi shkencor dhe divulgativ**, si: traktate, libra, monografi, studime, artikuj, kumtesa, referate etj., të botuara në revista dhe organe të ndryshme të periodikut brenda dhe jashtë vendit dhe e thënë me fjalë të tjera ka botuar **mbi 35 libra e monografi shkencore** gjithsej.¹⁵

Ndësa i dyti është z. Ahmet I. Boriçi, mësues, drejtues shkolle, didakt dhe botues tekstesh shkollore.

U lind në Shkodër, ku mori mësimet e para, duke kryer gjimnazin (1972). Më 1977 ka kryer Universitetin e Tiranës, dega matematikë. Ka punuar për shumë vite në fshatra të rrethit dhe në vitin 1987 punon në Gjimnazin e Shtetit, Shkodër, (Shkollën “28 Nëntori”), i cili ka veprimtari të dendur botuese në fushën e teksteve mësimore (si autor i vetëm dhe me bashkautorësi) me **27 tekste të ndryshme**, që përmbliidhen në **2700 faqe** të llojeve të ndryshme me teori, ushtrime etj.¹⁶

3. Dy fjalë si mbyllje:

Duhet të jemi të kujdesshëm në rastet e përvjetorëve të shkollave të mesme të tjera të Shkodrës si: Medresetë, Kolegji Saverian i Jezuitëve, Shkolla Normale e Motrave Stigmatine dhe Shkolla Normale (1917) (*Për të cilën kemi shkruar në “ZANI I NALTË”, themeluar më 1923 - Viti V, Nr. 19 (172), f. 44-49.*)

Në bankat e kësaj shkolle kanë mbaruar me qindra e qindra nxënës, që pasi kanë kryer studimet e larta, kanë shërbyer në të gjitha skajet më të largëta të Shqipërisë, të përgatitur nga një staf prej qindra mësuesish të talentuar që i kanë bërë nder kombit dhe arsimit tonë.

15. Përgatitur për botim në librin “Portrete të shquara...”, Shkodër, 2017:153-160.

16. Po aty, “Një jetë me dinjitet...” (Për mësuesin z. Ihsan Boriçi), f. 247-253.

Një vështrim historik mbi librin “Historia e pashallarëve shqiptarë në Perandorinë Osmane” të Syrja bej Vlorës

Pjesa e II

Dr. Hasan Bello
Instituti i Historisë, QSA

Abstrakt

Libri i Syrja bej Vlorës “Historia e pashallarëve shqiptarë në Perandorinë Osmane” është një përpyetje modeste për të hedhur dritë mbi një numër të konsiderueshëm personalitetesh, të cilët kanë jetuar, vepruar dhe kontribuar në një shtet perandorak, pjesë e të cilit ishin edhe shqiptarët për pesë shekuj.

Në këtë libër jepen të dhëna me karakter të përgjithshëm, të cilat, për hir të së vërtetës, sot mund të quhen të tejkaluara për ata studiues që do të merren me hulumtimin e thelluar të periudhës osmane. Ndërsa për lexuesit e pasionuar të historisë, ato përbëjnë një kontribut të vyer, me informacion pak ose aspak të njohur. Autori shpalos të dhëna me interes për emra të njohur e të panjohur nga historiografia shqiptare. Ndoshta për faktin se për këto personalitete, në vend të arsyës, ka mbizotëruar paragjykimi.

Ky libër në dorëshkrim është shkruar në gjuhën osmane dhe së bashku me përkthimin në gjuhën shqipe gjendet në Arkivin Qendror të Shtetit-Tiranë.¹ Ai ka 144 faqe në osmanisht dhe 52 faqe në gjuhën shqipe, të cilat janë përkthyer nga orientalisti Jonuz

1. AQSH, F: S. Vlora, D. 9.

Tafilaj. Në inventarin e hartuar nga përgjegjësi i sektorit të dorëshkrimeve turke në arkivin historik, orientalisti Haki Sharofi, shkrubet data e marrjes në dorëzim të këtij përkthimi 26 qershor 1963.² Ndërsa për kohën se kur është shkruar nga Syrja bej Vlora, ende nuk kemi asnjë të dhënë.

Megjithëse ky përkthim në dorëshkrim është në dialektin verior dhe përmbante një sasi të konsiderueshme gabimesh, ne jemi përpjekur që të ndërhyjmë vetëm aty ku ishte domosdoshmërisht e nevojshme. Kjo, sepse dialektet së bashku me përkthimet e realizuara në një periudhë të caktuar janë një pasuri e jashtëzakonshme dhe mbajnë vullën e kohës. Por, nga ana tjetër, për t' i ardhur në ndihmë lexuesit, vitet e kalendarit hënor i kemi konvertuar në kalendarin diellor, duke i vendosur ato në kllapa, pa e prekur origjinalin. Aty ku ka pasur ndonjë term historik osman jemi përpjekur që ta shpjegojmë me shenjë (*) në nëntekst. Ndërsa për disa personalitete, për të cilët ekzistojnë datëlindjet, viti i vdekjes dhe koha se kur kanë shërbyer si kryeministra, ato i kemi vendosur në kllapa.

2. Po aty.

Historia e pashallarëve shqiptarë në Perandorinë Osmane II

nga Syrja bej Vlora

1. Rexhep Pasha
2. Kurd Mehmed Pasha
3. Ahmed Pasha (Dervishi)
4. Ahmed Pasha
5. Mustafa Pasha
6. Selman Pasha
7. Selman Pasha
8. Sulejman Pasha
9. Ahmed Pasha
10. Ismail Pasha
11. Ahmed Pasha
12. Arslan Pasha
13. Ebu Beqir Bej
14. Tahir Pasha
15. Ismail Pasha
16. Mahmud Pasha
17. Maliq Pasha
18. Jahja Efendi
19. Ali Pashë Tepelena
20. Ibrahim Pasha
21. Ibrahim Pasha
22. Ismail Pasha
23. Hasan Pasha
24. Sylejman Pasha
25. Salih Pasha
26. Ali Pasha
27. Selim Sati Pasha
28. Ahmed Efendiu
29. Is'hak Efendiu
30. Hyjsejn Hysni Bej
31. Shaker Mehmed Pasha
32. Mustafa Sherifi Pasha
33. Osman Mazar
34. Sylejman Spahiu
35. Sylejman Refat Pasha
36. Galip Mustafa Bej
37. Ismail Haki Pasha
38. Zeki Pasha

39. Ismail Rahim Pasha
40. Mehmed Pasha
41. Hoxha Hasan Tahsim
42. Aqif Mehmed Pasha
43. Asaf Bej
44. Ali Pasha
45. Fehim Bej
46. Nazif Mehmed Pasha
47. Vejsel Pasha
48. Vaso Pasha
49. Hamdi Ahmed Pasha
50. Hasan Haki Pasha
51. Ali Riza Bej
52. Abdyl Bej Frashëri
53. Abdurrahman Nasib Efendi

Mustafa Pasha: Është nga Janina, i biri i Haxhi Mehmed Pashës. Tue qenë djalë i një ajani (parësi) dhe dashamirë i perandorisë, në vitin 1158 h (1745) u emëruë mytesarrif në Delvinë me gradë mirmirani. Këtu qëndroi për një kohë të gjatë, mandej i pushuem erdhi në Stamboll ku vdiq në vitin 1172 h (1758). Qe i zellshëm, trim e njëkohësisht edhe administrator i zoti. Sanxhaku i Delvinës pati qetësinë e duhun për sa qëndroi aty Mustafa Pasha, dhe i madh e i vogël gjithkush pati për të nderim.

Selman Pasha: Në kohën që ishte në fron sulltan Mahmudi I u gradue mytesarif i Janinës me gradë mirmiran, ndër detyrë që pati gjatë njëzet vjetëve u tregue një administrator i aftë, megjithëse i egër e i rreptë në punë. Qe trim. Vdiq në vitin 1177 h (1763).

Selman Pasha: Është djali i Mehmed Pashës, agë e parësi e Gjakovës. Me gradë mirmirani u emënuë mytesarif në Janinë, në vitin 1148 h (1735). Mbas tetë vjetëve që ndej këtu, u transferue si mytesarrif në Shkup, ku qëndroi për një kohë të gjatë. Fanatizmi i tij kombëtar qe çfaqë edhe në të nëpër guxim e trimni të jashtzakonshme që tregoi; gjithashtu u dallue dhe me cilësina si një administrator i mirë.

Sulejman Pasha: Elbasanas, nga një familje fisnike. Me gradë mirmiran iu dha funksioni si rojtar (muhafëz) në Zishtovi. Për shërbimet e jashtëzakonshme që kreu në këtë vend, në vitin 1185 h (1771) u emënuë me gradën vali i Janinës, tue u naltësue edhe në vezirni. Mbrapa vali i Shkupit e muhafis i Hutin-it. Në vitin 1190 h (1776) në Ajnë-Bahti (Sepan), në vitin 1191 h (1777) n'Ohër bashkë me muhafëzllëkun e Hutinit. Mbas tri vjetëve vali në Selanik; lanë do kohë në dispozicion, mbrapa u dërgue si muhafiz në Agribug (Eube). Vdiq në vitin 1197 h (1782). Qe trim, i zoti dhe administrator i mirë.

Ahmed Pasha: Është nga Ohri. E para nëpuni i tij qe Kapëxhë-bash. Për zotësinë që tregoi ndër nëpunësina që pati sidomos për trimëninë që provoi në vitin 1197 h (1782) në krye të trupit ushtarak, si shpërblim nga sulltani, u emënuë

po në këtë vit me gradë vezirniye si Bashbug në Bugdan (Moldavi), tue pasë mbi vehte edhe mytesarriflikun e Ohrit. Një vit mrapa iu dha valillëku i Halepit. Në vitin 1198 h (1783) kur ishte në Stamboll iu pre koka, i paditun për disa fajë që kishte bënë ndër nëpunësina ma të përparshme.

Ismail Pasha: Është nga Prishtina. Iu dha grada mirmiranit si shpërblim i përpjekjeve të tija të jashtëzakonshme në luftën kundra Rusëve që filloi në vitin 1187 h (1773) ndër ditët e para kur hypi në fron sulltan Mustafai III e që përfundoi me zbritjen e ushtrivet ruse deri në Tunë (Danub), mbasi këto shkelën krejt Maxharinë, Vllahinë e Moldavinë; e mbrapa si mytesarrif i Akshehirit u dërgue në luftë kundra Bagdatit. Në vitin 1197 h (1782) muhafëz në Janik, mbas një viti mytesarrif në Bursa ku dhe vdiq.

Ahmed Pasha: Është i biri i Mehmed Pashës, mytesarrif i Shkodrës. Me ndërmjetësinë e Ahmet Pashës, vëllait të tij, u bë mirmiranë e mbrapa, në vitin 1198 h (1783), mytesarrif i Ohrit. Nën përshtypjet e kohës bani za në punë të mbrapshta, me thanë ma drejtë, ngrejti krye dhe u dënue me vdekje në vitin 1201 h (1786). Qe trim.

Arsllan Pasha: Është nga Janina. Mbasi pati nëpunësina të ndryshme në vitin 1109 h (1697) u

emënuë vali në Janinë. Këtë rang e mbajtën pjestarët e familjes së tij deri në vitin 1203 h (1788) që u emënuë vali i këtij vendi Ali Pashë Tepelena. Qe njeri i matun e bamirës. La shumë vepra bamirësie. Xhamia e ndërtueme prej tij që mori emnin “Xhamia e Arsllan Pashës” në skajin veri-lindor të kalasë së Janinës, në një vend të naltë mbi liqen, asht një nga ndërtesat ma të bukra të Janinës. Pranë xhamisë ka një medrese e një teqe Nakshibendishë, ku janë të varrosun Sheh Jusufi e Sheh Abedini, pasardhësit e sheh Aliut, i tarikatit Nakshibendi, për të cilin me tevatun beshet* se ishte një shejt. Pjesa më e madhe e Bejlerëvet të Janinës zbresin nga barku i këtij Arsllan Pashës.

*Sipas të dhënave të transmetuara gojë pas goje.

Ebu Beqir Bej: Është djali i Ahmed Pashës, prej Qesrije (Kosturi). I dalë nga Kalem (i praktikuem në zyrë-J.T.) në moshë të re hyni në radhë të hoxhallarëvevet. Në vitin 1155 h (1742) u emënuë financier i vogël i Evkafit* dhe mandej kaloi ndër funksione të ndryshme. Në vitin 1168 h (1754) historian (dhe kjo ishte ndër funksjone zyrtare-J.T.), në 1173 h (1759) Nazir i Tepelenës (shef i fonderisë së topavet) e në fund teqerëi evvel (një lloj nëpunësi si sekretar). Në vitin 1178 h (1764-1765) u pushue, por pa lanë edhe një muaj u muer prap në shërbim të shtetit si

ruznamexhi (historiograf); por për shkak ankimesh që u banë kundra tij u pushue dhe u internue në Limnos. Po në këtë vit t'internimit u lirue dhe u emënie tezqerexhi në financë, në vitin 1183 h (1769) sekretar i Jeniçerëvet, mbrapa zëvendës çausbash e në 1187 h (1773) definitivisht në këtë vend. Mbas do nëpunish që pati ma mbrapa, në 1196 h (1781), u emënie Muhasebi-Evvel**, në 1197 h (1782) Shikki (?) - Sani Defterdar. Në vitin 1209 h (1794) vdiq. Qe i zoti në çashtje financash, i drejtë dhe fort i nderuem në kohë të tij.

*Evkafi ishte zyra që merrej me administrimin e pronave vakëf.

**Kryellogaritar.

Tahir Pasha: Është nga Bilishti. Qe nën komandë të Mehmet Pashës me gradë majori dhe mori pjesë në luftë të Vidinit, ku tregoi trimni dhe gajret. Mbrapa shkoi në Egjipt me Jusuf Zija Pashën dhe për shërbimet e mira që bani këtu iu dha grada e mirmiranit. Kur u kthye në Stamboll ushtria perandorake, ai ngeli në Egjipt dhe mori pjesë me gjithë dy vëllaznit e vet, Hasan Pashën e Abdi bejnë, në intrigat që i lufti Stambollës Mehmet Ali Pasha. Në vitin 1218 h (1803) me pushimin e Husrev Pashës qe nja njëzet e tri ditë zëvendës-vali n'Egjipt. Në këtë vit u dogj në një zjarm ku gjeti vdekjen. Qe njeri naiv, natyrë dervishi dhe simpatizues i mexhizubë-vet (posrede).

Ismail Pasha: I përkrahun prej Mustafa Pashës, vali i Marashit, u ba Ket'huda i këtij. Dhe prap me ndërmjetësinë e tij pati shërbime të ndryshme dhe, për hir të tij, fitoi famë. Kështu në vitin 1215 h (1800) me gradë veziri u emënie vali i Marashit. Në vitin 1216 h (1801) komandant i ushtrisë që luftuen në Egjipt kundra Napolonit. Në një kohë qe vali i Sajdas. Pak më mbrapa u pushue dhe iu pre koka, mbasi i qe zbulue që kish marrë anën e armikut.

Mahmud Pasha (Zukaogllu): Është nga Elbasani. Me mendimin që të tërhiqte prej qeverisë Ali Pashë Tepelenën u dërgue kahë ana e Janinës dhe në vitin 1237 h (1821) u nderue me gradë të mirmiranit. Po në këtë vit u emënie mytesarrif i Elbasanit, ku qëndroi pesë vjet. Në vitin 1242 h (1826) vdiq. Qe njeri që kishte dëshirë të bante mirë.

Maliq Pasha: Prej një familje fisnike, u emënie mytesarrif në... (?) me gradë mirmiranë. U dallua si një administrator i mirë. Në vitin 1223 h (1808) u ba mytesarrif n'Elbasan. Gjatë nëpunësie prej ma se dhjetë vjetësh që pati këtu, la një emën të mirë të pa harrueshëm. Në vitin 1236 h (1820) u transferue si mytesarrif i Iç-Ilit e i Sofjes e mrapa i Qastendilit. Vdiq pas pak kohe që qe në këtë vend.

Jahja Efendi: Erdhi i ri në Stamboll dhe hyri në saraj. I dhanun pas mësimave ndoq shkollën e Enderunit dhe u pajis me dituni. U muer dhe me hifz (me mësim Kur`ani përmenc), në mënyrë që t'i ndigjohet këndimi i tij i Kur`anit. Tue u zhvillue kështu zgjimin e tij, u emënuë nga ana e Padishahut Miftah-aga (ai që mbante çelsat e dyerve të sarajit) e mandej Ket`huda i visarit mbretënor 1197 h (1782). Mbas katër vjet të këtij shërbimi u emënuë Silahdor perandorak dhe si shërbeu dhe këtu katër vjet, u pushue e mbas pak kohe vdiq. Pat një shkrim të bukur dhe në pak kohë hyni në radhë të kaligrafëve të famshëm. Ka një vepër të shkrueme me dorën e tij artistike në xhaminë e Ajasofjes.

Ali Pashë Tepelena: Ali Pasha asht një vezir, që pati një famë të madhe nëpër veprat e tij të jashtëzakonshme që kreu në kohën e sulltan Selimit të III, sulltan Mustafajit të IV e sulltan Mahmudit të II. Ma se tridhet e tre vjet sundoi në Janinë si vali e si derebej (feudal). Ali Pasha ka lindur në qytetin e Tepelenës në vitin 1157 h (1744). Gjyshi i tij qe mirmiran Ali Pasha, i cili vdiq historikisht në rrethimin e Korfuzit në luftën që u hap kundra Venedikasavet, tue lanë pas vedit tre djem. Ma i vogli ndër këta vëllazën Veli beu ma mbrapa u ba Pashë me gradë mirmiran tue ngelë pa

trashigim, pse iu morën dy vëllezërit e tjerë, u dha mbas plaçke tue qenë në moshë të re dhe në pak kohë arriti me grumbullue një pasuni të madhe dhe me ja bo taraf (partizanë) prej vedit. Vjen një ditë në Tepelenë dhe i djeg të vëllaznit ndër shtëpija të veta. Merret vesht, se kjo vepër e tija po dezaprovohet nga bejlerët e tjerë dhe se këta janë marrë vesht ndër vedi për t'a zhdukun Veli beun, largohet prej vendit të vet dhe shtrëngohet me jetue larg disa kohë. Por në saj të influencës që i ka sigurue vehtes dhe të parëve që ka fitue ban çka don në rajonin e tij dhe kështu fiton famë dita ditës. Në këto kohë mytesel`lim (sundimtar) i Tepelenës asht kushrini, Islam beu, të cilit i drejtohet që t'ia lëshonte nën juridikcion e protekcion të tij Hormovën dhe Leklin, dy katunde të krishtenë. Katunde të krishtenë të Shqipnisë së Jugut pranojshin mbrojtjen e një personi në za (të zotin) për t'i shpëtue sulmit e grabitjevet të çetavet dhe i pagujshin atij personi mjaftë të holla si të drejtë mbrojtje. Ky sistem i dobët i kohëve primitive e mesjetare vazhdoi për një periodë të gjatë ndër disa vise të Perandorisë Osmane, sidomos ndër ato vende të pjellshme e të begatshme kufitare me vendet dezerte e shterpë. Banorët e këtyne vendeve tue mos pasë se me çka me sigurue jetesën e tyne, jepeshin gjithnjë mbas grabitjeve, në mënyrë që ata të vendeve të begatshme, të lidhun me

tokën e me punën, nuk mund të përballojshin sulmet e atyne grabitqarëvet. Në këto vende të begatshme tue mos mundë me ngreh këtë formë organizimi që shohim sot, pranojshin mbrojtjen e një njeriut dhe e paguejshin këtë randë. Po kështu dhe Veli beu nën këtë emën mbrojtësi merrte të holla prej banorëvet t'atyne dy katundëvet, dhe këtë gja ia njehte vehtes një nderë. Tue marrë kështu në mall a në të holla nga ato katunde dhe tue çvesh popullin rreth e për qark me anë çetash që kishte formue n'anë tjetër e tue marrë për vedi pjesën ma të majme ndër këto grabitje i lindi Veli beut një ditë dëshira m'u ba i madh. Qe, i shtyem prej këtij instikti nisët'or konsiderojë si shemër Islam benë që ma parë i kishte ba nderë dhe kështu mer një qëndrim për të shti në sferë të protektoratës së tij të tanë atë qark. Kështu këto dy fuqi kundërshtarë do të përplaseshin një ditë njana me tjetrën dhe njëna prej tyne do të thyhej. Si edhe ngjau. Me shkas që të shtrohej Hormova, kin dalun dore, zjarmi i diskordit u ndez dhe në fund Veli beu, dalë në këtë përleshje fitues, vranë Islam benë. Vdekja e mytesel'limit, Islam beut, ia la shprazët sheshin Veli beut, prandaj ky me një herë kërceu në vend të tij, tue nxjerrë njëkohësisht nga sulltani edhe gradën e mirmiranit, të cilën gradë e ktheu në pashë, megjithse ky përparim i tij nuk ngelte pa gjetë rezistencë ndër bejlerë të vendit. Veli

Pasha ishte martuem dhe kishte dy djem e dy vajza. Tue i pasë vdekë kjo grue, u martue së dytit herë me Hankon (Ismihan-in) të bijën e Zejnel begut të Mehmed Pashës, nga parësi e Konicës. Dhe nga kjo martesë pati një djalë e një vajzë. E qe, Ali Pasha, të cilit po i japim këtu biografinë asht djali që i lindi Veli Pashës nga martesa me këtë gruen e dytë. Kur vdiq Veli Pasha, Ali Pasha ishte ende një foshnje, në moshën nandë vjeç, i ngelun jetim. E ama e mori me vedi këtë dhe të motrën e tij Shehnisanë 7 vjeç dhe shkoi te i ati. Kjo grua ishte guximtare, njëkohësisht edhe intrigante. E vetmja dëshirë e saja ishte me marrë revanshin e të shoqit nga bejlerët që e kishin pague me hye e me banue në Tepelenë. Prandaj, përherë këtë ide i frymzonte të birrit dhe n'anë tjetër s'rinte duerlidhë, por organizonte marrëveshje me miqt e vjetër e të shoqit. Bejlerët e Kardhiqit të Gjirokastrës ç'me kohë ishin n'armiqësi me Ali Pashën, gjyshin e Ali Pashës për të cilin po flasim tashti, dhe si shenjë e kësaj armiqësie e kishin përbuzë e marrë nëpër këmbë Hankon. Kjo grue, mbushë në zemër me ndjesina urrejtjeje dhe shpoge ndaj bejlerëvet e Kardhiqit, por e dëshprueme se nuk mund e shfrenonte mllefin kundra tyne, e kapi për qafe të birin, para se me vdekë dhe e porositi me ngulm t'ia merte hakun babait të tij. Ali beu (në këtë kohë nuk ash ba ende pashë-

J.T.) me ngacmimet e s'amës mori udhën e t'et. Por veprat e tija që konsistojshin në prishje të sigurimit e të qetësisë, i tërhoqën vrejten Kurd Ahmed Pashës, mytesarrifit (gubernatorit) të Vlorës, dhe prandaj ky porositi, në mënyrë këshilli të shoqnuem dhe me kërcnime, që të shporrej brigandazhit dhe të kthente në Berat ku do t'i jepen një punë e përshtatshme me pozitën e tij. Ali beu i bindet këtij këshilli, vjen në Berat dhe provoi funksione që i besohet si serqerde për të shtypë banditizmin që aso kohe kishte marrë një përpjestim shumë të randësishëm ndër ato anë. Kurd Ahmed Pasha kishte një vajzë dhe Ali beu mendonte se tue u martue me të do të shtinte në dorë mytesarriflikun e Beratit që kishte si krye-vend Vlorën; bile tërthorazi kishte fillue t'a çfaqte këtë mendim. Por Kurd Ahmed Pasha e gjykoi si ma të drejtë me i dhanë të binë Ibrahim beut, djalit të Kapllan Pashës, nga familja e Sinan Pashë Vlorës. Ali beu i zemëruem se nuk mund e realizoi këtë qëllim nuk rrin ma në Berat, largohet prej këtu dhe kapë prap rrugën e brigandazhit, dhe në viset e Tepelenës që i bani si qendër veprimi Ali beu mori randësi, saqë filluen me i ardhë ankime kundra tij Kurd Ahmed Pashës, i cili tue kuptue tashma se këshillat nuk do t'i bajshin fajde, vendosi me përdorë forcë dhe andekand shpërndau ç'pallje, tue i premtue

pesëmij grosh atij që t'i sillte kokën e Ali beut. Si për çudi Ali beu që merr vesht këtë vendim të Kurd Ahmed Pashës, sendërgjon një hile, natyrisht pse shuma e premtueme si e majmë ishte lakmueme prej tij, dhe i çon pashës një palë rroba të vetat të përlyeme me gjak dhe kështu shtjen në dorë të hollat. Kështu, Ali beu në një anë me friksime e kërcnime dhe n'anë tjetër me këto të holla ban për vehte partizanë dhe nisë me i dhanë shqetsime Kurd Ahmed Pashës. Në sa shtohet forca e brigandazhit t'Ali beut aq ma serjoze bahej dhe ndjekja e gjurmimi i tij prej Pashës, i cili u premtonte të holla e privilegje atyne që do t'a vritshin e për ma fort armiqvet të tij. Tue e pa ngushtë vedin, Ali beu, nga ndjekjet që i baheshin e tue mos mundë ma m'u mbajtë në Tepelenë e rrethe, bashkë me disa partizanë të vet shtrëngohet me u strehue te Kapllan Pasha, mytesarrif i Delvinës e shemër e Kurd Ahmed Pashës. Kapllan pashaj çmoi meritat e Ali beu, dhe i dha për grue të bijën e tij Ymmigjylthym-in. Dasma u ba madhshtore. Sidomos bukuria e jashtzakonshme e nuses ngjalli zilinë ndër shumë veta që e shihnin. Dhe Ali beu, si një provë e mirënjohje ia dha të kunatit motrën e vet Shehnishah hanëmin. Kështu, krushqia u ba dy anshe. Aso kohe lufta turko-ruse vazhdonte; dhe në Mal të Zi kishte shpërthye kryengritja, për të mposhtur atë ishte ngarkue Mehmed Pasha, vali i Rumelisë.

Ky bashkë me sanxhak-bejlerë të tjerë kishte ftue dhe Kapllan Pashën me marrë pjesë në këtë ekspeditë. Kapllan Pasha në këtë shteg ra në kurth t'Ali beut, dhe gjet vdekjen. Ali beu kishte pa kaq të mira prej Kapllan Pashës. Këtij ia detyronte jetën; aq ma tepër i kishte dhanë për grue dhe të bijën. Kjo vepër gjakatare e Ali beut kundra bamirsit të tij, formon një ndër veprat e tij ma të poshtra. Kapllan Pasha mbronte së tepri Himarjotët, dhe Ali beu lajmoi se Himara do të bahej qendra e lëvizjeve të vjehrrit të tij për independencë. Ky lajm u ba shkak që Kapllan Pasha të dënohej me vdekje. Një ditë, pa zhurmë e pa potere, u thirr në Manastir prej valiut Mehmed Pashës. Kapllan Pasha ngarkoi menjëherë, mbas sigurimeve që i dha dhëndrit Ali beu, u nis e shkoi në Manastir ku me të mbriritun iu pre koka, ashtu si e kishte parandi. Ali beu, tue krye në një anë këtë poshtërsi n'anë tjetër shkoi në lamë të luftës me vullnetarë që mblodh dhe aty shërbeu mirë dhe tregoi trimni, për të cilën meritë nga ana e Padishahut iu dha grada e Mirmiranit bashkë me mytesarriflikun e Tërhallës. Me vdekjen e Kurd Mehmed Pashës Bash-bug i derbendevet dhe mytesarrif i Vlorës, u emënuë këtu mytesarrif me gradë Mirmirani dhandri i tij Ibrahim beu, tue iu besue roja e derbendevet Ali Pashës. Ali Pasha me tu emënuë Mytesarrif në Tërhallë, u përpoq me

shti ndër duer të veta edhe Janinën dhe në pak kohë ia doli këtij qëllimi, tue u nderue prej sulltanit me gradë veziri. Ali Pasha tash ma u bind se koha e favorizonte me marrë shpagë kundra armiqvet të tij, dhe gjith kujdesin e tij e drejtoi kahë ky qëllim. Veprat e shpagimit t'Ali Pashës, krye direkt nga ana e tij ose tërthorazi, janë fort barbare. Bile mund të thuhet se porositë e s'amës i çoi në vend përtej se duhej. Sepse nëpër influencë të jashtëzakonshme që i siguroi vetvehtes vrau të gjithë ata që i kishin ba ma të voglin dam, i zhbini me plagë e shtëpi dhe ua shoi vatrat; me një fjalë s'la të keqe pa ba. Tue zgjanue në një anë rrethin e influencës së vet, në anë tjetër ndau Ali Pasha me vehte me pastrue vendin nga krenët e nga njerzit me influencë që mund t'i kishte kundërshtarë dhe nisi punën tue dërgue ushtarë kundra Ibrahim Pashës, dhandrit të Kurd Ahmed Pashës. E xu të ngratin rob dhe si të tillë e mbajti në burg deri sa vdiq. Sa herë që populli i lutej Ali Pashës t'a lironte Ibrahim Pashën, i njohur për virtytet e tij të mira, Ali Pasha ia shtonte atij vujtjet, ia ndryshonte turturat deri që ma në fund si thuhet e vrau me dorë të vet kur mori urdhën të premë prej Stambollës që ta lironte, dhe lajmoj Stambollën që vdiq nga vdekja e natyrshme. Kur e mori rob Ibrahim Pashën me grue e me fëmi, kreu dhe një vepër tjetër të çuditshme. Ia mori me dhunë për

grue të shoqen Ibrahim Pashës, bijë e Kurd Ahmed Pashës që nuk pat mundësi ta merrte, si ç'u tha ma naltë. Kurse vajzat e Ibrahim Pashës i pat marrë qysh më parë për djemt e vet e për të nipin. Kështu vu nën kambë dhe krushqinë. Influenca e Ali Pashës shtohet dita ditës dhe vetë ai përpigjet ta forconte këtë influencë. Zgjanoi rrethin e sundimit të vet deri në Elbasan e deri në Dibër, veç Jenishehrit, Tërhallës, Moresë e Agribuzis (Eubesë) shtiu në suazë të sundimit të tij dhe vise nga Greqia; djemvet të vet iu solli nga Stambolla grada Mirmiranësh. Myftar Pashën e emënoi mytesarrif në Ajnebahti (Levanti) e Veli Pashën në Tërhallë. Dhe Tepelenasi, kishte paraqitjen e një serqerdeje ushtrie të rregullt si Mehmet Ali Pasha (i Misirit); prandaj donte m'e imitue këtë. Mirëpo midis tyre, si e thekson dhe i nderueshmi historian Xhevdet Pasha, kishte ndryshim. Mehmed Ali Pasha ma fort se ndër punë ushtarake, ishte shumë i zoti në diplomaci e një person jashtzakonisht prudent e administrator i mirë. Administrimi i Misirit e begatia që i dha këtij vendi janë prova të dukshme të inteligjencës e të zotësisë së tij. Kurse veprat e sjelljet e Ali Pashë Tepelenës i ngjajnë veprave të serqerdes të një fallange bashibuzuke. Në punë të Tepelenasit nuk shihet ajo rregull e ai perfeksionim që bin në sy, në punë të Mehmed Ali Pashës të Misirit. Ndërsa ky përpigjet për begati të

Misirit, Ali Pasha i ynë shiqon si e si me tërhjekë dobi prej vehtes në bujqësi e në tregti dhe me begatë çifligjet e veta, numri i të cilëve vinte tue u shtue ditë për ditë. Me shkase të vogla ban për vedi katunde dhe i zhndrron këto në formë çifligjesh. Katundarët tue u dëmtue prej këtyne veprave, përgjojshin gjithnjë perëndimin e hyllit të tij. Por me gjithë këtë sjellje, Ali Pasha përpigjet me vu rregull e disiplinë në vend dhe kësaj pune ia arriti tamam si duhet. Të mos ishte shtye së tepri në vepra barbare, n'intriga e në gjakderdhje dhe të mos ndjente një shije sadiste sidomos në tortura që ia kalojshin atyne mesjetare dhe një kënaqsi në përsëritjen e këtyne torturave, ai s'do t'ia arrinte atij përfundimi tragjik që arriti dhe si pasojë vendi nuk do të shihte damin që pau. Një e metë e dytë e Ali Pashës ishte dëshira e tij me zhdukë personat me influencë e me dinjitet që mund t'i bëheshin shemër. Një mend, ku kishte njerëz të këtij kalibri, i hoqi kësaj jete një nga një ose shpesh, tue përdorë intriga, i ndërseu ata kundra shoqishoqt dhe vetë qëndronte si spektator. Dikush prej tyre internohej nga pashaj e dikush prej tue mos mundë me ndejë në vend nën kushte të krijueme prej tij, lente plang e shtëpi dhe largohej. S'ishin vetëm pasanikët që dëmtoheshin. Merrej nëpër kambë dhe pjesa e varfën e popullit dhe përdorej angari në emna të ndryshëm.

Bukuria e vajzave dhe gravet ishte faj për to, dhe shtrëgoheshin me ndej mësheftë, pa pa diell as dritë me sy. Dhe një tjetër mungesë e tij: Me përkrahë injorancën. Metodat me të cilat qeveriste vendin me gjithësi t'arsyeshme, prap jo aq të pëlqyeshme nga Stambolli. Por një gjë ishte e vërtetë: Presioni i frytshëm që ushtronte mbi grekët, në mënyrë që për këta ishte e mundur të ngrejshin krye për deri sa të vazhdonte influenca e pushteti i tij. Një paradoks bie në sy në qëndrimin e Ali Pashës ndaj grekëve: Me gjithëse në një anë kundërshtarë i grekëve dhe i lëvizjes së tyre nacionale, në anë tjetër gjithë punët burokratike t'administratës së vet i kryente me anë të një komisioni i përbanum prej grekësh, mbasi edhe vetë njihje një greqishte vulgare e kështu mund t'a kontrollonte korrespondencën. Bile punë për t'u çuditë, në një kohë kur nga shqiptarët iu hoq besimi, armatosi grekët dhe nisi t'i përdorë këta kundra qeverisë perandorake. Prandaj ka dhe asish që besojnë se prej këtu u frymzue shpirti grek për një revolucion, i cili erdhi tue ngufue dhe tue u forcue dalë kadalë. Në fund, mizoritë e Ali Pashës u ranë në vesh qeveritarëve të Stambollit. Pasho Beu i Janinës, i mënimë ç'më kohë kundra Ali Pashës u bashkue me Halit efendinë edhe ky kundra Ali Pashës dhe ia intriguen përpara sulltanit se ai kishte qëllime independence, intrigë kjo që e zemroi sulltanin. Në fillim nuk

patën aq efekt intrigat e Halit efendiut; por mbrapa ato intriga dhanë frytin e tyre me ndërhyrjen e disa ngjarjeve, një ndër të cilat qe kjo; Ali Pasha çoi në Stamboll dy njerëz të tij vullnetarë, Hado Banin e Sylejmanin, për të vra Pasho Begun. Këta një ditë shtinë t'a vrasin Pasho Begun, kur ky po rrinte pranë dritares së shtëpisë së tij afër xhamisë s'Aja-Sofjes. Por atentati dështoi dhe autorët u kapën dhe pohuan fajin e tyre. Kjo ngjarje shpërtheu në Stamboll si një bombë dhe iu kallu tmerrin armiqëve të Sali Pashës, e sidomos Halit efendiut. Në Stamboll, Ali Pasha kishte partizanët e vet, si Hysejn bej Konicën, Elmas aga Merxhanin, Sheh Sylejman Efendinë dhe Said Efendi Janinën, të cilët Stambolli i këtheu në Janinë. E qe kjo ngjarje që shpejtoi ndjekjet kundra Ali Pashës. Si fillim masash kundra tij, vetë ai u pushue nga funksioni që kishte si roje e debendevet e mbrapa si prefekt i Janinës; djemt e tij Veli Pasha e Salih Pasha, njeni u pushue nga funksioni si prefekt i Tërhallës e tjetri si prefekt i Karli-Ili dhe Mehmed Pasha, biri i Veli Pashës nga sanxhaku i Delvinës. N'anë tjetër dhe Ali Pashës iu kumtue urdhëni që të tërhiqej në Tepelenë, në vendlindjen e tij, dhe aty të priste fermanin që do të nxirrte sulltani. Ali Pasha, i cili Janinën e konsideronte si një maliqane (domen) të vetën, lajmëroi Stambollin se s'mund largohet andej

dhe paraqiste disa shkaqe e justifikime. Ky qëndrim i tij u interpretue edhe më keq, prandaj këtë herë u vendos të merreshin masa të rrepta kundra tij. U organizua një ekspeditë ushtarake nën komandë të Hurshit Pashës. U ftuen me marrë pjesë në këtë ekspeditë dhe krenët e Shqipnisë së Veriut me fuqina të veta, mbasi ata me kohë ishin kundra Ali Pashës. Ali Pasha, tue marrë se punët e tij kishin marrë në thue, iu drejtue Stambollit dhe hyni n'mëshirë falje, por Stambolli nguli kambë t'a shtronte me njojet e Halit Efendiut. Atëherë Ali Pasha nuk gjeti rrugëdalje tjetër veçse m'u përgatitë për rezistencë, dhe kështu nisi t'organizojë fuqitë e veta. Megjithse ndër investiturat e kryevjetit iu la prap, me disa kushte, sanxhaku i Janinës, por ai tashi ma ishte gati për rezistencë me forca të veta t'armatosuna. E ky akt i tij këtë herë u muer si një revolt kundra sulltanit, dhe u pushue nga valillëku i Janinës, tue u emënuë në vend të tij Mehmed Pasha, me gradë vezirnie. E që nga këtu bindet esenca e konfliktit që mer mandej formën e një konflikti t'armatosun. Mirë keq, rrethimi i Janinës vijoi dy vjet. Por tue vazhdue presioni, njerzit e Pashës po shpërdaheshin, deri sa në vitin e dytë të rrethimit nuk i kishin ngelë besnikë veçse pesëdhjetë vetë. Kush i sillte shpinën Pashës jo vetëm që falej por edhe shpërblehej. Mbasi punët morën këtë përfundim filloi

korrespondencën me propozim që të falej me kusht që të vinte në Stamboll. Hurshit Pasha i lëshoi një akt, me të cilin i falej jeta, me kusht që të banonte në atë vend e në atë rrogë që do t'i caktonte qeveria. Dhe kështu Ali Pashaj doli nga kalaja dhe me pesë ose dhjetë njerzit e vet kaloi në ishull të liqenit të Janinës. Por çka se falja e tij nuk i vinte për hesapë Halit efendiut me shokë, për shkak se mas këndeje s'do të mund t'intrigonte ma kundra Pashës e për ma tepër, por sa të largohej nga Janina Ali Pashaj grekët do të ngrejshin krye, e atëherë ndoshta ai do të dërgohej prap në Janinë dhe kështu do t'i çmohej vlera. Ali Pashaj i kishte shkruë Stambollit (sulltanit) gjatë e gjerë, se njihte sekretet e shoqnisë së mësheftë "Filiqi Etiria" që kishte organizue revolucionin e madh grek e se dështimi i planevet të saj shoqnie varej në qenien e tij në Janinë. Mirëpo Halit efendi i kishte vendosë, sido që të ishte, me zhdukë nga jeta Ali Pashan, prandaj s`kishin vlerë asnjë ndër arsyet që i parashtronte ai sulltanit për t'u falun. Propozimet e Ali Pashës edhe pse gjeishin një jeh të favorshëm ndër disa personalitete të shtetit, intrigantë e djallëzor Halit efendiut paksojshin vlerën e fuqinë e propozimevet të saja. Tepelenasi dikur mbrohej ma së fortë dhe nuk kishin ndikim në moralin e tij masat që merreshin kundra tij, çfarë do karakterit që të kishin këto masa. Por dezertimi i

njerëzvet të tij një pas një e sidomos dorzimi i të bijëvet Myftar Pashës, Veli Pashës e Salih Pashës dhe i të nipit Mehmet Pashës ia tronditën moralin, dhe tashti ma nuk mund ta mbante atë tenacitet të dikurshëm mbasi mosha po i mbushte gati të qindat. Se ç'përshtypje bani dorzimi i të birit në shpirtë të tij, kuptohet prej faktit se nuk i mori kurrë ma në gojë emnat e tyne dhe bile iu kërcënohej me vdekje atyne që i përgojojshin. Kjo psikë e lindun në Ali Pashën, i cili vdiste në dashuni të të birëvet ma të fortë se çdo gjë tjetër, s'leu dyshim të provoj se sa e randë qe për zemër të tij vepra e tyne. Jeta e efemere që kaloi Ali Pasha si u vendos në manastir t'ishullit ku u strehues, qe plot dëshprim e shpresë. Pse, tue shpresue që do të shkonte në Stamboll dhe do të falej, mendonte se edhe nuk do të mund e qante derdin nga shkaku i intrigavet që luheshin kundra tij në kryengritjet. Hurshid Pashaj që kishte vendosë m'e marrë në dorë e që kishte dhanë dhe akt t'ia pëlqente këtë vepër të tijën u tremb prandaj donte t'a vriste; dhe për t'i dhanë çashtjes një trajtë serioze sendërgjoi edhe një ferman, në të cilin urdhënohej vrasja e Pashës. Hurshid Pasha këtë ferman ia dha ish valiut të Moresë Mehmed Pashës, që e kishte njeri të vetin, dhe ja ngarkoi atij vrasjen e Ali Pashës. Ai mori me vedi pesëmdhjetë vetë, veshi një më një dy gëzofa prej lëkure

delje dhe me një varkë kaloi n'ishull. Hyni befas në dhomën ku ishte ndejë Ali Pasha, me njerinë ma besnik të tij, Topall Arnaudin. Xhevdet Pasha (historian turk-J.T.) thotë se por sa Mehmed Pasha u fut në dhomë dhe i kallzoi fermanin shtini Ali Pasha kundra tij, e mandej Mehmed Pasha me të vetët qëlluen Ali Pashën për t'u mbrojtun dhe kështu e plagosën dhe e vran. Por nga versionit i historianit Xhevdet Pasha nuk asht e mundun të mos dyshojmë kur të mendojmë se deri në sa Mehmed Pasha veshi dy gëzofë leshi dhe iu fut befas në dhomë Ali Pashës, ky veprim provon paramendimin e tij me vra atë dhe përdorimin e armës ma parë nga ana e tij. Si do që të jetë, kështu ose ashtu, Ali Pasha si dhe njerzit që kishte pranë vedit u vranë. Koka e tij, me kokat e tre të bijëvet dhe të nipit u shpuen në Stamboll nga ana e Hurshit Pashës bashkë me sihariq të fitores, dhe këtyne që i shpjejshin, Silahdar Ahmed agës, Tatar agës e katër shokëvet të tyne u jepeshin gëzofa prej lëkure zibelinë. Koka e Pashës mbasi u ekspozue, si një masë shembullore, jasht Orta-Kapë-së, u varros jashtë Silivri-Kapësë. Trupi që ngeli n'ishull ia varrosën t'afërmit e tij pranë sarajit dhe mbrapa mbi varr i ngrehën një tyrbe. Historiani Xhevdet Pasha jep këtë gjykim të drejtë për Ali Pashë Tepelenën: "Ali Pashë Tepelena qe një mizor e gjakderdhës, por ndër lufta i shërbeu shumë perandorisë.

Njëmend meritonte të vritej, por ma përpara sido qoftë iu dha rasti të bahej i fuqishëm, sa që erdhi në një gjendje me i ba ballë vetëm në krye të vet një fuqie armike të madhe. Ishte ma oportune të përdorej ma me urti në mënyrë që fuqinë që fitoi t'a vente për ballë armikut. Por Halit efendiu, tue mos marrë të hollat që lakmonte prej Ali Pashës, i ra pa pra në qafë, bindi sultanin të çojë ushtri kundra tij dhe t'emënoj Hurshid Pashën serasqer (kryekomandant). Hurshid Pasha ia hapi grykën tepër fort kuletës. Veç që rropi Rumelinë, kërkoi të holla me grushta dhe nga visarët e shtetit. Dhe Stambolli i dërgoi, tue mendue se por sa të shuhej ngjarja e Ali Pashës do të dilshin në shesh visarët legjendarë dhe atëherë shpenzimet e banuna do t'i viheshin në vend. Kur shpërtheu kryengritja greke Ali Pashaj duhej të falej dhe të përdorej në këtë tue u lutë që të tërhiqej në një skaj me premtim që do të shërbente gjithnjë por sa t'i vinte për dore. Por Stambolli nguli këmbë në rrethim, tue i besue fjalëvet të Halit efendiut, i cili thonte se kryengritja greke ashtë prodhim i provokacioneve të Ali Pashës e ajo do të shuhet njëherit me trazimin që shkaktoi ky. Dhe ma në fund u vra në rrethana të sipërme.”

Ibrahim Pasha: Është nga derë fisnike e qytetit të Vlorës dhe dhandërr i Kurt Ahmed Pashës, vendin e të cilit e zuri si mytesarraf

mbasi pat vdekun ai. Kur Kurt Ahmed Pasha ftoi në Berat Ali Pashën, ai ia lypoi vajzën për grue, por në vend me ia dhanë këtij ia dha Ibrahim Pashës që e konsideronte si një i derës ma bujare. Ali Pasha u zemrue fort dhe kur gjeti rastin u ngrejt me marrë shpagë kundra tij dhe këtë gjë e realizoi tërthorazi. Ali Pasha me këtë mënyrë do të zhdukte edhe sherrin e vet, do të shtinte në dorë krejt Toskërinë e në ia shihte gjasën edhe Gegninë. Në vitin 1224 h (1808) Omer Pashë Vrioni iku prej Mehmed Ali Pashës, nga Misiri dhe erdhi në Berat. Ali Pashë Tepelena nisi këtë ta përdorë si mashë. Vrionasi kishte një armiqësi të vjetër me Ibrahim Pashën, prefektin e Vlorës, pse e pat largue dikur nga Berati. E tash Omer Pashë Vrioni e kishte për detyrë e nder të vepronte si mbas këshillavet të Ali Pashës, për të marrë kështu shpagë kundra Ibrahim Pashës, që e mbante për armik. Omer Pasha ngriti kundra Ibrahim Pashës Beratin e rrethet. Ibrahim Pasha tue mos mujtë me i qëndrue forcavet t`Omer Pashës, erdhi në Berat dhe u mbyll në kala. Ali Pasha që ishte një dinak ndërhyen këtë herë, nxjerr nga kalaja Ibrahim Pashën dhe shëndoshë e mirë e sjell në Vlorë. Omer Pasha kishte në dorë Beratin si zëvendës-prefekt. Por as ky as Ali Pasha nuk mjaftojshin me kaq, dëshirojshin m`e hjekë fare nga jeta. Prandaj, megjithëse Ibrahim Pasha kishte gjetë strehë në Vlorë,

ata të dy vazhdojshin në veprën e tyre kundra tij. Ky, tue mos mujtë m`u mbajtë as në Vlorë, vajti e gjeti strehë në Dukat. Ali Pasha, i cili pau se ra ngusht Ibrahim Pasha, ndërhyri prap gjoja për t`a përkrahun së tepri e mori atë në Janinë. Tashti shemri i kishte ra në dorë: Ali Pasha e merr këtë herë dhe e shtje në burg, njeriu në krahnor të cilit rreh një zemër bujare, duhej t`a falte hasmin, të sillej ndaj tij në mënyrë fisnike dhe t`a ndihmonte sidomos kur ai ishte në rrethana për t`u ndihmue. Ali Pasha jo vetëm që nuk u soll kështu kundra tij, por kreu një veprë të shëmtuet ndaj tij. Vajzën që nuk mujt dikur m`e marrë për grue, të shoqen e Ibrahim Pashës, tashti e mori për grue, me kunorë vërtetë, por me përdhunë. Ma parë pat marrë edhe vajzat e tij për të bijt e për të nipin. Në një kohë që fatpremi Ibrahim Pashë, i krrusun nën peshë të mjerimit dëneste por, Ali Pasha argtohej në pallat të vet me ish të shoqen e tij dhe me të bijat. Ibrahim Pasha ishte i njohun për moralin e tij të mirë dhe që gjithsesi kishte fitue simpatinë e dashuninë e popullit; prandaj mbarë populli i lypte hir për të Ali Pashës. Por ky në vend që të mos ja kursente hiret e veta e shtypte edhe ma tepër. Ma në fund ankimet e popullit mbërritën në Stamboll, e kur Stambolli urdhëroi të lihej i lirë dhe në këtë urdhër nguli kambë, Ali Pasha e vrau, si mbas një versionit me dorë të vet e si mbas një tjetrit me duer të tjerëvet. Dhe

sulltanin e lajmoi se kishte vdekë me exhel të vetin në 1235 h (1819). Ka edhe disa që thonë se me këtë ngjarje fillon zemërimi i sulltanit kundra Ali Pashës. Me gjithë këtë, qe si qe Ali Pasha e vuejti dënimin e fajit që bani në personin e Ibrahim Pashës, si mbas maksimës juridike El`xhezau mim xhinsilamal (dënimi si mbas natyrës së fajit).

Ibrahim Pasha: Vëllau i Mahmud Pashës, valiut të Shkodrës. Me qenë se ishte i njaj derës së vjetër e të njohun iu dha Sanxhaku i Ohrit, dhe në vitin 1211 h (1796), kur i vëllaj gjeti vdekjen tragjike, u emënuë prefekt i Shkodrës me gradë Rumeli-pajesi. Në vitin 1218 h (1803) me gradë veziri iu dha serasqerllëku i Rumelisë tue mbajtë gjithnjë mytesarriflëkun e Shkodrës. Në vitin 1220 h (1805) u bë vali i Rumelisë. Një vjet mbrapa iu muer ky valillëk dhe u la vetëm në Shkodër si mytesarrif. Vdiq në vitin 1227 h (1812).

I shërbeu me besnikëri qeverisë mbretnore dhe u dallue sidomos për trimni.

Ismail Pasha (Pasho): Është nga Janina dhe nga parësia e vendit. Në fillim qe ndër marrëdhanie të mira me Ali Pashë Tepelenën, por mandej u prish me të dhe i ra në dorë të birit të tij Veli Pashës, i cili e emroi Ket`huda të vedin. Kërkoit tërthoraz ta falte Ali Pasha, por se

fali dhe atëherë iku prej tij e u strehua prej Mahmud bej Dramës që ishte hasëm i familjes së Tepelenasit. Me ndërmjetësinë e këtij beu u përdor në disa shërbime të mbretnisë deri sa u gradua sillagamxhi-bash (komandant) minatorësh në vitin 1225 h (1810). Duke qenë se e ndihmoi Halit efendinë në intrigat kundra Ali Pashës, ky çoi në Stambollë dy njerëz të vet vullnetarë dhe këta e qëlluen një ditë në shtëpinë e vet, por se vran. Ismail Pasha shpëtoi mbi këtë ngjarje që bani një përshtypje të thellë, Ismail Pasha me Halit efendinë i dhanë forca intrigavet kundra Ali Pashës, derisa në fund e zhdukën këtë nga jeta. Ismail Pasha pat fitue simpatinë e Halit efendiut e të disa personaliteteve të shtetit, sa që në kohën kur veprohej kundra Ali Pashës dhe për të gjallë të tij iu dha valillëku i Janinës e i Delvinës bashkë me gradë vezirnie. Ju ngarkue dhe drejtimi i operacioneve ushtarake. Por u zbulue si ushtarak i një turbullimi që ngjau n'ushtri në kohë t'operacioneve, prandëj u pushue dhe u urdhnuë të shkonte në Filibe, mbrapa u vra 1237 h (1821). Qëndrimi i tij kundra Ali Pashës u naltësoi deri në shkallën e vezirnisë, por fundi i jetës i erdhi tragjik. Tue u orvatë me zhdukë rivalin e vet dhe ai mbaroi po ashtu.

Hasan Pasha: Kur Misiri u zaptue prej Napolonit, Hasan Pasha u dërgue bashkë me ushtri kundra tij

dhe për shërbim e zellë që dëftoi u nderue me gradën Mirmiran. Dhe në të shuëm të kryengritjes së Kretës qe komandant i ushtrisë që dërgoi Mehmed Ali Pasha vali i Misirit dhe këtu bani shërbime mbi veprën e shëmtuet të Nehabeut që mori një karakter serioz, me pushtimin nga ana e tyne e vendeve të shejtë, u dërgua kundra tyne me ushtri egjiptiane në Medinë në vitin 1231 h (1815). Mbas e pastroi vendin nga kryengritësit u emënuë muhafiz (komandant garnizoni) në Medinë. Vdiq në vitin 1240 h (1824). Qe trim, administrator e i mirëdashun nga qeveria.

Sylejman Pasha: Djali i Ibrahim Pashë Vlorës. I ngeli trashëgim nga stërgjyshët mytesarri flëku i Vlorës, vendlindja e tij. Në vitin 1240 h (1824) iu dha grada e mirmiranit. Mbrapa u ba muhafiz i Maçinit e më pas i Ibrailit. Mori pjesë në luftën kundra Rusëvet në vitin 1243 h (1827) dhe bani shërbime të mira, mbas kësaj lufte vdiq. Qe besnik e trim.

Salih Pasha: Djali i Sylejman Pashë Elbasanit. Nga një shtëpi e vjetër e Shqipnisë. I simpatizuem prej qeverisë, në vitin 1224 h (1809) iu dha grada e Mirmiranit. Në vitin 1236 h (1820) muhafiz i Babadagut duke pasë si funksion të shtuem edhe sanxhakun e Qostendilit, në vitin 1237 h (1821) muhafiz i Jergojit

duke mbajtë gjithnjë sanxhakun e Qostendilit, këtë herë tue iu dhanë grada e vezirnisë për mirëshërbimet e kryeme si shpërblim. Në vitin 1240 h (1824) vali i Tërhallës, mbas dy vjetvet i pushuem. Në vitin 1243 h (1827) vali në Selanik, në vitin 1245 (1829) prap në Qostendil, në vitin 1247 h (1831-1832) iu dha dhe Sanxhaku i Ohrit tue pasë dhe atë të Qostendilit. Në vitin 1248 h (1833) vdiq. Qe trim, besnik e i zoti në punë.

Ali Pasha (Masuh-zade):

Duke qenë nga një vend në breg t'Adriatikut dhe i mësuem qysh në vegjëli në punë detare u ba kapiten i një barke tregtare dhe t'u u stërvit u praktikue në detë, në kohë të Hysejn Pashës u muer me kantjere detare ku përparoi, deri sa në vitin 1225 h (1810) u gradue si kapedan. Në kryengritjen e Ali Pashës, kur nën komandë të Hurshit Pashës qe dërgue përtokë një fuqi ushtarake nën komandë t'Ali Pashës qe çue dhe një fuqi detare për me ruejtë brigjet dhe për me i pre Ali Pashës komunikacionin me anë të detit. Tue pas ba me vite kapidanllëkun dhe tue u tregue i zellshëm në çdo punë, në vitin 1237 h (1821), bashkë me vezirllëkun iu dha funksioni si kapedani-derja (Ministër-Marine). Në Sakëz iu dogj barka e bashkë me bark u dogj dhe ai vetë e vdiq. Qe njëmend i zoti për punë deti dhe trim.

Selim Sati Pasha. Është nga Manastiri. I ri shkoi në Misir dhe aty hyri në ushtri deri sa arriti me u ba komandant. Mandej u kthye në Stamboll me gradë Mirallaji, në vitin 1259 h (1843) u ba gjeneral brigade, e mbas pesë vjetësh drejtor i shkollës ushtarake, n'atë kohë u dallue për shërbime të vyeshme sidomos provoi zotësinë e tij me rregullimin e Institutit të Ligjevet. Në vitin 1256 h (1840) u emnue vali n'Ajdin, e mbas një viti vdiq. Qe puntor, inteligjent, e sidomos njeri me kulturë.

Ahmed efendi: Është nga Pirlepeja. Këndoi në medrese dhe doli myderris. Në vitin 1239 h (1823) inspektor i Eukatit dhe Mahrexh-Urovllasi (një titull në hijerarkinë e klerit mysliman-J.T). Në vitin 1241 h (1825) si u suprimue Oxhaku i Jeniçerëvet u dërgue në Rumeli për me zbulue bektashinjte, ndej pesë vjet në Rumeli dhe këtu bani shqyrtime e inspektime. Në kthim u emënu në nënpunësinë që kishte, e në vitin 1251 (1835) u ba mulla i Medinei-munevvere-s (një titull fetar). Në vitin 1256 (1840) vdiq. Qe njeri me virtyte të mira e i dijshtëm.

Is'hak efendi: Prej Narte, djali i një hebreu i konvertuem. Is'hak efendiu i ngelun bonjak qysh i vogël u dha mbas mësimet dhe tue mësue disa gjuhë të huaja u emënu dragoman n'arsenal. U ngarkue me marrëveshjen që u hap me anglezët

kur flota e tyne kaloi Dardanelet dhe ankoroi afër ishujvet. Në këtë rasë tregoi shërbime të jashtëzakonshme. Mbrapa u emënu si mësues i arabishtes në shkollën mbretnore t`inxhinierisë navale. Tue pasë mbi vedi gjithnjë këtë funksion u ngarkue me inspektimin e fortifikimevet që u pa e nevojshme të ndërtoheshin në Rumeli e n`Anadoll 1232 h (1816). Në vitin 1239 h (1823) u emënu dragoman i Divanit Humanjunit (Këshillit Mbretnor). Pati nëpunësi të ndryshme e në vitin 1247 h (1831) u emënu profesor në shkollë t`inxhinierisë. Në vitin 1251 h (1835) vdiq. Qe njeri me kulturë të gjanë, shkroi vepra dhe ka një tekst (koment) të Kur`anit. Pat një zotësi të madhe në paleologji, njihte gjuhët arabe, perse, greke, frënge, hebraishte, latinishte.

Hysejn Hysni bej: Është prej Konice. Mbasi kreu studimet e nevojshme hyni në shërbim të qeverisë deri sa u rradhue në mes të ylemave. Në vitin 1240 h (1824) financier i Haremejnit (Meke-Medine), mbas dy vjetëvet Ruznameخي i dytë. U ndodh dhe ndër të tjera nëpunësina, deri sa në vitin 1259 h (1843) vdiq. Qe njeri puntor dhe dashamirë i kulturës.

Shakir Mehmed bej (Myfti-Zade): Tue qenë nga një familje e njohun dhe notable përparoi shpejt dhe në vitin 1249 h (1833) u ba halife

i Sergjisë. Në vitin 1271 h (1854) Kryetar i Komisionit të zimemat-
evet (borxheve). Në vitin 1275 h (1858) vdiq.

Mustafa Sherif Pasha: Djalë i Mehmed Asaf Pashës, nip i Gazi Mehmed Pashë Shkodranit. Lindi në vitin 1221 h (1806). Tue qenë pinjoll i një dere fisnike u ba vali i Shkodrës me gradë Mirmirami, mbas dy vjetësh vezir. Pati sanxhaqet e Beratit e t`Ohrit për shërbimet e mira që bani në kryengritjen e Ali Pashës për ma tepër u ba dhe Serasqer. Në vitin 1245 h (1829) serasqer i Vidinit dhe korri suksese në luftën kundra Rusisë me 40.000 trima që kishte me vedi. Në vitin 1262 h (1845) vali i Bollusë e i Kastamonusë, në vitin 1263 h (1846), vali në Sejdari e një vjetë mbrapa n`Adana e n`Marash. Në vitin 1268 h (1851) u pushue. Prap i marrun në shërbim në vitin 1269 h (1852), u emënu vali në Hersekë, mandej në Konja në Xhezaizi-Bahri-Sefid, në Halep e ma në fund në vitin 1274 h (1857) vali në Izmir. Në vitin 1275 h (1858) Shejhulharemi (një titull nderi fetar). Ndërsa në vitin 1276 h (1859) vdiq në Medinë. Asht i varrosun në Bakia. Njeri me kulturë, administrator i mirë e trim. Qe dhe Shejhulumzera.

Osman Maz`har Pasha: Duke qenë nga ymeratë asht emne mytesarrif i Shkodrës, në vitin 1265 h (1848) iu dha grada e vezirnisë. Në

vitin 1270 h (1853) vali i Selanikut, mbas dy vjetësh i Tarabullusit (Tripoli), në vitin 1275 h (1858) vali i Shkupit. Vdiq në vitin 1277 h (1860). Kudo që shërbeu ia doli me sukses dhe fitoi famë.

Sylejman Spahiu: Nga parësi e Shqipënisë, i njohun për trimni. Në vitin 1255 h (1839) u ftua në Stamboll dhe tu iu çmua merita u emënu në regjiment të Bosnjes. Në vitin 1258 h (1842) u transferue në Vranie, në vitin 1262 h (1845) në Varna. Vdiq kur po kthehej prej këtu.

Sylejman Refat Pasha: Është djalë i Arnavut Mustafa agës. Në të ritë e tij ka hye n`Enderun dhe t`u u dëftye i zgjuet u ba, në një kohë të shkurtër Çokadar në vitin 1247 h (1831). Në këtë kohë u suprimua jeniçerllëku dhe u formua ushtria e re e Sylejman Refat Pasha, mbasi qe marrë me mësimë si shumë të tjerë u ba kapiten në ushtri 1245 h (1829), në pak kohë major, kolonel, gjeneral brigade e ma në fund gjeneral divizioni 1258 h (1842). Në këtë gradë të fundit u emënu edhe Kryetar i Dari-Shura (Këshillit të Shtetit). Dy vjet mbajti në këtë funksion e mandej me gradë veziri, u emënu kryetar i Mexhlisi-Valasë (Këshillit të Naltë) e në vitin 1261 h (1845) serasqer (ministër lufte). Mbas një viti u pushua, por mbas pak ditësh u emënu ambasador në Paris, në vitin 1264 h (1847) Ministër

i Tregtisë dhe në krye të javës u ngarkua me mision në Moldavi, në këthim Ministër Lufte, në vitin 1267 h (1850) anëtar i Këshillit të Naltë, më 1268 h (1851) vali në Bursa, mbas tre muejsh i pushuem. Prap u muer në shërbim vali në Halep, n`Izmir, Sham e në Bursa. Në vitin 1276 h (1859) u pushue prap. Antar në Këshillin e Tanzimatit, në vitin 1277 h (1860) vali n`Edrene. Në krye të javës u pushua. Prapë vali në Vidin, në vitin 1280 h (1863) vali n`Edrene. Vdiq në vitin 1281 h (1864). I matun, xhentil, poet e njëkohësisht i zoti.

Galib Mustafa Bej: Është i biri i Ismail Pashë Leskovikut, ka lindë në vitin 1245 h (1829). Mbasi bani studimet në vend të vet, erdhi i ri në Stamboll dhe hyri në Mektubi-i Sedaret (zyrë e korrespondencës së kryeministrit-J.T.). Në vitin 1268 h (1851) divan-qatib i Veli Pashës ma vonë kaloi kajmekam në Banallukë, qatib në ushtrin perandorake, mandej antar i këshillit doganor e në vitin 1283 h (1866) financier (llogaritar) në Doganë. Vdiq në këtë vit. Qe poet.

Ismail Haki Pasha: Njihet me mbiemnin Shehsivar-zade derë e vjetër në Leskovik. Erdhi i ri në kryeqytet dhe hyni në shërbim të qeverisë. Mbas pak kohe Kapëxhëbash, Mirmiran dhe mandej kajmekam në Çëllder. Në vitin 1271 h (1854) me gradë vezir muhafiz në

Kars. Dhe mbas një viti vali në Van, në vitin 1276 h (1859) i pushuem. Po në këtë vit vali në Halep. Në vitin 1278 h (1861) vali në Harput, në vitin 1279 h (1862) vali në Erzurum, mbas një viti pushue. Në vitin 1282 h (1865) vali në Prizren, mbas tri vitesh pushue prapë 1285 h (1868). Vdiq në vitin 1289 h (1872) në Stamboll në një kohë që ishte i pushuem. Qe i zoti, i sjellshëm e atdhetar.

Zeki Pasha: Mbas bani studimet, erdhi në kryeqytet dhe punoi në disa nënpunësi civile. Mori gradën e Mirmiranit, sundimtar në Meke, mytesarrif në Sivas e në Lazistan. Vdiq në vitin 1290 h (1873). Qe i zoti e njeri aktiv.

Ismail Rahmi Pasha: Është djali i Veli Pashës, të birit të Ali Pashë Tepelenës. Kur iu vra i gjyshi dhe në këtë rasë dhe i ati e sollën në Stamboll bashkë me Mahmud beun, vëllanë e vet. Mbas një kohe në vitin 1246 h (1830) u ba Kapëxhëbash dhe tue plasë në këtë kohë lufta u dërgue me shërbim në ballë të luftës. Edhe pasi që provoi zell e besnikëri si në luftë dhe në kohë paqe, në vitin 1257 h (1841) u ba Mirahori II, si u suprimue ky vend ngeli në dispozicion dhe u emnue më tej Bash-Baki-Kollu. Në vitin 1264 h (1847) mytesarrif në Tërhallë e në këtë vit me gradë vezirnie u emënu vali në Trabzon, n'at vit në Edirne, mbas dy vjetësh në Janinë, në vitin 1268 h (1851) në

Xhezairi-Bahri-Setid (n`Arkipelet) e mbas tri vjetësh në Halep. U pushue, por prap në vitin 1273 h (1856) u emnue vali n'Edrene e në vitin 1274 h (1857) në Silistre. Mbas një viti u pushua, por prap u muer në shërbim pa kalue shumë kohë si vali në Selanik, e në atë vit në Kretë, në vitin 1278 h (1861) në Tërhallë, në vitin 1283 h (1866), mbasi qe pushue një herë në Kastamonu, mandej në Bursa prap në pushim, mbrapa vali në Prizren. Në vitin 1288 h (1871) anëtar në Këshill të Shtetit mbrapa Kryetar i Gjyqevet Ndëshkimore, prap mandej anëtar i Këshillit të Shtetit. Në vitin 1292 h (1875) vdiq. Bujar, elegant dhe i dhanun mbas qejfevet.

Mahmud Pasha: Është djali i madh i Mustafa Pashë Shkodrës. Lindi në vitin 1240 h (1824) dhe me qenë se ishte nga një derë bujare e njohun si zakonisht u nderue me gradë të Mirmiranit dhe në vitin 1274 h (1857) mytesarrif në Menteshë, një vit mbrapa në Lazistan me gradë Bejlerbej i Rumelisë, mandej n'Ajdin, n'Mush, n'Islimuje, në Jenipazar, e ma në fund në vitin 1284 h (1867), në Hersekë, ku vdiq mbas dy vjetëvevet. Është i varrosun në Mostar në xhami të Karagjozit. Qe një zotni trim e dashamirë i mbretnisë.

Hoxha Hasan Tahsin efendi: Hoxha Tahsin efendiu qe djali i një kadiu dhe lindi në vitin 1227 h (1812)

në Filat të Janinës. Vitet e para i kaloi pranë t'et dhe mësoi pranë tij, mandej erdhi në Stamboll, hyni në medrese dhe mbasi kreu këtu shkencat e nalta doli myderriz. Fill mbas luftës së Krimesë kryeministri Reshid Pasha (i madhi) për të provue se turqit do të hyjshin në rrugë qytetërimi dhe për të përgatitë për këtë qëllim elemente me njohuni të reja, për të cilët kishte nevojë shteti, dërgoi në Paris disa studenta osmanlli ndër të cilët ishte dhe Tahsin efendiu. Ky megjithëse kreu atje studimet që duheshin nuk i konsideroi këto të mjaftueshme dhe ngeli në Paris me mendim që t'i çonte edhe më përpara njohuritë e tij. Qeveria e emnoi imam në ambasadën osmane. Tahsin efendiu që shtini në dorë një rasë të tillë, iu kushtue mësimet të shkencave të natyrës, të fizikës, kimisë, të gjeologjisë e të minerologjisë, shkenca që asokohe gadi gadi ishin të panjohura për botën turke dhe i pajisun me këto mësimet u kthye në kryeqytet. Dinjitarët e shtetit çmuan zotësinë e tij dhe e emnuan rektor në universitet që u hap rishtas, një ndër profesorët e këtij universiteti qe dhe Xhemaludin Afgani, fama shkencore e të cilit kishte marrë dhenë. Krejt ndryshe nga tjerët, nga ata me horizont të ngushtë mendojshin Hoxha Tahsini e Xhemaludin Afgani, të dy të pajisun me idena liberale e moderne. Por edhe ambjenti nuk ishte akoma i përgatitun sa që të blunte mendime këso dore të

reja dhe prandaj tue u interpretue ligësht hapja e këtij universiteti, më në fund u mbyll në kohë kur ishte kryeministër Ali Pasha. Tahsin efendiu me shokun e tij u cilësuen si të pafe dhe për këta s'ngelte tjetër veçse m'u tërheqë në një skutë e mandej me zhvillue prap aktivitetin e tyne në qoftë se ata mendje shkurtër ishin përmirsue në gjykimet e tyne. Dhe kështu bani Tahsin efendiu. Filloi me dhanë mësimet në ndërtesën përballë Portës së Naltë që sot asht Medresetul`hatlatinë (Shkolla e Kaligrafëvet). Mirëpo ishte i dëshpruem tepër, pse s'mund e përmirsonte opinionin e popullit dhe kështu i mbushun në këtë dëshprim vdiq në vitin 1298 h (1881), tue pas kalue moshën 70 vjeç. Është i varrosun në varrezat e Erenkojit. Ka disa përkthime me përmbajtje shkencore, disa vepra të vetat mbi fizikë e filozofi si dhe disa poezi.

Veprat e shtypuna të Hoxha Tahsinit janë këto: “Bazat e Kozmografisë”, “Psikologji”, “Misteret e ujët dhe t'ajrit”, “Gjeneza ose krijimi”.

Me mburrje vë këtu një vjershë të tij që asht fort e njoftun:

Të librit të rruzullimit fletët janë distancat e panumrueme

Rreshtat e ngjarjevet të kohës janë shekujt e pakufizuem.

E trupëzue, por me kuptim në këtë botë asht çdo qenie.

Aqif Mehmed Pasha: Është djali i Veli beut derë e vjetër e Shqipnisë. Ka lind në vitin 1238 h (1822). Mbasi u begat me dije hyni në shërbim të qeverisë dhe në radhë të hoxhallarëvet. Në vitin 1265 h (1848) ka hy në sekretari të Kryeministrisë. Mbas pesë vjetësh u ba mytesarrif i Shkupit me gradë Mirmirani. Në vitin 1275 h (1858) u naltësue në gradën e vezirit dhe u emënue vali i Selanikut e mbrapa i Janinës. Mbrapa në dispozicion. Prap vali ndër shumë vende të mbretnisë deri në vitin 1289 h (1872). Në këtë vit u ftue në kryeqytet si Kryetar i Këshillit të Shtetit, mbas dy vjetëve u pushue, në krye të dy ditëve të pushimit iu kthye nëpunësia, në vitin 1302 h (1884) prap u largue, prap u muer dhe u çue si vali në Xhezajiri-Bahri-Sefid mbas nandë vjetëve në këtë nëpunësi u kthye në Stamboll i pushuem, mbas pak kohe vdiq. Ka dijtë frëngjisht e greqisht, ka qenë xhymert e njëkohësisht administrator e poet.

Asaf bej: Është djali i Ismail Pashë Tepelenës. Tue qenë pinjoll i një dere të vjetër e me za të Shqipnisë, iu dha grada e Mirmiranit dhe mbasi u përdor në disa shërbime qeveritare u ba kryetar i Bashkisë së Yskydarit (Stamboll) në tetë nandë vjet që mbajti këtë funksion, arriti me pasë gradat Rumeli-Pajesi e mandej Bálá. Mbrapa doli në pension dhe në vitin 1305 h (1887) vdiq. Qe i pasun, shumë simpatik e me virtyte të mira.

Ali Pasha: Është prej Guçije. Mbas luftës Ruso-Turke 1293 h (1876) tue pa se vendi i tij me rrethe do t'i jepej Malit të Zi, u revolute kundra qeverisë dhe me një grusht patriotësh arriti për hir të këtij akti me i fitue disa vende qeverisë osmane. Ju çmue kjo vepër dhe si u mbyll konflikti me Malin e Zi iu dha grada e Mirmiranit e ma mbrapa u muer n'ushtri me gradën Mirliva (gjeneral brigade). Në vitin 1305 h (1887) ra dëshmor në një ngjarje (?). Qe jashtëzakonisht trim e patriot. Tue iu çmue shërbimet që i kishte sjellë mbretërisë me urdhër të sulltanit iu ngreh mbi varr një tyrbe.

Fehim bej: Është nga ylematë. Në koh t'Abdylazitit u muer në pallat si tyfekxhi. Mandej doli jashtë Stambollës me funksion nënprefekti, tue u ba mbrapa prefekt. Në një kohë qe edhe zëvendës vali në Sajda. Vdiq në vitin 1307 h (1889). Qe trim e dashamirë i perandorisë dhe një administrator bajagi i mirë.

Nazif Mehmet Pasha: Është nga Manastiri, mbasi u pajis me kulturë dhe arriti sa me qenë i zoti me u marrë me çashtje korrespondence, hyni në shërbim të qeverisë si sekretar, tue u emërue ma mbrapa si Divan-Qatib (sekretar i Ohrit) i Serdar Omer Pashës. Kështu mori gradën e Mirmiranit dhe u emënue mytesarrif i Shkupit, ku qëndroi për një kohë të gjatë. Tue i pasë shërbye

me zellë perandorisë u nderue me gradë të Bejlerbeut. Mandej u ba mytesarrif i Kudsit (Jeruzalemit), por pak mrapa u pushue. Në vitin 1293 h (1876) me gradën e vezirnisë u emënuë vali në Kosovë e në vitin 1296 h (1878) Ministër i Vakufevet perandorake. Mbas disa muajsh u la në dispozicion, u muer prap në shërbim dhe u emënuë vali në Izmir e ma në fund, në vitin 1305 h (1887), vali në Siri, ku mbas dy vjetësh vdiq. Qe një administrator i mirë, shkrimtar, modest dhe i dhanun mbas qefevet. Kur qe në Shkup mytesarrif pat lanë aty një emën të mirë.

Vejsel Pasha: Hyni i ri në shërbim t'ushtrisë dhe shërbeu në armatë të tretë dhe në Bosnje. Provoi se ka merita e zotësi, dhe shkallë shkallë u gradue deri sa në vitin 1284 h (1867) u ba major. Në luftë kundra Ruisë dhe ka ana e Bosnjes bani shërbime të çmueshme, prandaj u gradue kolonel, mandej gjeneral brigade, komandant në Shëpka e gjeneral divizioni. Mbrapa u përdor në shërbime të ndryshme në armatën e tretë e të dytë, në vitin 1302 h (1884) u ba marshall, qëndroi gjashtë vjet dhe tue qenë se në këtë kohë u smue u kthye për t'u mjekue në Stamboll, por mjekimi nuk i solli ndonjë dobi. Kështu, vdiq në vitin 1309 h (1891). Qe trim, i shkathët e dashamirë i perandorisë.

Vaso Pasha: Është prej Shkodre. Hyni në shërbim të qeverisë si funksionar drejtësie, ku mandej u ba antar gjykatorje. Në vitin 1293 h (1876) u emënuë antar i Komitetit Administrativ në Hersekë. Si këtu ashtu dhe ndër funksione tjera që pati punoi me drejtësi e zellë, prandaj në vitin 1300 h (1882) u nderue me gradë veziri dhe u emënuë guvernator i Libanit, vend ky që kishte një karakter administrativ të posaçëm. Në këtë post qëndroi dhjetë vjet dhe dha kontribut të mirë në detyrën e tij. Vdiq në Liban, në vitin 1300 h (1894). Qe i drejt dhe i zoti i punës. La të shtypun një vepër me vlerë e titullume "Shqipnia e Shqiptarët" e cila u përkthye prej Danish bej Prishtinës dhe u botue.

Hamdi Ahmed Pasha: Hyni në shërbim t'ushtrisë dhe nga meritat e zellin e tij të jashtëzakonshëm, shkallë shkallë e në pak kohë u gradue një herit kolonel, mandej gjeneral divizioni e mbrapa në vitin 1279 h (1862) myshir (marshall) i xhandarmërisë. Mbrapa shërbeu në armata të ndryshme, u ba Ministër i Xhandarmërisë, vali në Prizren, prap për së dyti herë Ministër i Xhandarmërisë e mandej vali në Bosnjë me gradë veziri. Ma vonë vali në Selanik, për të tretën herë Ministër Xhandarmërie e mbas një viti komandant në Selanik 1245 h (1829). Disa kohë mbrapa u emënuë kryetar i Komisionit të Emigracionit

në Anadoll dhe tue qenë në këtë shërbim vdiq në Bursa në vitin 1312 h (1894). Qe trim e administrator i mirë.

Hasan Haki Pasha: Është djali i Mustafa Pashë Shkodrës. Ka lindë në Shkodër në vitin 1242 h (1826). Tue qenë në moshën njëzet vjeç, me gradë Sanije ka hye në zyrë të korrespondencës së Ministrit të Jashtëm. Në vitin 1278 h (1861) mytesarrif në Midili (Mitelenë), mbas dy vjetësh në Rodos e mbrapa ndër disa vende të tjera. Në vitin 1292 h (1875) u nderue me gradë veziri dhe u emënuë vali në Van. Në vitin 1304 h (1886) vali në Selanik, mbas dy vjetësh antar i Komisionit për Punët Botore, në vitin 1305 h (1887) vali në Halep. Në vitin 1313 h (1895) u pushue dhe në këtë vit vdiq. Dinte arabisht, persisht e frëngjisht, i zoti me shkruë si prozë ashtu dhe vjershë, poet, inteligjent e administrator i zoti.

Ali Riza Beu: Djali i vogël i Mustafa Pashë Shkodrës. Mbas mësoi zakonisht dhe fitoi dinjitet filloi në seksion të korrespondencës së kryeministrit. Në vitin 1283 h (1866) u martue me Hajrie Hanëmin vajzën e Mehmet Ali Pashës, valiut të Misirit. Pak kohë ma mbrapa u emnue sekretar korrespondence e mandej antar i Këshillit të Shtetit. Në këtë nëpunësi qëndroi për një kohë të gjatë dhe herë mbas here u nderue

me gradën Bala. Vdiq në vitin 1313 h (1895). Është i varrosun në Ejud Sulltan. Qe merakli me mbledhë libra me vlerë, i zoti e patriot.

Abdyl bej Frashëri: Djali i Halid bej Frashërit e vëllau i madh i shkrimtarit osman Shemseddin Sami beut. Mbas ndoqi mësimet do kohë mbrapa i vdiq i ati e mbrapa e ëma. Abdyl beu atëherë u vendos në Janinë për të sigurue jetën e vet e të vëllezërvet që i kishin mbetë mbi krye. Në Janinë u muer me studime, e n'anë tjetër dhe me sigurue gjallninë. Në këtë ngushtie arriti të mësojë arabisht, persisht, frëngjisht e greqisht. Kur lindi çashtja e kufirit me Greqinë e kur grekët mësyen në kufi, ky me disa shokë të vet filloi përpjekjet e tij dhe për të provue se Janina e Preveza nuk i takojshin n'as një mënyrë Greqisë, bani një udhëtim n'Europë për t'ardhë në kontakt me kabinetet e Europës. Përpjekja e tij dha fryt dhe ato vise të bukra i ngelën mbretënisë osmane. Për t'u ba ballë kështu provokacioneve të serbëveve e të malazezëveve hyni dhe në lidhjen që u formue në Prizren. Por tue u interesue ligësht qëllimet e kësaj mbledhje nga disa shpifarakë e dashakeqë, u mbaj i mbyllun tre vjet në kala të Prizrenit dhe i internuem afër dy vjetësh në Ballëkesir e në Bandërma. Në vitin 1303 h (1885) u fal prej sulltanit dhe mbas pak kohe u emënuë antar i Këshillit Bashiak (në Stamboll). Kur ishte i mbyllun në kala

të Prizrenit pat marrë një sëmundje e cila erdhi tue i rëndue gjithnjë deri sa në vitin 1310 h (1892) vdiq; u varros në Merdivenkovj. Qe jashtzakonisht inteligjent e dashamirë i perandorisë me plot kuptimin e fjalës.

Abdurrahman Nasib Efendi: Është djali i Halil Fejzi Efendiut prej Libohove, ish-kadi i Shkupit. Ka lindë në vitin 1258 h (1842) pak kohë mbasi i vdiq i ati. Mbasi kreu mësimet e veta fillore në Libohovë prej myderrisash dhe në Shkodër në rushdiqe, vajti në Stamboll dhe aty mbaroi medresen. Kreu dhe shkollën e Muvvabit (të kadilerëvet) në fillim të karrierës së tij u emënuë kadi në Nevrekop, në vitin 1287 h (1870) kadi i qendrës në vilajet të Bosnjes, n'atë vjet në Travnik, mandej në

Rodos. Në Janinë kryetar i Këshillit të Diktimit të degës civile, mandej n'organizimin e gjyqevet iu nderue titulli e iu ba kryetar i gjykatës së shkallës së parë. Në vitin 1305 h (1887) u pushue por pa mbushë vitin mbas pushimit u emënuë rend mbas rendi kadi i Dijarbakërit, n'Erzurum, në Bursë, në Janinë, në Selanik, në Siri, në Halep, prap në Selanik e në vitin 1327 h (1909), mbas Konstitucionit antarë i Gjykatës së Diktimit e pak mbrapa kadi i Misirit. Ma në fund, tue qenë në moshën 72 vjeçare, në vitin 1330 h (1911) hypi në selinë e naltë të Shehul-islamit. Mbasi 6 muej e 25 ditëvet ra nga ky post bashkë me kabinetin, u dha pas lutjevet e pas studimevet deri sa vdiq në 13 xhemazeyilahir të vitit 1332 h (9.5.1914). U varros në Makrikoj.

Xhamia e Et'hem Beut në Tiranë një shkëlqim i arkitekturës islame në Shqipëri

Msc. Brunilda Basha
Master of Science (Built Environment),
KAED, IIUM, Malajzi

Abstrakt

Mbishkrimet dhe ndërtesat kanë një rëndësi të madhe historike. Në disa raste ato pasqyrojnë informacione të panjohura më parë, apo një panoramë të larmishme të aktivitetit njerëzor. Në raste të tjera rigjallërojnë historinë, duke risjellë fakte të prekshme për gjeneratën e re dhe përcjellin një atmosferë të kulturës, e cila mungon shumë ditët e sotme.

Në kohën kur Perandoria Osmane arriti kulmin e lulëzimit të saj, gjatë shekujve XV-XVI, arti osman në Shqipëri ishte shumë i ngjashëm me atë në Shkup apo Edirne. Ndërkohë, në shekullin XVII, ndikimi i qeverisë qendrore osmane filloi të zbehej, kështu që kontributi i vendasve në ndërtesat islame në Shqipëri filloi të rritej. Në fund të shekullit XVIII dhe në fillim të shekullit XIX, përzierja e elementeve osmane arriti kulmin e saj, me shfaqjen e një stili të veçantë shqiptaro-islam. Ky lloj stili përbënte një sintezë të elementëve fetarë dhe shekullarë, qoftë osman dhe vendas, qoftë perëndimor.

Ndërthurja e këtyre tipareve, në dukje homogjene, reflekton në fakt historinë dhe natyrën e Shqipërisë, si një kryqëzim i Lindjes dhe Perëndimit. Këto vepra të fundit, siç i quan Machiel Kiel (2011), janë konsideruar si produkt i “shekullit të artë të kulturës islame në Shqipëri”. Në këtë rast bëhet fjalë për “epokën e artë” në kuptimin e zhvillimit në fushën e arkitekturës.

Ky punim synon të analizojë se si Islami është përhapur në trojet shqiptare dhe se si

ndërtesat, faltoret, përvetësuan elemente islame duke u përshtatur plot harmoni me arkitekturën vendase dhe elementët e saj. Për këtë është shqyrtuar literaturë mbi Islamin në Shqipëri dhe mbi arkitekturën islame. Pas kësaj është marrë si rast studimi xhamia e Et'hem Beut në Tiranë, për të shpalosur faktet e një marrëdhënie të arkitekturës vendase dhe evropiane islame. Në këtë punim, gjithashtu, përçohet një përshkrim i detajuar i xhamisë në fjalë nga ana historike e arkitekturore. Punimi ka për qëllim, gjithashtu, të promovojë përmirësimin e arkitekturës islame në Shqipëri dhe rëndësinë e saj në zhvillimin e arkitekturës shqiptare. Në të njëjtën kohë, shpresohet të shndërrohet në një burim reference për kërkime dhe studime të ardhshme në fjarëdo lloj fushe.

Fjalët kyçe: *Islam, xhami, arkitekturë islame, art osman, komuniteti mysliman.*

1. Hyrje

Shqipëria është një vend si vogël malor, në pjesën jugperëndimore të Gadishullit të Ballkanit, me një sipërfaqe pak a shumë sa të Maryland-it. Shtrihet pranë brigjeve të detit Adriatik dhe gjirit të Otrantos, që lidh Adriatikon me brigjet e detit Jon. Më shumë se dy e treta e sipërfaqes në Shqipëri është e mbuluar me hapësira malore të ndërthurura me lëndina lumore. Një relief i tillë ka ndikuar në ngujimin e shumicës së popullsisë (Walbank, Frank W, 2001). Gjatë historisë së saj, Shqipëria ka qenë shënjestër luftërash dhe konkurrence për pushtet mes fuqive të ndryshme. Grekët, romakët, venedikasit dhe osmanët kanë kaluar, ose kanë qëndruar, duke lënë shenjë me kulturat dhe traditat e tyre, po ashtu edhe me rrënojat e tyre. Megjithatë,

Shqipëria ka qenë një ndër vendet më të pasura me traditë dhe kulturë në të gjithë Ballkanin. Gjuha shqipe mendohet ta ketë origjinën nga gjuha antike ilire (Illyrian), e cila ka qenë një gjuhë e ndarë nga gjuhët e tjera indo-evropiane (Omoniglot.com, 2010).

Turqit osmanë mësynë gjatë shekullit XIV dhe kështu, Shqipëria u bë pjesë e perandorisë për më se katër shekuj. Gjatë kësaj kohe, shumica e popullsisë pranoi Islamin. Pas shekujsh, si pre e perandorive të ndryshme, më në fund Shqipëria fitoi pavarësinë në vitin 1912.

Shteti modern shqiptar u themelua nga mbetjet e Perandorisë Osmane, ku rrethohet nga të gjitha anët me shqipfolës (Draper & Stark, 1997).

Pas Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria u shndërrua në një shtet komunist për 40 vite me radhë, nën udhëheqjen e Enver Hoxhës. Regjimi

komunist përfundoi në fillim të viteve '90 dhe që atëherë vendi ka kaluar në një periudhë tranzicionale të një forme demokratike me një ekonomi tregu. Sot, pas vitesh nën ateizëm, konsiderohet si një vend me shumicë myslimane (Vokshi, M. 2008).

Për sa i përket arkitekturës dhe zhvillimit të saj, Shqipëria karakterizohet nga larmia e stileve falë ndikimit të huaj, që e bën atë të pasur në shumëllojshmëri, në kohë të ndryshme. Monumenti më i vjetër arkitekturor daton, që nga mijëvjeçari i parë (p.e.s.) dhe ka qenë i ndërtuar nga ilirët. Nga mesi i mileniumit të parë para erës sonë deri nga mesi i mileniumit të parë pas erës sonë, grekët dhe romakët ndërtuan struktura ende të dukshme në natyrën rurale dhe urbane. Në Mesjetë kemi një mbizotërim të natyrës së krishterë në veri të Shqipërisë, ndërsa stili arkitekturor islam dhe osman mbizotëroi më së shumti në jug.

Objektet arkitekturore islame janë të ngjashme me modelet osmane, duke krijuar kështu një fizionomi vendase. Më e ndërlikuara ndër të tjera është Xhamia e Plumbit në Shkodër, e ndërtuar gjatë viteve 1773-1774 nga Mustafa Pashë Bushati.

Vëllimi qendror i mbuluar me çatitë trekëndëshe, më të ulëta në qoshe, prania e portikut dhe tre dritare(ve) të njëpasnjëshme, janë karakteristikat kryesore të kësaj xhamie.

Etapat e zhvillimit të xhamive, që nga kohët e hershme, tregojnë për ndryshimin e rolit të tyre përgjatë historisë. Stilit arkitekturor i përdorur më së shumti në xhami, duket se është ndikuar nga përdorimi dhe vetëdijesimi për rëndësinë e fesë në këtë kontekst.

2. Islami në Shqipëri

Kontakti i parë me Islamin, në Shqipëri, është vërtetuar se ka qenë në fillim të shekujve të mesjetës. Falë pozitës gjeografike të Shqipërisë, ajo është përshkruar shpeshherë nga misionarë turq dhe arabë, të cilët kalonin për qëllime tregtare, fetare apo ushtarake (Zekaj, 2010). Shumica e besimtarëve myslimanë në Shqipëri janë sunit. Komuniteti Mysliman është i njohur nga shteti dhe nga vetë komuniteti. Sipas një sondazhi të vitit 2009, drejtuar nga një gazetë (Gazeta Tirana) shënohej një numër prej 568 xhami sunitë dhe 70 teqe dhe makame bektashiane.

Objekti i parë fetar, pra faltorja e parë, është ndërtuar në vitin 1389, në Berat, dhe është i modelit *selxhuk*. Pas rënies së Perandorisë Osmane, popullsia myslimane në Shqipëri ka pësuar përndjekje të shumta. Persekutimi më i madh ka qenë në vitin 1967, kur regjimi komunist ndaloi praktikimin e fesë në çfarëdolloj forme. Gjatë viteve të regjimit komunist, që zgjati deri më 1991, shumica e hoxhallarëve

dhe dervishëve u ekzekutuan, u burgosën, u persekutuan, apo u detyruan të linin vendin. Faltoret e tyre u shkatërruan dhe librat, apo literaturat e ndryshme, u dogjën e u zhdukën. Shteti komunist promovoi dhe sponsorizoi ideologjinë e vet përmes propagandës për ta çrrënjësuar Islamin nga shqiptarët.

Me ardhjen e demokracisë, në vitin 1990, në Evropën Lindore liria e (praktikimit të) fesë u rikthye përsëri. Shqiptarëve u lejohej sërish të praktikonin fenë e tyre dhe të rigjallëronin identitetin e tyre të humbur. Sfidat që prekin myslimanët në Shqipëri janë pak a shumë të ngjashme me sfidat e myslimanëve të tjerë në Ballkan. Vendet e Ballkanit gjithashtu karakterizohen nga një popullsi myslimane vendase; nga një sistem politik tranzicional i dalë nga një formë socializmi autokratik, apo qeveri komuniste, dhe nga eksperiencia e tyre me myslimanë të huaj, të cilët krijuan mundësi për vendasit, duke përçuar edukim fetar tek ata, duke ndërtuar xhami, duke bërë investime në sferën publike dhe të ngjashme. Xhamia ka qenë vendi më i rëndësishëm për shumicën e myslimanëve.

3. Zhvillimi i arkitekturës islame në Shqipëri

Me ardhjen e Islamit, arkitektura islame është zhvilluar paralelisht me ngjarjet kohore. Kur flasim për

arkitekturë islame, nuk nënkuptojmë vetëm xhamitë, por edhe ndërtesa (të tjera), si shkolla fetare, librari, kështjella, etj. Në Shqipëri, arkitektura islame është ndikuar nga arkitektura e Perandorisë Osmane. Arkitektura islame në Shqipëri përfshin xhamitë, namazgjatë, faltoret, medresetë, teqetë, tyrbet dhe të tjera ndërtesa të ngjashme. Kontaktet e para të shqiptarëve me Islamin janë përkatësisht të hershme.

Fillimet e arkitekturës islame filluan kryesisht në kështjella, si për shembull, xhamia e parë në Berat brenda mureve të kalasë, në vitin 1389, dhe xhamia Fet'hije (e Kuqe) e ndërtuar në vitin 1417.

Xhamitë brenda kalasë janë të thjeshta, sepse fillimisht kanë qenë projektuar vetëm për garnizonet. Ndërsa monumentet islame kanë filluar në periudhën e dytë të Bajazitëve. Bajaziti i II-të, apo Bajaziti i Shenjtë, njihet për pagën, që arriti të vendoste mes Perëndimit dhe Venedikut, në mënyrë që tregtia të vazhdonte akoma për shumë kohë.

Ai urdhëroi që të zbritej nga kalaja dhe të ndërtohej në qytet ajo që njihet me emrin varosh. Varoshi është menjëherë përtej rrethinave të kalasë dhe sipas përkatësisë fetare, në çdo varoshi ka një xhami ose kishë.

Sipas profesor Sulejman Dashit, arkitekt dhe restaurues, veprat e artit islam shqiptar janë një produkt i artit islam si xhami, medrese, por

edhe kisha, manastire dhe ndërtesa që gjenden në të gjithë Ballkanin, në troje të banuara nga shqiptarët, pavarësisht nëse janë jashtë kufijve të Shqipërisë. Falë pozitës së saj gjeografike, Shqipëria, e cila ndodhet në kufijtë mes qytetërimit lindor dhe perëndimor, pati mundësinë të shfrytëzonte zbulimet më të fundit të teknologjisë së ndërtimit.

Kronikani osman, Evlija **Çelebiu**, ka shkruar se kur udhëtoi përmes Shqipërisë, ai vuri re se në Berat, Gjirokastrë dhe Shkodër, secili qytet ishte i ndarë mjeshtërisht dhe kishte arkitekturën tipike vendase. Një tjetër element arkitekturor i artit islam në Shqipëri dhe që e bën atë të veçantë dhe ndryshe nga vendet e tjera të Ballkanit e nga kryeqendrat e tjera të Perandorisë Osmane, është kulla e sahatit, që qëndron krahu për krahu xhamisë kryesore të qendrës së qytetit. Kjo kullë sahati shërbente si një kohërrëfuese për të gjithë qytetin, për kohët e faljes etj. Kulla e parë e sahatit në Perandorinë Osmane u ndërtua në vitin 1555, ndërkohë në Elbasan dhe Berat ekzistonte prej kohësh. Kullë sahati ka pasur edhe në Shkodër, Peqin, Elbasan, Berat, Kavajë, Tiranë, Libohovë dhe Gjirokastrë. Këto kulla kanë qenë një element karakteristik i qyteteve në fjalë. Teknologjinë për të ndërtuar kulla me sahat aq të përpiktë, Shqipëria e mori nga mundësitë e shumta për të pasur marrëdhënie diplomatike me perëndimin.

Objekti i parë islam u ndërtua në vitin 1389 në Berat në stilin selxhuk. Një tjetër xhami e hershme është edhe ajo e Iljaz bej Mirahorit në Korçë, e ndërtuar më 1494, pasi Perandoria Osmane mori nën kontroll të gjithë vendin. Një ndër xhamitë më të vlerësuara në Shqipëri është ajo e Krugës, rreth 30 kilometra në veri të kryeqytetit. Xhamia është e pozicionuar në themelet e Kështjellës së Skënderbeut dhe është ndërtuar në vitin 1779. Brenda ka tavane prej druri të pikturuara, që duken si një grup kubesh të mbështetura mbi një kënd paralelesh. Një tjetër ndërtesë është dhe xhamia e Peqinit, e ndërtuar në vitin 1822, në të cilën është ndërtur edhe një kullë sahati në minaren e vetme të saj (P. Ward, 1992). Sipas studiuesit Roald Hysa (2008), stili osman është dominues në xhamitë në Shqipëri për shkak të qëndrimit të tyre në këtë vend për më se 500 vjet, por megjithatë vërehen edhe shumë elementë dhe tipare vendase të pranishme në ndërtesat në fjalë sipas vendit dhe kohës. Kjo mund të vërehet qartë në arkitekturën e atyre pak xhamive që mbijetuan, deri në krijimin e shtetit shqiptar si: Xhamia e Et'hem Beut në kryeqytet, xhamia Mbret në Elbasan, xhamia e Beqarëve dhe e Plumbit në Berat, Muradijes në Vlorë, Mirahorit në Korçë, etj.

Xhamitë në Shqipëri janë dy llojesh: lloji i parë është monumental, ku njësi të ndryshme janë në

harmoni me njëra-tjetrën. Stili klasik osman i këtij lloji e ka origjinën nga arkitektura bizantine ku në qendër të xhamisë ngrihet një kupolë e rrumbullakët dhe një portë e madhe me tri kupola të vogla, si dhe minaret e holla pranë hyrjes.

Lloji i dytë janë xhamitë drejtkëndëshe me çati tradicionale dhe tavanet prej druri të pikturuar, tipike të Ballkanit. Arti dekorativ i brendshëm është më shumë i pranishëm në xhamitë me kupolë, ndërsa thurja dhe gdhendja e drurit është e pranishme në modelet me tavane të drunjto.

Më vonë dizenjuesit iu afruan më shumë artit vendas popullor. Kjo vihet re sidomos në arkadat, varëse rrobash të gjera, dekoret, ngjyrat e jashtme etj. Në faltoret në Tiranë, për shembull, vihen re dekorime luleje sidomos në peizazhet e pikturuara, në shtyllat dhe muret e brendshme dhe në tavane. Të gjitha këto zbukurime janë shumë të përafërta me motivet popullore tipike të arkitekturës vendase. Disa nga këto lloj motifesh me lule gjenden edhe te zbukurimet e jashtme të xhamisë së Et'hem Beut në Tiranë për të cilën do të flitet më poshtë.

Sipas një studimi, shënohen rreth 1127 xhami në të gjithë vendin, por duke filluar nga viti 1945 shumica e hapësirave, apo ndërtesave të xhamive u shndërruan në një tjetër funksion, si për shembull xhamia e Tabakëve, Dine Hoxha dhe e

Kokonozit, ndërsa xhamitë e tjera u dogjën dhe u shkatërruan dhe në vend të tyre u ndërtuan shkolla, parqe apo ndërtesa banimi (Hysa, 2008).

Takoel tregon se gjatë kësaj kohe xhamitë u shndërruan në stalla lopësh, ndërsa kishat në stadione volejboli. Pra, gjatë viteve '45-'67 u ndaluan xhamitë dhe përdorimi i tyre u zëvendësua me diçka tjetër. Pas 23 vjet ndalimi, me ardhjen e demokracisë, xhamitë të cilat i shpëtuan prishjes, u rihapën dhe planimetria e qytetit filloi të ndryshonte.

4. Xhamia e Et'hem Beut

4.1 Sfondi i xhamisë



Figura 1: Pamja e jashtme e xhamisë

Xhamia e Et'hem Beut (fig. 1) është ndërtesa më e vjetër e Tiranës. Themeluesi i xhamisë, Mulla Beu, ishte një feudal nga Petrela, nipi i Sulejman Pashës. Ka gjasa që ndërtimi i xhamisë të ketë filluar në vitin 1793 gjatë sundimit të Selimit III. Mulla Beu vdiq në vitin 1808. Djali i tij, Haxhi Et'hem Beu, e

përfundoi ndërtimin e xhamisë në vitin 1238 hixhri (1822/23), siç shkruhet në derën (hyrjen) e xhamisë (Kiel, M. 2012). Gjithashtu, aty gjendet edhe data e vdekjes së Mulla Beut. Et'hem Beu dhe gruaja e tij, Belkize, janë varrosur në varre të mbuluara me mermer në hyrje të xhamisë, në të dyja anët. Të dy varret janë ruajtur mjaft mirë deri në vitin 1967. Në fillim të viteve '70 gurët me mbishkrimet e varrit të Et'hem beut u hoqën për të mos u rikthyer më kurrë. Gjatë kohës së monizmit në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë xhamitë u mbyllën. Më 18 janar 1991, pavarësisht kundërshtimeve të autoriteteve komuniste, mijëra njerëz morën pjesë në ceremoninë e hapjes së xhamisë së Et'hem beut.

Xhamia është e vendosur në Sheshin Skenderbej, në qendër të qytetit. Bashkë me kullën e sahatit ajo përbën një pikë referimi me domethënie për arkitekturën e Tiranës. Xhamia gjendet pranë objekteve të rëndësishme si ministritë dhe Bashkia e Tiranës. Kulla e sahatit ndodhet rreth 20 metra në të majtë të xhamisë, në anën jug-lindore të saj.

4.1.1 Analizë e planit hapësinor të xhamisë së Et'hem Beut

Xhamia përbëhet nga një hapësirë e zakonshme për falje, me kupolë (10.5 m²) dhe një korridor

të gjerë në pjesën e hyrjes, me një tavan të sheshtë dhe një çati druri të mbuluar me tjegulla, ndërsa në anën e djathtë ndodhet minarja e gjatë dhe e hollë. Dizajni i xhamisë ka një plan drejtkëndor me përmasa 17.50 x 15.00 m dhe me një sipërfaqe të përgjithshme prej 260 metrash katrorë. Ka tre hapësira kryesore faljeje. Dy janë për meshkujt dhe një për femrat. Zona e meshkujve gjendet në katin përdhes dhe në pjesën e hyrjes, ndërsa zona e femrave gjendet në katin e sipërm.

Pjesa kryesore e faljes për meshkujt ka një plan në formë katrorë, ku pjesa e brendshme është 7.75 metra katrorë. Sipër zonës kryesore të faljes gjendet një mbajtëse në formë tetëkëndëshe dhe sipër një kupolë me diametër 8 metër, e mbuluar me material plumbi. Mjedisi i brendshëm është i ndriçuar nga disa dritare të vogla të vendosura në dy rreshta. Nga ana e brendshme, kupola dhe tavani janë të pikturuara në mënyrë harmonike. Zona e dytë e faljes për meshkujt është në hyrje, siç quhet ndryshe veranda dhe ndodhet brenda xhamisë. Është në formë L-je, e cila të orienton drejt pjesës kryesore të faljes.

Teksa ngjitesh nga holli i faljes, nëpërmjet një dere të vogël, gjenden shkallët në formë spiraleje në një bosht pingul. Vendi i faljes për femra mund të arrihet me anë të këtyre shkallëve. Zona e faljes për femra është e vogël dhe mund të

mbajë vetëm një radhë (saf). Është e vendosur si gjysmë kati në hollin kryesor. Ka disa rafte librash, ndërsa dysHEMEJA është e shtruar me tapet.

Hyrja për në zonën e abdesit dhe tualeteve është e vendosur në bazament tek e cila arrihet nëpërmjet shkallëve të vendosura pranë hyrjes.

Jashtë xhamisë, te hyrja kryesore, gjenden dy varre. I pari është i Et'hem Beut, i cili ishte i biri i Mulla Beut, themeluesit të xhamisë. Varri ndodhet në anën e majtë të hyrjes kryesore të xhamisë dhe është i dëmtuar. Varri i dytë është i Belkizës, gruas së Et'hem Beut. Varri i dytë është në kushte më të mira në krahasim me atë të bashkëshortit. Ndodhet në anën e djathtë të hyrjes kryesore, në krah të kundërt me varrin e Et'hem Beut.

4.1.2 Tiparet arkitektonike të xhamisë së Et'hem Beut

Xhamia nuk është ndërtuar gjatë një periudhe të vetme. Historia e ndërtimit të saj përshkruhet në dy mbishkrime të gjata. Pjesa më e vjetër e ndërtesës është hollit me kupolë i ndërtuar në vitin 1208 H (1793/94). Tri dekada më pas është ndërtuar portiku i jashtëm. Portiku është një korridor i gjatë, asimetrik në drejtim të boshtit të hollit dhe planit të vet.

4.1.2.1 Kolonat

E gjithë fasada e xhamisë është e përbërë nga 15 harqe, e përforcuar nga kolona të larta guri 2.90 metër secila dhe me diametër po aq. E stilizuar me shkronja të ndryshme me lartësi 0,60 metra dhe bazë 0,45 metra, e mbajtur nga një çati druri. Disa nga këto arkada, rreth katër prej tyre, gjenden në fasadën veriore, shtatë të tjerat në fasadën lindore dhe tri të fundit në pjesën perëndimore.



Figurat 2: Kolonat rreth fasadës së xhamisë

4.1.2.2 Katet

Sistemi i kateve është i përbërë nga pllaka betoni. Kati përdhës është i ngritur nga toka me rreth 1 metër. Pjesa e brendshme është e mbuluar me qilim, ndërsa pjesa e jashtme është me pllaka mermeri me forma të parregullta. Kati nëntokë, pra kati ku gjenden banjat, është i veshur me pllaka porcelani 0.3 m x 3.4 m, secila me ngjyrë të bardhë.

4.1.2.3 Muri

Nga rasti i marrë në studim kuptohet se sistemi i murit, i përdorur për të ndërtuar xhaminë, është një sistem me blloqe të dyfishta. Blloqet janë të vendosura në shtresa e të lidhura me llaç. Muret e brendshme janë mjaft të trashë, duke krijuar një hapësirë për librat në çdo dritare. Muret, rreth 2,5 metra nga toka, janë të suvatuara dhe të lyera me gëlqere, ndërsa pjesa e sipërme është e pikturuar me motive floreale nga artistët e asaj kohe.

4.1.2.4 Kulmi dhe tavani

Kulmi është elementi kryesor, që i jep xhamisë një identitet shqiptar. Po të mos ishte për minaren ajo nuk do të dallohej nga ndërtesat e tjera. Është e ndërtuar me pllaka balte në formë katrani. Mbulon hyrjen e xhamisë, ndërsa sipër pjesës kryesore të faljes, në formën tetëkëndore, gjendet kupola. Ajo ka një diametër prej 8 metrash, e mbuluar me plumb. Kurse tavani është ndërtuar thjesht me dërrasa të vëna njëra pas tjetrës.

4.1.2.5 Shkallët

Shkallët e jashtme janë prej pllakash mermeri në formë të rregullt. Përbëhen prej katër shkallësh, që të çojnë në një gjysmë sferë, si hyrëse e pjesës së brendshme të xhamisë. Shkallët, që të çojnë te hapësira e faljes së grave janë shumë

të ngushta dhe në një formë spirale, që mundëson kalimin e një personi të vetëm. Shkallët janë të ndërtuara me betonim të thjeshtë dhe nuk është përdorur material shtesë. Secili hap është shumë i lartë dhe krijon pak vështirësi në ngjitje, madje nuk kanë as mbajtëse anësore për personat e moshuar. Shkallët të çojnë gjithashtu edhe drejt minares (ose shkallët kanë dy dalje njëra, që të çon te hapësira e faljes për femra dhe tjetra të çon lart te minarja e xhamisë).

4.1.2.6 Dyert

Dyert përbëhen prej portave dhe dritareve. Xhamia ka tre porta kryesore. Njëra te hyrja qendrore e xhamisë, me ngjyrë kafe, përbëhet nga dy kanate dhe një kornizë drejtkëndore, e cila e kufizon në skajet e saj. E dyta është një portë më e vogël në pjesën e brendshme të xhamisë, që të çon për te hapësira e faljes. Është prej druri dhe me një panel prej xhami, ndërsa mbi të muri është i dekoruar me motive lulësh. Porta e tretë është në pjesën e brendshme të hapësirës së faljes. Ajo të çon për te vendfalja e femrave. Është njëkanatëshe dhe me një hark të vogël përkulur në krye.

Ndërsa dritaret janë të vogla, të vendosura në lartësi të ndryshme në dy rreshtat e xhamisë. Dritaret më të vogla janë të vendosura në muret e brendshme të xhamisë, ndërsa ato të mëdhatë e me hark rrethojnë nga lart hyrjen nga tri anët.

4.1.2.7. Minarja

E gjithë minarja është ndërtuar me gur gëlqeror dhe e gdhendur në pjesën e brendshme dhe të jashtme. Lartësia e saj është gati 33,44 metra dhe me një diametër prej 1.40 metrash. Minarja ka formën e një shtylle sferike dhe me diametrin, që zvogëlohet me rritjen e lartësisë. Në pjesën e jashtme është e përbërë nga 15 kanale urash.

Ballkoni i rrumbullakët mbështetet mbi një mbajtëse të ngulur diku në një platformë. Për të mbërritur atje duhet kaluar nga hapësira e faljes përmes portës së vogël dhe të ngjitësh shkallët prej 90 hapash në formë trekëndore të mbështetura mbi një bosht pingul të vendosur në mes. Kangjellat janë prej druri të punuar me dorë.

4.1.2.8. Burimi

Uji është një element i rëndësishëm në jetën e komunitetit mysliman. Nuk është vetëm një element jetik, por edhe një element shumë i rëndësishëm për pastërtinë dhe higjienën. Kështu, kudo në Tiranë ka pasur burime uji (abdes'hane në formë shatërvani), në çdo xhami, apo dhe në qendrat kryesore të kryeqytetit. Të tillë ka pasur edhe xhamia e Et'hem Beut. Burimi gjendet në një qoshe të xhamisë, i ndërtuar me gurë cilindrikë

me një diametër gati 1 metër. Në ditët e sotme ka vetëm një funksion simbolik, pasi nuk qarkullon ujë dhe nuk përdoret më.

4.1.2.9 Dekorimi dhe zbukurimi

Muret, tavanet dhe kupola janë të dekoruara me motive gjithësh të gjelbra dhe lulesh në pjesën e brendshme dhe të jashtme të xhamisë. Ky lloj stili dekorimi është i zakonshëm, mirëpo panorama përfundimtare është një mrekulli. Brenda, hapësira e faljes shpaloset në një mënyrë të veçantë. E gjithë hapësira e mureve dhe e kupolës nga brenda është e dekoruar me motive të veçanta, të cilat nuk gjenden asgjëkund. Ngjyra e fushës është një e hirtë e ëmbël, duke krijuar mjeshhtërisht kontrast me ngjyrën e kuqe të kaftë dhe të gjelbër të të gjithë panoramës. Pikturime të **ndërlikuara të shumëllojshmërisë së luleve me** pikturimet e qyteteve të mrekullueshme dhe të xhamive të bukura krijojnë një panoramë të ngjashme me ndërtesat e vjetra në Turqi, Maqedoni dhe Bullgari. *Mibrabi* qëndron përballë hapësirës së faljes, i punuar më gdhendje **në kafe të errët dhe shkallët me ngjyrë druri. Të** gjitha orenditë e tjera si ora dhe kornizat janë të gjitha prej druri dhe janë të vendosur në mënyrë të shpërndarë nëpër xhami.

5. Përfundimi

Si përfundim, mund të themi se xhamia e Et'hem Beut është shembulli më i mirë i arkitekturës tipike islame në Shqipëri. Ndër të tjera është një dëshmi e periudhës klasike, gjatë së cilës ndërtesat kanë qenë të vogla, por të mbledhura me një stil të ndikuar nga qytetërimi i Perandorisë Osmane dhe aftësia e projektuesve për të ndërthurur këtë stil me stilin tipik vendas. Kombinimi i hapësirës për falje dhe verandës së gjërë me disa kolona dhe

e rrethuar nga minarja e hollë nga njëra anë dhe nga kulla e sahatit nga ana tjetër, është vlerësuar si një ide origjinale shqiptare. Mbi të gjitha, kombinimi i elementeve shekullarë dhe fetarë, përfshirë këtu elemente osmane, vendase dhe perëndimore, kanë formësuar pjesën qendrore dhe bërthamën e qyteteve në Shqipëri. Kombinimi i këtyre elementeve në pamje të parë heterogjene, reflekton ndërkohë historinë e Shqipërisë, si një urë lidhëse e Lindjes me Perëndimin.



Bibliografi

1. Abu Dawud, *Sunan Abi Dawud*, Kitab al-Salah, Hadith No. 461.
2. Akel Kahera, Latif Abdulmalik, Craig Anz, (2009). *Design criteria for mosques and Islamic centers: art, architecture and worship*. Published by Elsevier Ltd.
3. Al-Bukhari, *Sahih al-Bukhari*, Kitab al-Salah.
4. Aliu, B., (2010). *Roli i xhamisë në mbrojtjen e identitetit fetar dhe kombëtar*, <http://www.bashkimaliu.com> (8 janar, 2011)
5. Al-Kattani, al-Taratib al-Idariyyah, vol. 1 p. 299.
6. Bakiu, G. A., (2008). *Xhamitë e Tiranës*, <http://www.zeriyt.com/xhamite-e-tiranes-revista-klan-t44980.0.html> (20 janar 20, 2011)
7. Draper, S. (1997). *Ethnic and Racial Studies. The Conceptualization of an Albanian Nation*. Vol. 20, No. 1. [Online] Available: http://sdraper.ece.wisc.edu/researchDir/pdf/ERS_97.pdf (October 20, 2012)
8. Encyclopædia Britannica Online. *Albania: History: The Ottoman Empire: The Nature of Turkish Rule*.
9. Hatibi, E., (2008). *The building process of the Albanian identity under the modern claims*. Published: *ËORLD BULLETIN*. [Online] Available: <http://www.worldbulletin.net/index.php?aType=haberArchive&ArticleID=25610> (February 3, 2011)
10. Holod, R., Khan, H., (1997). *The mosque and the modern world: architects, patrons and designs since the 1950s*. Thames and Hudson, London.
11. Hysa, Roald A., (2008). *Xhamitë e Tiranës*, Xhamia e Kokonozit
12. Jairazbhoy, R.A., (1972). *An outline of Islamic architecture*. London: Asia Publishing House.
13. Jaser Auda, (2009). *The role of the mosque in Islam*. [Online] Available: <http://mdarik.islamonline.net> (January 21, 2011)
14. Kiel, M.(2011). *Arkitektura Osmane në Shqipëri*, AIITC, Tiranë, 2012.
15. KMSH, *Roli i xhamisë nga pikëpamja sociologjike*, www.kmsh.al (10 janar, 2011)
16. Kruja, Genti, *Një vështrim historik mbi tolerancën dhe mirëkuptimin ndërjetar në Shqipëri*, www.kmsh.al (8 shkurt 2011)
17. Leedy, P. D., (1989). *Practical Research: Planning and Design*. MacMillan, fifth edition
18. Luxner, L., (1992). *Albania's Islamic rebirth*. Published: Saudi Aramko World Journal. pg 38-47
19. Michel, G., (1996). *Architecture of Islamic World: its history and social meaning*. Thames and Hudson, London
20. Miller, E. (2009), *Mapping the Global Muslim Population: A Report on the Size and Distribution of the World's Muslim Population*. Washington, DC: Pew Research Center, [Online] Available: <http://pewforum.org/newassets/images/reports/Muslimpopulation/Muslimpopulation.pdf> (November 20, 2012)

21. Mohamad Tajuddin Haji Mohamad Rasdi. (1998). *The mosque as a community development centre: Programme and architectural guidelines for contemporary Muslim societies*. Published by University Technology Malaysia, Skudai, Johore.
22. Muslim, Sahih Muslim, Kitab al-Dhikr wa al-Du'a wa al-Tawbah wa al-Istighfar, Hadith No. 6518.
23. Omoniglot.com. *Albanian (Shqip)*. 2010. [Online] Available: <http://www.omniglot.com/writing/albanian.htm> (September 21, 2012)
24. P. Ward, Albania, Cambridge and New York 1983. 'Albania', *Aramco World* July/August 1992: 38-47
25. Siti Horiyah Abdul Cholid. (2000). *Mosque management in Malaysia: a framework for enhancement initiatives*. Master thesis, International Islamic University Malaysia
26. Sheikh Omar Bakri Muhammad. *The role of the mosque*. Published: Al-Muhajiroun
27. Sheikh Sayed Ad-Darsh. *The mosque as a community center; the functions of the Prophet's mosque*. [Online] Available: <http://www.islamonline.net> (January 5, 2011)
28. Vokshi. M. (2008) *Islam in Albania*. UK
29. Walbank, F.W. (2001) "*History of Albania and Kosovo: Life Among the Tribes: Albania & Kosovo*". p. 66, 3rd Ed. London, England: A & C Black Ltd
30. Zekaj, R., *Zhvillimi i kulturës Islame te Shqiptarët gjatë shekullit XX*, AIITC, Tiranë, 1997.

Shënimi i ditës së flamurit nga Komuniteti Mysliman në Shqipëri më 1924

Nuridin Ahmeti, Kosovë

Abstrakt

Nga materialet e shfletuara arkivore dhe literatura që lidhet me festimin e Ditës së Flamurit nga Komuniteti Mysliman i Fierit në atë kohë, mund të përfundojmë se Komuniteti dhe drejtuesit e tij, të ndihmuar edhe nga organet shtetërore të kohës, kishin një qasje me respekt për këtë ditë. Dita e Flamurit, nuk ishte ditë e zakonshme si të tjerat, por një mobilizim i vërtetë i Komunitetit. Kjo festë ishte shtetërore dhe për përgatitjen e kësaj dite, organet kompetente dërgonin shkresën, disa ditë më parë, me qëllim që komuniteti t'i niste përgatitjet për këtë ditë.

Pas marrjes së shkresës nga organet shtetërore, selia e Komunitetit Mysliman në Tiranë u niste shkresë Myftinjve të rrethit dhe pas përfundimit të manifestimit, myftinitë dërgonin raport në selinë qendrore të Komunitetit në Tiranë. Njëri nga raportet është edhe ky, i dërguar nga Myftinia e rrethit të Fierit, të cilin e prezantuam më lart.

Sado që rrethanat politike ishin jo të favorshme për t'u kremtuar kjo festë, megjithatë, Komuniteti ishte mobilizuar me gjithë kapacitetet e tij që kjo festë të bëhej sa më madhështore. Ajo që bie në sy në këtë organizim është se njerëzit pa dallime fetare, funksioni e pozite shoqërore, shkonin në kishë dhe në xhami për ta shënuar Ditën e Flamurit. Ndoshta, këto forma të organizimit për festa të caktuara kombëtare, duhet të jenë ende model për udhëheqësit tanë politik dhe fetarë.

“Çdo shqipëtar, duhet të dijë e të çmoji vleftën e rendësin e dheut e të flamurit kombëtar e të vetëqeverimit, e kështu me mish e me shpirtë, të ketë dashuri e të çfaqjë ndjenjat fisnike të kombësisë e të lërë kujtime të mira në “Histori”.

(A. Spahiu, Myftiu i Fierit).

Hyrje

Sentenca e lartshënuar përmban vetëm disa nga porositë që Myftiu i Rrethit të Fierit, z. A. Spahiu ua drejton të pranishmëve në një fjalim ceremonial të organizuar në Fier më 1924, me rastin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 28. XI. 1912. Këto të dhëna, deri te ne kanë ardhur në formë raporti që ishte përgatitur nga Myftinia e Fierit më 1924, disa ditë pasi ishte mbajtur ceremonia në nënprefekturën e Fierit, siç quhej asokohe. Raporti mban nënshkrimin e Myftiut dhe datën 28. XI. 1924. Ky dokument është i protokolluar me numër 229 dhe ruhet në Arkivin Qendror të Shtetit Shqiptar, në fondin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, me siglën: AQSH, F. 482, V. 1924, D. 13, f. 1-5.

Janë disa arsye pse kemi menduar t'i bëjmë një vështrim këtij raporti dhe t'ua risjellim këtë lexuesve:

E para - deri më sot nuk dimë të jetë publikuar ky raport.

E dyta - botohet më rastin e nëntëdhjetë e trevjetorit të mbajtjes së këtij fjalimi dhe njëqindpesë vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.

E treta - fjalët e myftiut të Fierit të shprehura në këtë manifestim, edhe sot janë aktuale.

E katërta - mënyra e festimi të kësaj feste, para më shumë se nëntëdhjetë viteve, duhet të jetë prej modeleve të mira edhe për kohën

tonë, si për pushtetin, ashtu edhe për komunitetin.

E pesta - mbart mesazhin, përveç tjerash, edhe të asaj që ne si popull krenohemi - "të mirëkuptimit ndërfitar".

E gjashta - pavarësisht se ky raport i përket një nënprefekturë, siç ishte Fieri, mesazhi që bart i kalon kufijtë e vendit ku u mbajt.


Manifestimet qendrore që janë mbajtur në Tiranë, për disa vite janë botuar edhe në organin e atëhershëm të këtij komuniteti, në revistën "Zani i Naltë". Duhet theksuar se në Shqipëri, në aspektin politik, viti për të cilin po flasim ishte mjaft i tendosur. Politika në Shqipërinë e viteve 1920-1924, solli edhe mjaft pakënaqësi te popullata, si rezultat i së cilës do të fillonte edhe një kryengritje që njihet si "Kryengritja e qershorit" dhe që solli qeverinë gjashtë mujore të Fan Nolit (nga 16 qershori deri më 24 dhjetor të vitit 1924) dhe rikthimin e Ahmet Zogut (më 24 dhjetor 1924).¹

Pavarësisht rrethanave specifike e politike të kohës, Komuniteti Mysliman në Shqipëri, nuk e harroi shënimin e kësaj feste. Duhet përmendur se me gjithë ndërrimet në pushtet, legjislacioni me të cilin funksiononin komunitetet fetare në Shqipëri ishte ai që u bë pas viteve '20.²

1. Kastriot Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005*, Sh. b. "55", Tiranë, 2006, f. 211-228

2. *Po aty*, f. 167-174

Po si u shënua kjo festë nga Komuniteti Mysliman Shqiptar gjatë viteve 1920-1924



Shkresa e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës drejtuar GJNSH më 1922

Dokumentacioni nga fondi i Komunitetit Mysliman, që gjendet në Arkivin e Shtetit Shqiptar, ofron mjaft të dhëna për organizimin e kësaj feste ndër vite, por edhe në vitet që ne kemi marrë në trajtim.

Përpyekjet faktike për t'u shkëputur nga Turqia, myslimanët në Shqipëri i filluan nga viti 1913, kur haxhi Vehbi Dibra, krahas detyrës së caktuar nga Kuvendi Kombëtar i Vlorës si udhëheqës i Senatit, atij i ngarkohet edhe detyra e udhëheqësit të Komuniteti Mysliman

të Shqipërisë.³ Nga viti 1916, kur forcat austro-hungareze pushtojnë Shqipërinë, në dokumentacionin që ne kemi hasur në Fondin e Komunitetit Mysliman në këtë arkiv, por edhe në literaturën përkatëse, nuk kemi gjetur ndonjë të dhënë se është shënuar zyrtarisht kjo festë nga ana e Komunitetit Mysliman, mbase mund të ketë pasur ndonjë festim individual. Pavarësisht se nuk kemi të dhëna për festim zyrtar të kësaj feste në këtë kohë, disa të dhëna tregojnë për përpjekjet e administratës austro-hungareze në Shqipëri, për reformimin e administratës dhe institucionit të KMSH-së.

Mbështetur në disa dokumente, si ai e 7 prillit 1917, i dërguar nga Komanda austro-hungareze në Shkodër, tregojnë se është festuar një festë (nuk tregohet se për çfarë feste bëhet fjalë) nga disa xhami të cilat i administron KMSH, por që nuk kanë marrë leje paraprake nga kjo komandë.⁴ Përkitazi më letrën e lartcekur, Gjyqi i Naltë i Sheriatit, në shkresën nr. 39, e cila i drejtohet kadiut të Shkodrës më 14 prill 1917, sqaron se asnjë festë popullore etj., nuk duhet të organizohet pa lejen

3. Hasan Bello, "Shkëputja e Shqipërisë nga Kalifati Osman dhe përpjekjet e bëra për Autoqefalin e Xhamisë Shqiptare", *Gjurmime albanologjike-SSH*, nr. 40, IAP, Prishtinë, 2011, f. 140.

4. *Arkivi Qendror i Shtetit Shqiptar* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F) 482, Viti (më tej: V) 1917, Dosja (më tej: D) 39, Fleta (më tej: fl.), 4.

paraprake të Komandës austro-hungareze: “festat popullore, gëzimet e përgjithta e të mbledhurat etj- munden m’u mbajtë vetun mbasi të kenë parapëlqimin e *Bezirkumandës*, e për me mujt m’e nxjerrë kët pelqim”.⁵ Pavarësisht ndërhyrjeve të tilla nga komanda austro-hungareze në disa manifestime, si ajo që u cek më lart, të dhënat, gjatë viteve 1916-1918, tregojnë se Austro-Hungaria në Shqipëri ndaj Komunitetit Mysliman përgjithësisht përdori një politikë konstruktive.⁶

Mendojmë se duhet theksuar që në vitin 1916, konkretisht në tetor të këtij vitit, komanda austro-hungareze e vendosi Gjyqin e Naltë të Sheriatit në Shkodër, në krye të të cilit ishte Vehbi Dibra⁷. Nga nëntori i vitit 1921, kemi shkresa të cilat janë të firmosura nga nënprefekti i Prefekturës së Tiranës, të cilat i dërgohen siç shkruhet “Kryesisës së Gjyqit Naltë të Sheriatit”, ku i bashkangjitur është edhe programi i shënimit të kësaj dite. Kjo shkresë nga Prefektura e Tiranës i dërgohet Kryesisës së Gjyqit të Lartë të Sheriatit më 26. XI. 1921, një pjesë të së cilës po e prezantojmë si më poshtë:

“Mbi Kremtimin e ditës 28. Nëndor.

5. *AQSH*, F. 482, V. 1917, D. 39, fl. 7

6. Hasan Bello, “Roli i Austro-Hungarisë për organizimin e institucioneve të fesë islame në Shqipëri në vitet 1916-1918”, *Gjurmime albanologjike-SSH*, nr. 43, IAP, Prishtinë, 2014, f. 217-229.

7. *AQSH*, F. 482, V. 1917, D. 19, fl. 30.

Me 27 të Nëndorit ne mbramjet te gjitha do te jen te stolisina a te zbukurime me flamur; dafina e me drita.

Me 28, ora 9 do te bahen lutje në xhami e ne kisha.

Ora 10, këshilli i Nalt tue pas ne an te djabatte Kabinetin e ne ane te majte Kryetar e Nenkryetarin e Parlamentit pret urime ne sallone e Keshillit Ministrues; ne mendyre si vazhdone:

Me pare hyejn per urime Parlamentaret e Drejtoret e Pergjitheshem.

Kryemiftiu me duatare.

Keshilltaret me Kryetaret e zyrvet.

Trupi ushtarak e gjithe Nenpunesit e zyrvet Ministore.

Nenprefekti; Kryekatundari; Keshilla e katundarise dhe paria e vendit.

Ora 11-12 Repesantantet dhe te buajt”⁸

Në vitin 1922, në një shkresë të nënshkruar nga Myftiu i Përgjithshëm Vehbi Dibra, i cili iu drejtohet myftinjve të rretheve në Shqipëri, i vë në dijeni për vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 47, dt. 4.1.1922, në lidhje me festat zyrtare. Aty theksohet edhe “Dita e shpalljes e vetqeverimit e 28 Nanduer” - siç thuhet në këtë shkresë. Pos tjerash,

8. *AQSH*, F. 482, V. 1921, D. 61, fl. 2. Urdhërese e dërguar nga Prefektura e Tiranës, për Kryesin e Gjyqit të Naltë të Sheriatit, dt. 26. 11. 1921.

janë të përmendura edhe festat fetare për komunitet fetare të Shqipërisë. Për Komunitetin Mysliman, si festa zyrtare, janë caktuar këto: “Ditë të bajramit të Math dhe të Vogel, Dita e Mevludit, Miraxhit, Regajbit, Beratit”.⁹ Për vitin 1922 dokumentacioni është mjaft i pasur, që tregon se janë dërguar disa shkresa, nga administrata shtetërore në Tiranë në adresë të zyrës së Komunitetit Mysliman, njëra nga këto është edhe shkresa e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës nr. 2144, ku kërkohet nga Komuniteti Mysliman që me dt. 28 Nëntor t’i stolisin të gjitha xhamitë. Prefekti i Tiranës i lutet Komunitetit që t’i njoftoj të gjithë Myftinitë e vendit, që për këtë ditë t’i stolisin xhamitë, duke ndezur drita natën e 27 dhe 28 Nëntorit.¹⁰

Është për t’u theksuar, se Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, i ka kushtuar rëndësi të veçantë, dëshmorëve të atdheut. Ata kanë organizuar edhe dua e “ Hatme i Sherif”- siç e quajnë ata, në përkujtim të dëshmorëve që kanë dhënë jetën për vatan. Kjo gjë vërehet edhe nga shkresa nr. 130, e nënshkruar nga haxhi Vehbi Dibra, ku Gjyqi i Naltë i Sheriatit i dërgon Kryesisë së Këshillit Kombëtar në Tiranë, dhe ku ftohen që të marrin

pjesë në këtë organizim. Aty thuhet: “Me anë të kësaj shkrese, kemi nderin me e lajmue Shkelqësin t’Uej se, ky Gjyq nesër ora 9 para dreke në xhamin e vjetër, ke mejtue me mbyll një (Hatme i Sherif) e me ba një lutje per rahatën e shpirtit të gjithë atyne Dishmorëve qi kanë dhanë jeten e vet per shpetimin e Atdheut”.¹¹

Në mars të vitit 1923, në Kongresin e Parë Mysliman të mbajtur në Tiranë, edhe juridikisht, Komunitetit Mysliman Shqiptarë vepron i pavarur. Ndërsa në muajin tetor, nis punën revista “Zani i Naltë”, Organ i Komunitetit Mysliman Shqiptar.¹² Për vitin 1923, nuk kemi hasur ndonjë shkresë në Fondin e Komunitetit Mysliman për këtë datë, edhe pse mendojmë se duhet të ketë ndonjë material apo dokument arkivor edhe për këtë vit. Çuditërisht, as revista “Zani i Naltë”, nuk na jep ndonjë të dhënë-njoftim për ndonjë organizim për këtë datë nga ana e Komunitetit Mysliman, deri në vitin 1925. Kjo revistë në nr. 9 të muajit nëntor të viti 1925, i kushton pothuajse një numër të tërë Ditës së Flamurit, duke filluar që nga fjala e redaksisë.¹³

11. *AQSH*, F. 482, V. 1922, D. 14, fl. 2

12. Roberto Morozzo della Roca, *Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1939*, (Përktheu Luan Omari), Sh. b. Elena Gjika, Tiranë, 1994, f. 28-30.

13. *Zani i Naltë*, nr. 9, Nantuer, Vit’i II, Tiranë, 1925, në: “Zani i Naltë”, V. I, KMSH, BFIM, BIK, Tiranë, Prishtinë, Shkup, 2015, f. 641-672.

9. *AQSH*, F. 482, V. 1922, D. 14, fl. 1. Urdhëresë e Këshillit të Ministrave, nr. 3 dërguar Gjyqit të Naltë të Sheriatit, dt. 04. 1. 1922

10. *AQSH*, F. 482, V. 1922, D. 14, fl. 7

me epitetet i “shtrenjtë”, “lyer me gjak”, “i vlefshëm”. Myftiu në mes tjerash komunikon me Flamurin dhe duke iu drejtuar atij me thirrjen: “O-Flamur, Flamuri Kombëtarë, Krishterë e Muhamedanë, si binjak, në Kishë e në Xhami të festojmë dhe valimin tënd në Shqipëri nga i madhi Zot lusim e kërkojmë”.¹⁵

Në pjesën e tretë bëhet fjalë për lutjen që Myftiu i drejton Zotit për të mirën e Atdheut dhe popullit. Ai i lutet Zotit për popullin e tij që ta mbrojë nga ligësitë dhe nga mallkimi. Po ashtu falënderon Zotin, që, siç thotë Myftiu, na ka falur një komb fisnik e të shquar në botë. Gjithmonë, lutjet e tij shoqërohen fillimisht me lutje ndaj Zotit dhe më pas për Atdheun e kombin: “O Zot pa shoq, ki mëshirë për gjithë profetët që na ke dergu, prej Z. Ademit e deri tek i madhi Muhamed ‘Alejhi e selatu ve selam’ dhe për farefisën e tyre dhe për shokët e tyre dhe për neve kombin shqiptar dhe për gjithë njerëzit, ç’ke kriju “amin”.¹⁶

Në pjesën e katërt ndërkaq, Myftiu, me fjalë madhëron kombin, flamurin, vëllazërinë, miqtë. Madhëron dëshmorët, dhe lutet për shpirtat e tyre, duke i përmendur disa edhe me emra, pa harruar sigurisht Abdyl e Naim Frashërin, Ismail Qemalin etj., duke shtuar para çdo fillimi të fjalisë, fjalën “Rroftë”, bie fjala “Rroftë Kombësija, valoftë

Flamuri Kombëtar, rroftë Atdheu, vazhdoftë qeverija shqiptare, rroftë vëllazërija e bashkimi, rroftë miqtë e Shqipënis. Ndjes pafçin, shpëtimtarët e kombësis e të atëdheut Abdyl e Naim bej Frashëri dhe Ismail Qemal bej Vlora. Ndjes pafçin, gjithë dëshmorët e atdheut e të kombësis”.¹⁷

Për të qenë më korrekt me lexuesin, ne e kemi transkriptuar të gjithë raportin dhe po e sjellim ashtu siç është përpiluar në vitin 1924, nga vetë dora e Myftiut të Fierit, pa hequr dhe shtuar asgjë.

“Zyra e Myftiut Fier

Nr. 229

Të sherijatit, Kryesis, këshillit nalt të sheriatit në Tiranë

Me nderime ju paraqitim urimet e ditës së flamurit Kombëtar 28.XI.1912, dhe ju bajmë të ditun se si mbas programit që me u komunikoi prej nënprefekturës këtushme. Sot më 28. XII. 1924 të premtën para dreke ora në “9” turke, ndodhur një shumicë, myslimanë e krishterë dhe gjithë zyrtarët dhe fuqija e gjandermarisë dhe nxënësit e shkollave mashkullore e femnore dhe trupi arsimor në kishën “ortodokse” u ba festimi e lutja e flamurit kombëtar dhe si u mbarue festimi në kishë, së bashku dulmë prej kisha, mysliman e krishterë erdhmë në xhami, mbrënda në xhami duke u ndodhur nënprefekti e gjithë zyrtartë

15. *AQSH*, F. 482, V. 1924, D. 13, fl. 1-2.

16. *AQSH*, F. 482, V. 1924, D. 13, fl. 3.

17. *AQSH*, F. 482, V. 1924, D. 13, fl. 4.

dhe kryetari me gjithë trupin fetare të klerit ortodokse dhe një shumicë prej popullit mysliman e krishterë, u ba me nderime festimi dhe për dije ju paraqitim kopjen e fjalës e të lutjes që mbajtëm në gjuhën amtare

Me nderime 28. XI. 1924

Myfti

A.Spahi

Fjala e lutja që mbajti në “Ditën e flamurit” më 28.XI.1924 në Xhami

Parathënjë

1

ZZ, të nderçim vëllazër shqipëtar. Sikurse e dini, tash jemi mbledhur, më këtë “falore”, xhami të shënjtë, të festojmë ditënë 28.XI.1912, të ngrehjësë flamurit Kombëtar e të shpalljës vetëqeverimit tonë.

2

Vëllazër të nderçim-Kjo ditë, për Kombin tanë ashtë një ditë historike, një ditë e shënuar, një ditë gëzimi si Bajram e Pashkë.

3

Vëllazër të dashur-fort mirë ta dini. Kjo ditë e shënuar nër neve, ashtë dita e ngjalljes, dita e shpëtimit nga robërija e nga zgjedhat e huaja. Kjo ditë, na ka faltur liri e vetëqeverimin tonë.

4

O- flamur, flamur i shenjtë, vleftën e ke shumë të shtrënjtë.

O-flamur i Kuq i lyer me gjak, ti tregon në botë këtë Kombin tonë “Plakë”

O-flamur, flamuri Kombëtarë, Krishterë e Muhamedanë, si binjak, në Kishë e në Xhami të festojmë dhe valiminë tëndë në Shqipëni nga i madhi Zot lusim e kërkojmë.

5

Vllazën, atdheu shqipëniya, ashtë “Djepi e foleja, janë” dhe ky flamur, ky flamur i shenjtë, tregon, njofton në botë, kombësi, e vetëqeverimin tanë. Prandaj, çdo shqipëtar, duhet të dijë e të çmoji vleftën e rendësin e dheut e të flamurit kombëtar e të vetëqeverimit, e kështu me mish e me shpirtë, të ketë dashuri e të çfaqjë ndjenjat fisnike të kombësisë e të lërë kujtime të mira në “Histori”.

6

Vellazër kur se një njeri i banë të mirë tjetërit, njerëzishtë musë pari, detyrohet të bajë falënderime mirëbamësit, me qen se asht kështu, dhe neve, si robë që jemi, për këtë lumturi të vetëqeverimit dhe për çdo mirësi që na ka falur i madhe Zot, detyrohemi ti bajmë lutje “Perëndisë” tonë.

-Lutja-

O Zot i Madh, mbrona nga djallëzit e ligësit e të mallëkuarit e të gursuarit “amin”

O Zot i gjithësisë, me emnin mëshiruës, të madhënisë tënde,

fillojmë me të ba këto lutje.

O Zot i Vërtet, lavdi të bajmë që na ke kriju njeri në formë, të bukur dhe një komb fisnik të shquar në botë, dhe që na ke falur gjith mirësit.

O Zot pa shoq, ki mëshirë për gjithë profetët që na ke dergu, prej Z. Ademit e deri tek i madhi Muhamed “Alejhi e selatu ve selam” dhe për farefisnin e tyre dhe për shkokët e tyne dhe për neve kombin shqiptar dhe për gjithë njerëzit, ç’ke kriju “amin”

O Zot, të lutemi, mbrona kombinë e atdhenë dhe neve dhe gjith çke kriju, nga çdo rrezik tokor e qiellor “amin”

O Zot i dhurushëm, udhëtona në rrugën e drejtë, falna mëkatat, pastrona zëmërat, largona nga djallëzitë e ligësitë që i bijen dëm fesë e kombësis, dhurona mirësit, rendona peshën e të mirave, forcona këmbët në urën e siratit, zbardhna fytyrën më të dy jetët, ndritana me fytyrën e bukur të naltësis tënde, vendosna në “Parajsën” që na ka takuar, mos u zemro prej neve, mbrona nga mundimi i shpirtit e të varrit e të zjarimit dhe mos na trego sketerën që ke përgatitur për keqbërësit “amin”

O Zot, për madhënin tënde dhe për nderin e gjithë profetëve këto lutje që të bamë pranoji “amin”

Përfundimi

Rroftë Kombësija, valohtë flamuri kombëtar

Rroftë atdheu, vazhdohtë qeverija shqiptare

Rroftë vëllazënjia e bashkimi

Rrofshin miqtë e Shqipënis

Ndjes pafçin, shpëtimtarët e kombësis e të atëdheut Abdyl e Naim bej Frashëri dhe Ismail Qemal bej Vlora.

Ndjes pafçin, gjithë dëshmorët e atdheut e të kombësis

Myftiu i Fierit

*Spahi*¹⁸.

Përfundim

Nga materialet e shfletuara arkivore dhe literatura që lidhet me festimin e Ditës së Flamurit nga Komuniteti Mysliman i Fierit në atë kohë, mund të përfundojmë se Komuniteti dhe drejtuesit e tij, të ndihmuar edhe nga organet shtetërore të kohës, kishin një qasje me respekt për këtë ditë. Dita e Flamurit, nuk ishte ditë e zakonshme si të tjerat, por një mobilizim i vërtetë i Komunitetit. Kjo festë ishte shtetërore dhe për përgatitjen e kësaj dite, organet kompetente dërgonin shkresën, disa ditë më parë, me qëllim që komuniteti t’i niste përgatitjet për këtë ditë.

Pas marrjes së shkresës nga organet shtetërore, selia e Komunitetit Mysliman në Tiranë

18. *AQSH*, F. 482, V. 1924, D. 13, fl. 1-5.

u niste shkresë Myftinjve të rrethit dhe pas përfundimit të manifestimit, myftinitë dërgonin raport në selinë qendrore të Komunitetit në Tiranë. Njëri nga raportet është edhe ky, i dërguar nga Myftinia e rrethit të Fierit, të cilin e prezantuar më lart.

Sado që rrethanat politike ishin jo të favorshme për t'u kremtuar kjo festë, megjithatë, Komuniteti ishte mobilizuar me gjithë kapacitetet

e tij që kjo festë të bëhej sa më madhështore. Ajo që bie në sy në këtë organizim është se njerëzit pa dallime fetare, funksioni e pozite shoqërore, shkonin në kishë dhe në xhami për ta shënuar Ditën e Flamurit. Ndoshta, këto forma të organizimit për festa të caktuara kombëtare, duhet të jenë ende model për udhëheqësit tanë politik dhe fetarë.

Kontributi i revistës ‘Dituria islame’ në fushën e predikimit islam – hytbeja si shembull

Dr. Sedat Islami, Kosovë

Abstrakt

Revista “Dituria islame” ka një rëndësi të veçantë dhe historike në fushën e predikimit islam në Kosovë e më gjerë. Këtë rëndësi më së miri e dëshmon kontributi i saj i fokusuar, përveç të tjerash, edhe në përgatitjen profesionale të predikuesve – hoxhallarëve dhe ndihmesën e tyre permanente me tema fetare (vaçe dhe hytbe). Sfond historik këtij kontributi i jep paraqitja e saj në kohën e rrethanave të papërshtatshme politike në Kosovë dhe jo vetëm. Në Shqipëri, ku më parë nxirrreshin revista fetare, për shkak të regjimit komunist, nxjerrja e tyre qe ndaluar, ndërsa në Kosovë, përkundër sistemit sundues komunist, liria e shtypit fetar deri diku ekzistonte, megjithatë literatura fetare në shqip qe vonuar. Kështu, dalja e revistës “Dituria islame”, krahas “Edukatës islame”, revistë kjo tremujore, do të kontribuonte shumë për ngritjen e vetëdijes fetare islame në përgjithësi dhe për formimin e predikuesve fetarë në veçanti. Ky punim mëton të hedhë dritë pikërisht mbi këtë rol të ngritjes profesionale të imamëve dhe ligjëruesve fetarë, dhe këtë duke iu referuar hytbes nga aspekti profesional (si mjet predikues) dhe artistik (si përmbajtje dhe interpretim). Punimi është i ndarë në dy pjesë kryesore: në pjesën e parë jam marrë me materialet përkitazi me kornizën teorike për hytben, ndërsa në pjesën e dytë i jam përkushtuar anës praktike të tyre, respektivisht aspektit përmbajtjesor dhe rregullimit teknik e artistik të hytbeve. Krejt në fund, kam përmbledhë me pak fjalë rezultatet e këtij punimi dhe rekomandimet e tij.

Fjalët kyçe: dituria islame, predikimi islam, hytbeja e shumës, edukimi fetar, imamët shqiptarë.

HYRJE

Ligjërimi ka një rëndësi të veçantë për shkak se paraqet litarin që mban gjallë komunikimin shoqëror ndërmjet njerëzve dhe jo vetëm. Ai paraqet edhe nivelin e ngritjes intelektuale e qytetare të një populli dhe këtu qëndron shpjegimi se përse i është kushtuar rëndësi vazhdimisht asaj. Ai, nëse do të përdornim ilustrimin figurativ të disa studiuesve myslimanë, në raport me qytetërimin është sikur gjuha në raport me trupin.¹

Këtu qëndron shpjegimi se përse ligjërimin dhe të folurit i është kushtuar rëndësi në të gjitha qytetërimet dhe civilizimet, ashtu siç u kushtohet rëndësi edhe sot e kësaj dite. Rëndësi i është kushtuar edhe në Islam, ku, përveç bazave dhe kritereve përkatëse, janë modifikuar edhe ato elemente ekzistuese, në mënyrë që t'i përshtaten Islamit dhe parimeve të tij. Kjo ka bërë që ligjërimi të pësojë një ndryshim pothuajse strukturor dhe gjithëpërfshirës në tematikë, shprehje dhe veçori.² Ligjërimi është bërë edhe detyrim fetar, veçanërisht ai i ditës së xhuma, që konsiderohet pjesë përbërëse e adhurimit.

Nga këtu, dijetarët myslimanë e kanë trajtuar vazhdimisht ligjërimin, qoftë si kapitull të librave të caktuar, qoftë si libër të veçantë, sepse prej tij është varur shumë edhe përhapja e fesë.

Ligjërimi fetar, si koncept e art, ka zënë vend edhe te ne, shqiptarët myslimanë. Ai është shtjelluar në kuadër të planprogrameve mësimore, por edhe të materialeve publicistike. Megjithëkëtë, trajtimet për hytben ndër ne kanë munguar, ashtu siç kanë munguar trajtimet me këtë tematikë nga revista “Dituria islame”.

Problematika e hulumtimit

Nga këtu, vjen ky punim që të trajtojë këtë aspekt të lënë anash, dhe këtë duke gjurmuar për përgjigje të dy pyetjeve hulumtuese:

1) Sa ka kontribuar Dituria Islame në konceptet teorike për Hytben?

2) Sa ka mbështetur Dituria Islame imamët dhe ligjëruesit me materiale për ligjërimet e tyre ditëve të xhuma, festave dhe datave të caktuara?

Qëllimet e hulumtimit

1) Ky punim studion aspektin teorik të trajtesave shkencore dhe profesionale përkitazi me ligjërimin fetar në revistën Dituria Islame.

1. Shih: Sheisha', Abdul Mun'im Subhi dhe Savi, Seid. (2008) *Usul el-hatabe*. Pv.b.: p.sh.b. f. 205.

2. Shih: Mahmud, Ali Abdul Halim. (1991) *Fikhu-d-Da'ueti ila Allah*. Ed. 3. Mensure: Dar el-uefa. Vëll: 1, f. 169.

2) Punimi mëton të hedhë dritë mbi materialet e përgatitura për ligjërimit, respektivisht anën përmbajtjesore të tyre, në radhë të parë, por edhe aspektin teknik e artistik të tyre, gjëra këto me rëndësi në këtë fushë.

Rëndësia e hulumtimit

Rëndësia e këtij punimi qëndron në faktin se ai, mbase për herë të parë, ofron një trajtim kronologjik dhe gjithëpërfshirës të ligjërimit fetar në revistën “Dituria Islame”. Lexuesit, në përgjithësi, dhe ligjëruesit fetarë, në veçanti, për herë të parë mund të njihen me aspekte të ndryshme përkritazi me hytbet, si, fjala vjen, historikun e tyre, klasifikimin, vërejtjet dhe sugjerimet, gjëra këto që ndikojnë pozitivisht në përmirësimin dhe ngritjen e nivelit të ligjërimit tek ata. Punimi, ka rëndësi edhe për shkak se është pararendës dhe hapës i shtigjeve për trajtim të ligjërimit edhe në revista tjera fetare në gjuhën shqipe.

Metodologjia dhe skema e punimit

Metodologjia e ndjekur në këtë punim është kryesisht përshkruese. Hulumtimi ka mëtuar para së gjithash evidentimin e materialeve ligjëruese dhe rreth ligjërimit, për të bërë më pas analizimin e tyre dhe për të përcaktuar përmbushjen

e kriterëve përkatëse. Ai shtrihet në dy pjesë kryesore: pjesa e parë i dedikohet kornizës teorike për hytben ndërsa pjesa e dytë merret me hytbet e përgatitura, pra aspektin përmbajtjesor dhe teknik e artistik të tyre. Në fund fare kam përmbledhur rezultate dhe rekomandime përkatëse.

Allahun e lus të më shpërblejë për çdo të qëlluar ndërsa për gabime dhe lëshime i drejtohem me përrulësi që të më falë dhe mëshirojë!

I. Korniza teorike për hytben

I.1. Klasifikimi profesional i materialeve për hytben

Materialet që kanë trajtuar hytben nga perspektiva profesionale janë relativisht pak dhe, po kështu, janë të vonshme. Në fakt, nga materialet ekzistuese, vetëm njëri është shkruar para luftës dhe ai është përkthim nga gjuha boshnjake.³ Materialet e tjera i përkasin periudhës së pasluftës dhe janë publikuar në intervale të gjata kohore. Qasja e tyre ndaj hytbes është qasje bazike dhe plotësuese. Përveç tyre ekzistojnë edhe shkrime tjera që, me përmbajtjen e tyre, edhe pse jo të drejtpërdrejta, kontribuojnë në plotësimin e informacioneve rreth *Hytbes* dhe *Hatibit*.

3. Fjala është për artikullin “*Hytbeja-domethënia dhe karakteristikat themelore*” të Dr. Jusuf Ramiq, të publikuar në fillim të vitit 1991. Më shumë rreth këtij artikulli do të flasim në pikën që vijon.

Në vazhdim do të ofrojmë një klasifikim tematik të këtyre materialeve për të parë nga afër se deri në ç'nivel është trajtuar hytbeja nga aspekti teorik dhe profesional.

I.1.1. Materiale të drejtpërdrejta

Materialet që kanë trajtuar hytben në mënyrë të drejtpërdrejtë janë vetëm dy. Materiali i parë është përkthim nga gjuha boshnjake, ndërsa materiali tjetër është shkrim autorial. I pari është botuar në dekadën e parë të revistës (v. 1991), ndërsa i dyti në dekadën e dytë (1999). Edhe pse të përpiluar në pak faqe, artikujt ia kanë dalë të ofrojnë njohuri të mjaftueshme për hytben dhe këtë pothuajse në të gjitha fushat e saj.

Le të shohim më konkretisht një përmbledhje të shkrimeve në fjalë të radhitura sipas kohës së publikimit të tyre.

1) “Hytbeja-domethënia dhe karakteristikat themelore” – nga Prof. Dr. Jusuf Ramiq⁴

Artikulli në origjinal është në gjuhën boshnjake ndërsa në shqip është përkthyer nga hoxha Nexhat Ibrahim. Autori shihet ta këtë trajtuar fillimisht hytben në kuadër të hatabes – ligjërimit ose fjalimit si tërësi,⁵ rëndësinë e të cilës e sheh te

kumtimi i fesë. Pra ajo është mjet me të cilin Muhamedi a.s. që nga dita e dërgimit kumtoi fenë. Ndërsa për hytben, si formë e veçantë e ligjërimit, respektivisht hytbet e xhumasë dhe bajrameve, autori shpjegon të jetë praktikuar pas kalimit të Muhamedit a.s. në Medinë.

Përveç shpjegimeve që kanë të bëjnë me aspektin normativ të hytbes, autori merret edhe me interpretimin e hytbes. Ai na kujton se hytbeja duhet të mbahet në këmbë, zëri duhet të jetë tingëllues dhe i fuqishëm, dukja e ligjëruesit duhet të jetë e rregullt si dhe duhet të përdoret mimika. Kur flet për temat e hytbes, autori shpjegon se ato duhet ta përfshijnë Islamin si besim dhe sistem.

Me pak fjalë, artikulli ofron një përmbledhje të rëndësishme këshillash dhe mësimesh për hytben, të cilat ndikojnë fuqishëm në një hytbe të suksesshme.

2) “Hytbeja, vazi dhe vaizi” nga Hajrullah Hoxha⁶

Ky është artikulli i dytë që flet drejtpërdrejtë për hytben. Autori, siç mund të lexohet nga periodiku i publikimeve të tij, këtë temë e ka përpiluar si një lloj hyrje për hytbet e tij që do të pasojnë në numrat vijues. Ai ka ofruar një përmbledhje

në përgjithësi. Shih: Shelebi, Abdul Xhelil Abduhu. (1987) *El-Hatabetu ue i'dadu-l-Hatib*. Ed. 3. Kajro: Dar esh-shuruk, f. 13.

6. Nr. 111-112, v. 14, shtator-tetor 1999, f. 30-34.

të thukët dhe koncize rreth hytbes, gjegjësisht rreth llojeve, rëndësisë dhe rregullave përkatëse të saj. Ai e sheh hytben të rëndësishme për shkak se ajo, jo vetëm që është mjet i kumtimit të Islamit, por sepse, njëkohësisht, prej saj varet edhe pranimi i Islamit nga të tjerët. Përgjatë shtjellimit, vërehen porosi shumë profesionale të autorit, sidomos kur flet për temat e hytbes, ku jep tre këshilla të arta:

- trajtimin e Islamit në përgjithësi, duke filluar nga besimi, detyrimet fetare dhe sistemet e Islamit për shoqërinë

- trajtimin e gjërave sipas kohës dhe vendit të tyre

- fokusimi në drejtimin e “ehlu sunnet-it” gjatë shpjegimeve të çështjeve të besimit dhe medhhebin lokal gjatë shpjegimit të çështjeve të fikhut.

Autori gjatë trajtimit të hytbes insiston në ruajtjen e konceptit të saj, si në thelb – përmbajtje, si në interpretim. Më qartë, ai urren që hytbeja të kalojë nga një mjet të cilit – pas Allahut – i detyrohem për pranimin e kësaj feje nga shumë njerëz në një ambient hikajesh (tregimesh) e përrallash. Temat duhet të kenë ngjyrë realiteti dhe aktualiteti.

Çështje tjetër me rëndësi që ka trajtuar autori, e që nuk është në shkrimin paraprak, është edhe ajo e përkthimit të hytbes. Ai ka dhënë një përgjigje të balancuar dhe të arsyeshme. Nëse thotë me gojën

plot se duhet ta përkthejmë hytben patjetër që popullit t’i mësohet feja në tërësi, megjithatë, këtë e thotë vetëm për lëndën e shtjelluar, ndryshe, për pjesët bazë të hytbes, si në fillim, si në mbarim, mendon se duhet të ngelin në origjinal.

Artikulli, jo vetëm që ka plotësuar atë të mëparshmin, por ka ndriçuar edhe fusha tjera, duke u bërë kështu një prurje me rëndësi dhe peshë në fushën e përgatitjes profesionale për hytben.

I.1.2. Tema plotësuese

E veçantë e këtyre temave është se ato merren më shumë me temat e hytbeve dhe interpretimin e tyre sesa me aspektet tjera. Për këtë shkak janë klasifikuar si plotësuese. Janë gjithsej katër shkrime që trajtojnë këto aspekte të hytbes dhe, edhe këto sikur materialet e cituara në pikën paraprake, janë të publikuara në intervale kohore të ndryshme (1991, 2007, 2009 dhe 2014.) Dy shkrimet e para janë përkthime ndërsa dy shkrimet tjera janë autoriale.

1) “Namazi i ditës së premte”⁷

Shkrimi është përkthyer nga anglishtja. Emri i autorit nuk figuron ndërsa përkthyes në shqip është Nexhmedin Ramadani. Hytbeja është diskutuar si pikë e temës por me theks dhe rëndësi të veçantë. Në të është parashtruar nevoja e madhe e përgatitjes dhe arsimimit

7. Shih: Nr. 269, v. 6, shtator 1991, f. 16-18.

të ligjëruesve, ashtu siç është folur për natyrën e temave që duhen rrahur dhe ngjyrën e tyre aktuale e shoqërore. Në të është bërë thirrje që hytbeja të interpretohet me zë të bukur, të jetë tërheqëse si dhe të dominohet nga ngjyra fetare, respektivisht ajetet.

Në këtë shkrim një pjesë i është rezervuar edhe çështjes së përkthimit të hytbes, për çka jepen disa propozime dhe disa mënyra jashtë të cilave nuk mund të dilet, por duke u vënë theksi mbi propozimin e parë, sipas të cilit hytbeja fillohet në origjinal (arabisht) e pastaj shpjegohet në gjuhën përkatëse.

2) “Hytbeja e suksesshme” nga autori Muhamed Gazali⁸

Materiali në origjinal është në të vërtetë pjesë e hyrjes së një përmbledhjeje dyvëllimëshe me hytbe të Shejh Muhamed Gazalit, të cilën në shqip e solli Miftar Ajdini. Autori fillimisht flet për rëndësinë e hytbes dhe rolin e saj në ngritjen e vetëdijes dhe civilizimit të një populli. Për ta kryer këtë funksion, ai jep këshillat në vazhdim:

- Hytbeja të jetë e fokusuar rreth një teme,

- Sistemimi dhe radhitja e pjesëve të ligjëratës,

- Ngjyra fetare e argumenteve (ajete, hadithe, thënie nga të parët...),

- Shmangia e temave që nuk përçojnë mesazhe uniteti, bashkimi, paqeje, sepse ato nuk përkojnë me xhaminë dhe mesazhin e saj,

- Aktualiteti i hytbes, respektivisht trajtimi i çështjeve që prekin drejtpërdrejtë xhematin dhe interesat e tyre,

- Interpretimin e thellë dhe të synuar të teksteve, veçmas atyre që nuk kuptohen drejt nëse mjaftohet vetëm me citimin tekstual të tyre,

- Referimi shembujve të gjeneratave të para në dije dhe qytetërim, sepse kështu përshkruhet një e kaluar e lavdishme, sikurse edhe evidentohen aktorët që mund të na çojnë përpara si shoqëri e qytetërim,

- Gjatë trajtimit të rrymave dhe lëvizjeve të devijuara, imami duhet të mjaftohet me shpjegimin e konceptit të vërtetë islam, pra nuk duhet t'i referohet burimeve të rrymës apo lëvizjes por të prezantojë të vërtetat nga Kur'ani dhe Sunneti që besimtarëve t'iu ofrojë një koncept dhe imazh të qartë të temave/ problematikave që diskutohen,

- Ushtrimet para fjalimit, dhe këtë duke rishikuar përmbajtjen e ligjëratës, duke verifikuar tekstet dhe argumentet si dhe duke improvizuar mbajtjen e saj para xhematit,

- Reduktimi i hytbes në fjalët, fjalitë, konceptet dhe argumentet që i japin formë hytbes, pa u lëshuar në detaje të tepërta, që ndonjëherë, përveç monotonisë mund të shkaktojnë çrregullim të brendshëm të temës, respektivisht të thuhet gjërat që nuk janë të nevojshme dhe të harrohen ato që janë thelbësore.

8. Shih: Nr. 204-205, v. 21, korrik-gusht 2007, f. 28-29.

Ky material mund të thuhet lirisht se është një lloj kursi trajnues në distancë. Leximi i tij kohë pas kohe imamit i mundëson që të ruajë ritmin e një ligjëruesi të suksesshëm.

3) “Përsiatje rreth rëndësisë dhe rolit të hytbes në Islam”⁹

Artikulli është shkrim autorial nga Nexhat Ibrahim. Artikulli hapet me një përshkrim të rëndësisë së hytbes për të vazhduar më pas me disa këshilla e rekomandime të fuqishme që një ligjërues duhet t'i ketë në konsideratë. Autori veçon këto këshilla e udhëzime:

- Të kihet parasysh struktura e xhematit-audencës,

- Të përvetësohen metodat dhe mënyrat e komunikimit, që Hytbeja më pas të ketë efekt pozitiv,

- Shprehja e kontrolluar e emocioneve, respektivisht ta bëjë hytben këshillëdhënëse e përkujtuese.

Ky artikull është i një rëndësie të veçantë. Këshillat e tij janë aktuale dhe në hap me kohën. Autori synon që hytbes të mos i humbasë rëndësia që ka, pavarësisht zhvillimeve teknologjike. Hytbeja mund të vazhdojë të kryejë rolin e saj edukativ dhe fetar vetëm nëse imami shfaq vetëdije karshi përgjegjësisë së ngarkuar mbi supë dhe avancim të vazhdueshëm në përvetësimin e njohurive, shkathtësive dhe teknikave të suksesshme të komunikimit me njerëzit.

4) “Çfarë të ligjëroj në Hytben e xhumasë?”¹⁰

Autori i këtij shkrimi, Sedat Islami,¹¹ është fokusuar në disa kritere që ndikojnë në suksesin e imamit në përzgjedhjen e temës për hytben e tij. Fillimisht, ka folur për rëndësinë që ka performimi gjatë hytbes, për tu ndalur më pas te kriteret e përzgjedhjes së temës, respektivisht te roli dhe ndikimi i xhematit në përzgjedhjen që imami i bën temave të hytbes. Autori konsideron se imami duhet të jetë vigjilent dhe të përzgjedhë propozimet e qëlluara, që të mos injorojë tërësisht kërkesat e xhematit, por njëkohësisht duhet edhe të ketë pavarësinë që, si një edukator, të trajtojë temat e duhura dhe të nevojshme, qoftë edhe nëse ato duhen përsëritur.

Në fakt, ai sheh dy mënyra se si të përzgjidhen propozimet:

a. Mbledhja e propozimeve me qëllim klasifikimi. Autori i referohet një praktike të suksesshme të Këshillit të Përgjithshëm të Çështjeve Islame dhe Vakëfeve në EBA, dhe

b. Konsultimi të jetë në rrethe më të ngushta, madje xhemati të mos jenë fare pjesë e tyre. Propozimet duhet të trajtohen vetëm në forume hoxhallarësh, sepse kështu atyre do t'iu jepej ngjyrë më e theksuar profesionale.

9. Shih: nr. 232, v. 24, nëntor 2009. F. 18-19.

10. Shih: nr. 291, viti 28, nëntor 2014, f. 33-

35.

11. Autor edhe i këtij punimi.

I.1.3. Tema indirekte

Këto tema kanë trajtuar aspekte që lidhen në një formë ose në një tjetër me ligjërimin. Ato ndonjëherë i kushtohen thirrësit dhe përgatitjes së tij, herën tjetër fokusohen në ndonjë formë a mënyrë se si arrihet deri te dija, ashtu siç në shkrime të caktuara i përkujtohet përgjegjësia që ka edhe vigjilenca që duhet të ketë për detyrën e tij si prijës, etj.¹²

II. Hytbeja si material i shkruar

II.1. Hapësira kushtuar hytbeve

12. Shih: 'Roli i imanit në fsbat', Shefqet Qorolli, v.5, nr. 26, qershor 1991, f. 28-29; 'Roli i imanit në ditët e sotme', Bahri Curri, v.11, nr. 69, qershor 1995, f.20-21; 'Roli dhe rëndësia e shtypit në ushtrimin e detyrës së imanit', Miftar Ajdini, v.11, nr. 78, mars 1996, f. 45; 'Personaliteti i thirrësit islam', Sadik Mehmeti, v. 14, nr. 113-114, nëntor-dhjetor 1999, f. 27; 'Detyra e imanit mision i shenjtë', Sulejman Osmani, v.17, nr. 140, shkurt 2002, f. 46-48.; 'Roli i imanit në ruajtjen e unitetit në xhematin e veç', Qemajl Morina, v. 18, nr. 153 prill 2003, f. 45-46; 'Thirrësi islam', Bahri Simnica, v. 19, nr. 176-77, mars 2005, f. 6-18; 'Përgatitja e Thirrësit islam', Bahri Simnica, v. 19, nr. 178, maj 2005, f. 10-13; 'Thirrësi duhet të ketë besim të thellë në Allahun', Bahri Simnica, v. 19, nr. 179, qershor 2005, f. 11-13. Shkrime të Bahri Simnicës për thirrësin dhe të thirrurit shih edhe në numrat vijues: nr. 11-12, f. 11-12; nr. 13-14, f. 13-14; nr. 15-16, f. 15-16; nr. 17-18, f. 17-18; nr. 19-20, f. 19-20; nr. 21-22, f. 21-22; nr. 23-24, f. 23-24; nr. 25-26, f. 25-26; nr. 27-28, f. 27-28; nr. 29-30, f. 29-30; nr. 31-32, f. 31-32; nr. 33-34, f. 33-34; nr. 35-36, f. 35-36; nr. 37-38, f. 37-38; nr. 39-40, f. 39-40; nr. 41-42, f. 41-42; nr. 43-44, f. 43-44; nr. 45-46, f. 45-46; nr. 47-48, f. 47-48; nr. 49-50, f. 49-50; nr. 51-52, f. 51-52; nr. 53-54, f. 53-54; nr. 55-56, f. 55-56; nr. 57-58, f. 57-58; nr. 59-60, f. 59-60; nr. 61-62, f. 61-62; nr. 63-64, f. 63-64; nr. 65-66, f. 65-66; nr. 67-68, f. 67-68; nr. 69-70, f. 69-70; nr. 71-72, f. 71-72; nr. 73-74, f. 73-74; nr. 75-76, f. 75-76; nr. 77-78, f. 77-78; nr. 79-80, f. 79-80; nr. 81-82, f. 81-82; nr. 83-84, f. 83-84; nr. 85-86, f. 85-86; nr. 87-88, f. 87-88; nr. 89-90, f. 89-90; nr. 91-92, f. 91-92; nr. 93-94, f. 93-94; nr. 95-96, f. 95-96; nr. 97-98, f. 97-98; nr. 99-100, f. 99-100; nr. 101-102, f. 101-102; nr. 103-104, f. 103-104; nr. 105-106, f. 105-106; nr. 107-108, f. 107-108; nr. 109-110, f. 109-110; nr. 111-112, f. 111-112; nr. 113-114, f. 113-114; nr. 115-116, f. 115-116; nr. 117-118, f. 117-118; nr. 119-120, f. 119-120; nr. 121-122, f. 121-122; nr. 123-124, f. 123-124; nr. 125-126, f. 125-126; nr. 127-128, f. 127-128; nr. 129-130, f. 129-130; nr. 131-132, f. 131-132; nr. 133-134, f. 133-134; nr. 135-136, f. 135-136; nr. 137-138, f. 137-138; nr. 139-140, f. 139-140; nr. 141-142, f. 141-142; nr. 143-144, f. 143-144; nr. 145-146, f. 145-146; nr. 147-148, f. 147-148; nr. 149-150, f. 149-150; nr. 151-152, f. 151-152; nr. 153-154, f. 153-154; nr. 155-156, f. 155-156; nr. 157-158, f. 157-158; nr. 159-160, f. 159-160; nr. 161-162, f. 161-162; nr. 163-164, f. 163-164; nr. 165-166, f. 165-166; nr. 167-168, f. 167-168; nr. 169-170, f. 169-170; nr. 171-172, f. 171-172; nr. 173-174, f. 173-174; nr. 175-176, f. 175-176; nr. 177-178, f. 177-178; nr. 179-180, f. 179-180; nr. 181-182, f. 181-182; nr. 183-184, f. 183-184; nr. 185-186, f. 185-186; nr. 187-188, f. 187-188; nr. 189-190, f. 189-190; nr. 191-192, f. 191-192; nr. 193-194, f. 193-194; nr. 195-196, f. 195-196; nr. 197-198, f. 197-198; nr. 199-200, f. 199-200; nr. 201-202, f. 201-202; nr. 203-204, f. 203-204; nr. 205-206, f. 205-206; nr. 207-208, f. 207-208; nr. 209-210, f. 209-210; nr. 211-212, f. 211-212; nr. 213-214, f. 213-214; nr. 215-216, f. 215-216; nr. 217-218, f. 217-218; nr. 219-220, f. 219-220; nr. 221-222, f. 221-222; nr. 223-224, f. 223-224; nr. 225-226, f. 225-226; nr. 227-228, f. 227-228; nr. 229-230, f. 229-230; nr. 231-232, f. 231-232; nr. 233-234, f. 233-234; nr. 235-236, f. 235-236; nr. 237-238, f. 237-238; nr. 239-240, f. 239-240; nr. 241-242, f. 241-242; nr. 243-244, f. 243-244; nr. 245-246, f. 245-246; nr. 247-248, f. 247-248; nr. 249-250, f. 249-250; nr. 251-252, f. 251-252; nr. 253-254, f. 253-254; nr. 255-256, f. 255-256; nr. 257-258, f. 257-258; nr. 259-260, f. 259-260; nr. 261-262, f. 261-262; nr. 263-264, f. 263-264; nr. 265-266, f. 265-266; nr. 267-268, f. 267-268; nr. 269-270, f. 269-270; nr. 271-272, f. 271-272; nr. 273-274, f. 273-274; nr. 275-276, f. 275-276; nr. 277-278, f. 277-278; nr. 279-280, f. 279-280; nr. 281-282, f. 281-282; nr. 283-284, f. 283-284; nr. 285-286, f. 285-286; nr. 287-288, f. 287-288; nr. 289-290, f. 289-290; nr. 291-292, f. 291-292; nr. 293-294, f. 293-294; nr. 295-296, f. 295-296; nr. 297-298, f. 297-298; nr. 299-300, f. 299-300; nr. 301-302, f. 301-302; nr. 303-304, f. 303-304; nr. 305-306, f. 305-306; nr. 307-308, f. 307-308; nr. 309-310, f. 309-310; nr. 311-312, f. 311-312; nr. 313-314, f. 313-314; nr. 315-316, f. 315-316; nr. 317-318, f. 317-318; nr. 319-320, f. 319-320; nr. 321-322, f. 321-322; nr. 323-324, f. 323-324; nr. 325-326, f. 325-326; nr. 327-328, f. 327-328; nr. 329-330, f. 329-330; nr. 331-332, f. 331-332; nr. 333-334, f. 333-334; nr. 335-336, f. 335-336; nr. 337-338, f. 337-338; nr. 339-340, f. 339-340; nr. 341-342, f. 341-342; nr. 343-344, f. 343-344; nr. 345-346, f. 345-346; nr. 347-348, f. 347-348; nr. 349-350, f. 349-350; nr. 351-352, f. 351-352; nr. 353-354, f. 353-354; nr. 355-356, f. 355-356; nr. 357-358, f. 357-358; nr. 359-360, f. 359-360; nr. 361-362, f. 361-362; nr. 363-364, f. 363-364; nr. 365-366, f. 365-366; nr. 367-368, f. 367-368; nr. 369-370, f. 369-370; nr. 371-372, f. 371-372; nr. 373-374, f. 373-374; nr. 375-376, f. 375-376; nr. 377-378, f. 377-378; nr. 379-380, f. 379-380; nr. 381-382, f. 381-382; nr. 383-384, f. 383-384; nr. 385-386, f. 385-386; nr. 387-388, f. 387-388; nr. 389-390, f. 389-390; nr. 391-392, f. 391-392; nr. 393-394, f. 393-394; nr. 395-396, f. 395-396; nr. 397-398, f. 397-398; nr. 399-400, f. 399-400; nr. 401-402, f. 401-402; nr. 403-404, f. 403-404; nr. 405-406, f. 405-406; nr. 407-408, f. 407-408; nr. 409-410, f. 409-410; nr. 411-412, f. 411-412; nr. 413-414, f. 413-414; nr. 415-416, f. 415-416; nr. 417-418, f. 417-418; nr. 419-420, f. 419-420; nr. 421-422, f. 421-422; nr. 423-424, f. 423-424; nr. 425-426, f. 425-426; nr. 427-428, f. 427-428; nr. 429-430, f. 429-430; nr. 431-432, f. 431-432; nr. 433-434, f. 433-434; nr. 435-436, f. 435-436; nr. 437-438, f. 437-438; nr. 439-440, f. 439-440; nr. 441-442, f. 441-442; nr. 443-444, f. 443-444; nr. 445-446, f. 445-446; nr. 447-448, f. 447-448; nr. 449-450, f. 449-450; nr. 451-452, f. 451-452; nr. 453-454, f. 453-454; nr. 455-456, f. 455-456; nr. 457-458, f. 457-458; nr. 459-460, f. 459-460; nr. 461-462, f. 461-462; nr. 463-464, f. 463-464; nr. 465-466, f. 465-466; nr. 467-468, f. 467-468; nr. 469-470, f. 469-470; nr. 471-472, f. 471-472; nr. 473-474, f. 473-474; nr. 475-476, f. 475-476; nr. 477-478, f. 477-478; nr. 479-480, f. 479-480; nr. 481-482, f. 481-482; nr. 483-484, f. 483-484; nr. 485-486, f. 485-486; nr. 487-488, f. 487-488; nr. 489-490, f. 489-490; nr. 491-492, f. 491-492; nr. 493-494, f. 493-494; nr. 495-496, f. 495-496; nr. 497-498, f. 497-498; nr. 499-500, f. 499-500; nr. 501-502, f. 501-502; nr. 503-504, f. 503-504; nr. 505-506, f. 505-506; nr. 507-508, f. 507-508; nr. 509-510, f. 509-510; nr. 511-512, f. 511-512; nr. 513-514, f. 513-514; nr. 515-516, f. 515-516; nr. 517-518, f. 517-518; nr. 519-520, f. 519-520; nr. 521-522, f. 521-522; nr. 523-524, f. 523-524; nr. 525-526, f. 525-526; nr. 527-528, f. 527-528; nr. 529-530, f. 529-530; nr. 531-532, f. 531-532; nr. 533-534, f. 533-534; nr. 535-536, f. 535-536; nr. 537-538, f. 537-538; nr. 539-540, f. 539-540; nr. 541-542, f. 541-542; nr. 543-544, f. 543-544; nr. 545-546, f. 545-546; nr. 547-548, f. 547-548; nr. 549-550, f. 549-550; nr. 551-552, f. 551-552; nr. 553-554, f. 553-554; nr. 555-556, f. 555-556; nr. 557-558, f. 557-558; nr. 559-560, f. 559-560; nr. 561-562, f. 561-562; nr. 563-564, f. 563-564; nr. 565-566, f. 565-566; nr. 567-568, f. 567-568; nr. 569-570, f. 569-570; nr. 571-572, f. 571-572; nr. 573-574, f. 573-574; nr. 575-576, f. 575-576; nr. 577-578, f. 577-578; nr. 579-580, f. 579-580; nr. 581-582, f. 581-582; nr. 583-584, f. 583-584; nr. 585-586, f. 585-586; nr. 587-588, f. 587-588; nr. 589-590, f. 589-590; nr. 591-592, f. 591-592; nr. 593-594, f. 593-594; nr. 595-596, f. 595-596; nr. 597-598, f. 597-598; nr. 599-600, f. 599-600; nr. 601-602, f. 601-602; nr. 603-604, f. 603-604; nr. 605-606, f. 605-606; nr. 607-608, f. 607-608; nr. 609-610, f. 609-610; nr. 611-612, f. 611-612; nr. 613-614, f. 613-614; nr. 615-616, f. 615-616; nr. 617-618, f. 617-618; nr. 619-620, f. 619-620; nr. 621-622, f. 621-622; nr. 623-624, f. 623-624; nr. 625-626, f. 625-626; nr. 627-628, f. 627-628; nr. 629-630, f. 629-630; nr. 631-632, f. 631-632; nr. 633-634, f. 633-634; nr. 635-636, f. 635-636; nr. 637-638, f. 637-638; nr. 639-640, f. 639-640; nr. 641-642, f. 641-642; nr. 643-644, f. 643-644; nr. 645-646, f. 645-646; nr. 647-648, f. 647-648; nr. 649-650, f. 649-650; nr. 651-652, f. 651-652; nr. 653-654, f. 653-654; nr. 655-656, f. 655-656; nr. 657-658, f. 657-658; nr. 659-660, f. 659-660; nr. 661-662, f. 661-662; nr. 663-664, f. 663-664; nr. 665-666, f. 665-666; nr. 667-668, f. 667-668; nr. 669-670, f. 669-670; nr. 671-672, f. 671-672; nr. 673-674, f. 673-674; nr. 675-676, f. 675-676; nr. 677-678, f. 677-678; nr. 679-680, f. 679-680; nr. 681-682, f. 681-682; nr. 683-684, f. 683-684; nr. 685-686, f. 685-686; nr. 687-688, f. 687-688; nr. 689-690, f. 689-690; nr. 691-692, f. 691-692; nr. 693-694, f. 693-694; nr. 695-696, f. 695-696; nr. 697-698, f. 697-698; nr. 699-700, f. 699-700; nr. 701-702, f. 701-702; nr. 703-704, f. 703-704; nr. 705-706, f. 705-706; nr. 707-708, f. 707-708; nr. 709-710, f. 709-710; nr. 711-712, f. 711-712; nr. 713-714, f. 713-714; nr. 715-716, f. 715-716; nr. 717-718, f. 717-718; nr. 719-720, f. 719-720; nr. 721-722, f. 721-722; nr. 723-724, f. 723-724; nr. 725-726, f. 725-726; nr. 727-728, f. 727-728; nr. 729-730, f. 729-730; nr. 731-732, f. 731-732; nr. 733-734, f. 733-734; nr. 735-736, f. 735-736; nr. 737-738, f. 737-738; nr. 739-740, f. 739-740; nr. 741-742, f. 741-742; nr. 743-744, f. 743-744; nr. 745-746, f. 745-746; nr. 747-748, f. 747-748; nr. 749-750, f. 749-750; nr. 751-752, f. 751-752; nr. 753-754, f. 753-754; nr. 755-756, f. 755-756; nr. 757-758, f. 757-758; nr. 759-760, f. 759-760; nr. 761-762, f. 761-762; nr. 763-764, f. 763-764; nr. 765-766, f. 765-766; nr. 767-768, f. 767-768; nr. 769-770, f. 769-770; nr. 771-772, f. 771-772; nr. 773-774, f. 773-774; nr. 775-776, f. 775-776; nr. 777-778, f. 777-778; nr. 779-780, f. 779-780; nr. 781-782, f. 781-782; nr. 783-784, f. 783-784; nr. 785-786, f. 785-786; nr. 787-788, f. 787-788; nr. 789-790, f. 789-790; nr. 791-792, f. 791-792; nr. 793-794, f. 793-794; nr. 795-796, f. 795-796; nr. 797-798, f. 797-798; nr. 799-800, f. 799-800; nr. 801-802, f. 801-802; nr. 803-804, f. 803-804; nr. 805-806, f. 805-806; nr. 807-808, f. 807-808; nr. 809-810, f. 809-810; nr. 811-812, f. 811-812; nr. 813-814, f. 813-814; nr. 815-816, f. 815-816; nr. 817-818, f. 817-818; nr. 819-820, f. 819-820; nr. 821-822, f. 821-822; nr. 823-824, f. 823-824; nr. 825-826, f. 825-826; nr. 827-828, f. 827-828; nr. 829-830, f. 829-830; nr. 831-832, f. 831-832; nr. 833-834, f. 833-834; nr. 835-836, f. 835-836; nr. 837-838, f. 837-838; nr. 839-840, f. 839-840; nr. 841-842, f. 841-842; nr. 843-844, f. 843-844; nr. 845-846, f. 845-846; nr. 847-848, f. 847-848; nr. 849-850, f. 849-850; nr. 851-852, f. 851-852; nr. 853-854, f. 853-854; nr. 855-856, f. 855-856; nr. 857-858, f. 857-858; nr. 859-860, f. 859-860; nr. 861-862, f. 861-862; nr. 863-864, f. 863-864; nr. 865-866, f. 865-866; nr. 867-868, f. 867-868; nr. 869-870, f. 869-870; nr. 871-872, f. 871-872; nr. 873-874, f. 873-874; nr. 875-876, f. 875-876; nr. 877-878, f. 877-878; nr. 879-880, f. 879-880; nr. 881-882, f. 881-882; nr. 883-884, f. 883-884; nr. 885-886, f. 885-886; nr. 887-888, f. 887-888; nr. 889-890, f. 889-890; nr. 891-892, f. 891-892; nr. 893-894, f. 893-894; nr. 895-896, f. 895-896; nr. 897-898, f. 897-898; nr. 899-900, f. 899-900; nr. 901-902, f. 901-902; nr. 903-904, f. 903-904; nr. 905-906, f. 905-906; nr. 907-908, f. 907-908; nr. 909-910, f. 909-910; nr. 911-912, f. 911-912; nr. 913-914, f. 913-914; nr. 915-916, f. 915-916; nr. 917-918, f. 917-918; nr. 919-920, f. 919-920; nr. 921-922, f. 921-922; nr. 923-924, f. 923-924; nr. 925-926, f. 925-926; nr. 927-928, f. 927-928; nr. 929-930, f. 929-930; nr. 931-932, f. 931-932; nr. 933-934, f. 933-934; nr. 935-936, f. 935-936; nr. 937-938, f. 937-938; nr. 939-940, f. 939-940; nr. 941-942, f. 941-942; nr. 943-944, f. 943-944; nr. 945-946, f. 945-946; nr. 947-948, f. 947-948; nr. 949-950, f. 949-950; nr. 951-952, f. 951-952; nr. 953-954, f. 953-954; nr. 955-956, f. 955-956; nr. 957-958, f. 957-958; nr. 959-960, f. 959-960; nr. 961-962, f. 961-962; nr. 963-964, f. 963-964; nr. 965-966, f. 965-966; nr. 967-968, f. 967-968; nr. 969-970, f. 969-970; nr. 971-972, f. 971-972; nr. 973-974, f. 973-974; nr. 975-976, f. 975-976; nr. 977-978, f. 977-978; nr. 979-980, f. 979-980; nr. 981-982, f. 981-982; nr. 983-984, f. 983-984; nr. 985-986, f. 985-986; nr. 987-988, f. 987-988; nr. 989-990, f. 989-990; nr. 991-992, f. 991-992; nr. 993-994, f. 993-994; nr. 995-996, f. 995-996; nr. 997-998, f. 997-998; nr. 999-1000, f. 999-1000; nr. 1001-1002, f. 1001-1002; nr. 1003-1004, f. 1003-1004; nr. 1005-1006, f. 1005-1006; nr. 1007-1008, f. 1007-1008; nr. 1009-1010, f. 1009-1010; nr. 1011-1012, f. 1011-1012; nr. 1013-1014, f. 1013-1014; nr. 1015-1016, f. 1015-1016; nr. 1017-1018, f. 1017-1018; nr. 1019-1020, f. 1019-1020; nr. 1021-1022, f. 1021-1022; nr. 1023-1024, f. 1023-1024; nr. 1025-1026, f. 1025-1026; nr. 1027-1028, f. 1027-1028; nr. 1029-1030, f. 1029-1030; nr. 1031-1032, f. 1031-1032; nr. 1033-1034, f. 1033-1034; nr. 1035-1036, f. 1035-1036; nr. 1037-1038, f. 1037-1038; nr. 1039-1040, f. 1039-1040; nr. 1041-1042, f. 1041-1042; nr. 1043-1044, f. 1043-1044; nr. 1045-1046, f. 1045-1046; nr. 1047-1048, f. 1047-1048; nr. 1049-1050, f. 1049-1050; nr. 1051-1052, f. 1051-1052; nr. 1053-1054, f. 1053-1054; nr. 1055-1056, f. 1055-1056; nr. 1057-1058, f. 1057-1058; nr. 1059-1060, f. 1059

Ja disa prej këtyre rubrikave: *njohuri islame*¹⁴, *akaid*¹⁵, *mesazhe*¹⁶, *etikë*¹⁷, *edukatë islame*¹⁸, *moral*¹⁹,

*ablak*²⁰, *familjare*²¹, *pikëpamje*²², *qasje*²³, *vështrim*²⁴, *reflektim*²⁵, *aktualitet*²⁶, *mesazhe*²⁷, etj.

Tema të këtilla mund të gjesh absolutisht në çdo numër të revistës “Dituria Islame”. Madje, në disa numra, mund të gjesh një numër të gjerë temash të kësaj natyre.²⁸

14. Përveç aspektit tematik të ngjashëm, fakt tjetër që më ka bërë të bindem për këtë dhe të cilin e kam hasur nëpërmjet vëzhgimit të temave, është edhe ky i kësaj rubrike. Që nga numrat e parë, autori i kësaj rubrike Avni Aliu [*rabmet pastë*], ishte pothuajse autor i rregullt i hytbeve. Më vonë, duke filluar nga numri 18 i vitit të pestë të revistës, ai merr këtë rubrikë, duke bërë që rubrika e hytbeve të mungojë. Shih: ‘*Dini islam – formulë jetë*’, v. 5, nr. 18, tetor 1990, f. 3-4; ‘*Njeriu dhe personaliteti i tij në Islam*’, v. 5, nr. 19, nëntor 1990, f. 25-27; ‘*Islami dhe përgjegjësia*’, v.5, nr. 20, dhjetor 1990, f. 28-30, etj. Rubrika ka vazhduar edhe në numra tjerë me autorë tjerë. Shih temën: ‘*Rruga e qëlluar dhe rruga e gabuar*’, nga Sherif Ahmeti, v. 5, nr. 22-23, mars 1991, f. 10-13. Në këtë numër, për hir të korrektësisë, figuron një hytbe nga Zekerija Bajrami, sikur që në numra tjerë, krahas kësaj rubrike mund të gjesh edhe rubrikën e hytbeve.

15. Shih temat: ‘*Vlera e duase*’, nr. 210, v. 21, janar 2008, f. 24-26; ‘*Burimet e forcës tek besimtari*’ nr. 210, v. 21, janar 2008, f. 27-29; ‘*Adhurimi*’, nr. 213, v. 21, maj 2008, f. 20-21;

16. Shih mesazhin e Jetish Bajramit, (ish) kryetar i BI-së, nr. 15-16, viti 5, korrik 1990, f. 6-7.

17. Shih temat: ‘*Morali islam bazament për ngritjen e civilizimit njerëzor*’, v. 21, nr. 212, mars 2008, f. 24-26; ‘*Përgojimi, ves i keq*’, nr. 291, viti 28, nëntor 2014, f. 22-24.; ‘*Raporti i njeriut ndaj Krijuesit*’, nr. 210, v. 21, janar 2008, f. 33-34.

18. Shih temën: ‘*Morali fetar – bazë për ekzistencën e shoqërisë njerëzore*’ nr. 100, v. 13, shkurt 1998, f. 39-41.; ‘*Të rinjtë dhe feja*’, nr. 52, viti 9, tetor 1993, f. 10-11.

19. Shih temën: ‘*Përfitimi i moralit*’, nr. 307, v. 29, prill 2016, f. 27-29.

20. Shih temën: ‘*Modestia*’, viti 21, nr. 212, mars 2008, f. 31-33; ‘*Përkujtimi i Allahut*’, nr. 269, v. 26, dhjetor 2012, f. 25-26; ‘*Vlera e punës në fenë islame*’, v. 24, nr. 227, qershor 2009, f. 28-30.

21. Shih temën: ‘*Pasojat e mosrespektimit të prindërve*’, v. 26, nr. 165-166, gusht-shtator 2012, f. 38-41.

22. Shih temën: ‘*Besimi të bën të moralshëm*’, nr. 129-130, v. 16, mars-prill 2001, f. 29.

23. Shih temën: ‘*Kur’ani dhe ne – sa i ngjasojmë atij?*’, v. 21, nr. 218, nëntor 2008, f. 23-25.; ‘*Pse janë të prapambetur muslimanët?*’, v. 21, nr. 212, mars 2008, f. 27-30.; ‘*Respektojmë kufijtë e Allahut*’, v. 24, nr. 227, qershor 2009, f. 36-37.; ‘*Qëndrimi islam karsbi terrorizmit*’, nr. 210, v. 21, janar 2008, 30-32;

24. Shih temën: ‘*Pse vonohet ndihma e Allahut?*’, v. 24, nr. 227, qershor 2009, f. 42-43.; ‘*Të drejtat dhe pozita e femrës në Islam*’, v. 21, nr. 211, shkurt 2008, f. 44-45.; ‘*Sistemi moral i Islamit*’, v. 5, nr. 25, maj 1991, f. 14-16.

25. Shih temën: ‘*Myslimani në kobë dhe marginalizimi eventual i sistemit hyjnor*’, nr. 186-187, viti 20, janar-shkurt, 2006, f. 13-17

26. Shih temën: ‘*Frika nga Allahu Fuqiplotë*’, nr. 307, v. 29, prill 2016, f. 19-21.

27. Shih temën: ‘*Dita e Ashurasë*’, nr. 210, v. 21, janar 2008, f. 19-23.

28. P.sh. nr. 186-187, viti 20, janar-shkurt, 2006, ka këto tema në këto rubrika që lirisht mund të përdoren me pak modifikime si hytbe: edukatë: ‘*Xhama dhe mesazhi i saj*’, f. 10-12; *reflektim*: ‘*Myslimani në kobë dhe marginalizimi eventual i sistemit hyjnor*’, f. 13-17; edukatë: ‘*Islami fton për bashkëpunim dhe mirëkuptim*’, f. 18; qasje: ‘*Viti i ri mysliman*’

II.2. Ndarja e hytbeve

II.2.1. Ndarja e hytbeve sipas kategorisë

1) Hytbe të manifestimeve qendrore

Këto janë hytbe të mbajtura kryesisht nga autoritetet më të larta të Bashkësisë Islame të Kosovës.²⁹ Hytbet zakonisht janë në fillim të numrit, por ka raste kur këto hytbe janë të vendosura në fund të numrit fare.³⁰

Po kështu, këtu mund të vërehen edhe hytbe të autoriteteve më të larta të kohës së ish-Jugosllavisë, respektivisht të Reis-ul-Ulema-së³¹ që janë të përkthyer në shqip ose janë marrë nga autorë shqiptarë jashtë trojeve tona.³²

2) Hytbe të rregullta brenda rubrikës së revistës, për të cilat do të bëjmë fjalë te hytbet serike.

3) Hytbe me shkas, të cilat janë shkruar përkritazi me ngjarje, zhvillime dhe data të caktuara.³³

ofron mundësi për pendim, f. 19-20; ahlak: *'Mendjemadbësia'*, f. 21-22; ahlak: *'Normat dhe vlerat në Islam'*, f. 23-26; ahlak: *'Mesazhi islam – fe për të gjithë'* f. 47-50.

29. Shih nr. 15-16, viti 5, korrik 1990, f. 6-7.

30. Për këtë do të flasim në pjesën që kemi rezervuar për kritikë.

31. Shih nr. 15-16, viti 5, korrik 1990, f. 5-6.

32. Shih hytbeja e Fitër Bajramit nga Imam Vehbi Ismaili, imam në Amerikë, nr. 36, viti 6, prill 1992, f. 5-6.

33. Shih sa për ilustrim: *'Muhammedi alejhiselam – lindja dhe jeta e tij'*, v. 14, nr. 119-120, mars-qershor 2000, f. 21-24.; *'Hixhreti*

II.2.2. Ndarja e Hytbeve sipas autorësisë:

1) Hytbe autoriale. Hytbe të kësaj natyre janë shumica absolute.

2) Hytbe të përkthyer. Hytbe të kësaj natyre ka fare pak.³⁴

II.2.3. Ndarja e hytbes sipas temës

1) Hytbe serike.

Rëndësia e këtyre hytbeve është se ato janë hytbe të përgjithshme, që kurdo që të mbahen, kanë vendin dhe rëndësinë e tyre. Hytbe të këtilla ka, madje që nga fillimi. Gjithsej kemi arritur të evidentojmë pesë seri:

a. Seria e namazit nga Avni Aliu.³⁵

b. Seri hytbesh për besimin nga Hajrullah Hoxha³⁶

– shpërngulja e Muhammedit alejhiselam', v. 19, nr. 174-175, janar-shkurt 2005, f. 14-17.; *'Hytbeja e të drejtave të punëtorëve'*, v.21, nr. 213, maj 2008, f. 25-27.; *'Madhbështia e ezanit'* nr. 235, v. 25, shkurt 2010, f. 28-30. *'Qëndrimi i besimtarit karshi fatkeqësive natyrore'*, nr. 269, v. 26, dhjetor 2012, f. 27-28.

34. Si shembuj do të veçoja këto dy hytbe: *'Prindërit dhe fëmijët'*, v. 4, nr. 13-14, prill-shtator 1989, f. 11-13.; *'Meritat e muajit Ramazan'*, Dr. JusufKardavi, v. 20, nr. 194, shtator 2006, f. 16-19.

35. Shih hytbet në: nr. 1, v. 1, shtator 1986, f. 17-18.; v. 2, nr. 4-5, janar-qershor, f. 31-32; v. 2, nr. 6, korrik-shtator 1987, f. 22-23.

36. Shih hytbet në numrat: v. 16, nr. 127-128, janar-shkurt 2001, f. 17-20.; v. 16, nr. 132, qershor 2001, f. 20-22.; v. 16, nr. 138, dhjetor 2001, f. 14-16.; v. 17, nr. 140, shkurt 2002, f. 14-18.; v. 18. nr. 150, janar 2003, f.

c. Seria për robërit e singqertë të Allahut nga Sedat Islami³⁷

d. Seria për *premtimet hyjnore për besimtarët* nga Sedat Islami³⁸

e. Seria për *shembulli i besimtarit* nga Sedat Islami³⁹

2) Hytbe të lira.

Janë hytbe që nuk janë pjesë e përhershme e rubrikës së Hytbeve në diturinë islame. Hytbe të këtilla ka shumë.⁴⁰

40-42.; v. 18, nr. 163, shkurt 2004, f. 23-25.; v. 18, nr. 165, prill 2004, f. 15-18.; v. 18, nr. 170-171, shtator-tetor 2004.; v. 18, nr. 172, nëntor 2004, f. 15-18.; v. 18, nr. 173, dhjetor 2004, f. 16-19.; v. 19, nr. 176-177, mars 2005, f. 19-21.; v. 19, nr. 178, maj 2005, f. 14-17.; v. 19, nr. 185, dhjetor 2005, f. 24-27.; v. 20, nr. 190, maj 2006, f. 13-15.; v. 19, nr. 201, prill 2007, f. 18-21.

37. Shih numrat: nr. 236, v. 25, mars 2010, f. 20-21; nr. 238, v. 25, maj 2010, f. 17-18.; nr. 239, v. 25, qershor 2010, f. 16-18.; nr. 242, v. 25, shtator 2010, f. 21-22; nr. 243, v. 25, tetor 2010, f. 16-18; nr. 245, v. 25, dhjetor 2010, f. 18-20; nr. 246, v. 25, janar 2011, f. 20-22.; nr. 247, v. 25, shkurt 2011, f. 17-19.; nr. 250, v. 25, maj 2011; nr. 251-252, v. 25, qershor-korrik 2011, f. 9-11; nr. 255, v. 25, tetor 2011, f. 15-17.

38. Shih numrat: nr. 253, v. 25, gusht 2011, f. 25-27. ‘nr. 257, v. 25, dhjetor 2011, f. 15-16.; nr. 258, v. 25, janar 2012, f. 24-26; nr. 260, v. 25, mars 2012, f. 17-19.; nr. 263, v. 25, qershor 2012. f. 25-27.; nr. 265-266, v. 26, gusht-shtator 2012, f. 20-22; nr. 267, v. 26, tetor 2012; f. 32-33.; nr. 268, v. 26, nëntor 2012, f. 20-21.

39. Janë botuar vetëm dy tema nga kjo seri: ‘Besimtari sikur qitro’, nr. 284, viti 27, mars 2014, f. 34-37.; ‘Besimtari sikur njeriu i gjallë’, nr. 286, viti 27, maj 2014, f. 36-37.

40. Shih hytbet: ‘Alkooli, e keqe e madhe në jetën

II.2.4. Kritikë

II.2.4.1. Mungesa e vazhdimet me trajtesa shkencore të zgjeruara

Megjithëse ka tema që kanë rrahur hytben nga aspekti teorik goxha mirë, prapë nevoja për të vazhduar me tema profesionale për hytben ndihet. P.sh. në asnjërën prej punimeve, qoftë këto bazë, plotësuese apo të tjera, nuk është diskutuar për mënyrën praktike të përgatitjes së hytbes. Ndonjëherë, megjithëse është rrahur si çështje, ligjëruesi mund të ketë para vetes referenca të shumta, por kjo nuk garanton sukses përderisa ai nuk di si t’i përdorë ato, si të përfitojë prej tyre, si t’i radhisë brenda hytbes së tij.

e përditshme’, v. 21, nr. 218, nëntor 2008, f. 26-27.; ‘Pasojat e devijimit moral’, nr. 270, v. 26, janar 2013, f. 20-22.; ‘Padrejtësia ndaj njerëzve-kejo vepër e shëmtuar’, nr. 271, v. 26, shkurt 2013, f. 16-18.; ‘Rëndësia e fitimit ballall të pasurisë’, nr. 272, v. 26, mars 2013, f. 17-18.; ‘Turpi dhe rëndësia e tij në jetën e besimtarit’, nr. 273, v. 26, prill 2013, f. 19-20.; ‘Falënderimi për mirësitë’, nr. 274, v. 26, maj 2013, f. 24-26.; ‘Paragjykimet rreth Islamit’, nr. 277-278, v. 27, gusht-shtator 2013, f. 19-21.; ‘Reflektime të përqendrimit në fe në jetën e besimtarit’, nr. 280, v. 27, nëntor 201, f. 22-23.; ‘Sprovat e kohës së fundit’, nr. 281, v. 27, dhjetor 2013, f. 13-14.; ‘Përse adhurimi në kohë krizash është zgjidhja më e mirë?’ nr. 296, viti 28, prill 2015, f. 28-30.; ‘Hytbeja e Pejgamberit alejhiselami’, v. 19, nr. 179, qershor 2005, f. 16-17, etj.

II.2.4.2. Mungon aspekti artistik dhe teknik

Ndonëse jo gjithnjë dhe në çdo numër, aspekti teknik dhe artistik i hytbes mungon. Me aspektin teknik kam për qëllim hyrjen në arabisht, e cila, siç pamë edhe nga shtjellimet, është shumë me rëndësi. Ndërsa me aspektin artistik kam për qëllim shoqërimin e materialit të shkruar me imazhe përkatëse. Mungesa e këtyre elementeve theksohet veçmas në numrat e viteve të fundit.

Si tjetër vërejtje në këtë aspekt është edhe mungesa e klasifikimit dhe radhitjes së hytbeve zyrtare në vendin e përshtatshëm. Është vënë re herë pas here zhvendosja e hytbes nga fillimi i numrit në mes ose në fund fare.⁴¹ Kjo, edhe pse ka ndodhur rrallë, megjithatë ka qenë diçka që një lexuesi ia vret syrin, sidomos për faktin se hytbeja është mesazhi më i rëndësishëm që lexohet nga figura qendrore e myslimanëve të vendit.

Probleme me klasifikimin shfaqen edhe herëve tjera kur tema, jo vetëm që është hytbe, por është edhe në kuadër të ndonjë serie të caktuar, ndërsa nuk figuron si hytbe.⁴²

41. Si shembuj shih hytbet në numrat: nr. 129-130, mars-prill 2001, f. 64-65; nr. 160-161, nëntor-dhjetor 2003, f. 65; nr. 207, v. 21, tetor 2007, f. 50.; v. 16, nr. 243, v. 25, tetor 2010, f. 48; nr. 257, v. 25, dhjetor 2011, f. 52; nr. 268, v. 26, nëntor 2012, f. 49-50.; v. 18, nr. 257, v. 25, dhjetor 2011, f. 52.

42. Shih hytben: *'Frika nga zjarri i Xhebenemil'*, e cila është në kuadër të serisë

II.2.4.3. Mungojnë hytbet e numrave me temë të caktuar

Në revistë nuk i është kushtuar rëndësi që të ketë hytbe për numra me temë të caktuar. Edhe pse ka raste kur numri me temë të caktuar ka edhe hytben përkatëse⁴³, gjë që na bën të besojmë se këto vërejtje që po japim janë me vend për shkak se janë anashkaluar praktika të revistës. Dhe këtu kemi të bëjmë me dy vërejtje kryesore:

a. Mungesa e temës për numrin përkatës⁴⁴ duke ndodhur madje që të jetë shkëputur hytbeja në këta numra me temë të caktuar qëllimshëm për faktin se në numrat paraprak dhe në numrat e mëvonshëm ka hytbe.⁴⁵

b. Ekziston temë por që nuk lidhet me numrin,⁴⁶ por kjo nuk ndodh shpesh.

'Robërit e sinqertë të Allahut', nr. 242, v. 25, shtator 2010, f. 21-22.

43. P.sh. nr. 115-116, v. 14, janar-shkurt 2000, është për Haxhin dhe në të ka një hytbe për Haxhin. Numri 148, viti 17, tetor 2002, i është kushtuar ramazanit dhe aty ka një hytbe për agjërimin.

44. P.sh. numri 222, v. 22, janar 2009, është për Hixhretin ndërsa nuk ka hytbe; nr. 256, v. 25, nëntor 2011, është për Haxhin, hytbe nuk ka; nr. 276, v. 27, korrik 2013, nuk ka hytbe ndërsa tema është për Ramazan, etj.

45. P.sh. nr. 264 ka qenë numër për ramazan, në numrin para tij ka hytbe, sikur që edhe në numrin pas tij.

46. P.sh. numri 296, (viti 28, prill 2015) i cili i është kushtuar Israsë dhe Miraxhit ndërsa nuk ka hytbe për Isranë por për adhurimin (f. 28-30), i cili ka vetëm lidhje indirekte me temën e numrit.

II. 2.4.4. Shkëputjet ndërmjet temave të hytbeve serike

Është vënë re te hytbet serike intervali kohor i gjatë ndërmjet publikimit të tyre. Kjo sigurisht e gjymton mesazhin e hytbes serike dhe e minimizon efektin edukativ të saj.

Përfundim

Përmbyllja e këtij punimi nënvizon rezultatet kryesore të tij si dhe disa rekomandime përkatëse. Sa i përket rezultateve, ato janë:

1) “Dituria Islame” ka kryer dhe vazhdon ta kryejë rolin e saj në përgatitjen profesionale të imamëve. Kjo shihet nga temat që diskutohen. Në këtë drejtim, ajo ka luajtur dhe vazhdon të luajë rol të rëndësishëm edhe në përgatitjen e përket ligjërimit si koncept e art.

2) Materialet e ofruara për kornizën teorike të hytbes, edhe pse numerikisht nuk janë shumë, ato janë të shkruara asisoj që, edhe në rrafshin kohor por edhe në atë përmbajtjesor, plotësojnë njëra tjetrën, duke na ofruar kështu njohuri që mundësojnë perfeksionimin e artit të ligjërimit në vazhdimësi.

3) “Dituria Islame” ia ka dalë të mbulojë boshllëkun e publicistikës fetare, duke u ofruar imamëve asistencë dhe mbështetje me tema me vlerë për derset, vazet dhe hytbet e tyre.

Ndërsa sa i përket rekomandimeve, do të veçojmë:

1) Të vazhdohet me trajtimin e hytbes nga aspekti profesional i saj, pasi mungojnë aspekte të pashtjelluara

të saj. Janë përshkruar disa gjëra në vija të trasha se duhet të jenë kështu e ashtu por aspekti praktik i tyre se si vihet deri tek ato mungon. Kjo mund të bëhet me vazhdimin e një tradite të vjetër të organizimit të seminareve me imamë ku praktikisht do të shtjelloheshin këto tema.

2) Hytbeja të ngelë rubrikë e përhershme në revistë dhe këshilli redaktues të ngarkojë njërin prej anëtarëve që në vazhdimësi të përkujdeset për këtë rubrikë. Pra, të mos ngelë rubrikë vullnetare, sepse, siç është vënë re, ka pasur shkëputje jo vetëm të rubrikës si rubrikë, por edhe brenda ndonjë serie të caktuar vëren distancë të gjatë kohore të publikimit të temave, gjë që të bën të bindesh për mungesën e seriozitetit tek autorët.

3) T’i kushtohet rëndësi hytbeve për numra me temë të caktuar. Është vënë re mungesa e hytbes në numra të tillë edhe pse ka tema të tjera të shumta. Do të kishte qenë mirë, madje, që në numra të caktuar për Ramazanin dhe Haxhin të publikohen edhe hytbe nga arkiva që i shërbejnë imamëve për tërë muajin. Ashtu siç do të ishte mirë të publikoheshin edhe hytbe të manifestimeve për Fitër dhe Kurban Bajram. Kjo⁴⁷ është vënë re në një rast dhe besoj se do të ishte e dobishme që imamëve t’i ofrohej hytbeja paraprakisht. Kjo, po kështu mund të përzgjidhet nga arkiva e hytbeve zyrtare të BIK-së.

4) T’i kushtohet rëndësi aspektit teknik dhe artistik të hytbes, gjë kjo që ka qenë por është neglizhuar.

47. Shih nr. 125, v. 15, nëntor 2000, f. 18.

Hafiz Sabri Beg Bushati – personalitet i admirueshëm e frymëzues i Shkodrës

**Prof. dr. Sadije Bushati
Universiteti “Luigj Gurakuqi”
Fakulteti Ekonomik Shkodër**

Abstrakt

Cilësitë e rralla morale të hafizit, përkushtimi i plotë fetar e shoqëror, kultura e përgjithshme dhe përgatitja profesionale, atdasheduria dhe integriteti i tij politik, detyrat serioze e me përgjegjësi, si ajo e imamit, e myderrizit, e vajzës dhe e kryemyftiut dinjitoz, pa lënë mënjane impenjimin në rolin me aq përgjegjësi historike për konsolidimin e shtetit shqiptar, për ruajtjen e tërësisë tokësore e zhvillimin e demokracisë, si pjesëmarrës i Kongresit të Lushnjës, e si anëtar i Senatit, bënë që lidhjet e tij miqësore të shtriheshin edhe jashtë rrethit të hoxhallarëve, duke krijuar kështu një “ansambël” dashamirësish, si me intelektualët: Hamit Gjylbegaj, Hamdi Bushati, Riza Drini etj., apo me përfaqësues të familjeve me tradita të vjetra: Selim Reçi, Oso Koplaku, Mubo Kazazi, Junuz Boriçi, Nuto Podgorica, Elez Muka, Ymer Lutfia, Caf Reçi, Elez Sokoli, Et’hem Koplaku, Riza Kaduku.

Hafiz Sabri Beg Bushati, i njohur edhe me emrin Ejup Sabri, trashëgimtar i bushatlinjve të Shkodrës, që i takon degëzimit të trungut me fillesë Hysen Pashën,

nip i Ali Beut të Beqir Beut; djali i Shabanit, lindi në Shkodër në vitin 1889. Ai u shqua jo vetëm si klerik, por edhe si personalitet publik e përfaqësues i qytetarisë shkodrane. I paraqitshëm, karizmatik, me trup



të gjatë e elegant, atdhedashës, i ndershëm dhe i nderuar për aftësi, me karaktere i përkushtuar, krijoi në vetvete një personazh të respektuar “nga i madh e i vogël”, siç thuhet në Shkodrën tonë. Nga ky degëzim i pemës së bushatllinjve¹, janë shquar luftëtarët e patriotët si Beqir Beu, dëshmor në luftën e I të Shpuzës me 1840, Ali Beu që mbas kryengritjes së vitit 1833, së bashku me kushëririn e vet Jusuf Beun, formuan organin qeverisës, që administroi qytetin për një muaj, derisa qeveria osmane pranoi kushtet e kryengritësve; po ky Ali Beu, përfaqësoi Shkodrën në Këshillin e Përgjithshëm të Lidhjes në Prizren; Malo Bej Bushati, si komandant i Xhandarmërisë shqiptare dhe që më vonë, pengoi veprimin e D’Annuncios për sjellje armësh; Nusho Beu i Ulqinit; pastaj politikani Maliq Bushati deri

1. “Bushatllinjët” Hamdi Bushati, f.366-369.

Kryeministër,²; klerikët H. Halit Bushati, Molla Rustem Bushati dhe më vonë, dëshmor i luftës nacional-çlirimtare Nuri Bushati etj.³

Hafiz Begu, në moshën 3 vjeçare mbetet jetim nga nëna, e cila ndërroi jetë gjatë një lindjeje, ngjarje që ndoshta influençoi për formimin e karakterit të fortë të Hafiz Sabrisë, por që në raste të veçanta, thyhej dhe derdhte lotë.

Në fëmijëri ndoqi mejtepin e Hafiz Isuf Kelmendit dhe më pas medresenë e lagjes Qafë, kjo e fundit institucioni arsimor më i vjetër në Shkodër, në periudhën e sundimit turk.⁴ Aty shquhet si nxënës i aftë dhe sapo përfundon studimet në medrese, vazhdon studimet e larta fetare në Stamboll. Për shkak të fillimit të luftës Ballkanike, ngaqë ishte i pajisur me ndjenja atdhetare të theksuara, ndërpret studimet dhe hyn si vullnetar në grupimin luftarak, që ndodhej te kodra e Boksit. Qëndron pak ditë; në këtë kohë martohet me Nadire Bushatin, motra e Xhemal Bushatit, edhe këta bushatllinj, por nga dega e Vishobegëve dhe nga kjo martesë lindi Samija. Kur e bija bëhet 5 vjeçe, Hafizi humb bashkëshorten nga gripi spanjoll. Samija, kujtonte deri në pleqëri se kur ishte e vogël, i ati e merrte në prehër dhe shpesh herë ai përlostej. Ajo mendonte

2. “Bushatllinjët” Hamdi Bushati, f.366-369.

3. Të dhëna gojore e me shkrim nga familja e farefisi.

4. “Shkodra dhe motet” Hamdi Bushati, vëll. I, f.359-368; 477.

se kjo gjendje shkaktohej ngaqë edhe ajo kishte pësuar të njëjtin fat; kishte mbetur jetime nga nëna. Ai duhej të ndjente dhembshuri të shumëfishtë, për të ëmën, për të shoqen, për veten dhe për të bijën.

Mbas vdekjes së Nadires, Hafizit i propozohet martesë me motrën tjetër të Xhemalit, Merjemen, për të rritur me përkujdesje mbesën 5-vjecare, Samijen. Nga kjo martesë lindën shumë fëmijë, por jetuan e krijuan familje vetëm tre, Vahidi, Hasani dhe Hadija, me diferenca 9 vjeçare nga njëri tjetri.

Krijimi i familjes dhe rrethanat historike bënë që në pranverën e vitit 1913, Hafizi të rifillojë studimet teologjike në vend, duke pasur si pedagogë emra të njohur si H. H. Jusuf Kelmendi, Tahir Myftija dhe personalitetin e shquar Haxhi Vehbi Dibra, nga i cili edhe u diplomua e fitoi titullin Myderriz.

Fillon menjëherë punën si myderriz dhe përgatit disa hoxhallarë të rinj, të njohur të qytetit tonë e më gjerë si Hafiz Sulejman Durrësi, Ibrahim Vekshari, Ali Çanga, Hafiz Sabri Koçi etj. Këtë veprimtari e zhvillon kryesisht në Xhaminë e Kuqe të qytetit, shpesh edhe në shtëpinë e tij, gjithmonë në mënyrë vullnetare.

Krahas mësimdhënies fetare ai kryen edhe veprimtari patriotike, si shumë burra të farefisit të tij. Gjatë viteve 1915-17 vepron së bashku me atdhetarët përparimtarë kundër forcave destabilizuese në shërbim të

propagandës antishqiptare. Në vitin 1916, ai mori pjesë në revoltën e fuqishme të mbajtur në Xhaminë Plakë nga popullata myslimane e Shkodrës, kundër austriakëve, të cilët, edhe pse qenë pushtues, kur hynë në Shkodër më 22 Janar 1916, u pritën nga krejt popullata shkodrane si shpëtues nga pushtimet serbe e malazeze. Shkaktar që kërkesa e administratës austriake për të detyruar djemtë shqiptarë në angazhimin pranë ushtrisë austriake si luftëtarë.⁵ Edhe Hafizi ndenji 3 ditë në burg.⁶ Gjithashtu, ai mbështeste dhe ndihmonte veprimtarinë e Komitetit për Mbrojtjen e Kosovës, i cili e kishte qendrën e vet në Shkodër, me drejtues Hoxhë Kadriun, mik i afërt i Hafizit⁷.

Megjithatë, angazhimi politik më i fortë i Hafizit, mund të konsiderohet pjesëmarrja e tij në Kongresin e Lushnjës. Si rrjedhim i pjesëmarrjes në Luftën Ballkanike dhe veprimtari të tjera patriotike, u përzgjedh në listën e delegatëve për Kongresin e Lushnjës. Nga prefektura e Shkodrës, Lezha do të përfaqësohej me dy delegatë, ndërsa Shkodra me katër të tillë.

Kongresi u hap më 21 janar 1920, por meqenëse delegatët e disa zonave ishin penguar nga forca të ndryshme antishqiptare, punimet u shtynë dhe u zhvilluan gjatë 28-31 janarit. Edhe

5. "Bushatllinjte", Hamdi Bushati, f. 366-369.

6. Të dhëna gojore e me shkrim nga familja e farefisi.

7. "Në kujtim të brezave", F. Luli, I. Dizdari, N. Bushati, f. 347-364.

delegatët e Shkodrës nuk qenë në datën 21 janar, mbasi u ndaluan rrugës nga forcat e Qeverisë së Durrësit, sepse kjo e fundit, e ndihmuar nga Qeveria Italiane, donte të pengonte mbajtjen e Kongresit. Mbas disa ditëve ata u liruan dhe nënshkruan vendimet e marra në Kongres, nga i cili u zgjodh një përfaqësi me atributet e Senatit ose Parlamentit, i pari për Legjislativin tonë, që u quajt Këshilli Kombëtar. Senati, përbëhej nga 37 anëtarë, ndër të cilët ishte edhe Hafiz Sabriu. Në Kongres u zgjodh edhe Qeveria, që u quajt Këshilli i Lartë Kombëtar dhe Tiranë u shpall kryeqytet i Shqipërisë. Më 11 shkurt qeveria e re fillon punën në Tiranë, e kryesuar nga Sulejman Delvina, ndërsa më 27 mars zhvillohet mbledhja e parë e Këshillit Kombëtar (Senatit). Mbas një muaji, më 27 prill, 1920, në mbledhjen e 30-të të Senatit, krijohet Komisioni për Arsim e Punë Botore, ku bën pjesë edhe Hafizi, së bashku me 6 senatorë të tjerë. Në mbledhjen e -31të, datë 29 prill, lexohet programi i arsimit, ku ndër të tjera shkruhet: "... Për me pasun njerëz shkencorë do të mbahen nga Qeveria disa studentë, që mësojnë ndër shkollat e natës të Evropës". Ndërsa në mbledhjen e datës 13 prill, Hafizi ishte zgjedhur anëtar i njërit prej dy komisioneve të rendit, që kishin si qëllim frenimin e rebelëve të Mustafa Krujës dhe të Esad Toptanit, që donin të rrëzonin qeverinë e sapo formuar.⁸

8. "Bisedimet e Këshillit Kombëtar, senati. Legjislatura e parë, viti 1920; Tiranë,

Komisionet ia dolën mbanë dhe i dhanë mundësi qeverisë të forcohet, duke grumbulluar forca mbrojtëse.



Duhet theksuar se situata politike në këtë kohë ishte e rënduar, mbasi në disa zona të vendit, kishte forca pushtuese, lufta e Vlorës, lufta e Koplikut (në të cilën u angazhua edhe Hafiz Begu për një kohë të shkurtër), komplete dhe aksione të kundërshtarëve vendas, por edhe grupimi i shumicës së senatorëve në dy kampe kundërshtarë: ai i Aqif Pashës që përmbante ish anëtarë të Qeverisë së Durrësit etj., dhe ai i Ahmet Zogut, që përmblihte krahun kombëtar. Hafizi bënte pjesë në një grup të vogël, jashtë dy të parëve, të cilët donin të ruanin ekuilibrin në Senat⁹.

Qeveria e pavarur e S. Delvinës nuk i rezistoi kundërshtarëve politikë, sidomos kur u vendos të thirrej Asambleja dhe dha dorëheqje.

shtypshkronja "Mbrothësia", Kristo P. Luarasi, 1923, f. 22, 44, 46.

9. Të dhëna gojore e me shkrim nga familja e farefisi.

U krijua Qeveria e re me elementë jashtë grupimeve me kryetar Iliaz Bej Vrioni. Senati i dha votëbesim dhe u shpërnda në nëntor 1920^{10,11}

Hafizi konsiderohej opozitar falë lidhjes së ngushtë me kunatin e tij, opozitarin e njohur, Xhemal Bushati; falë mosaprovimeve të politikës së Ahmet Zogut; falë miqësisë me Hoxhë Kadriun dhe senatorin e Dibrës, Ramiz Dacin etj; për këto arsye Hafiz Begu u vendos si kandidat në listën e deputetëve të grupit “opozitar” në Shkodër për zgjedhjet e reja të vitit 1921.

Por, për të shfrytëzuar vlerësimin qytetar shkodran për ndershmërinë, atdhetarinë dhe autoritetin e tij, Hafiz Begu e vendosën pa e pyetur dhe pa marrë aprovimin e tij, si kandidat në listën e “popullores”, grupit politik kundërshtar. Ky fakt kishte implikuar një takim të opozitës, në të cilin Hafizi nuk ishte ftuar dhe zhvillohej në shtëpinë e kunatit, ku po debatoheshin dhe merrnin vendime kundra tij. Rastësisht e merr vesh dhe shkon në takim i paftuar, por i nervozuar dhe iu rendit e sqaron veprimet e tij të pastra e pa hile, për të cilat merr aprovimet kryesisht nga kunati i vet dhe largohet.¹²

10. “Bisedimet e Këshillit Kombëtar, senati. Legjislatura e parë, viti 1920; Tiranë, shtypshkronja “Mbrothësia”, Kristo P. Luarasi, 1923, f. 22, 44, 46.

11. “Ballafaqime politike në Shqipëri” (1897-1942), Sejfi Vllamasi, Shtëpia botuese “Naraida” Tiranë, 2000, f. 190-257.

12. Të dhëna gojore e me shkrim nga familja

Me anën e një njoftimi publik, tërheq kandidaturën dhe nuk angazhohet më në politikë; madje, i zhgënjyer nga pabesitë politike, shumë vite më vonë, u lë amanet djemve, të mos merren me politikë.¹³

Duke iu përkushtuar besimit e leximit dhe studimit të librave fetarë, ai kishte autoritetin e një dijetari islam dhe kjo i dha një autoritet e respekt të madh popullor. Mbas fitores së kryengritjes së qershorit në 1924 dhe dorëheqjes së kryemyftiut të Shkodrës H. Xhemal Naipi të “Popullores”, Hafiz Sabriu caktohet si kryemyfti. Pastaj, mbas fitores së Legalitetit, largohet nga detyra dhe e transferojnë si myfti në Berat. Në këtë kohë pati edhe lëvizje të tjera jo dashamirëse ndaj hoxhallarëve të tjerë, të cilët, me ta edhe Hafizi, i kundërshtuan emërimet e tyre. Kjo gjë u shkaktoi mbajtjen nën vërejtje nga xhandarmëria dhe një farë internimi në Tiranë, larg familjes. Më pas, nga protestat dhe reagimet e besimtarëve, u detyruan t’i pezullojnë këto emërimet të pavend. Sipas familjarëve, për emërimin e Hafizit në Berat, shkaktarë qenë pikëpamjet kundërshtarë, që kishte treguar kohë më parë Hafizi me Ahmet Zogun. Hafiz Begu ia vlerësonte atij zgjuarsinë, guximin dhe aftësinë si organizator, por kishte kuptuar synimet e tij për pushtet personal

e farefisi.

13. Të dhëna gojore e me shkrim nga familja e farefisi.

dhe manovrimet jo legjitime për t'i arritur ato. Konkretisht, A. Zogu pat organizuar një darkë me tre senatorët myslimanë të Shkodrës, Hafiz Begun, Xhemal Bushatin dhe H. Xhemal Naipin. Mbas bisedave dhe debateve me opozitarët (Hafizin dhe Xh. Bushatin), Hafizi, trim, pa ndroje dhe i drejtpërdrejtë i ka thënë: “E mira e kombit e don që ti të largohesh nga politika”. A. Zogu është përmbajtur, ndërsa Xh. Naipi, si përkrahës i tij, ka ulë kokën me dëshpërim e mosmiratim të këtij shpërthimi të Hafizit.¹⁴

Edhe një herë tjetër, Zogu i ardhur me detyrë shtetërore në Shkodër, i dërgon në shtëpi Hafizit lajmësin, Hamit Dizdari (policin e Bashkisë), për një takim. Ky i thotë lajmësit, thuaji se nuk ishte në shtëpi. Kur lajmësi kthehet mbas pak, i thotë të njëjtën përgjigje dhe në herën e tretë i thotë: “Thuaji, nuk don me ardhë”. Mbas kësaj përgjigje, thuhet se A. Zogu ka thanë: “Çfarë t'i bësh; ka kokë mushke”. Më vonë, mbas viteve '90, disa legalistë të kthyer në Shqipëri kanë treguar, sipas tyre, vlerësimin që ka shprehë A. Zogu për Hafizin: “Burrë i ndershëm, i drejtë, me karakter, por inatçor”.¹⁵

Ky vlerësim shfaqet mjaft dukshëm edhe në rastin e Kongresit

Mysliman, i cili filloi punimet më 24.02.1923. Pjesëmarrës nga Shkodra ishin Hafiz Sabri Begu dhe Halit Rroji, të zgjedhur nga Bashkia e qytetit. Gjatë mbledhjes mbërrin një telegram nga Shkodra, ku një grup qytetarësh protestonte se pjesëmarrësit nuk janë zgjedhur nga populli (mysliman) dhe kjo gjë diskutohet në Kongres. Hafizi largohet menjëherë; kolegu i tij një herë qëndron, por të nesërmen, më 25.02.1923, nuk marrin pjesë që të dy. Po në këtë ditë, më 25, mbërrin në Kongres një tjetër telegram, ku një shumicë e madhe, shprehin indinjatën për atë që ka ndodhur dhe mbështesin të dy pjesëmarrësit; por ata ishin larguar, nuk ndodheshin më në Kongres.¹⁶

Më pas Hafizi shërben si vaiz në lagjen Perash dhe me predikimet e tij linte mbresa të thella te besimtarët. Sipas familjarëve, ai ishte i preokupuar gjatë gjithë kohës për predikimin e radhës, përdorte disa “qitabe”-tekste në gjuhët perse, arabe ose turke, tri gjuhë që i zotëronte shumë mirë. Kështu ai ndërthurte mësimet e shenjta kur'anore dhe hadithet e Profetit (a.s.) me principe të etikës morale, me fjalën dhe me shembullin e tij në jetë, ai i edukonte besimtarët me frymën e atdhedashurisë, të vëllazërimit e të tolerancës fetare,

14. Të dhëna gojore e me shkrim nga familja e farefisi.

15. Të dhëna gojore e me shkrim nga familja e farefisi.

16. Arkivi Qendror i Shtetit, AQSH, Fondi Komunitetit Mysliman (482), viti 1923, Dosja 4, fletët 149-151; 153-154; 158, 161, 162.

ai ishte një ithtar i përparimit shoqëror e kulturor, mbronte idenë, që shkenca dhe feja duhej të ecnin paralelisht, përkrahte emancipimin e shoqërisë e të familjes.

Pushtimin fashist më 7 prill 1939 e priti me shqetësim. Mbas disa ditësh, familjarët transmetojnë fjalët e tij dëshpëruese të këtij fakti me një mik të tij: “Atë ditë e kam la çardakun e shtëpisë me lotë”. Agjentina proitaliane ishte përgatitur për t’i dalur përpara e për të pritur trupat ushtarake italiane te ura e Bahçallekut. Te Hafizi shkoi një i njohur dhe mik i tij, S. R., i cili i propozoi të dilnin te Ura e Bahçallekut, jo për agjunkturë apo servilizëm, por sipas atij, me qëllim që okupatori të zbutej e të mos bombardohej qyteti. Ky ishte një kurth i agjunkturës proitaliane për të nxjerrë parinë e qytetit si pritëse e okupatorit dhe disa persona u mashtruan, por Hafizi jo; ai nuk mund të pranonte një pushtues. Gjesti i tij ishte pjesë e rezistencës pasive të popullit tonë, në mbështetje të asaj me armë, që u zhvillua në pjesë të tjera të atdheut tonë.¹⁷

Qeveria e re, duke shfrytëzuar mbështetjen e tij në qytet, mospajtimin me politikën e Zogut dhe lidhjet fisnore me Maliq Bushatin, e emëroi kryemyfti. Duke qenë në këtë pozitë zyrtare, ai ftohej të merrte pjesë në ceremoni të ndryshme zyrtare, ai shpesh herë u

17. Të dhëna gojore e me shkrim nga familja e farefisi.

shmangej ose qëndronte në pjesën e parë të tyre.

Te “Dokumentet tregojnë...”, në faqen 144, tregohet se prefekti i Shkodrës kishte thirrur shumë zotërinj shkodranë për t’i njoftuar për ndryshimet politike që po ndodhnin në Shqipëri-data 28.09.1943. Në faqen 147 në krye të listës është emri i Hafiz Sabri Beg Bushatit.¹⁸

Respekti dhe nderimi ndaj Hafiz Begut nga qytetarët e vet ka si arsye kryesore, se ai ka mbrojtur të drejtën dhe ka kundërshtuar me guxim të gjithë ata që kanë abuzuar apo kanë dashur të shkelin të drejtat institucionale apo personale. Kështu, ai ka kundërshtuar dhe polemizuar me kryetarin e Komunitetit Mysliman të asaj kohe Bexhet Shapati, lidhur me koncensionet që donte t’u bënte autoriteteve italiane në dëm të institucioneve fetare myslimane¹⁹.

Hasani, i biri, tregon se në kohën e pushtimit fashist, ka ardhur në Myftininë e Shkodrës, Gjon (Gjush) Pistulli, nga Konsullata Italiane dhe i ka propozuar Hafizit si Kryemyfti, që konsullata, shteti Italian, të kontribuonte me shtesa rroge myezinët, sepse kanë rroga të vogla. Hafiz Begu i është përgjigjur: “Nuk mund të pranoj këtë shtesë nga vlera, që ka caktuar Komuniteti Mysliman.

18. “Dokumentët tregojnë ...” Gëzim H.Juka, f. 144-147.

19. “Në kujtim të brezave”, F.Luli, I.Dizdari, N. Bushati, f. 347-364.

Në qoftë se dëshironi t'i ndihmoni, thërritni ata personalisht dhe ju a jepni vetë.” Duke u përshëndetur për t'u larguar, Gjushi i ka thënë: “Qenke zotnia vetë”. Këtë person, më vonë, e ka arrestuar pushteti komunist dhe një ditë e kanë thërritur në drejtorinë e burgut. Kur është kthyer në qeli, e kanë pyetur arsyen e thirrjes dhe ai ka treguar se e kanë pyetur për Hafiz Begun, nëse ka marrë para. Këtë fakt e ka treguar bashkëvuajtësi në qeli i Gjushit, Ahmet Kopluku.

Edhe në kohën e pushtimit nazist, si Kryemyfti i Shkodrës, u përpoq për mbrojtjen e integritetit juridik të institucionit fetar. Familjarët tregojnë se komandanti gjerman Hausding i kërkoi dislokimin e trupave gjermane në territorin e xhamisë Begas, por Hafizi e kundërshtoi, duke i thënë se nuk lejohet fetarisht një veprim i tillë dhe se ai nuk e kishte këtë kompetencë juridike e institucionale. Më vonë gjermanët e realizuan me urdhër nga lart.²⁰

Edhe te revista “Zani i Naltë”, në faqet 409-410 gjejmë një letër, që i dërgon Këshillit të Naltë të Sheriatit, Tiranë, në të cilën shënohet se, “mësuesit e besimit islam nuk figurojnë në kuadrin e vjetit shkollor 1924-25 dhe se nuk ka përpjesëtim të drejtë të kreditit të dhanun për Arsim; se nuk ndahet sipas nevojës arsimore e kulturore, por as sipas proporcionit të frymëve të besimit...”²¹

20. Të dhëna gojore e me shkrim nga familja e farefisi.

21. Kolana “Zani i Naltë”, nr. 1, f. 409, 410,

Qytetarët e Shkodrës ja njohën ndershmërinë e atdhedashurinë Hafizit edhe të tjerëve në çdo kohë. Kështu, në një trakt të Tetorit të 1944, i emërtuar “Dy rrugë” i bëhet “...thirrje shqiptarëve të gabuar e të rrejtnun me u shkëputë nga rradhët e okupatorit nazist... dhe me marrë shembull nga njerëzit e ndershëm si Luigj Mjeda, Pjetër Simoni, Hafiz Sabri Begu, Malo Melgusha, Brahim Gjyrezi ...”²² Megjithatë, pushteti komunist i harroi lëvdatat dhe më pas, në shkurt të 1946 e largoi nga detyra si kryemyfti i Shkodrës, i hoqi “Triskën e Frontit” dhe e trajtoi në vitet në vazhdim si fetar, si ish-pronar tokash, si mik i Jup Kazazit (nacionalisti i nderuar e i mirënjohur, organizator i Lëvizjes Antikomuniste të Postribës), si i informuar për këtë lëvizje. Kjo e fundit, edhe pse ishte e vërtetë, nuk u provua kurrë, megjithë përpjekjet, që bëri pushteti komunist. E torturuan nipin e Hafizit, Ahmet Koplukun, 15 vjeçar, në shtëpinë e të cilit qëndroi i fshehur Jup Kazazi, në se e takonte këtë të fundit Hafizi, por nuk nxorën gjë.²³ Një herë tjetër, i shkoi në shtëpi sekretari i përgjithshëm i Frontit Demokratik, Zija Dibra, i shoqëruar me një prokuror, e për ta provokuar, i bënë pyetjen: “Si mendon ti për pjesëmarrjen e gruas në luftën nacional-çlirimtare?”

vëll. I, 1923-24-25.

22. AQSH., Dosja 28, fleta 7/1, viti 1944.

23. Të dhëna gojore e me shkrim nga familja e farefisi.

Sipas Hafizit, prezenca e prokurorit, mund të ishte gatishtëria e tyre për ta prangosur direkt, mbas një përgjigjeje sipas “oreksit” të tyre, prandaj u është përgjigjur: “Për të dhënë fetva (gjykim të saktë në përputhje me besimin), duhet punë e nuk mund të jepet ajo si simit në tezgë”.²⁴

Popullariteti, që gëzonte në qytetarët e Shkodrës e ka penguar pushtetin komunist për ta prangosur pa prova, të cilat nuk i siguruan kurrë.

Nga viti 1946 deri në vitet ‘60, Hafizi ushtron detyrën e vaizit (predikues) në xhaminë e Bardhë të Perashit në qytet, duke gjetur kënaqësi shpirtërore e fetare. Mësonte nxënës dhe në kohën e lirë lexonte në bibliotekën e tij, e cila, sipas Hoxhë Bashkim Bajraktarit, në përshtypjet e tij dhënë me shkrim, është “*dëshmi e diturisë dhe devotshmërisë së tij. Shumica e materialeve të bibliotekës ishin voluminoze, me nga 4, 5 ose 10 volume. Tefsiri i madh prej 7 volumesh i Fabri Raziut, ishte njëri nga thesaret e bibliotekës. Shënimet që kishte vënë në librat e Jurisprudencës islame (Fikëhut), në Red-dulMuhtaraled-dur-riL Muhtar’ tregojnë etjen e tij për dituri, ndërsa si dijetar shpirtëror, njihet nga literatura islame mistike e bibliotekës së tij si Ihja Ulumid-din; Tedbir-Tedbiri, El-Insanul-Kamil etj., të cilët konsiderohen thesare mistike islame botërore.... Besoj dhe mendoj se H. Sabri Beg Bushati radhëtet ndër xbehabiret e fshëbur islamë shqiptarë ...”*.²⁵

24. Të dhëna gojore e me shkrim nga familja e farefisi.

25. Të dhëna me shkrim nga Haxhi Bashkim

Tronditja më e madhe për të dhe gjithë besimtarët e vërtetë që viti 1967, kur filloi fushata kundër fesë, institucioneve të saj, por edhe kundër individëve fetarë në mënyrën më poshtëruese, duke mësyrrë të rinj dhe injorantë ndër mbledhjet e organizuara në lagje dhe rrugë, kundër personave me çallmë dhe veladonë.

Qeveria komuniste, për të njolllosur figurën e tij fetare, përdori një fotografi të një ceremonie zyrtare dhe e vendosi (pa emër) në muzeun ateist të qytetit të Shkodrës. Më pas, duke iu referuar asaj fotografie, e akuzuan edhe se i ka dalë para okupatorit Italian. Kur një mik i tij ia ka treguar këtë akuzë, ai shumë i shqetësuar, është ngritur në këmbë dhe i ka pohuar: “Me këtë çallmë kemi vënë themelet e shtetit shqiptar, nuk kam pritur pushtuesin e kurrë nuk kam prekur para të huaja.”²⁶

Në këtë kohë Hafizi u “vetburgos” në shtëpi; nuk doli për asnjë arsye, as kur i vdiq i vëllai, vetëm e vetëm për të ruajtur veshjen fetare të respektuar. Në një mbledhje të lagjes së tij të organizuar për diskriminimin e njerëzve të fesë, Hafizi nuk ishte prezent; merrte pjesë i biri, Hasani. Dikush kërkoi të merren me zor e të sillen në mbledhje. Kishte shumë persona, që kishin frikë të reagonin, por për fat të mirë, një zonjë e moshuar ndërhyri:

Bajraktari.

26. Të dhëna gojore e me shkrim nga familja e farefisi.

“Të lihet Hafizi, mos të sillet, ai është plak”. Ismail Teli, që drejtonte mbledhjen, e aprovoi në heshtje dhe e kaloi si problem. Familja më pas ka falënderuar I. Telin, sepse e dinin që Hafizi nuk do të pranonte kurrë të merrej me zor dhe kushedi çfarë do të ndodhte...²⁷

Brenda familjes ishte i heshtur; përpigjej të mos i rëndonte njerëzit e shtëpisë me kërkesa; edhe në vitet e pleqërisë donte të vetëshërbehej; në asgjë nuk e kalonte masën. Edhe kur nuk biente dakord për diçka, përdorte fjalor të rezervuar dhe ton të përmbajtur. Këshillonte vazhdimisht familjarët për korrektësi

27. Po aty.

në marrëdhënie me të tjerët, veçanërisht në ato ekonomike.²⁸

Pranë shtëpisë, banesës familjare të Hafizit, ka qenë ish ndërtesa e burgut dhe familjarët tregojnë ndodhjen e shpeshtë të arratisjes të burgosurve në çdo kohë. Besnik i traditës shqiptare që “miku s’pritet në besë”, asnjëherë nuk është sinjalizuar xhandarmëria, apo policia në këto raste. Familjarët kujtojnë rastin e një ish të burgosuri nga Tropoja që, i aksidentuar në arratisje e sipër, u strehua, u mjekua për disa ditë, pastaj u përcoll mik pas miku deri në Postrribë dhe prej andej në fshatin e tij.

28. Po aty.



Myftiu i Shkodrës H. Sabri Bushati, duke falur namazin e xhenazes së Sheh Qazim Hoxhës

Ndërroi jetë më 28 shkurt 1971, mbasi qëndroi rreth një javë i sëmurë në shtrat. Në ditët e fundit qëndronte pa lëvizur, nuk mund të komunikonte dhe as të ushqej; por në xhumanë (të premtën) e fundit të tij, ai papritur, është ngritur ndenjor, ka marrë tejemum, është falur dhe përsëri është shtrirë pa folur asnjë fjalë. Të dielën ka ndërruar jetë.²⁹

Hafiz Sabri Beg Bushati ishte personalitet, jo vetëm për aftësitë dhe karakterin e tij, por kishte edhe paraqitje të jashtme të admirueshme: i gjatë, elegant, i veshur me xhybe të hapur, ngjyrë qumështi gjatë verës dhe të zezë, gjatë dimrit; me çallmën e bardhë e të rregullt; me sy të mëdhenj, që po të kërkosh me vëmendje në fotot e tij, sheh krenari, por edhe vuajtje e dëshpërim^{30, 31}.

Vlerësim të lartë të paraqitjes së tij ka bërë At Visarion Xhuvani në burgun e Burrelit: "...kur dilte H. Sabri Beu (në parlament), sikur po dilte perandori". Shumë familje të njohura qytetare, për raste familjare, e kanë pasur për nder ardhjen e tij e sidomos caktimin e tij si prijës i grupit në fejesa e martesë të shtëpia e krushqve, sipas zakoneve familjare të kohës.³²

29. Po aty.

30. "Nderim për Hafiz Sabri Bushatin" Ismail H. Mucej, gazeta "Drita e Dijes", nr. 76, dhjetor 2005, f.2-3.

31. "Kujtime për Hafiz Sabri Bushatin", Sytki Bushati, gazeta "Drita e Dijes", nr. 76, dhjetor 2005, f.3.

32. Të dhëna gojore e shkrim me nga familja

Hafiz Begu kishte miqësi me shumë personalitete të njohura, politikanë, fetarë etj. Po përmendim disa prej tyre, duke treguar edhe ndonjë episod.

Hafiz Ali Korça, i cili i ka dhuruar me dedikim, librin "Rubairat" e Omer Khajamit, të përkthyer nga vetë ai.

Haxhi Ibrahim Efendi Kaduku, myfti në Kavajë, vinte si mik edhe për të fjetur në shtëpinë e Hafizit.

Qazim Efendi Hoxha, me të cilin kanë pasur ditë të caktuara të javës për vizita te njeri tjetri.

Hafiz Abdulla Bërdica, të cilit Hafizi i ka besuar çelësat e zyrës, kur ai është larguar me detyrë jashtë qytetit. Kanë qenë bashkënxënës në Mejtep, Medrese dhe në Stamboll.

Molla Rustem Beg Bushati; Riza Drini; Mytesim Këllici; Hafiz Maliqi nga Shijaku, i cili i ka mësuar shqiptimin "Gurrah" të Kur'anit.

Hasani, djali i dytë, gjatë haxhillëkut që kreu me 1992, takoi në Mekë një ish-nxënës të babait të vet, hoxhë Isufin nga fshatrat e Tiranës, që me leximin që i bëri Kur'anit, i befasoi të pranishmit; për Hasanin, befasimi që më i madh, kur ai deklaroi plot krenari dhe mirënjohje se këtë "dhunti" e kishte fituar nga mësuesi i tij, i nderuari H. Sabri Bushati.

"Cilësitë e tij të rralla morale, përkushtimi i plotë fetar e shoqëror, kultura e përgjithshme dhe përgatitja e farefisi.

profesionale, atdhedashuria dhe integriteti i tij politik, detyrat serioze e me përgjegjësi, si ajo e imamatit, e myderrizit, e vaizit dhe e kryemyftiut dinjitoz, pa lënë mënjanë impenjimin në rolin me aq përgjegjësi historike për konsolidimin e shtetit shqiptar, për ruajtjen e tërësisë tokësore e zhvillimin e demokracisë, si pjesëmarrës i Kongresit të Lushnjës, e si anëtar i Senatit, bënë që lidhjet e tij miqësore të shtriheshin edhe jashtë rrethit të hoxhallarëve, duke krijuar kështu një “ansambël” dashamirësish, si me intelektualët: Hamit Gjylbegaj, Hamdi Bushati, Riza Drini etj., apo me përfaqësues të familjeve me tradita të vjetra: Selim Reçi, Oso Kopluku, Muho Kazazi, Junuz Boriçi, Nuto Podgorica, Elez Muka, Ymer Lutfia, Caf Reçi, Elez Sokoli, Et’hem Kopluku, Riza Kaduku.”³³

Pas ndryshimeve demokratike, filluan rivlerësimet e personaliteteve të denigruara nga diktatura komuniste. Biografi i parë i Hafiz Sabri Bushatit qe shkrimtari Fadil

Kraja³⁴, i cili me të drejtë denoncon faktin që për dekada të tëra nuk u fol për meritat e këtij kleriku dinjitoz.

Për meritat e tij, së bashku me një grup klerikësh dhe intelektualësh, u dekorua me dekret Nr. 1045 datë 20.03.1995 nga Presidenti i Shqipërisë, z. Sali Berisha, me Medaljen “Për veprimtari patriotike” me motivacion: “Intelektual dhe patriot i shquar që luftoi për një Shqipëri të lirë e demokratike”.

Edhe Këshilli i Bashkisë Shkodër, në mbledhjen e datës 01.11.2010, me vendimin numër 84, i akordoi Hafiz Sabri Bushatit titullin “QYTETAR NDERI” pas vdekjes me këtë motivacion: “Deputet dhe përfaqësues i shquar i Shkodrës dhe i Lezhës në Kongresin e Lushnjës në vitin 1920, pjesëmarrës në luftën e Koplikut. Myfti i Shkodrës në vitet 1924 dhe 1946-1939. I shkolluar në universitetin e Stambollit, i cili mbas ndalimit të ushtrimit të besimit fetar në vitin 1967 u vetë burgos për t’u mos u tjetërsuar me heqjen e rrobës së klerikut derisa ndërroi jetë”.

33. “Në kujtim të brezave”, F.Luli, I.Dizdari, N. Bushati, f. 347-364.

34. “Hafiz Sabri Bushati, një emër që i bëri nder atdheut”, Fadil Kraja, gazeta “Drita Islame”, viti I, nr. 19, Shtator 1992, f.3.

Qytetrimi i vërtetë e qytetrimi mjeshtror

Qytetrimin n'ë ndafshim në dyë pjesë kujtoj se do të profitojmë. I, Qytetrimi lindor a qytetnimi i vërtetë. II, Qytetrimi prendimor a qytetrimi mjeshtror... Si populli i Çinit ashtu edhe Brahmat e Hindit edhe sod qytetrimin e Auropës e të Amerikës e shohinë me një syë të pa pelqyeshëm. Por kyë vështrim a është i drejt a jo? Ashtu edhe qytetrimi i perëndimit a asht një qytetrim i vërtetë a jo? Ahere kombet qi jetojnë jasht Europës dhe Amerikës a nuk janë të qytetruem as pak? A janë të egër?

Qytetrimin n'ë ndafshim më dyë pjesë ahere pyetjeve të ndryshme qi do të na vinë mundemi t'i përgjegjemi.

Pra të thome se qytetrimi është dyë llojësh qytetrimi i vërtetë dhe qytetrimi mjeshtror (teknik); në marshim para syësh qytetrimin mjeshtror ahere thomi qi Europa e

Amerika kanë arrirë në shkallën mâ të naltë të këtij qytetrimi dhe kombet e tjerë rrojnë si ata qi rronin dy tre shekuj mâ parë, po kurë të gjykojmë kundrazi kombet e lindjes i gjejmë me një qytetrim të vërtetë, si njerëz shpirt mirë e zemër quer.

Mjeshtria e vërtetë e Europës e Amerikës u ka dhanë një jetë të re. Në këto vise mjeshtria për mbi gjith fillosofitë po luen rolin mâ të math. Punimi, ikonomia edhe literatura kanë marrë një formë fort të ndryshme e nga këto pikpamje Europa, Amerika janë të qytetrueme, janë kohët e pritshme dhe Afrika e Azia janë kohët e shkueme.

Tashti edhe lindja për të mundur të jetojë si duhet, lipset me do e mos të përfshij gjith veglat mjeshtriore të perëndimit, për ndryshe nuk mundet të jetojë.

Sa për dituritë ajo fizikë e chimi qi

ndodhet në perëndim ndodhet edhe në lindje ku lind e perëndon një lloj llogjike ka, e kështu pra një lloji mjeshtrie duhet të vazhdojë.

Për shembllë të marrim Japonin: pes dhet vjet më parë, Japonët e panë se qytetrimi i vjetër i tyre mjeshtrorë më s'mundet të rronte dhe e panë se me ato vegla nuk po mundenin t'i bëjnë ballë sulmeve dituriake të botës, u mentunë dhe murrën qytetrimin mjeshtrorë të perëndimit pa far ndo një ndryshim, dërguën shumë nxanës në perëndim dyke vënë sipër nga një kujdestar të fortë e mjaft të ditshëm e të ndershem edhe kësi soj atë qytetrim e prunë në viset e veta. Me gjith këtë prunë dhe shumë mjeshtrë të famshëm me shpenzime të mbëdha në shtetin e vet e kështu ngrehën gjith fabrikat e duhura dhe përhapën dhe mbjelljen mjeshtrorë në gjithë atdheut të tyre. Sod Japonezët në aninë-ndertesat e tyre punojnë dhe ndritnavta.

Çudi Japonezët edhe gjellëtarët, këpucëtarët, petka-qepësit i a u shoqëruan nxënësve bashkë.

Për të mos qitur nga mëndja tokën e Japonisë, midis dy shollëve të këpucëve u shtrojnë pak dhe nga dheu i Japonisë, që kështu të mos shkellin tjetër dhe veç se dherit të tyre.(?)

Japonezët prej viseve të huaja marin vetëm qytetrimin mjeshtrorë dhe nga qytetërimi i tyre lindor nuk xhvishen kurrë.

Sot Japonezët perëndimit po i këndojnë shesh kapërzimi në ç'do mjeshtrëri edhe po përpiqen t'a shkojnë.

Mjerisht bota myslimane nuk gjeti kohë akoma të mentohet e të marrë këto mjeshtrëri e kështu të mundnjë t'i bëjë ballë sulmës tregëtare të perëndimit.

Bota myslimane si n'Azia ashtu dhe

n'Afrikë nuk pati kohë të përpiquej për këtë çështje e cila do t'i siguronte jetimin e lirinë të plotë në këtë botë.

Qeveria Arabe n'atë kohë që kishte kapur shkallën e përparimit edhe qytetërimin mjeshtrorë po e përhapte në gjithë botën, për fat të keq perëndoj.

Turqia që po zinte vëndin e saj nuk u përkujdes as pak, e kështu bota lindore mjaftësoj vetëm me një qytetërim të vërtetë shpirtor.

Qytetërimi i vërtetë

Qytetërimi i vërtetë formohet prej vetiave të qurme, ndjenja të nalta e shpirtë-bardhësië.

Në hedhshim vështrimin në perëndim atje gjejmë ankime nga mefshtësia e kësajë kategorije të qytetimit.

Qytetrimi i stolishçëm në perëndim e ka gjet sheshin të lirë e po i shtyë të zot deri sa mos me i njoft kombet tjer për njerëz.

Sot Hindi po ushqen 320 milion frymë vall atje sa fabrika ndodhenë.

Në Xhava e gjetk që ka përmbi 30 milion njerëz, vall Hollanda atje sa fabrika ka çel..

Rusia në Azi te vogël ç'fabrika hapi.

Pra mundim të themi pa frikë se nga pikpamja shpirt-naltësie, nga vetiat e bukura shpirtërore si Japonia ashtu edhe gjithë bota lindore edhe myslimane nga perëndimorët janë fort më të naltë. Këtyre shpirti u dhimbset, zemra u qan, trupi u rëqethet, kanë një njerëzim edhe një përrulje të fortë.

Ne, nga perëndimi mundim të marim vetëm qytetërimin mjeshtrorë edhe të mbajmë qytetërimin të vërtetë bashkë me disa zakone të bukura ashtu si i kemi trashëguar nga prindët t'onë. Në

qoftë se do të punojmë si orangotangoja e në marçim ballot, danset, pirjet e moralet e tjera dyk e lënë të shenjtat t'ona ahëre t'a dimë mirë se këtë shtet, keq-vetijërisht do t'a mbërmbysim vrik.

Në, për shëmbëll përparimi të kemi pasqyrë Japonezët.

Ne, mjeshtëritë duhet t'i ndryshojmë po shpirtin, moralin e zakonet duhet t'i ruajmë si më mirë. Si ç'do popull që mundohet të ndërrojë edhe shpirtin e moralin, ajy vdes për jetë për të cilat historia është mbushur me shëmbulla. Nji popull që majmunaset ka vrarë vehten me dorën e vetë.

Por t'a dimë dhe këtë se edhe qytetërimi perëndimor ndryshon, b. f. Franca ka tjetër qytërim, Anglia tjetër,

ashtu edhe Alëmanja me Italinë.

Tashti ne Shqipëtarët në qoftë se, kush kërkon të sjellë qytetërimin e Anglisë e t'jatri do të përpiqet të bjerë të Francës e kush do vendosnjë qytetërimin e lyksin e Italisë e cili të Gjermanisë, ahëre në vëndin që do të bijem qytetërimin mjeshtërior po bijem një sëmundje të tmerçme edhe mundohemi që të ndërrojme shpirtin që d. m. th. po përpiqemi me dorën e vetë, me dëshirën e vetë po i qitim themelin shtetit e kësi soj po vrasim vehten me gjithë brezin e pritçim.¹

H. A.

1. Marrë nga revista "Zani i Naltë", nr. 6, viti I, mars 1924, f. 182-187.

Abstracts in English

Islamic sciences

1. The right way of Islam's preaching

Msc. Veton Tulla & Msc. Hysni Skura

Bedër University, Department of Islamic Sciences

Abstract

Islam views humans as the most honorable creatures, which are endowed with conscience and will, and it considers the freedom of belief as an undeniable right. The Islamic religion tries to eliminate the obstacles that lie between God and the human intellect, conscience and will as fundamental principles. Of course, this objective is achieved through a multidimensional education and intellectual background on religious principles and provisions. It needs to be emphasized the fact that when Islam is properly understood, everybody can follow the path called "representation and communication" - the line of Islamic practice and communication in the best possible way, which would consequently lead to a harmonic and peaceful living with anyone around us.

It is a professional and moral responsibility for any Islamic preacher (mufti, imam, waiż, mueżzin, etc.) to explain the religion to the people in the best possible way without being distracted from the two main sources - the Qur'an and Prophetic Tradition - and, of course, combining their sermons with a methodology appropriate to their audience.

2. On the attributions ("Sifaa'-s") of God (صفات الله)

Azmir Jusufi (PHDc), Prizren – Kosovo

Abstract

It is known that - and far from it - God neither has a body, nor occupies a space; we cannot say if He is moving or not, and He cannot be characterized by exterior and interior feelings like humans. He does not resemble to anything. However, in order to fulfill human's will and to help them, the Magnificent Lord, in the last revelation in the Qur'an, has mentioned the attributes belonging to His Almighty (but) so that God to remain unmatched, as in fact He is.

If people - the philosophers - would have stopped on what the logic itself enables

about the recognition of supernatural power (God), it would have been enough. However, what caused the dialogue, annoyed them and tired them unnecessarily is the fact that they entered into research and study about something that was not so urgent.

Studies

3. Contribution of “Alauddin” madrassa on the religious education and the national issue during the years 1985 – 1995

Prof. Dr. Qazim Qazimi, Kosovo

Abstract

The “Alauddin” Madrassa with its very successful religious education activity, as well as its overall activities in all possible forms, made an unimaginable and unparalleled contribution in line with the comprehensive development of the Albanian education in Kosovo.

This madrasa has since contributed to the religious education in preparing cadres for all Albanian lands but also abroad. Through its educational and educative activities, as well as with its comprehensive activities, has also made an uncontested contribution to the national issue.

It must be acknowledged that the fate of “Alauddin” madrassa was and still continues to be closely related to the fate of the Albanian people in general and that of Kosovo in particular.

4. The project “Well...Penetrate!”

Blerim Lazimi, Dibër

Abstract

The first flights, the launch of satellites, the human arrival on the moon, the direct study of Mars, the study of our solar system and beyond, are all proofs that humanity – willingly or not - has walked on the scheduled path, just like the universe. This shows the accuracy of the Qur’an, each sentence of which is an argument on its own. Surely the Quran is the word of God. Otherwise, how could the products of the human mind of the seventh century (e.s.) be such accurate and clear projects of science development, so progressive application methods, so precise predictions about the future of mankind?! How can the Qur’an be considered a human word, when it is in all respects far from the prevailing legends of that time?! Surely, the project was only published by the One, Who designed the universe, created the mankind and everything that is in the heavens and the earth; the One Who is the Lord of Knowledge. Only under His inspiration practice that leads to the discovery of Truth is applied. Allah knows the past, the present, and the future of the cosmos and mankind.

Linguistics & Literature

5. The 95-th anniversary of the State Gymnasium

Prof. dr. Njazi Kazazi

University of Shkodra “Luigj Gurakuqi”

Department of Linguistics

Abstract

Due to the official propaganda, “the old feudal-bourgeois school of pre-liberation was severely oppugned both in content and in methodology” when the party led by Enver Hoxha, defined the path of revolutionary development of education in Albania “... according the war proclaimed to the old school.” In these conditions of such totalitarianism and extreme politicization “... the author was allowed the freedom of thought in dealing with history, but within the allowed bounds such that to not contradict some hardened Marxist-Leninist postulates.”

Researchers in these fields emphasized that this kind of school had “religious and clerical, reactionary and anti-nationalist spirit in the service of foreign patrons ...” and it was “... an anti-democratic school and above all, with a frenzied and aggressive anticommunist spirit “and furthermore, they reiterate “a true castle of cultural and ideological reaction in the service of foreigners not only anti-populist, but - as we have said - anti-nationalist.”

History

06. An Historical view on the book “History of Albanian Pashaliks in the Ottoman Empire” of Syrja bej Vlora Part II

Dr. Hasan Bello

Institute of History, Center of Albanological Studies

Abstract

The book “History of Albanian Pashaliks in the Ottoman Empire” of Syrja bej Vlora is a modest attempt to shed light on a number of personalities who have lived, worked and contributed for an imperial state, part of which were also Albanians during five centuries.

In this book, data of general character are given, which for the sake of truth can now be considered as outdated from those scholars who want to deal with a profound research of the Ottoman period. As for passionate readers of history, they are a valuable contribution, with little or no previously known information. The author discloses interesting data for familiar and unknown names from Albanian historiography, perhaps for the fact that for these personalities, prejudice instead of sound reasoning did prevail.

This book in manuscript was written in the Ottoman language and now it can be found at the State Central Archive of Tirana together with the translation into Albanian. It has in total 144 pages in Ottoman and 52 pages in Albanian translated by the orientalist Jonuz Tafilaj. In the inventory compiled by the orientalist Haki Sharofi, the manager of the Turkish manuscript section in the historical archive, the date of receipt of this translation June 26, 1963 appears. As for the time when it was written by Syrja bey Vlora, we still have no data.

Although this manuscript translation is in the northern dialect and contains a considerable amount of errors, we have intervened only where it was indispensably necessary. This because dialects along with translations made in a given period are a tremendous asset and bear the stamp of the time.

But on the other hand, in order to help the readers, we converted the years of lunar calendar to the solar calendar by placing them in parenthesis without changing the original text. In the sections in which an Ottoman historical term appears we tried to explain it with the sign () in the subtext. As for some personalities - whose birthdays, the year of death and the time they served as prime ministers is shown - we have placed them in brackets.*

07. Et'hem Bey Mosque at Tirana – a splendor of Islamic architecture in Albania

Msc. Brunilda Basha

Master of Science (Built Environment), KAED, IIUM, Malaysia

Abstract

Inscriptions and buildings have a great historical significance. In some cases they reflect previously unknown information, or a colorful picture of human activity. In other cases, they revitalize the story, bringing tangible facts to the younger generation and convey an atmosphere of culture that is really absent nowadays.

At the time when the Ottoman Empire reached its peak - during the 15th and 16th centuries – the Ottoman art in Albania was very similar to that in Skopje or Edirne. Meanwhile, during the 17th century, the influence of the Ottoman central government began to fade, so the contribution of local masters to Islamic buildings in Albania began to grow. At the end of the eighteenth and early nineteenth centuries, the mix of Ottoman elements with other innovative elements reached its peak due to the emergence of a special Albanian-Islamic style. Such a style constituted a synthesis of religious and secular elements - both Ottoman and the indigenous, and Western as well.

The combination of these seemingly homogeneous features actually reflects the history and nature of Albania as a crossroads between the East and the West. These recent works - as Machiel Kiel (2011) called them - are regarded as the product of the “golden age of Islamic culture in Albania”. In this case it is about the “golden age” in the sense of development in the field of architecture.

This paper aims to analyze how Islam was propagated into Albanian lands and how buildings, shrines, embody the Islamic elements in harmony with the local architecture and its elements. For this purpose, literature on Islam in Albania and on Islamic architecture has been studied. Thereafter, Et'hem Bey Mosque in Tirana was taken as a case study to reveal the facts of a relationship between the local and European Islamic architecture. Also, in this paper, a detailed description of the mosque in question is presented from the historical and architectural point of view. The paper also aims to promote the improvement of Islamic architecture in Albania and its importance in the development of Albanian architecture. At the same time, it is hoped to turn into a reference source for future research and studies in any field.

Key words: Mosque, Islamic architecture, Ottoman art, Muslim community, Islamiization.

8. Flag Day celebrations by Muslim Community in Albania in 1924

Nuridin Ahmeti, Kosovo

Abstract

From the browsing archive materials and the literature related to the celebration of Flag Day by the Muslim Community of Fier at that time, we can conclude that the community and its leaders, assisted by the state organs of the time, had a respectful approach to this day. Flag Day was not a common day like the other; rather, it was a source of a real mobilization by the Community members. This was a state-run holiday and for its celebration, the competent authorities sent the letter a few days before it, so that the community could begin its preparations for such an important day.

After receiving a letter from the state authorities, the headquarters of the Muslim Community in Tirana sent a message to the Muftis of all districts and after the end of the manifestation, muftiates sent a detailed report to the Community headquarters in Tirana. One of the reports is this one which we presented above, sent by the Muftiate of Fier district.

Although political circumstances were unfavorable to celebrate this holiday, the Muslim Community was mobilized with all its capacity to make this celebration as magnificent as possible. What is noticeable about this organization, is that people without religious differences, function and social status, went to church and to the mosque to celebrate the Flag Day. Perhaps, these forms of organization for certain national holidays must still be a model for our political and religious leaders.

Communication Sciences

9. Contribution of “Dituria Islame” magazine in the Islamic sermon - hutba as an example

Dr. Sedat Islami, Kosovo

Abstract

The magazine “Dituria Islame” has a special and historic significance in the field of Islamic preaching in Kosovo and beyond. This importance is best evidenced by its contribution, focusing - among other things - in the professional preparation of preachers - imams and the permanent assistance with religious subjects (sermons and hutba-s) provided to them. The historical background to this contribution is provided by its presentation at a time of inappropriate political circumstances in Kosovo and not only. In Albania, where religious journals had been firstly published, their publication was banned by the communist regime. While in Kosovo, despite the existence of communist ruling system, the freedom of the religious press somewhat existed, although the Albanian religious literature was delayed. Thus, the publication of “Dituria Islame” magazine, along with “Edukata Islame”, - a quarterly magazine - would greatly contribute in raising the Islamic religious awareness in general and to the formation of religious preachers in particular. This paper seeks to shed light on such a role of professional growth of imams and religious lecturers, with reference to sermons from the professional (as a preacher) and artistic aspect (as content and interpretation). My work is divided into two main parts: in the first part I have dealt with the materials for the theoretical frame for the sermon, while in the second part I discussed their practical aspect, respectively the content aspect and the technical and artistic arrangement of the sermons. At the end, I summarized the results of this paper and the recommendations drawn from it.

Key words: Islamic knowledge, Islamic preaching, Friday sermon, religious education, Albanian Imams.

Personalities

10. Hafiz Sabri Bey Bushati - an admirable and inspiring personality of Shkodra

Prof. dr. Sadije Bushati

“L. Gurakuqi” University

Faculty of Economics, Shkodër

Abstract

The rare moral qualities of this hafiz, his full religious and social devotion, his general culture and professional preparation, his patriotism and political integrity, his seriousness and responsible duties - such as the duty of imam, muderriz, vaiz and the dignified musti - without leaving aside his commitment to the role of such historical responsibility in the consolidation of the Albanian state, the preservation of the territorial integrity and the development of democracy, as a participant of the Lushnja Congress and as a Senate member, all these made his friendly ties extended even outside the circle of imams, thus creating an "ensemble" of goodwill, with respectable intellectuals as: Hamit Gjylbegaj, Hamdi Bushati, Riça Drini etc., or with representatives of old tradition families: Selim Reci, Oso Kopliku, Muho Kazazi, Junuz Boric, Nuto Podgorica, Elez Muka, Ymer Lutfia, Caf Reci, Elez Sokoli, Et'hem Koplik, Riça Kaduku.

Retrospective

11. The True Civilization and the Mastery Civilization

Abstract

The civilization is of two types: true civilization and mastery (technical) civilization. If we consider the mastery civilization, then we can say that Europe and America have reached the highest rank of such a civilization and the other nations live like the people of two or three centuries ago, but if we have a look at the eastern nations, we find they have a true civilization as good-willing and pure-heart people.

From the West we can take only the mastery civilization and keep the true civilization together with some kind habits which we have inherited from our ancestors. If we behave as orangutans and take from them dancing, cabarets, drinks and other morality problems and leaving aside our divine traditions, then we will overthrow our nation with our hands.

Rregullat e shkrimit

Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë, që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

1. Artikulli duhet të jetë punë studimore e kërkimore, shkencore origjinale.
2. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që trajton. Ai nuk duhet të jetë më i gjatë se 35 karaktere.
3. Të vihet emri i autorit me gradën shkencore përkatëse. Poshtë emrit të jepet pozicioni zyrtar i tij/saj.
4. Poshtë këtyre, në krye të shkrimit, me një paragraf të veçantë mund të jepet një abstrakt, duke radhitur të gjitha nënçështjet.
5. Artikulli duhet të jetë i strukturuar me disa nënçështje, sipas tematikës që shtron.
6. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, ku të jepen qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për ta shkruar atë dhe rëndësia e botimit të tij.
7. Të gjithë nëntitujt të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italik”, “Times New Roman 12” dhe të paraprihen nga numrat 1, 2, 3, etj.
8. Në fund të artikullit duhet të jetë një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerime a përfundime.
9. Artikull duhet të ketë në fund bibliografinë.
10. Artikulli duhet të ketë footnote-a dhe referenca në fund të faqes, për të treguar burimin e një citati a të një informacioni që jepet në tekst dhe duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë: autorin, titullin e veprës, shtëpinë botuese, vitin dhe vendin e botimit, numrin e faqes nga është marrë citati. Shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë duhet të jenë në thonjëza.
12. Kur informacioni merret nga interneti, duhet shënuar data; p.sh., 10 maj, 2008. Në fund të footnote-s vihet pikë dhe ajo rregullohet me «Justify».
13. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike.
14. Artikulli duhet të respektojë rregullat gramatikore të gjuhës shqipe standarde.
15. Shkrimi duhet të jetë “Times New Roman” me “Spacio 1”. Të mos mungojnë shkronjat “ç” dhe “ë”. I gjithë teksti të jetë “Justified”.